

**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I DREJTËSISË**

**I MITURI NË PROCESIN PENAL  
SI AUTOR I VEPRËS PENALE**

**PUNOI: Msc Dritan PEKA**  
**UDHËHEQËS: Prof.Dr.Vasilika Hysi**

**Tiranë , 2018**

Hyrje.....

**KREU I**

**Të miturit në konflikt me ligjin .....**

- 1.1. Kuptimi i termit “i mitur”. Vështrimi historik.
- 1.2. Trajtimi ligjor i të miturit në kohën e Zogut.
- 1.3. Trajtimi ligjor i të miturit në periudhën 1939-1945-1990.
- 1.4. Trajtimi ligjor i të miturit ne kodin penal të vitit 1995.
- 1.5. Kuadri ligjor ligjor për mbrojtjen e fëmijëve, 2017
- 1.6. Gjykatat për të miturit
- 1.6.1. Ekzistenca e gjykatave për të miturit, nevojë apo domosdoshmëri në Shqipëri

**KREU II**

**Të miturit në konflikt me ligjin.....**

- 2.1. Faktorët e riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve.....
- 2.2. Organet/personat kompetente të administrimit të drejtësisë për të mitur.....
  - 2.2.1. Strukturat për të miturin në polici
  - 2.2.2. Policia gjyqësore
  - 2.2.3. Prokuroria
  - 2.2.4. Asistenca ligjore dhe psikologjike
  - 2.2.5. Gjykata
  - 2.2.6. Avokatët
- 2.3. Procedimi i të miturve në çështjet penale.....
- 2.4. Dënimi me burgim si mjet i fundit ndaj të pandehurit të mitur, në përputhje me përjashtimin e procedurave gjyqësore.....
- 2.5. Ekzistenca e problemeve ligjore dhe praktike lidhur me dënimet ndaj të miturve .....
- 2.6. Dënimi, alternativat e dënimit.....
- 2.7. Ekzekutimi i dënimit.....



## **KREU III**

### **I mituri si autor i veprës penale në aspektin ndërkombëtar**

- 3.1. Konteksti ligjor ndërkombëtar në fushën e drejtësisë për të mitur dhe raporti i tij me të drejtën e brendshme.....
- 3.2. Strategjia e drejtësisë për të miturit (2015-2020).....
- 3.3. Parimet kryesore ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin.....

## **KREU IV**

### **Trajtimi i të miturve në fazat e procesit penal. Vështrim krahasues me sistem italian të drejtësisë për të mitur.....**

- 4.1. Parimet e drejtësisë penale për të miturit sipas ligjit të ri.....
  - 4.1.1. Elementë të gjykimit të të miturit në konflikt me ligjin.....
  - 4.1.2. Dëshmia e të miturve në procesin penal
  - 4.1.3. Të drejtat dhe garancitë procedurale të të miturit.....
    - \**Qëndrim reflektues*.....
  - 4.1.4. Të drejtat e të miturit në fazën e hetimeve paraprake
- 4.2. Llojet e dënimit.....
  - 4.2.1. Masat e drejtësisë restauruese.....
  - 4.2.2. Shmangia nga ndjekja penale dhe dënimi, përmes masave alternative.....
  - 4.2.3. Masa sigurimi të veçanta për të miturit.....
  - 4.2.4. Masat disiplinore.....
    - \**Qëndrim refletues*.....
- 4.3. Legjislacioni për drejtësinë për të mitur në kontekst krahasues me atë italian lidhur me të miturin në procesin penal.....

## **KREU V**

### **Vendime gjyqësore të formës së prerë**

- 5.1. E drejta e ankimit si e drejtë themelore e individit në çështjet penale të të miturve.....
- 5.1.1. Trajtimi i të miturit në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.....
- 5.1.2. Statistika.....
- 5.2. Të dhëna statistikore të institucionit të prokurorisë për të pandehurit e mitur në konflikt me ligjin, 2013-2015.....
- 5.3. Probleme të hasura në praktikë.....

## **KREU VI**

- 6.1. Përfundime dhe rekomandime.....

## **BIBLIOGRAFIA.....**

## *Hyrje*

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, për të cilat, sot, në kohët moderne flitet shumë, në fakt burojnë fillimisht nga të drejtat e fëmijëve. E them këtë, pasi një shoqëri bashkëkohore, e cila respekton të drejtat njerëzore të fëmijëve, ka repektuar të drejtat e njeriut. Për këtë arsye, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në vitin 1989, duke u bërë kështu, mjete dhe qëllimi kryesor i mbarë botës, për të siguruar mirëqenien e fëmijëve. Kjo konventë është ratifikuar nga 191 shtete të botës, ndërmjet tyre edhe vendi ynë, fakt që tregon se ajo është një nga dokumentet ligjore dhe politike më të pranuar nga shumë qeveri, si dhe duke dëshmuar që çështja e respektimit të të drejtave të fëmijëve, sot përbën një nga objektivat parësorë dhe thelbësorë për to. Pikërisht, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, si traktati i parë universal, që rregullon të drejtat e njohura botërisht për fëmijët, mban në konsideratë këto të drejta dhe nevoja thelbësore për fëmijët, nevoja që i ndihmojnë ata të gëzojnë një fëmijëri të lumtur.

Të gjitha këto të drejta dhe nevoja thelbësore ekzistojnë tek çdo fëmijë, pa dallim race, kulture, besimi fetar, gjinie, klase apo moshe. Në vijim, duhet të theksojmë, se të drejtat tek fëmijët janë në varësi të tyre, pasi çdo fëmijë është unik dhe ai ka nevoja të veçanta në përputhje me karakteristikat e moshës dhe të stadit të zhvillimit dhe këto nevoja ndryshojnë me rritjen e fëmijës.

Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në 28 shkurt të vitit 1992. Që prej atij viti e deri më tash, në funksion të zbatimit të konventës, e drejta e brendshme ka pësuar shumë ndryshime të rëndësishme, pasi doli në pah nevoja për plotësimin e kuadrit ligjor në fuqi, me ligje dhe politika të reja, në përmbushje të detyrimeve që vendi ynë ka marrë përsipër, nisur nga këto angazhime ndërkombëtare<sup>1</sup>. Por, krahas infrastrukturës së nevojshme ligjore, e rëndësishme për një shtet është edhe ndërtimi i infrastrukturës së duhur për zbatimin e këtyre politikave ligjore. Në këtë kontekst, vendi ynë është përpjekur dhe vazhdon të bëjë përpjekje, për këtë të dytën, gjithsesi mbetet shumë për të bërë.

Shoqëritë e sotme tregojnë një interes mjaft të madh ndaj të miturve, nisur nga fakti që është pikërisht, ky brez e ardhmja e shoqërisë. Për këtë arsye, shoqëritë moderne i kushtojnë kujdes

---

<sup>1</sup> Në vitet 1998-1999, Parlamenti miratoi tri ligje, ndër të cilët atë lidhur me të drejtat dhe detyrat e të burgosurve, si dhe përgjegjësia e qeverisë karshi tyre, për ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe ligjin për policinë e burgjeve

krijimit të kushteve për zhvillimin sa më të mirë të brezit të ri, duke u munduar të bëjnë çka është e mundur dhe në interesin më të lartë për fëmijën, për plotësimin e të drejtave dhe kërkesave, për të garantuar në të ardhmen një shoqëri me norma dhe respekt ndaj ligjit. Në këtë kuptim, shoqëria vihet përballë detyrimit për respektimin e të drejtave të fëmijëve, pasi plotësimi i këtyre të drejtave dhe kërkesave të tyre është i nevojshëm, jo vetëm për ekzistencë dhe mbrojtje, por gjithashtu, për pjesëmarrjen e tyre me një potencial të madh si anëtarë të shoqërisë (në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tyre), si dhe të rriten si qytetarë të përgjegjshëm e me norma.

Destabiliteti politik në rajonin e Ballkanit, pas rënies së regjimit komunist në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore, i ka detyruar këto institucione të ndërhyjnë aktivisht në politikat rajonale për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit.

Legjislacioni juridiko-penal i vendeve të rajonit, në lidhje me trajtimin e të miturve në procesin penal, aktualisht është në pajtim të plotë me politikën kriminale bashkohore që ndjekin shtetet anëtare të BE-së. Gjithsesi, nisur nga ritmet e shpejta të zhvillimit të shoqërisë së sotme dhe nga faktorë të ndryshëm ekonomik - socialë, shfaqen gjithnjë e më shumë veprime amorale apo kriminale. Pra, kriminaliteti në përgjithësi ka marrë një zhvillim dhe një rritje të ndjeshme, duke u bërë problem themelor i shoqërive moderne, duke cenuar cilësinë e jetes së njerëzve. Pjesë e këtij kriminaliteti është edhe kriminaliteti i të miturve, si një formë e veçantë e tij. Sipas statistikave, rezulton se kriminaliteti i të miturve në shoqëritë moderne ka ardhur duke u rritur, pra delinkuenca e të miturve<sup>2</sup> ka ardhur duke u zhvilluar dhe evoluar, sidomos në vendet me zhvillim më të lartë shoqëror-ekonomik. Ndaj, për shkak të shumë faktorëve që kanë të bëjnë me moshën, zhvillimin mendor, psikologjik e sociologjik të tyre, është një domosdoshmëri, që kriminaliteti i të miturve të trajtohet ndaras nga kriminaliteti i të rriturve. Ky trajtim i veçantë i të miturve bëhet me qëllim, që legjislacioni penal dhe ai procedural penal të luajnë një rol sa më efikas në parandalimin e kriminalitetit të të miturve.

Parandalimi i kriminalitetit tek të miturit është një pjesë thelbësore e parandalimit të krimit në shoqëri. Kjo arrihet, duke e përfshirë të miturin në veprimtari të ligjshme dhe në dobi të shoqërisë. Parandalimi i suksesshëm i kriminalitetit tek të rinjtë kërkon përpjekje prej të gjithë faktorëve e aktorëve të shoqërisë, në mënyrë që të garantohet një zhvillim harmonik i adoleshentëve, duke nxitur dhe respektuar zhvillimin e personalitetit të tyre, që nga fëmijëria e hershme. Në parandalimin e dukurisë së kriminalitetit tek të miturit, shtrohet nevoja e

---

<sup>2</sup> “E drejta penale për të mitur”, 2005, Ismet Salihu.

ndjekjes së një politike të përshkallëzuar, e cila konsiston në marrjen e përpunimin e disa masave<sup>3</sup>, të tilla si: krijimi i mundësive për arsimim, ofrimi i shërbimeve dhe programeve me bazë komunitare, mbrojtjen e mirëqenies, zhvillimin e të drejtave dhe interesave të të gjithë të rinjve, etj. Kjo politikë duhet të mënjanojë kriminalizimin dhe penalizimin e një të mituri, për sjellje që nuk shkaktojnë dëme të rënda për zhvillimin e të miturit ose dëmtojnë të tjerët.

Faktor me rëndësi në parandalimin e krimit tek të miturit, është zbulimi i faktorëve që ndikojnë në nxitjen e tij dhe mënjanimi apo pakësimi i tyre. Studime të shumta etiologjike kanë si objekt fenomenin e kriminalitetit të të miturit, me qëllim përcaktimin e faktorëve kriminologjik, që ndikojnë në formimin e elementëve kriminalë të të miturit. Një degë e veçantë e kriminologjisë është kriminalogjia e delinkuentëve të mitur, që studion natyrat e posaçme të krimit dhe sjelljes amorale të të rinjve<sup>4</sup>. Kështu, si shkaqe dhe faktorë që ndikojnë në socializimin apo kriminalizimin e të miturit janë zhvillimi social-ekonomik dhe intelektual i shoqërisë, mjetet e komunikimit masiv, mjedisi ku jeton i mituri, si familja, rrethi shoqëror, arsimi, diferencimi ekonomik e social i shoqërisë, etj. Pra, janë faktorë të shumtë që ndikojnë zhvillimin dhe rritjen e kriminalitetit të të miturit, që nuk varen nga trajtimi i tyre pas kryerjes së një veprë penale. Në këtë kuadër vlen të përmendet nocioni i delinkuencës minorile<sup>5</sup>, që sipas mendimit tim nuk shfaqet vetëm në momentin e kryerjes së një veprimi të parashikuar si krim në ligjin penal, por duhet parë më gjerë. Kështu, delinkuenca minorile shfaqet në shkeljen e rregullave të tjera shoqërore, si: veprimeve amorale, shkeljeve civile, sjelljeve asociale dhe, masat edukuese duhet të ndërmerren që në këtë moment, pa prituri kryerjen e veprave penale.

Pra, siç e parashtrua, faktorët që ndikojnë në nxitjen e kriminalitetit të miturit janë të ndryshëm dhe nuk kanë lidhje me trajtimin e veçantë dhe liberal të të miturve nga legjislacioni penal. Madje, ky trajtim ka sjellë ndikim pozitiv në uljen e kriminalitetit dhe pakësimin e recidivizmit. Ndaj, edhe legjislacioni ynë i jep gjithnjë e më shumë rëndësi trajtimit të veçantë të të miturve.

Në këtë kuadër, më lejoni të parashtroj *qëllimin e kësaj teme studimore*, që është kuadri i ri ligjor penal për të miturit në Shqipëri, shtjellimi i masave që duhet të ndërmerren në rastin e

---

<sup>3</sup> Direktivat e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Miturve – Direktivat e Riadit, 14 dhjetor 1990.

<sup>4</sup> E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Vllado Kambovski, fq.1082

<sup>5</sup> Po aty, fq.1083

procese penale të të miturve në konflikt me ligjin apo në rastet, kur ata janë viktima ose dëshmitarë në proces, institucionet shtetërore dhe mekanizmat e zbatimit të këtij legjislacioni, etj, do të vihet theksi në problemet që janë shfaqur në praktikën tonë të ndjekjes penale ndaj të miturit dhe të ekzekutimit të dënimeve ndaj tyre, si dhe do të jepen rekomandime për zgjidhjen e këtyre problemeve, me qëllim trajtimin sa më të përshtatshëm të të miturit, që është autor i veprave penale, por jo vetëm.

### **Metoda studimore**

Në këtë studim jam përpjekur të ndërthur literaturën, nga pikëpamja teorike, me atë të studimit praktik të disa prej çështjeve më “*pikante*”, në fushën e drejtësisë penale për të mitur, të trajtuara në punën time të përditshme, si prokuror. Gjithashtu, kam përdorur metodën analitike, krahasuese dhe atë të evidentimit të problemeve, nëpërmjet shprehjes së qëndrimeve reflektuese dhe, gjetjes së një rrugëzgjdhjeje të mundshme për to. Të dhënat statistikore të përdorura më kanë shërbyer për të ilustruar dispozitat e Kodit Penal, që prekin të miturit në konflikt me ligjin, viktima dhe/apo dëshmitarë, pavarësisht gjinisë (meshkuj apo femra).

## *Falenderim*

Një falenderim të veçantë do të dëshiroja t'ua adresoja të gjithë miqve, kolegëve e bashkëpunëtorëve të mi, për ndihmesën e dhënë në hartimin e këtij punimi.

Gjithashtu, një falenderim i veçantë i shkon udhëheqësit të temës, Prof.Dr.Vasilika Hysit, për kontributin e vyer dhe këshillat e dhëna, lidhur me konceptimin e kësaj mikroteze që në gjenezë dhe thellimin e studimit më tej në doktoratë.

## KREU I

### **Të miturit në konflikt me ligjin**

#### ***1.1. Kuptimi ligjor i termiit “i mitur”. Vështrim historik***

Shpeshherë, në jetën tonë të përditshme ne e dëgjojmë dhe e hasim termin “i mitur”, në aspektin letrar, gjuhësor, ligjor, psikologjik, etj. Nisur nga përkufizimet e mësipërme, sipas kontekstit në të cilin përdoret termi, për efekt të këtij punimi, termin “i mitur” ne do ta shohim në aspektin kriminologjik dhe në penalogji. Në aspektin gramatikor, i mitur konsiderohet personi që nuk ka arritur akoma moshën e pjekurisë, duke mos u bërë ende zot i vetes dhe i përgjegjshëm për veprimet e tij. Duke iu referuar nenit 1, të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, i mitur do të konsiderohet *cdo fëmijë që nuk ka mbushur moshën 18 vjec*. Ndërsa, referuar “Oxford – Dictionary of Law”, i mitur, *cilësohet personi, ndërmjet moshës 10 dhe 17 vjec, i cili ka kryer një krim dhe personi rreth moshës 14 deri në 17 vjec që kryen një krim, cilësohet si i ri*. Po kështu, edhe Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në dokumentat e saj, kriminelin e mitur e përkufizon si : “.....çdo fëmijë ose adoleshent, të cilit i ngarkohet kryerja e një vepre penale ose është deklaruar fajtor për kryerjen e saj...”<sup>6</sup>.

Në të gjitha disiplinat shkencore të së drejtës, haset dhe trajtohet gjerësisht termi i “i mitur”, si pjesëmarrës aktiv në marrëdhëniet e ndryshme juridike. Edhe në legjislacionin penal trajtohet termi “i mitur”, që lidhet pikërisht, me personat në moshë të re që kryejnë vepra penale. Në këtë fushë të së drejtës , termi “i mitur” është i lidhur me dukurinë e kriminalitetit, që do të thotë se fillimisht ne duhet të ndalemi e të kuptojmë atë. ***Me kriminalitet kuptohet tërësia e krimeve të kryera në një periudhë dhe hapësirë të caktuar***. Për të kaluar më pas, në kriminalitetin e të miturve, i cili vlerësohet nga këto degë të së drejtës, ***si kriminalitet i kryer nga individë, që nuk kanë arritur moshën madhore***.

Në disa prej vendeve, mosha për përgjegjësi penale, jo gjithmonë përputhet me moshën madhore, në kuptimin e të drejtave politike e civile (e drejta për të zgjedhur ose e njohur ndryshe si e drejta e votës, e drejta për të hyrë në një marrëdhënie të thjeshtë kontraktuale), cka bën që kuptimi i dukurisë së kriminalitetit të të miturve, të përafrohet më shumë me atë social-historik. Kjo do të thotë, që përkufizimi i termiit “*kriminel i mitur*”, lidhet me trajtimin

<sup>6</sup> Përmbledhje e akteve ndërkombëtare, botim i UNICEF.



ligjor që i bëhet vetë të miturit, trajtim që ndryshon nga njëri shtet në tjetrin dhe është i ndërvarur nga shumë faktorë psikologjikë e ligjorë, të lidhur ngushtësisht me faktorët socialë.

Ndërsa, duke ju referuar përkufizimit të Ragip Halilit, mund të themi, se *krimineli i mitur është ai individ, që nuk ka mbushur moshën madhore të parashikuar nga ligji penal dhe kryen një vepër të dënueshme nga ligji*<sup>7</sup>.

Kriminaliteti i të miturve nuk është një dukuri e re, e shfaqur në kohët moderne, por është një dukuri që ka ekzistuar hershëm dhe ka patur vecoritë e tij në periudha të ndryshme të zhvillimit historik. Duke hedhur një vështrim historik, lidhur me trajtimin ligjor të të miturit, do të vërejmë që daton hershëm, që me Kodifikimin e Justinianit, ku është vendosur një kufi ligjor, mes të miturit (*impuberes*), nga i rrituri (*puberes*), që është mosha katërmbëdhjetë vjeç<sup>8</sup>. Më pas, në kohën e errët të mesjetës, deri në shekullin XVI, dallimi në trajtimin e të miturit ka qenë i papërfillshëm, deri në gjysmën e dytë të shekullit të XVII, kur legjislativet filluan të modernizohen e të kodifikohen. Ky trajtim i veçantë ndaj të miturit ka ardhur duke u zgjeruar në vende të ndryshme në shekullin XVIII, duke marrë një zhvillim konkret në kohën e zhvillimit industrial. Në shekullin XX shënohen arritjet më të mëdha të drejtësisë për të miturit dhe të trajtimin e të miturit në përgjithësi, por, sidomos në dekadat e fundit, trajtimi i të miturve është një problem i rëndësishëm prioritar, duke theksuar në mënyrë të veçantë mbarë-rritjen dhe mirëqenien e të miturve kudo në botë.

## **1.2. Trajtimi ligjor i të miturit në kohën e Zogut**

Kontribut i vlerave të shtetit juridik është lufta, ndaj çdo forme të sjelljes kriminale, sigurimi i qetësisë dhe mirëqenies së përgjithshme në vend, ku spikat, humanizimi i metodave të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në mënyrë të veçantë qëndrimi, që Kodi Penal mban ndaj të miturve në procesin penal.

Sjelljet kriminale dhe pjesëmarrja e të miturve në krime, kanë bashkë-udhëtuar me shoqërinë njerëzore. Mënyrat e shfaqjes së krimeve i kanë rivalizuar gjithmonë format dhe metodat, që shoqëria, nëpërmjet strukturave të saj ka përdorur për parandalimin dhe luftimin e tyre. Ndëshkimi i të miturve nga ligji penal, gjatë historisë gati një shekullore të shtetit tonë,

<sup>7</sup> "Kriminalogjia", R. Halili, Prishtinë 2008, fq.22

<sup>8</sup> E drejta penale pjesa e përgjithshme, Vllado Kamboski, fq. 1085.

mendojmë se nuk është ndikuar nga zhvillimet historike, politike, ekonomike, nëpër të cilat ka kaluar shoqëria nga viti 1912-të, e deri në ditët e sotme.

Më 28 nëntor 1912, në prani dhe në emër të delegatëve që përfaqësonin popullin shqiptar, të ardhur nga të gjitha viset e vendit Ismail Qemali, e shpalli Shqipërinë, “...shtet të lirë, sovran, e të pamvarur dhe j’u kërkoi zyrtarisht Fuqive të Mëdha njohjen ndërkombëtare të saj.”<sup>9</sup>.

Pas aktit solemn të shpalljes së pavarësisë, sovraniteti i qeverisë nga pikëpamja territoriale ishte mjaft i kufizuar dhe, puna për ndërtimin e një kuadri ligjor të përshtatshëm u pengua edhe nga konfliktet civile. Në vitin 1914, administrata e shtetit erdhi në Durrës dhe i dorëzoi kurorën e fronit mbretëror Wilhem Won Widit<sup>10</sup>. KNK-ja, në bazë të kompetencave të saj, miratoi Kushtetutën e parë të vendit, të quajtur “Statuti Organik i Shqipërisë”<sup>11</sup>.

Deri në këtë periudhë kohe, as që mund të flitet për politikë penale, në drejtim të parandalimit dhe mbajtjes nën kontroll të kriminalitetit e, aq më pak, për rëndësinë e trajtimit të të miturve në procesin penal.

Megjithëse, u kryen një sërë reformash në legjislacion, në drejtimin penal ishte në fuqi Ligji Penal Osman,<sup>12</sup> “...derisa të kompletoheshin ligje të ndryshme që nevojiteshin sipas statutit të krijuar, do të mbetej në fuqi legjislacioni Ottoman në tërësinë e vet, duke respektuar me sa të ishte e mundur zakonet e vendit”<sup>13</sup>.

Ky kod mbeti në fuqi, deri në miratimin e Kodit Penal, në vitin 1928. Megjithatë, shtesat dhe ndryshimet që ju bënë këtij kodi, ndëshkimi i të miturve dhe caktimi i masave të dënimit, trajtohen në pjesën e katërt, “Rastet që ekskludojnë a jo gjegjëshniën dhe që shkaktojnë meritmin e penës”.<sup>14</sup> Sipas nenit 40, “.....ata që, në bërjen e sipër të fajit, nuk kanë mbushur moshën e trmbëdhjet vjetëve, quhen pa gjykim, dhe nuk janë të gjegjëshëm për fajin që bëjnë, por me vendim të gjykatës së delikteve, u dorzohen prindërve a kujdestarëve, pasi ju merret

<sup>9</sup> Historia e Shqipërisë II. Tiranë, 1984, po aty.

<sup>10</sup> Kastriot Dervishi. Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005. Tiranë, 2006 Fq 42.

<sup>11</sup> Arben Puto. “Çeshtja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare”. Tiranë, 1987. Fq 594.

<sup>12</sup> Kodi Penal i Perendorisë Osmane. Tiranë, 1924. Biblioteka Kombëtare, S 12/46 D.

<sup>13</sup> Botim i Komisionit të Krenimit të 25-vjetorit të Vetqeverimit. Shqipëria me 1931. Tiranë, 1931. Fq 85.

<sup>14</sup> Kodi Penal i Perendorisë Osmane. Tiranë, 1924. Fq 8-13.

*letërpremtim, ose dergohen në strehë urtësimore për t'u ndaluëm dhe stërvitum, për një kohëmoshtariën e tyre”.*<sup>15</sup>

Nëse, gjatë kësaj periudhe kohe, pa i mbushur pesëmbëdhjet vjet, “...vogëlushët kryejn ndonjë krim, ata që ishin ngarkuar më ruajtjen e tyre, gjobiteshin deri në 100 (njëqind) lira....”.

Nëse faji, ishte krim që passjell dënim me vdekje, burgim ose burgim të përjetshëm, të miturit burgoseshin për urtësim, pesë deri në dhjetë vjet. Për çdo krim tjetër, që passjell dënime të tjera, ndaj të miturve jepeshin dënime me burgim për urtësim, në masën e ¼ së dënimit, të paraparë për të rriturit.

Kur të miturit kanë mbushur moshën 15 vjet, por janë më të vegjël se 18 vjet, për rastin kur krimi passjellte dënim me vdekje ose burgim a burgim të përjetshëm, fëmijët dënoheshin me burgim për urtësim, 7 - 15 vjet. Për çdo formë tjetër krimi, i mituri dënohej me 1/3 e dënimit, të dhënë për të rritur. Kur masa e dënimit kryesor ishte gjobë, për të miturit, shqiptohej në ½ e masës së asaj, që aplikohesh për të rriturit.

I mituri, përjashtohesh nga përgjegjësia penale, kur provohej se, krimi ishte kryer nën sindromën e çmendërisë, si dhe kur, provohej mosdashja e të miturit në krim, për shkak të dhunës së ushtruar për kryerjen e tij, shtyrjen në krim nga respekti apo urdhëri nga prindërit, kujdestarët apo tutorët, nuk përbëntë dhunë. Gjithashtu, sipas nenit 42 (shtojca 22.05.1327) nuk quhen faj, veprat e bëra në mbrojtje të jetës apo të shëndetit, nga sulme të çfardoshme, si dhe veturdhërimi, për shkak të tronditjes psikike, për shkak të vjedhjes së at-çastëshme, që i bëhet vjedhjes apo dëmtimit të pasurisë së të miturit.

Në nenin 45 të këtij Kodi, parashikohen masat e ndëshkimit të të miturit, në rastin kur provohej, se ka bashkëvepruar me dy ose më shumë persona për kryerjen e krimit. Në këto rrethana, vepra konsiderohej rënduese dhe masa e ndëshkimit ishte më e madhe. Konkretisht, jo më pak se 10 vjet burgim, kur krimi passjell dënimin me vdekje ose burgim apo burgim të përjetshëm dhe, në raste të tjera, masa e dënimit ulej nga 1/6 deri në 1/3 e masës së dënimit, të dhënë për të rriturit.

---

<sup>15</sup> Kodi Penal i Perendorisë Osmane, neni 40.

Në nënin 46 të këtij kodi, parashikohet masa e dënimit për të miturit për krimet e mbetura në tentativë, kur kryersi provohej se ka poseduar mjete speciale për kryerjen e krimit, masa e dënimit parashikohet, jo më pak se shtatë vjet, për krime që pasjellin dënimin me vdekje ose burgim të përjetshëm, dhe për raste të tjera, masa e dënimit zbritet nga ½ në 2/3-tat, e saj.

Duke mos patur të dhëna statistikore të besueshme, nuk jemi në gjendje të bëjmë një analizë shkencore mbi numrin e krimeve të kryera nga të miturit, e për pasojë mungon një përfytyrim i saktë e i plotë për pjesëmarrjen e kësaj grupmoshe në krime, si dhe mënyrën e trajtimit të tyre, gjatë procedurës, para dhe pas dhënies së dënimit.

Republika e Zogut, me dekretin e 3 qershorit 1927, miratoi Kodin Penal Shqiptar dhe Ligjin “Mbi Aplikimin e Kodit Penal”. Të dy aktet e mësipërme hynë në fuqi më 1 Janar 1928.<sup>16</sup> Ky Kod, kishte pikësynime demokratiko - borgjeze dhe një frymë përparimtare. Hartuesit e tij ishin mbështetur në Kodin Penal Italian të vitit 1889, që njihet si një ndër kodet më të mira të Evropës.

Në Kodin Penal të Zogut, në nenet 54, 55 dhe 56, përcaktohet shprehimisht se, më lejoni të citoj:

#### ***Neni 54***

*“ Nuk bahen ndjekje kundra atij, i cili kur ka krye fajin, nuk ka mbushë moshën 10 vjeç. Por, po të jetë se faji i bamun sjell ndëshkimin me vdekje, me burgim të përjetshëm, me burgim të randë ose burgim jo më pak se 1 vit, gjyqi, mbi kërkimin e prokurorit, mund t’urdhmoj që fajtori i vogël të mbyllet në një institut-edukimi dhe përmirësimi, kur ekzistojnë të këtilla; kjo mbyllje vazhdon deri sa të mbushi moshën 20 vjeç dhe gjyqi kurdoherë ka të drejtë të revokojë këtë vendim të mbylljes, e t’urdhënojë që ai i vogël tu dorëzohet prindve ose atij të cilit ligja i ngarkon kujdesin.*

*Në rast se gjyqi urdhënon t’i dorëzohet prindëve ose kujdestarit, i porosity këta që të kujdesen për rruajtjen dhe edukimin dhe të vërejnë sjelljen e tij, se, në rast që këta nuk e vërejnë, kështu i vogli ban ndonjë delikt të c’do lloji, kanë me pague një gjobë të lehtë nga një qind deri në pesëqind franga ari, të cilën e cakton n’atë vendim.”.*

---

<sup>16</sup> “Gazeta Zyrtare Nr.1”, Tiranë, janar 1928, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë.

## **Neni 55**

*“.....Nuk bahen ndjekje kundër atij, i cili në kohën kur ka ba faji ka pasë mbushun moshën 10 vjeç, por jo 15 vjeç dhe nuk ka pasun një fuqi mendore cmuëse.*

*Por, në rast që faji i banum ndëshkohet mbas ligjës me vdekje, me burgim të përjetshëm, me burgim të randë ose me burgim jo më pak se 1 vit, aplikohen dispozitat e paragrafit II, të nenit të ma sipërm.*

*Në qoftë se, fajtori e ka pasun fuqinë cmuëse të nalt-përmendum, ndëshkimi i veprës së tij bahet simbas rregullave të poshtshemueme:*

- 1. Në vend të ndëshkimit me vdekje ose me burgim të përjetshëm caktohet burgim nga gjashtë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*
- 2. Ndëshkimet e tjera zbriten, si mbas rregulli, që tregon paragrafi IV e V, i nenit 48.*
- 3. Ndëshkimet me ndalim nga ofiqet publike dhe me vrejtim të Autoritetit të sigurimit publik, nuk aplikohen.*

*Këto ndëshkime vuhet në institute të caktueme për të vegjlit dhe nuk mund të merren si bazë për përsëritje.*

## **Neni 56**

*“....Ay, që kur ka ba fajin ka pasë mbushë moshën 15 vjeç e jo atë 18 vjeç, ndëshkohet si mbas rregullave të poshtëshënueme:*

- 1. Në vend të ndëshkimit me vdekje ose me burgim të përjetshëm, epet një ndëshkim nga 12 deri në 20 vjet burgim të randë.*
- 2. Kur faji sjell ndëshkim të përkohshëm që kalon të 12 vjetët, epet po asilloj ndëshkimi nga 6 deri në 12 vjet; në qoftë se kalon të 6 vjetët, por jo të 12-ët, epet asilloj ndëshkimi nga 3 deri në 6 vjet dhe në rastet e tjera ndëshkimi zbritet në gjysëm.*
- 3. Ndëshkimeve me gjobë u zbritet një e treta.*

*Në qoftë se në kohën e dënimit fajtori nuk ka mbushë 18 vjetët, gjyqi mund t’urdhmojë që ndëshkimi kundra lirisë personale të vuhet në një institut përmirësimi, dhe ndalimet nga ofiqet publike dhe të nënvmunit në vrejtim të posacme t’Autoritetit të sigurimit publik, nuk aplikohen.”.*

Siç shihet, në kohën e Zogut, moshë e përgjegjësive penale ishte e përcaktuar, sipas Kodit Penal të asaj periudhe, 10 vjeç dhe, llojet e dënimeve të aplikuara, ishin në varësi të rrezikshmërisë së veprës penale të kryer. Kështu, referuar nenit 54, të Kodit Penal të Zogut, në të cilin parashikohej se, në rast se krimi i kryer nga personi që nuk ka mbushur këtë moshë (fajtori i vogël), dhe konkretisht, kur për veprën e kryer, parashikohej dënimi me vdekje, me burgim të përjetshëm, me burgim të randë ose burgim jo më pak se 1 vit, i mituri mund të mbyllej në një institut riedukimi, deri në moshën 20 vjeçare.

Për këtë vendim, i dënuari gëzonte të drejtën e revokimit në cdo kohë, në rast se, vëreheshin shenja të përmirësimit dhe ai kthehej pranë prindërve ose kujdestarit të caktuar.

Këta persona ishin të ngarkuar, sipas ligjit me ruajtjen dhe vëzhgimin e të miturit, të nxjerrë nga këto institucione dhe në raste se, ai kryente sërish një vepër penale të çfarëdo lloji, i mituri dënohej me gjobë, e cila caktohej në vendimin e lirimimit nga instituti i riedukimit.

Në vijim, në nenin 55, të Kodit Penal të Zogut, parashikohej se nuk mbante përgjegjësi penale personi, që kishte mbushur moshën 10 vjeç, por jo 15 vjeç, dhe nuk kishte aftësi mendore për të vlerësuar rëndësinë e veprimeve të tij. Për këta persona, mund të aplikoheshin mbyllja në një institut riedukimi, me të drejtë revokimi, sikurse parashikohej në nenin 54, për të miturin nën 10 vjeç. Por, i mituri, nga 10 deri në 15 vjeç, për të cilin, gjykata vlerësonte, se zotëronte aftësinë mendore për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tij, mbante përgjegjësi penale. Dënimet e parashikuara në ligj për këta të mitur ishin të reduktuara dhe maksimumi i dënimit të parashikuar, ishte 15 vjet burg. Për të miturin nga 15 deri 18 vjeç, ky kod parashikonte përgjegjësinë penale, por dënime të reduktuara dhe maksimumi i dënimit që mund të aplikoheshin, ishte 20 vjet.

### **1.3. Trajtimi ligjor i të miturit gjatë periudhës 1939-1945-1990**

Pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore, Dhoma Fashiste Koorporative (dhe më pas Senati), në prani të delegacionit shqiptar miratoi ligjin, sipas të cilit, Mbreti i Italisë, pasi pranoi Kurorën e Shqipërisë mori titullin “Mbret i Italisë dhe Shqipërisë, Perendori i Etiopisë”<sup>17</sup>. U miratua statuti i ri i Mbretërisë Shqiptare, i cili kishte 54 nene, të ndara në 8 kapituj, sipas të cilit, mbetej në fuqi Kodit Penal i vitit 1928.

<sup>17</sup> “Historia e shtetit shqiptar, 1912-2005”, Kastriot Dervishi, Tiranë, 2006, fq.422.

Gjatë kësaj periudhe kohe, në Shqipëri filloi të konsolidohej ajo forcë politike që do të drejtonte shtetin për një periudhë mëse pesëdhjetë vjeçare. Rezoluta e Konferencës së Pezës e mbajtur me 16 shtator 1942, ishte akti i parë që qartësonte disa nocione të së drejtës penale dhe procedurale penale, me përmbajtje krejt tjetër politiko-shoqërore.

Me ligjin nr.61, datë 17.5.1945, “*Mbi abrogimin e legjislacionit të mëparshëm*”, në nenin 1, theksohej: “.....*Statutet, ligjet, dekret-ligjet, rregulloret dhe dekretet e programuara, gjatë kohës së okupacionit italian dhe gjerman abrogoheshin dhe deklaroheshin të pa qena....*” .. Në nenin 3, shprehimisht thuhej: “.....*ligjet, dekret-ligjit dhe rregulloret, që ishin në fuqi në Shqipëri, para 7 prill 1939, mbeten në fuqi edhe për kohën e ardhshme....*”<sup>18</sup>. Sipas interpretimit, që i bënte kësaj dispozite dekreti nr.392, datë 25.1.1947, thuhej se: “...*dispozitat e mësipërme vlejnë si rregulla juridike, por jo si dispozita në fuqi, kur nuk bien në kundërshtim me frymën e re demokratike dhe aktet ligjore të Pushtetit Popullor.....*”<sup>19</sup>. Këto dispozita mbetën në fuqi, deri më 13 maj 1948, kohë në të cilën, Kuvendi Popullor miratoi Kodin Penal të RPSH, që qëndroi në fuqi, derisa doli kodi penal pasardhës, i cili hyri në fuqi më 1 shtator 1952 dhe Kodit të Procedurës Penale, që hyri në fuqi, më 1 qershor 1953.

Me ligjin nr.5591, datë 15.6.1977, u miratua Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i cili hyri në fuqi, më 1 tetor 1977 dhe në ndryshim nga kodi i mëparshëm, ndahej në dy pjesë:

- pjesa e përgjithshme dhe,
- pjesa e posaçme.

Trajtimi i të miturve, sipas kodeve të mësipërme, gjatë kësaj periudhe kohe, ishte pothuajse i njëjtë.

Neni 7, i Kodit Penal të ish-Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, parashikonte, që përgjegjësia penale fillonte në moshën 14 vjeç, si për krime, ashtu edhe për kundravajtje penale. Neni 21 parashikonte që, i mituri, i cili nuk kishte mbushur moshën 18 vjeç, dënohej jo më shumë se me gjysmën e dënimit me heqje lirie, që parashikonte dispozita përkatëse për

---

<sup>18</sup> Fletoria zyrtare nr.5, Tiranë, 1945.

<sup>19</sup> Fletoria zyrtare nr.1, Tiranë, 1947.

veprën e kryer. Po aty, në nenin 34, përcaktohej shprehimisht e drejta e gjykatës, për të përjashtuar nga dënimi të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale, nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe për rastet të tilla, si: për shkaqe të arsyeshme personi nuk ishte në gjendje të kuptonte plotësisht se vepra e tij ishte shoqërisht e rrezikshme, kur kishte kryer një vepër penale me rrezikshmëri shoqërore të vogël dhe në kushtet e një tronditjeje psiqike, si dhe kur mendohej se nëpërmjet masave edukuese, do të arrihej përmirësimi i tij.

Për të miturit nga mosha 14 deri në 18 vjeç, neni 34 i këtij Kodi parashikonte përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale, në rastet, kur i mituri i kësaj moshe nuk e kuptonte që vepra e tij ishte shoqërisht e rrezikshme, kur kishte kryer një vepër penale me rëndësi të vogël ose, duke u ndodhur në gjendje tronditjeje psiqike ose, kur çmohej se masat edukuese arrinin qëllimin për përmirësimin e tij.

#### **1.4. Trajtimi ligjor i të miturit në kodin penal të vitit 1995**

Shndërrimet e reja politike, shoqërore, ekonomike, që ndodhën në Shqipëri pas përmbysjes së regjimit totalitar, krijuan kushtet për trajtimin e problemeve të së drejtës penale me objektivitet shkencor, larg politizimit të së kaluarës moniste, duke e ndarë kështu përfundimisht legjislacionin penal, nga legjislacioni penal i para viteve 1990.

Legjislacioni shqiptar, bazuar edhe në aktet e ndryshme ndërkombëtare, merr në mbrojtje dhe kujdes të veçantë të miturit. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, si dhe aktet e tjera ligjore, janë hartuar në pajtim me aktet dhe parimet ndërkombëtare. Shqipëria ka një legjislacion bashkëkohor për mbrojtjen e të miturve, që procedohen penalisht për kryerjen e një vepre penale. Kështu, edhe Kodi Penal i RSH-së, i vitit 1995, është përpjekur t'i kushtojë një vëmendje të veçantë trajtimit të të miturit.

Në Kod, duke vlerësuar që, personi në çastin e kryerjes së veprës penale, të ketë arritur një zhvillim të përgjithshëm për të kuptuar rëndësinë e veprës që po kryen, në nenin 12 të tij, ka përcaktuar si moshë për fillimin e përgjegjësisë penale për krimet, atë 14 vjeç, ndërsa për kundravajtjet penale 16 vjeç. Por, legjislatori i ka dhënë një hapësirë gjykatës, vlerësimin rast pas rasti, nëse i mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç, ka atë aftësi të nevojshme, për të kuptuar që veprimet e tij janë të kundraligjshme. Në rast se, i mituri nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, kryen një vepër penale, procedimi penal ndaj tij nuk mund të fillojë dhe në rast se ka filluar, duhet të pushojë.



Në nenin 51, të këtij kodi, është përcaktuar, që për të miturit që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer, pra, i mituri nuk mund të dënohet me më shumë se gjysmën e maksimumit dhe minimumit, që parashikon dispozita përkatëse për veprën penale të kryer.

Neni 52, parashikon përjashtimin e të miturit nga dënimi, në rastet kur vepra e kryer prej tij, nuk ka rrezikshmëri të lartë shoqërore, si dhe autori i veprës nuk paraqet rrezikshmëri. Pra, është lënë në çmim të gjykatës, që të vlerësojë dy kriteret për përjashtimin e të miturit nga dënimi, që janë:

- **rrezikshmëria e ulët e veprës penale**, pra duhet të kemi të bëjmë me një vepër penale jo të rëndë, jo shoqërisht të rrezikshme dhe, që nuk ka sjellë pasoja të konsiderueshme;
- gjithashtu, duhet të vlerësohet edhe **rrezikshmëria e autorit të veprës penale**, që në rastin konkret është i mituri, duke marrë në konsideratë sjelljen e tij të mëparshme në institucionet arsimore apo në ambjentin ku ai jeton, si dhe reflektimin e tij për veprën e kryer dhe për mospërsëritjen e saj. Në këto raste, gjykata mund të vendosi mbylljen e të miturit në një institucion riedukimi.

Lidhur me mënyrën e ekzekutimit të dënimit me burgim për të miturit, neni 33, i Kodit Penal, parashikon që i mituri duhet ta kryejë dënimin me burgim në institucione të veçanta, të ndarë nga të rriturit. Në të gjitha këto dispozita, shihen shumë qartë karakteri humanitar dhe riintegruer i Kodit Penal, përse i përket të miturit. Shfuqizimi i paragrafit të dytë të nenit 31, që kishte të bënte me moslejimin e ekzekutimit të dënimit me burgim të përjetshëm për të miturit, është një hap regresiv, përse i përket të drejtave të tyre.

Në Kodin Penal janë parashikuar masat edukuese për të miturit dhe mënyra e zbatimit të tyre, si dhe masat alternative të dënimit. Vlen të theksohen ndryshimet e fundit të këtij Kodi, të bëra nëpërmjet ligjit nr.10023, datë 27.11.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të RSH-së”. Këto ndryshime kanë parashikuar masa alternative, të cilat nuk janë përcaktuar vetëm për të pandehurin e mitur, por janë mjaft të përshtatshme për t’u aplikuar për ta. Këtu mund të përmendim nenin 58, që është “gjysëmliria”, neni 59 “Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë”, si dhe neni 59/a “qëndrimi në shtëpi”. Të tri këto dënime alternative parashikohen për persona me rrezikshmëri të ulët

shoqërore, që janë dënuar me masa dënimi të ulëta, pra janë mjaft të përshtatshme për të pandehurit e mitur. Një hap pozitiv shënon neni 60, ku janë parashikuar detyrimet e të dënuarit të vënë në provë, me qëllim që dënimi të ketë efekt edukues dhe socializues për të dënuarin e mitur, si dhe krijimi i shërbimit të provës, që do të ndjekë e mbikqyrë ekzekutimin e këtyre dënimeve.

Edhe në Kodin e Procedurës Penale, janë një sërë dispozitash që kanë të bëjnë me të drejta dhe liritë e të miturit, si autor i veprës penale. Kështu, neni 41, i këtij Kodi ka të bëjë me verifikimin e moshës së të pandehurit dhe ngarkon organin e procedurës, që në çdo fazë të procedimit, kur ka shkaqe për të besuar që i pandehuri është i mitur, të bëjë verifikimet e nevojshme, për përcaktimin e moshës. Verifikimi bëhet mbi bazë dokumentacioni ose në mungesë të tij, edhe me akt ekspertimi dhe në rast se, edhe pas këtyre verifikimeve mbeten dyshime, prezumohet se i pandehuri është i mitur. I pandehuri i mitur, sipas nenit 49, të Kodit të Procedurës Penale, asistohet detyrimisht nga avokati mbrojtës. Pra, asnjë veprim procedural nuk mund të kryhet me të pandehurin ose personin nën hetim të mitur, pa i caktuar një avokat mbrojtës. Gjithashtu, kjo dispozitë përcakton në mënyrë të shprehur edhe asistimin e të miturit nga një psikolog ose sociolog, gjatë seancave të marrjes në pyetje, në çdo fazë të procedimit, me qëllim që t'i krijojë kushte të favorshme të miturit, të shprehet lirshëm dhe të shpjegojë saktësisht për sa pyetet. Kjo ndihmë ligjore dhe asistencë psikologjike, i sigurohet të miturit *gratis*, në pamundësi ekonomike nga ana e tij, në çdo fazë të procedimit. Në bazë të nenit 42, të Kodit të Procedurës Penale, organi procedural është i detyruar të marrë të dhëna në lidhje me kushtet e jetesës, me familjen, shkollimin, ambjentin shoqëror, që të sqarojë përgjegjshmërinë e të miturit dhe të caktojë masa dënimi sa më të përshtatshme. Që në momentin e arrestimit në flagrancë apo ndalimin e të miturit që kryen një veprë penale, Kodi i Procedurës Penale përcakton detyrimin e njoftimit të prindit ose kujdestarit dhe në raste të veçanta, i jep të drejtë prokurorit, që i mituri të mos izolohehet në ambjentet e paraburgimit.

Procedura penale që në momentin e arrestimit apo të ndalimit i jep të miturit një trajtim të posaçëm, që ka të bëjë me mbajtjen e tij në ambiente të posaçme, njoftimin e menjëhershëm të prindërve apo kujdestarit. Gjithashtu, edhe në caktimin e masave të sigurimit për të miturit, Kodi i Procedurës Penale, parashikon mbrojtjen sa më të gjerë të të drejtave dhe lirive të tyre. Kështu, i mituri nuk mund të arrestohet asnjëherë për kryerjen e një kundravajtjeje penale dhe për izolimin e të miturit, gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë procesin edukativ - mësimor.

Gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, me dekret të Presidentit të Republikës<sup>20</sup>. Paralelisht janë krijuar dhe seksionet e veçanta për të miturit, në prokuroritë e gjashtë rretheve gjyqësorë, ku janë vendosur seksionet për të mitur të gjykatave, me qëllim përgatitjen e prokurorëve dhe personelit ndihmës të tyre në trajtimin e veçantë dhe të specializuar të të miturve.

### **1.5. Kuadri ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**<sup>21</sup>

Vendi ynë ka ratifikuar konventat dhe protokollet kryesore të OKB-së dhe Këshillit të Evropës. Gjithashtu, ka miratuar së fundmi edhe Protokollin e 3-të opsional të KDF, për procedurën e komunikimit, si dhe Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje<sup>22</sup>. Përveç miratimit të këtyre instrumentave ndërkombëtarë ligjorë, janë miratuar edhe ligjet dhe akte të tjera nënligjore në këtë fushë. Ligji nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”<sup>23</sup> ka parashikuar ngritjen e mekanizmave të rëndësishëm institucionalë në nivel qendror dhe vendor, për të garantuar realizimin me efektivitet të këtyre të drejtave, mbrojtjen e tyre, si dhe ofrimin e përkujdesjes së posaçme për fëmijët.

Që prej ratifikimit të KDF-së e deri më tash, në funksion të zbatimit të saj, e drejta e brendshme ka pësuar shumë ndryshime të rëndësishme, për plotësimin e kuadrit ligjor në fuqi, me ligje dhe politika të reja, në përmbushje të detyrimeve që vendi ynë ka marrë

---

<sup>20</sup> Dekreti nr.5351, datë 11 qershor 2007, i Presidentit, për krijimin e seksioneve të veçanta për të miturit në 6 gjykata të rretheve.

<sup>21</sup> Peka N. “Promoting and protecting children rights - one of the key factor for sustainable development of Albania”, paper presented in International Scientific Conference, London, 2017, published with proceedings.

<sup>22</sup> Ligji nr.86/2013, “Për ratifikimin e Protokollit të 3 opsional të KDF-së, “Për procedurën e komunikimit”. Miratimi i këtij protokollit shpreh angazhimin e shtetit shqiptar për të bashkëpunuar në procedurat e komunikimit dhe hetimit me të gjitha vendet e tjera, palë në këtë protokoll, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe lirive themelore në nivel kombëtar. Gjithashtu, vendi ynë në përmjet këtij miratimi u krijon kësaj kategorie-fëmijëve të qenit subjekt i të drejtave të plota dhe u jep mundësinë që ata të kërkojnë zgjidhje në nivel ndërkombëtar, nëse këto të drejta u shkelen dhe ata nuk gjejnë zgjidhje në sistemin ligjor të brendshëm. Edhe ratifikimi i ligjit nr.104/2012, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, synoi përmirësimin e legjislacionit në përputhje me kërkesat e Konventës. Vlen të përmendet nisma e ndërmarrë nga institucionet e zbatimit të Konventës, për përfshirjen në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, të dhunës në familje, si vepër penale dhe rritjen e dënimeve penale, për veprat që kanë të bëjnë me dhunën në familje, duke përfshirë edhe dhunën ndaj fëmijëve, lidhur me humbjen e përgjegjësisë prindërore, periudhës së sigurisë, përndjekja, si dhe dënimi për keqtrajtimin fizik ose psikologjik të të miturit nga prindërit, vëllai, motra, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të.

<sup>23</sup> Ligji nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, miratuar nga Parlamenti më 23 shkurt 2017, FZ nr.43, fq.2815.

përsipër, nisur nga këto angazhime ndërkombëtare<sup>24</sup>. Një hap konkret në këtë drejtim është miratimi për herë të parë i një Kodi të Drejtësisë Penale për të Mitur<sup>25</sup>.

Por, krahas infrastrukturës së nevojshme ligjore, e rëndësishme për një shtet është edhe **ndërtimi i infrastrukturës së duhur institucionale për zbatimin e këtyre politikave ligjore**. Në këtë kontekst, vendi ynë është përpjekur dhe vazhdon të bëjë përpjekje, për këtë të dytën, gjithsesi mbetet shumë për të bërë.

### **1.6. Gjykatat për të miturit**

Sistemi i drejtësisë për të mitur është i ndryshëm nga sistemi i drejtësisë penale.

Fillimisht, le të ndalemi pak në kuptimin e termit “gjykata për të miturit”.

Çdo shtet ka gjykata speciale, të quajtura zakonisht gjykatat për të mitur, për t'u marrë me të mitur, të cilët kanë qenë të akuzuar për kryerjen e një veprë penale. Kështu, në vend të akuzohen zyrtarisht për një krim, të miturit akuzohen për kryerjen e veprës, me vonesë.

Një procedim penal për të mitur fillon, kur prokurori i çështjes apo oficeri i policisë gjyqësore parashtron kërkesën, duke e akuzuar të miturin për kryerjen e një veprë penale dhe duke i kërkuar gjykatës ta shpallë atë fajtor. Në qoftë se, akuzat provohen dhe krimi është kryer, i mituri, autor i veprës penale, paraqitet përpara gjykatës (me kompetenca të gjera). Në këtë pikë, gjykata për të miturit ka autoritetin të bëjë atë, çka konsiderohet në interes të të miturit delikuent.

Shpesh, gjykata për të miturit ruan autoritetin ligjor mbi të miturin për një periudhë të caktuar kohe, derisa i mituri bëhet një i rritur, apo ndonjëherë edhe më gjatë.

---

<sup>24</sup> Gjatë gjithë këtyre viteve kuadri ligjor dhe institucional, lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ka ardhur duke u përmirësuar, me miratimin e disa akteve ndërkombëtare dhe instrumentave të tjerë ligjorë shumë të rëndësishëm, si psh: ratifikimi i protokolleve opsionalë në zbatim të KDF të OKB-së, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e fëmijës nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”, ratifikuar me ligjin nr.10071/2009, Konventën e Evropës “Për marrëdhëniet me fëmijët”, ratifikuar me ligjin nr.9359/2005, etj. Në Konventën “Për të Drejtat e Fëmijës”, katër janë parimet bazë: mosdiskriminimi (neni 2, i konventës), interesi më i lartë i fëmijës (neni 3), e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit (neni 6), e drejta e pjesëmarrjes (neni 12).

<sup>25</sup> Ligji nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”, miratuar më 30.3.2017

### ➤ *Historia e gjykatave për të mitur*

Gjykata për të mitur dhe filozofia e saj në trajtimin e minorenëve, të cilët shkelin dhe dhunojnë ligjin penal, ndryshe nga të rriturit, është shumë e vjetër. Historikisht, të miturit delikuentë janë trajtuar njësoj si të rriturit kriminelë.

Dënimi (ndëshkimi) në ligjin zakonor anglez ishte baza e filozofisë në të drejtën penale. Një supozim bindës se fëmijët nën 7 vjeç nuk do të mund të formojnë qëllim kriminal, është eliminuar nga një qëndrim më i ri të sistemit të drejtësisë penale.

Fëmijët ndërmjet moshës 7 dhe 14 vjeç janë supozuar të paaftë për të formuar qëllimin e nevojshëm penal<sup>26</sup>. Fëmijët mbi moshën 14 vjeç konsiderohet të kenë kapacitet për të formuar qëllim kriminal. Kohë më parë, nuk ka pasur gjykata të veçanta për fëmijët dhe, ata janë trajtuar si kriminelë të rritur. Të miturit janë arrestuar, janë mbajtur në paraburgim dhe janë dënuar nga një gjykatë, që kishte diskrecion për të urdhëruar burgosjen e të miturit në të njëjtin burg si kriminelët e rritur. Edhe pse fëmijët morën të njëjtin dënim si të rriturit, ata nuk ishin të pajisur me mbrojtje si për procese të akorduara për kriminelë të rritur<sup>27</sup>.

### ➤ **Pranueshmëria për gjykatën e të miturve**

Për t'u kualifikuar për gjykatën për të mitur, një i ri duhet të jetë një "*i mitur*" në bazë të ligjit. Në shumicën e vendeve, mosha maksimale për të qenë i gjykuar nga një gjykatë për të mitur është 18<sup>28</sup>. Në disa vende të tjera kjo moshë është 16 apo 17, dhe shumë rrallë mund të ndeshim moshën maksimale të caktuar në 19 vjeç. Gjithashtu, ka shtete, të cilët caktojnë afate moshe më të ulëta për të mitur, në mënyrë që ata të kualifikohen për t'u gjykuar nga gjykata për të miturit. Disa prej shteteve i konsiderojnë fëmijët 14 vjeç e lart, si të aftë për të formuar qëllim kriminal, kështu që shumica e rasteve që përfshijnë të rinjtë 14-18 vjeç gjykohen nga gjykata për të mitur. Në rrethana të caktuara, një i mitur mund të gjykohet në gjykatën penale për të rritur.

Shumica e shteteve e konsiderojnë fëmijët nën moshën 7 vjeç, të jenë të paaftë për të përcaktuar dallimin në mes të drejtës dhe të gabuarës, apo formimin e një "*mendje fajtor*". Zakonisht, është gjykata ajo, që mund ta cilësojë një fëmijë mes moshës 7 dhe 14 vjeç, si

---

<sup>26</sup> Megjithëse, sot, në praktikën gjyqësore, shpesh thuhet se prokurori, mund të hedhë poshtë këtë prezumim, duke dëshmuar se fëmija di të bëjë qartazi dallimin në mes të drejtës dhe të gabuarës.

<sup>27</sup> P.sh, të miturit nuk kanë të drejtën "e kushtit", të akuzës nga juri e madhe [dhe] të drejtën për një gjykim publik.

<sup>28</sup> Shih shtjellimin që është bërë për këtë çështje në Kreun I.

“*mendje fajto*re”. Nëse gjykatësi mendon se fëmija ishte në gjendje të formojë qëllim kriminal, fëmija do të dërgohet në gjykatë për të mitur. Pra, fëmijët nën moshën shtatë vjeç janë të shkarkuar zakonisht nga përgjegjësia për veprimet që ata kryejnë. Në vend të kësaj, prindërit duhet të paguajnë kompensim për të gjithë ata që janë viktimizuar nga aktet e një fëmijë në moshë shumë të re. Në disa prej këtyre rasteve, gjykata e shpall një prind të papërshtatshëm për t'u kujdesur për një fëmijë që ka kryer vepra të këqija dhe, e vendos fëmijën nën kujdestari të të afërmeve apo të një kujdestari ligjor.

### ➤ Raste të zgjidhura në gjykatën e të miturve

Jo të gjitha rastet e dëgjua në gjykatën për të mitur janë raste të delikuençës (ato që përfshijnë kryerjen e një krimi). Në disa vende, nga praktika penale<sup>29</sup> në këto gjykata, ka edhe dy lloje të tjera të rasteve:

- rastet në ngarkim të të miturve dhe,

---

<sup>29</sup> Legjislacioni amerikan i drejtësisë penale për të mitur, “Federal Juvenile Delinquency Code”, USA. Gjykata e parë për të mitur në USA u krijua në Illinois më 1899 dhe, siguroi një dallim ligjor, midis braktisjes së të miturve dhe krimit. Ligji që themeloi gjykatën, Ligji i Gjykatës për të Mitur të Illinois i vitit 1899, u krijua kryesisht për shkak të avokimit të grave të tilla si Jane Addams, Louise DeKoven Bowen, Lucy Flower dhe Julia Lathrop, të cilët ishin anëtarë të klubit me influencë të Çikagos. Gjykata e Çikagos u hap më 1 korrik 1899 me kryesimin e gjykatësit Tuthill, së bashku me disa anëtarë të Klubit të Gruas të Çikagos që vepruan si këshilltarë për prejardhjen e shkelësit të mitur. Krijimi i një gjykate për të mitur ndihmoi në përsëritjen e interpretimeve kulturore dhe ligjore të "interesave më të mirë të fëmijës". "Supozimi themelor i sistemit fillestar të të miturve dhe ai që vazhdon të mbizotërojë, ishte se të miturit ishin përgjithësisht më të përshtatshëm për rehabilitim sesa kriminelët e rritur. Ky aplikim i ri i “*parens patrea*” dhe zhvillimi i një gjykate të veçantë për të mitur hodhën themelet për krijimin e sistemin modern të drejtësisë për të mitur.

Sot, në këto vitet e fundit, legjislacioni për reformën e drejtësisë për të mitur në Shtetet e Bashkuara është përmirësuar shumë. Politikatat penale të drejtësisë për të mitur kanë njohur zhvillime pozitive, krahasuar me ato të 20 viteve më parë. Pas një rritjeje dramatike të krimit serioz të të miturve në fund të viteve 1980 dhe fillim të viteve 1990, legjislaturat në pothuajse çdo shtet, miratuan ligje për të mbajtur më shumë të dënuar të rinj të përgjegjshëm, përmes alternativave të dënimit për të rritur. Megjithatë, deri në vitin 2015, secili shtet vazhdon të rishqyrtojë politikatat e tij dhe të rivendosë qasjet ndaj drejtësisë për të mitur, për të prodhuar përgjigje më efektive ndaj krimit të të rinjve dhe për të përmirësuar sistemet e përgjithshme të drejtësisë. Sot, reforma e drejtësisë për të miturit është bërë një çështje kryesisht dypartiake, pasi ligjvënësit punojnë së bashku për të zhvilluar politika të reja, për të lidhur përgjegjësinë e shëndoshë fiskale, sigurinë e komunitetit me rezultate më të mira për të rinjtë. Reformat e reja legjislative pasqyrojnë një interes në qasjet zhvillimore të përshtatshme për metodat më të bazuara në prova dhe alternativat me kosto efektive për burgosjen e të miturve. Gjithashtu, ekzistojnë shumë studime, që vënë në dispozicion të ligjvënësve dhe fushës së zhvillimit të adoleshentëve - të rejtat më të fundit shkencore, shoqërore dhe të sjelljes, që i dallojnë të miturit nga shkelësit e rritur. Tendencat e fundit në legjislacionin për drejtësinë e të miturve në USA, paraqesin një drejtim të ri të rëndësishëm për reformimin gjerësisht të sistemit të drejtësisë për këtë kategori. Trendet më specifike janë shfaqur në drejtim të:

- rivendosjes së juridiksionit në gjykatën për të mitur;
- devijimi i të rinjve nga sistemi;
- reformimi i seksioneve të parburgimit;
- ndryshimi i masës së “dënimit me burg” në alternativa të bazuara në komunitet;
- sigurimi i mbrojtjes së fortë publike për të rinjtë;
- adresimi i pabarazive raciale dhe etnike në sistemet e drejtësisë;
- përgjigje më efektive ndaj nevojave të shëndetit mendor të shkelësve të rinj;
- përmirësimi i programeve të ri-integrimit dhe kujdesit për të rinjtë.

- kundërvajtjet penale.

Në këtë mënyrë, procedurat që zbatohen për të tri llojet e rasteve gjyqësore me të mitur, janë të ndryshme.

***i) Rastet e delikuencës së të miturve***

Këto raste përfshijnë të miturit që kanë kryer krime, që do të thotë se në qoftë se krimi ishte kryer nga një i rritur, çështja do të gjykohej nga gjykatë e rregullt penale. Por, procedurat në një gjykatë për të mitur, ndryshojnë thelbësisht nga ato të një gjykatë penale për të rriturit.

***ii) Rastet në ngarkim të të miturve***

Rastet që përfshijnë të miturit, të cilët janë abuzuar apo neglizhuar nga prindërit ose kujdestarët e tyre, të quajtur "rastet në ngarkim të të miturit", janë dëgjuar edhe në gjykatën për të mitur. Në një rast në ngarkim për të mitur, gjyqtari është ai që do të vendosë, nëse një i mitur duhet të hiqet nga një mjedis problematik në shtëpi.

***iii) Rastet që përfshijnë kundërvajtjet penale***

Një kundërvajtje penale është një shkelje që vlen vetëm për të miturit. Shembujt të tillë përfshijnë: mungesat pa arsye në shkollë, shkeljet e shtetrrrethimit, duke ikur, dhe të mitur që konsumojnë alkool.

***iv) Shkeljet e përbashkëta dhe "trendet" në rastet e të miturve***

Afërsisht, gjysma e të gjitha arrestimeve me të mitur janë bërë për disa kategori të caktuara të veprave penale siç janë: vjedhje, sulm i thjeshtë, abuzim me drogën, sjellje të çrregullt, dhe shkeljet e orës policore, etj<sup>30</sup>. Historikisht, shumica e rasteve gjyqësore me të mitur kanë

---

<sup>30</sup> Kjo i referohet sistemit amerikan të drejtësisë për të mitur. Kështu, sipas Zyrës Federale të Drejtësisë për të Miturit dhe Parandalimin e delikuencës, në një vit mesatar, vetëm rreth 3% të rasteve janë dërguar në gjykatë për të mitur të cilët rezultojnë të përfshirë në kundërvajtjeve të dhunshme si grabitje, përdhunim, vrasje, dhe sulmet e provokuara.

përfshirë shkelësit meshkuj. Por, numri i vajzave që hyjnë në sistemin e drejtësisë për të miturit ka qenë në rritje<sup>31</sup>.

**v) Procedurat në një rast gjyqësor për të mitur**

Kur një i mitur është i dyshuar për shkelje të një ligji penal, procedurat janë shumë të ndryshme nga ato të përdorura në gjykatën penale të të rriturve. Më e rëndësishmja, policia, prokurorët dhe gjyqtarët e gjykatave për të mitur, të gjithë kanë diskrecion të gjerë për të marrë hapa më joformale në trajtimin e rastit. Si rrjedhojë, shumë të rinj, të akuzuar asnjehërë nuk mbërrijnë në një seancë formale dëgjimi. Gjithashtu, të drejtat kushtetuese të të miturve janë të ndryshme nga ato të të rriturve, të cilët kanë qenë të akuzuar për kryerjen e një krimi<sup>32</sup>.

Disa raste për të miturit janë transferuar në gjykatën e të rriturve në një procedurë të quajtur një "dokument i heqjes dorë". Zakonisht, rastet e veprave penale për të mitur, që janë subjekt i heqjes dorë, të përfshijnë vepra të rënda, si përdhunim apo vrasje, ose të mitur, të cilët kanë qenë në vështirësi përpara. Të miturit kanë të drejtë për një seancë dëgjimore, për të vendosur nëse rasti i tyre duhet të transferohet në gjykatën e të rriturve.

**➤ Mundësitë e zgjedhjes së dënimeve për delikuentët e mitur**

Gjykatat e të miturve kanë një gamë të gjerë të mundësive për zgjedhjen e dënimit (zakonisht të quajtura "urdhurat e disponimit"), në qoftë se ata gjejnë se një i miturit është fajtor. Gjykatat mund të kufizojnë të miturin në mënyra të ndryshme: nga dërgimi i të miturit në një institucion tradicional të paraburgimit për të mitur, në vendosjen e të miturit në arrest shtëpie. Ajo çka është më e rëndësishmja, gjykatat për të miturit mund të urdhërojnë një gamë të tërë të dënimeve që nuk përfshijnë izolimin, duke përfshirë këshillimin, orën policore, dhe kushtin.

Kur një i mitur është i dyshuar për shkelje të një ligji penal, procedura që është ndjekur është shumë e ndryshme nga ajo e përdorur për të rriturit në një rast tipik penal. Të gjitha shtetet

---

<sup>31</sup> Po kështu, në vitet e fundit - në një vit mesatar, vajzat përbënin 27% të të gjithë të miturve, me të cilat përballen procedimet në gjykatat për të mitur në SHBA-ës.

<sup>32</sup> Për shembull, edhe pse të mitur kanë të drejtë për një avokat në një seancë gjyqësore dëgjimi, në shumicën e shteteve që nuk e kanë të drejtën që rasti i tyre të dëgjohet nga një juri.



kanë krijuar një sistem të veçantë gjyqësor për të mitur që kanë problem e janë në konflikt me ligjin. Edhe pse, disa të mitur janë gjykuar dhe, në fund të procesit janë deklaruar fajtorë nga këto gjykata për të mitur, aktorë të ndryshëm në një rast tipik për të mitur, duke përfshirë oficerë të policisë gjyqësore, prokurorë dhe gjykatës, kanë një diskrecion të gjerë në arritjen e rezultateve.

Edhe pse procedura për raste të delikuencës së të miturve ndryshon nga shteti në shtet, në vijim më lejoni t'a ilustruj me një "case study- rast studimor" për të mitur.

**\*Rast studimor ilustrues** : Si arrin policia në një marrëveshje me të miturin

Ka disa mënyra, që një i mitur mund të vijë në kontakt me zbatimin e ligjit, mbi shkeljen e pretenduar të një ligji penal. Disa të mitur janë arrestuar nga policia, ndërsa të tjerët janë të referuar në polici nga prindërit ose autoritetet e shkollës. Pavarësisht se si mund të trajtohet nga policia një rast i mundshëm për të mitur, një oficer i policisë mund të vendosë për t'u marrë me të miturit në disa mënyra:

*a) të lëshojë një paralajmërim*

Punonjësi i policisë mund të ndalojë të miturin, të lëshojë një paralajmërim dhe pastaj t'a lërë të miturin të shkojë. Kjo është përmendur shpesh si "*këshilluar dhe liruar*"- masë alternative.

*b) të mbajë të miturin derisa në mbërritjen e njërit prind*

Ndonjëherë, mund të ndodhë që oficeri i policisë do të ndalojë të miturin, mund të nxjerrë një paralajmërim për të dhe më pas, t'a lirojë të miturin nën mbikëqyrjen e një prindi ose kujdestari ligjor.

*c) të referojë në një gjykatë për të mitur*

Punonjësi i policisë mund të vendosë të miturin në paraburgim dhe çështjen e tij e referon në gjykatën për të mitur.

#### ➤ **Rastet që shkojnë në gjykatën e të miturve**

Kur oficeri i policisë referon një rast në gjykatën për të mitur, prokurori ose gjykata për të mitur cakton shpesh një oficer të shërbimit të provës, për të marrë për sipër rastin. Ky person mund të vendosë:

- ❖ pushimin e gjykimit;
- ❖ të trajtojë këtë çështje në mënyrë joformale apo,
- ❖ të paraqesë akuza formale (të quajtura "ka paraqitur kërkesën e rastit")<sup>33</sup>.

Për të vendosur se si të procedojnë, prokurori ose oficeri i shërbimit të provës duhet të marrin parasysh:

- rrezikshmërinë e veprës;
- mosha e minorenit;
- e kaluara e të miturit;
- provat e forta (evidente) për rastin;
- gjinia e të miturit (djemtë janë më të shumtë të shfaqur si autorë të veprës penale sesa vajzat);
- historia sociale e të miturit dhe aftësia e prindërve të të miturit për të kontrolluar sjelljen e tij ose të saj.

#### ***a) Procedurat joformale***

Nëse prokurori ose oficeri i shërbimit të provës vendos të vazhdojë me rastin e të miturit në mënyrë joformale, zakonisht, i mituri duhet të paraqitet para një oficeri të shërbimit të provës apo gjyqtarit. Në këtë rast të miturit, do t'i kërkohet të bëjë një ose më shumë si vijon:

- të dëgjojë një leksion të rreptë;
- të vijojë këshillimin;
- të marrë pjesë në klasat ku jepen mësimet pas shkollore;
- të paguajë viktimën për dëmet (dëmshpërblimi);
- të paguajë një gjobë;
- të kryejë punën në dobi të komunitetit ose,
- të hyjë në shërbimin e provës.

---

<sup>33</sup> Në një vit, në USA, psh mesatarisht, 20 % e rasteve të referuara në një gjykatë për të mitur nga oficeri i shërbimit të provës janë refuzuar dhe, rreth 25 % po ashtu, janë trajtuar jo zyrtarisht. Pjesa tjetër e rasteve të mbetura i është nënshtruar procedurës gjyqësore normale.

Nëse konstatohet abuzim me të miturin ose neglizhencë, si dhe kur, dyshohet se këto janë si pjesë e çështjes, gjyqtari i gjykatës për të mitur mund të iniciojë procedurën për heqjen e të miturit nga kujdesi prindëror ose kujdestari ligjor.

***b) Procedura formale: kërkesa e rastit***

Nëse prokurori ose oficeri i shërbimit të provës vendos të vazhdojë formalisht, ai/ajo do të paraqesë kërkesë në gjykatën për të mitur. I mituri është atëherë "i dënuar" (akuzuar formalisht) përpara një gjyqtari për të mitur të gjykatës ose gjyqtarit, në ato raste, kur gjykata mund të vendosë të dërgojë të miturin në gjykatën penale për të rritur. Gjykata do të përcaktojë nëse i mituri duhet të ndalohet ose të lirohet për periudhën kohore para seancës fillestare<sup>34</sup>.

Nëse çështja e të miturit mbetet në gjykatën për të mitur, mund të ndodhë që:

***a) I mituri hyn në një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë***

Shpesh, një marrëveshje mbi pranimin e fajësisë varet nga pajtueshmëria e të miturit me kushte të caktuara. Për shembull, si pjesë e një ujdje, i mituri mund të kenë nevojë që të marrë pjesë në këshillim, të ndalohet të qarkullojë ose të rimbursojë viktimën për dëmet.

***b) Gjyqtari "devijon" rastin***

Kur një gjyqtar i devijon një rasti, ai mban juridiksion mbi rastin, ndërkohë që i mituri i nënshtrohet një programi të rekomanduar (siç është këshillimi) ose kryen ndonjë veprim (si psh në shërbim të komunitetit apo pagesën e kthimit). Nëse i mituri nuk i përmbush këto detyrime, gjykata mund të rivendosë akuza formale.

***c) Gjyqtari mban një seancë dëgjimore***

Nëse rasti shkon në gjyq (i quajtur një "seancë gjyqësore dëgjimi" në një rast për të mitur), të dyja palët paraqesin provat dhe dëshmitë dhe avokatët argumentojnë rastin (si në një gjyq penal). Në shumicën e shteteve, dëgjimi është para një gjyqtari dhe jo para jurisë. Në përfundim të seancës, gjyqtari do të përcaktojë nëse i mituri është delikuent. Nëse është bërë

---

<sup>34</sup> Në rreth 80% të rasteve të përpunuara zyrtarisht në një gjykatë për të mitur, gjyqtari e lejon të miturin të qëndrojë në shtëpi, ndërkohë që është në pritje të dëgjimit.

një vendim kriminaliteti, oficeri i shërbimit të provës do të vlerësojë të miturin, do të urdhërojë ekzaminimin psikologjik ose testet diagnostikuese nëse është e nevojshme dhe, pastaj do të bëjë rekomandime në seancën e disponimit (e cila është e ngjashme me një proces të dënimit në gjykatën penale). Gjyqtari më pas, vendos se çfarë është në interesin më të mirë të të miturit, dhe mund të urdhërojë një prej këtyre gjërave si pjesë të disponimit, duke përfshirë:

- Këshillim;
- burgosje në një paraburgim për të mitur;
- rimbursimin e viktimës ose,
- shërbimin e provës.

Gjyqtari mund të urdhërojë të miturin të paraqitet në gjykatë periodikisht (të quajtura seanca pas disponimit), në mënyrë që të mund të monitorojë sjelljen e të miturit dhe progresin e tij.

- ***Gjykata për të miturit në Francë – funksionimi i saj***

Gjykata për të Miturit kryesohet nga gjyqtari i gjykatës për të miturit, i cili ndihmohet nga dy këshilltarë<sup>35</sup> dhe një nëpunës gjyqësor. Prokuroria përfaqësohet nga një prokuror nga zyra e prokurorisë, i cili është i specializuar në çështjet e të miturve. Gjykata mblidhet në përfundim të një procedure hetimore<sup>36</sup> apo në rastet e një *daljeje urgjente* në gjyq dhe ka kompetencë gjykimin e krimeve të lehta të kategorisë pesë<sup>37</sup>, disa krime të dënueshme<sup>38</sup> dhe krime të rënda<sup>39</sup> të kryera nga persona nën moshën 16 vjeç në momentin e ngjarjes.

- ***Gjykata e Azisit (me juri), për të miturit***

---

<sup>35</sup> Gjyqtarë të thjeshtë, të cilët gjykojnë së bashku me gjykatësin e Gjykatës për të Miturit. Në parim, këshilltarët janë të profesioneve të ndryshme (punonjës social, doktorë, tregtarë, punonjës banke, mësues, etj), të cilët megjithëse, nuk kanë arsimimin e duhur ligjor, janë të gjithë të interesuar për problemet e të rinjve. Ata rekrutohen nga të gjitha shtresat shoqërore, pasi kanë aplikuar për vendin e tyre në Gjykatën e të Miturve. Prejardhja e tyre nga profesione të ndryshme shoqërore është e rëndësishme. Para se të marrin në dorëzim këtë detyrë, këshilltarët kryesorë dhe zëvendësit e tyre, betohen përpara gjykatës së rrethit dhe më pas, emërohen në detyrë për një periudhë kohe 4 vjeçare, me të drejtë riemërimi. Në territorin francez ka rreth 1600 këshilltarë, për të gjitha Gjykatat e të Miturve (duke përfshirë edhe territore dhe departamente jashtë vendit).

<sup>36</sup> Pas një urdhri për transferim tek gjyqtari i Gjykatës për të Mitur, për shkak të një gjyqtari hetues, të autorizuar posaçërisht për një çështje të ndërlikuar.

<sup>37</sup> Dëmtime të lehta trupore, që e bëjnë viktimën të paaftë, për më pak se 8 ditë, drejtim motoçiklete pa masa mbrojtëse, si psh: kokore, drejtim automjeti pa leje, etj.

<sup>38</sup> Dëmtime trupore të rënda, vjedhje, tentativë, ndihmë apo nxitje në vjedhje, marrja e mallrave të vjedhura, dëmtim kriminal, kanosje, grabitje, sulm seksual, përveç përdhunimit.

<sup>39</sup> Përdhunim, vrasje, tentativë për vrasje apo ndihmë dhe nxitje për një vrasje, trafikim, prodhim apo përpunim droge, grabitje me armë, etj.

Krimet e rënda të kryera nga të rinjtë e moshës nga 16 deri në 18 vjeç, në momentin e ngjarjes, gjykohen nga Gjykata e Azisit për të miturit. Kjo gjykatë përbëhet nga tre gjyqtarë profesionistë<sup>40</sup> **dhe një juri**. Akuza paraqitet nga një gjyqtar relator për çështjet e të miturve. Seanca mbahet me dyer të mbyllura.

Gjykatat e të miturve punojnë me:

- Prokurorin e shtetit ose zëvendës prokurorin e shtetit, përgjegjës për çështjet e rinisë. Ata merren me mbrojtjen e të miturve, si dhe me dënimin e veprave penale të kryera nga të miturit. Ata kërkojnë në Gjykatën e të Miturve apo në Gjykatën e Asizit të të Miturve, mbrojtjen e interesave të shoqërisë dhe në fund të gjykimit kërkojnë ekzekutimin e dënimit të dhënë. Gjithashtu, përfaqësojnë Prokurorinë tek autoritetet vendore (konte, bashki, njësi të sigurisë vendore, etj);
- Shërbimet gjyqësore për mbrojtjen e të miturve. Këto struktura i rekomandojnë gjykatësve të Gjykatës për të Miturit, masa edukuese për të miturit, të cilët janë subjekt i vendimeve penale apo civile. Avokatët janë automatikisht të pranishëm në çështjet penale, p.sh. në rastet kur dyshohet që një i mitur ka kryer një vepër penale. Disa avokatë specializohen për mbrojtjen e të miturve.

• ***Vendimet e gjykatës për shërbimet gjyqësore, lidhur me mbrojtjen e të miturve***

Në rastin e drejtësisë penale për të mitur në Francë, ndeshim 3 veprimtari hetimore:

- mbledhja e informacionit social-ekonomik<sup>41</sup>;
- raporti i gjendjes shoqërore<sup>42</sup>;
- hetimi për drejtimin edukues<sup>43</sup>.

Këto hetime, kërkohet të kryhen si në në çështjet civile, ashtu edhe në ato penale. Detajet e këtyre informacioneve i japin mundësi gjyqtarit të kuptojë më mirë karakterin, të shkuarën dhe mjedisin e të miturit që gjykohet. Gjyqtari i Gjykatës së të Miturve mund të japë urdhër për sistemim ligjor nëse është e nevojshme për shkak të kohëzgjatjes së hetimeve.

<sup>40</sup> Kryetari i trupit gjykues ose një gjyqtar i Gjykatës së Apelit dhe 2 këshilltarë, të cilët zakonisht, përzgjidhen ndër gjyqtarët e Gjykatës për të Mitur.

<sup>41</sup> Nenet 8-1, 8-2 dhe 12, të urdhrit të datës 2.2.1945, mbi të miturit, autorë të veprave penale.

<sup>42</sup> Nenet 8, 9, 10 dhe 14-2, të urdhrit të sipërpërmendur, neni 150, i K.Pr.P, nenet 1183 e 1185, të po këtij kodi (i ri)

<sup>43</sup> Nenet 8 e 9, të urdhrit të mësipërm, si dhe nenet 150 e 1183, të K.Pr.P

*Vendime edukuese* gjithsej janë gjashtë. Veprimtari edukuese në një mjedis të hapur (VEMH), është një vendim mbikëqyrës<sup>44</sup>. Kurdoherë që është e mundur, gjyqtari e mban të miturin në mjedisin e tij të zakonshëm ku jeton dhe aty përmbushet vendimi. Nga ana tjetër, mbrojtja administrative, e cila është kontraktuale dhe kërkon marrvëshje nga të dyja palët, veprimtaria edukuese në mjedis të hapur është urdhër i detyrueshëm. Ky është urdhëri më i zakonshëm mbikëqyrës dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 2 vjet. Në praktikë, pas vlerësimit, departamenti i shërbimeve në mjedis të hapur në Shërbimet Gjyqësore për Mbrojtjen e të Miturve fillon një program edukimi, i cili ka si qëllim krijimin e një raporti personal me të riun, nëpërmjet veprimtarive të ndryshme kulturore, sportive, shëndetësore, përmes mbështetjes dhe ndihmës akademike.

- *Parashtrimi i procedurës së mbikëqyrjes edukuese – mbrojtja për të miturin në rrezik*

Në procedurën ligjore franceze parashikohet, që materialet e policisë i dërgohen prokurorisë, e cila mund të mos ndërmarrë një veprim të mëtijshëm, por mund t'ia kalojë gjykatës nëpërmjet një hetimi të menjëhershëm. Në çastin e dërgimit të dosjes në gjykatë, i pranishëm është përgjegjësi direkt për të miturin, prindi ose kujdestari. Në seancën e parë nuk është e thënë të jetë detyrimisht përfaqësuesi ligjor – avokati i të miturit. Gjithashtu, në seancën e parë mund të rekomandohen masa të përkohshme edukative dhe hetimore, të tilla si: mbikëqyrje e arsimimit, kthim te prindërit, raport mbi gjendjen sociale, shqyrtim i orientimit edukativ dhe sistemim në një institucion edukues. Ndërsa, përsa i takon shpalljes së vendimit, një ndër to mund të jetë masa e mbikëqyrjes arsimore në një mjedis të hapur (në të njëjtën kohë edhe mbikëqyrje familjare) ose sistemimi në një institucion rehabilitimi. Por, mund të jetë edhe një vendim i natyrës së ndryshme nga sa më sipër, që do të thotë se nuk ka arsye për mbikëqyrje arsimore.

Roli i shërbimeve sociale për të mitur është i rëndësishëm, pasi ky institucion ndihmon në parandalimin e fenomenit, ndihmon familjet në vështirësi, merr masa mbrojtëse me miratimin edhe të prindërve të të miturit.

*Mbrojtja për të rinjtë nga gjykata*<sup>45</sup>, garanton vazhdimësinë e veprimtarive edukuese dhe

---

<sup>44</sup> Shiko më poshtë: roli mbojtës i gjyqtarit të Gjykatës për të Miturit.

<sup>45</sup> Dekreti nr.75-96, i datës 18.2.1975, i cili përcakton kushtet dhe afatet për zbatimin e mbrojtjes së të rinjve nga gjykata.

parandalon rrezikun e ndërprerjes së integritetit të të riut, pasi ai bëhet madhor. Sipas këtij urdhri duhet që i mituri t'i paraqesë vetë një kërkesë gjyqararë të Gjykatës për të Miturit, i cili më pas, shqyrton kërkesën në bazë të rëndësisë dhe natyrës së problemeve të të miturit. Nëse, gjyqtari e pranon kërkesën, mund të zbatohet një ose disa nga urdhërat e mëposhtëm:

- vëzhgimi nga një departament i mjediseve të hapura;
- veprimtari edukuese në një mjedis të hapur;
- qëndrimi apo pranimi në një rezidencë.

Në të gjitha këto raste, kërkohet pëlqimi i të riut. Mbrojtja nga gjykata mund të pezullohet në çdo kohë nga gjyqtari i Gjykatës për të Miturit ose me kërkesë të përfituesit. Kjo mbrojtje, përfundon në moshën 21 vjeçare.

***Urdhrat për lirinë nën vëzhgim***, janë urdhra penalë edukues<sup>46</sup>, të cilët ose jepen përkohësisht gjatë fazës së hetimeve ose jepen nga gjykata, e cila jep dënimin, për të miturin që ka kryer një krim të dënueshëm. Ato përbëhen prej dy komponentësh:

- mbikqyrës;
- edukues.

Nëse, urdhri për lirinë nën vëzhgim është i përkohshëm, fillon veprimin e edukimit, që nga ngjarja për të cilën hetohet i mituri dhe në këtë rast, në dhënien e dënimit, gjyqtari mban parasysh karakterin e të miturit. Nëse jepet si urdhër i përhershëm, atëherë ky urdhër lejon, që veprimtaria të fillojë që prej veprimit, për të cilin është dënuar i riu, në atë çka shkaktoi veprimin, që përbën në fakt, edhe bazën e urdhrin dhe veprimin edukues, duke e mbajtur të miturin në mjedisin e vet familjar.

***Urdhrat për mbrojtjen nga gjykata***<sup>47</sup>, jepen nga gjyqtari si një masë kryesore. Ato nuk mund të zgjasin për më tepër se 5 vjet dhe për këtë arsye mund të vazhdojnë edhe pasi, i mituri të ketë mbushur 18 vjeç. Në këto raste, merren 2 masa:

- *sistemimi*;
- *mbrojtja në një mjedis të hapur*.

<sup>46</sup> Nenet 8, 8-1, 10, 11, 19, 20-7, 20-10, 21 dhe nenet nga 25 deri te 28, të urdhrin të datës 2.2.1945.

<sup>47</sup> Ligji nr.75-624, i datës 11.7.1975, për krijimin e mbrojtjes gjyqësore, nenet 8, 16/a, 28 dhe 31, të urdhrin të datës 2.2.1945, dekreti nr.76-1073, datë 22.11.1976, për kriminalitetin e të miturve.



Këto masa, mund të ndërthuren me anë të një urdhri, i cili nuk mund të vazhdojë, pasi i mituri të ketë arritur moshën madhore.

***Kompensimi penal***<sup>48</sup> është një urdhër edukues, që merret ndaj të miturve që kryejnë shkelje penale, me anë të të cilit, propozohet që i mituri të ndihmojë apo kompensojë viktimën apo të kryejë veprimtari në dobi të shoqërisë. Në rastin e fundit, kompensimi mund të jetë një kontribut, që sistemi penal gjyqësor i bën policisë bashkiake. Në rast të një kompensimi të drejtëpërdrejtë, kërkohet miratimi i viktimës, i cili mund të merret nga gjyqtari, vetë personi apo departamenti i caktuar. Ky urdhër është afatshkurtër, relativisht 3-4 muaj.

- ***Roli ndëshkues***

Nëse i mituri dyshohet të ketë kryer një krim<sup>49</sup>, gjyqtari ndërhyr për të hetuar dhe për të gjykuar çështjen, pasi çështja t'i jetë ngarkuar nga prokuroria. Gjyqtari kryen çfarëdolloj hetimi të nevojshëm rreth fakteve dhe karakterit të të miturit. Gjyqtari mbështetet nga Shërbimet Gjyqësore për Mbrojtjen e të Miturve<sup>50</sup>. Gjatë kësaj faze<sup>51</sup>, gjyqtari i Gjykatës për të Miturit, mund të lëshojë urdhëra të ndryshëm në varësi të moshës, natyrës së kriminit dhe dënimit të dhënë. Gjykata për të Miturit ka kompetencë për të vendosur dënime mbi të miturit që prej janarit të vitit 2005<sup>52</sup>.

### **Roli i gjyqtarit të Gjykatës për të Mitur**

Gjyqtari i Gjykatës për të Miturit, është personi kryesor në sistemin gjyqësor për të miturit në gjykatën e rrethit dhe ka rol mbrojtës dhe ndëshkues.

- ***Funksioni mbrojtës***

---

<sup>48</sup> Nga gjykatësi i Gjykatës për të Mitur, nga kjo gjykatë, nga gjykata Penale për të Mitur, në varësi të çështjes dhe është i hapur për apelim.

<sup>49</sup> Vepra penale të lehta, krime të dënueshme, krime të rënda.

<sup>50</sup> Shërbim edukues i përhershëm në gjykatë, për të informuar të miturit dhe familjet e tyre, të kryejë hetime, shërbime në ambiente të hapura dhe strehim pas gjykimit.

<sup>51</sup> Kompensim, liri me kusht, mbikqyrje nga ana e gjykatës, sistemim në mjediset e gjykatës për mbrojtjen e të miturve dhe mjediset e paraburgimit.

<sup>52</sup> Neni 20-9, i urdhrit të datës 2 shkurt 1945, i ndryshuar me aktin nr.2004-204, datë 9 mars 2004, i cili përshtat sistemimin e drejtësisë penale me ndryshimet në kriminalitet.



Gjyqtari i Gjykatës për të Miturit<sup>53</sup> (GjGjM) ka rol mbikëqyrës për arsimimin, atëherë kur një i mitur gjendet në rrezik fizik apo moral, për shembull në rastet, kur i është mohuar përkujdesja dhe/ose shkollimi i nevojshëm për të siguruar shëndetin, sigurinë dhe moralin e një të mituri. Çështja i kalon gjyqtarit të Gjykatës për të Miturit nga Zyra e Prokurorisë<sup>54</sup> dhe gjyqtari kryen hetimet e nevojshme. Gjyqtari i Gjykatës për të Miturit mund të sigurojë mbrojtje edhe për të rinjtë e moshës nga 18 deri në 21 vjeç, të cilët të ndodhur përballë problemeve të integritimit në shoqëri kërkojnë një urdhër për mbikëqyrje të edukimit të tyre, që të vazhdojë edhe pasi ata arrijnë moshën e pjekurisë<sup>55</sup>. Mbikëqyrja edukative mund të përfshijë vëzhgimin e të miturit dhe të familjes së tij në një mjedis të hapur<sup>56</sup> ose në vendin ku është sistemuar i mituri<sup>57</sup>.

### **1.6.1. Ekzistenca e gjykatave për të miturit nevojë apo domosdoshmëri në Shqipëri**

Krijimi i gjykatave për të miturit ekziston në shumë prej vendeve të zhvilluara perëndimore. Në parashtrimin e bërë më lart, për sa i përket ekzistencën së gjykatave të posaçme për të miturit, konkretisht sipas modelit amerikan dhe atij francez, bie në sy se ***Gjykata për të Miturit*** është institucion më vete, me gjyqtarë të trajnuar dhe specializuar për problemet e të miturve. Gjithashtu, ***në sistemin francez spikat edhe pjesëmarrja e prokurorit dhe e avokatit të specializuar për kriminalitetin e të miturve***. Të gjitha institucionet janë të fokusuar në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të miturit dhe jo me funksion parësor, për ndëshkimin e të miturit për veprën e kryer.

***Të dy legjislacionet i japin kompetencë gjyqtarit*** në caktimin e dënimeve për të miturit, për t'i dhënë hapësira e mundësi atij, në caktimin e masave edukuese dhe alternative, në mënyrë që të kufizohet sa më shumë aplikimi i dënimit me burgim. Në të dy legjislacionet, ***është***

---

<sup>53</sup> Vendosur me aktin e datës 22 korrik 1912, i cili parashikoi parimet bazë të sistemit gjyqësor francez për të miturit, megjithëse organizimi përfundimtar u vendos me urdhrin e datës 2 shkurt 1945 dhe atë të datës 23 dhjetor 1958.

<sup>54</sup> Kjo në përputhje me raportet e hartuara nga një individ privat apo nga departamenti i shërbimeve sociale për të miturin, në këshillin e kontesë. Në këtë rast, neni L-226-3, i Kodit të Familjes dhe Shërbimeve Sociale, kërkon që kryetari i këshillit të kontesë, të lajmërojë menjëherë Gjykatën për të Mitur, nëse një i mitur keqtrajtohet apo mendohet të jetë keqtrajtuar dhe është e pamundur të vlerësohet situata apo familja nuk është dakord me ndërhyrjen e departamentit të shërbimeve sociale për të miturit.

<sup>55</sup> Dekreti nr.75-96, i cili përcakton kushtet, në të cilat vepron gjykata për mbrojtjen e të rinjve.

<sup>56</sup> Vëzhgim nga një mësues i departamentit të gjykatës për mbrojtjen e të miturve apo nga departamenti i shërbimeve sociale për të miturit në kufijtë e jetës normale të familjes: ndjekja e shëndetit të tyre, pjesëmarrja në një qendër shëndeti apo qendër edukuese, etj. (më poshtë listohen masat dhe detyrat përkatëse, kompetencë e departamentit të gjykatës për mbrojtjen e të miturve).

<sup>57</sup> Sistemimi në strukturën e një departamenti të gjykatës për mbrojtjen e të miturve apo në një departament të mbrojtjes sociale për të miturit, varet nga mosha e të miturit dhe nga e shkuara e tij, sistemimi me një person të besuar, etj. (më poshtë listohen masat dhe detyrat përkatëse, kompetencë e departamentit të gjykatës për mbrojtjen e të miturve).

*parashikuar instituti i kujdestarisë*, i cili do të mbikqyrë realizimin e dënimeve alternative nga i mituri, do të vëzhgojë ndikimin që ka patur dënimi në sjelljen dhe shoqërimin e të miturit, si dhe për t'i ardhur në ndihmë familjeve me probleme në edukimin dhe shkollimin e fëmijëve. *Të dy legjislacionet dhe institucionet zbatuese janë ndërtuar në frymën e lehtësimit dhe favorizimit të të miturit*. Në të dy legjislacionet janë parashikuar zgjidhje mjaft të mira, që mund të adoptohen nga legjislacioni penal shqiptar.

Edhe pse tashmë kemi hyrë një fazë të re të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, ende në Shqipëri, çështjet penale me të miturit në konflikt me ligjin, gjykohen nga seksionet për të mitur, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë<sup>58</sup>.

Miratimi i një kuadri të ri ligjor për këtë çështje, ka përcaktuar se kur një i mitur ka kryer veprë penale së bashku me një të rritur, ai gjykohet në seksionet për të mitur të gjykatave të rretheve gjyqësore, duke zbatuar dispozitat e këtij KDPM, me përjashtim të rasteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale<sup>59</sup>. Të gjithë ata gjyqtarë, që caktohen për gjykimin e çështjeve penale me të mitur, duhet të jenë të trajnuar dhe specializuar në mënyrë të dedikuar në fushën e drejtësisë penale për të mitur<sup>60</sup>.

Për këtë, gjykimi i të miturve duhet të bëhet nga gjyqtarë të specializuar për drejtësinë për të miturit dhe me njohuri të gjera mbi çështjet penale për të miturit. Me dekretin e Presidentit të Republikës nr.5351, datë 11.6.2007, në gjykatat e gjashtë rretheve gjyqësore u krijuan seksionet e veçanta për të miturit. Këto seksione janë krijuar në gjykatat e gjashtë rretheve kryesore, që janë: Tirana, Durrësi, Gjirokastra, Korça, Shkodra e Vlora dhe mbulojnë veprat penale, të kryera nga të miturit, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjyqtarët, që janë përzgjedhur në këto seksione, i janë nënshtruar trajnimit në fushën e drejtësisë për të miturit dhe emërimi i tyre nuk kalon në rotacion. Ky trajnim i gjyqtarëve është i domosdoshëm, për të kuptuar arsytet që e shtynë të miturin në kryerjen e veprës, për të vlerësuar efektin që ka patur krimi në temperamentin e tij, si dhe për të caktuar llojin e masës së përshtatshme të dënimit, për veprën e kryer.

Mungesa e gjykatave për të miturit në sistemin tonë gjyqësor është shoqëruar me probleme, duke bërë që sistemi i drejtësisë penale për të miturit të ketë paqartësi dhe pasaktësi në

<sup>58</sup> Neni 27, "Kompetenca e gjykimit të çështjeve të drejtësisë për të mitur", i ligjit nr.37/2017.

<sup>59</sup> Konkretisht në nenin 80, pika 1, të KPP

<sup>60</sup> Neni 27, i ligjit nr.37/2017.

thelbin e tij. Kritikata në drejtim të administrimit të drejtësisë për të miturit prej gjyqësorit janë të lidhura me të meta, mangësi apo paqartësi të kuadrit ligjor dhe institucional. *Ligji material dhe ai procedural në këtë drejtim paraqet mangësi, profesionalizmi i gjyqësorit nuk është i arrirë, pasi ky sistem aktualisht, i bazuar në seksione, nuk trajton me seriozitetin dhe etikën e duhur një rast që ka të bëjë me drejtësinë për të miturit apo rasti nuk menaxhohet në mënyrën e duhur*, etj<sup>61</sup>.

Ende, legjislacioni penal për të miturit ka nevojë për përmirësime, për të bërë të mundur një trajtim sa më të posaçëm të të miturit, si autor të veprës penale.

### **\*Qëndrim reflektues**

#### ***Koncepti i “devijimit”***

Në shkencat shoqërore hasim një numër të madh përkufizimesh rreth konceptit të “devijimit”. Pothuajse në të gjitha ato, vërehet se ky koncept i atribuohet pamjaftueshmërisë së sjelljes së individëve ose grupeve shoqërore, kuadrit rregullator formal dhe joformal të kontekstit socio-kulturor të përkatësisë dhe shkeljet e kryera në këtë drejtim çojnë në aplikimin e sanksioneve përkatëse ndaj individëve shkelës<sup>62</sup>.

Sot, koncepti i devijimit ka evoluar dhe është zhvilluar më tej dhe, ekzistojnë dallime, ndërmjet një fenomeni me natyrë kriminale nga një devijimi shoqëror, duke e parë këtë të fundit si një fenomen dhe formë të divesitetit kulturor. Gjithashtu, devijimi është zgjedhje e individit (psh: vjedhja), e cila është e imponuar nga rrethana specifike (si disa sjellje të pazakonta, për shkak të patologjive specifike psikologjike). Pra, koncepti i devijimit qëndron në një lidhje të veçantë me konceptin e veprave penale. Në kontekstin e përgjithshëm të devijimit, i cili zbatohet për të miturit ka një aspekt të veçantë, i cili ka një zbatim më vete.

Ndërsa, është e vërtetë se morali i fëmijëve është shpesh një paralajmërim i deviancës së rriturve, është po aq e vërtetë dhe e zakonshme, që ky lloj devijimi manifestohet me tipare të tilla të veçanta, që e bëjnë devijimin një fenomen tërësisht origjinal dhe ndryshe nga dallimet

---

<sup>61</sup> Në raportin progresin e Komisionit Evropian për vitin 2005/561, një nga çështjet e nënvizuara në atë kohë ishte progresi i bërë nga Shqipëria në zhvillimin e mjeteve legjislative për drejtësinë penale dhe për të miturit si dhe në lidhje me trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë fushë. Sidoqoftë, në vijim, në të gjitha raportet progreset është cilësuar si problematike dhe që duhet të përmirësohet zbatimi i drejtësisë penale, kryesisht, vendosja e standardve lidhur me administrimin e drejtësisë penale për të miturit, pavarësia e gjyqësorit, ekzekutimi i vendimeve dhe rritja e transparencës në publik.

<sup>62</sup> LEONARDI, M., “Shkaqet dhe proceset e devijimit të të miturve”, “Drejtësia e të miturve: formimi, devijimi, ligji dhe gjyqi”, Milan, Giuffrè, 2004 p.44 GARELLI, në GALLINO (ed.), Manuali i Sociologjisë, Torino, Utet, 1994 fq. 380.

e tjera sjelljes<sup>63</sup>. Devijimi i fëmijëve karakterizohet nga disa tipare që nuk hasen gjithmonë tek të rriturit, të tilla si: mungesa e përkohshmërisë, të qenit i çrregullt, impulsiviteti, etj.

Devijimi, kryesisht i atribuohet moshës dhe një periudhe të caktuar të rritjes që e karakterizon atë, ndryshe e njohur si periudha e adoleshencës. Në këtë periudhë, devijimi i të miturve si sjellje shqetëson individët e rritur, por nga studimet socio-psikologjike të kohëve të fundit, ka rezultuar që faza e adoleshencës së të rinjve nuk mund të përcaktohet vetëm përmes një grupimi të kësaj moshe, pasi, në fëmijë të ndryshëm, ajo fazë fillon më herët, sikurse për disa të tjerë, ajo mund të zgjasë përtej moshës së pjesës tjetër të individëve. Gjithashtu, për këtë arsye, të rinjtë që hyjnë në rrethin e të miturve ndjekin deri në moshën njëzet e një vjeçare të gjitha shërbimet e të miturve dhe nuk katapultohen në realitetin e të rriturve.

Nuk mund të lëmë pa përmendur në analizën e shkaqeve të devijimit të fëmijëve, problemin e dinamikës familjare. Familja mund të shihet para së gjithash, si një urë komunikimi e rëndësishme, pasi ajo transmeton, që nga fillimi, përmbajtjen e vlerave shoqërore dhe të moralit në kontekstin shoqëror, në të cilin është integruar familja. Gjithashtu, mund të shihet si një “*agjenci e kontrollit social*”, sepse, në sajë të mekanizmave të edukimit, këto përmbajtje vazhdimisht i nënshtrohen kontrollit. Përveç kësaj, familja është vendi ku mësohen rregullat e marrëdhënieve hierarkike, sepse këtu figurat prindërore janë identifikuar si të lartësuar dhe, marrëdhëniet me prindërit janë përshkruar si prototip i atyre marrëdhënieve, që bartin brenda tyre autoritetin. Por, grupi i familjes duhet të konsiderohet, mbi të gjitha, si “*thelbi i mbështetjes dhe kënaqësisë emocionale*”, pasi ajo siguron mbështetje për zhvillimin e vetëbesimit dhe vetënxitjes, si dhe një vend identifikimi, përmes të cilit merret kryesisht identiteti seksual. Familja, si grup primar për të gjitha këto funksione luan një rol shumë të rëndësishëm social në fëmijërinë dhe adoleshencën. Në strukturën aktuale shoqërore, mekanizmat pozitivë familjarë nxisin një perceptim konstruktiv dhe pozitiv të identitetit të të miturit, i cili, nga ana tjetër, çon në një vlerësim të vetes e më pas, në një integrim normal social.

Devijimi i fëmijëve është një proces i vërtetë social, që zhvillohet përmes këtyre fazave që janë: mospërshtatja, pakënaqësitë, devijimi dhe rritja (ndryshimi).

Pakënaqësia si koncept dëshmon vështirësinë, që të rinjtë kanë në lidhje me mënyrën e të jetuarit me botën e rritur. Moshë e adoleshencës është periudha e kalimit nga fëmijëria drejt

---

<sup>63</sup> Po aty, LEONARDI M., fq. 47.

një faze, ku individi bëhet i ndërgjegjshëm për marrjen e përgjegjësive që lidhen me të qenit i rritur.

Pakënaqësia është zhvillimi personal i defekteve, gjë që shoqërohet me vështirësinë për t'u bërë pjesë e kontekstit shoqëror dhe për marrjen me përgjegjësi të një identiteti personal. Kur ne fillojmë të flasim për "*devijimin*" jemi në një fazë, ku tashmë sjella nuk përputhet me pritshmëritë sociale. Pakënaqësia mund të konsiderohet një nga faktorët e përshpejtimit të sjelljeve devijante, që, nëse përsëritet, shkon drejt përjashtimit social.

Rritja është procesi brenda kufijve të kontekstit të përkatësisë dhe, shpesh ndodh që të shoqërohet me mospërputhje, shqetësime, pakënaqësi.

Në literaturën e sociologjisë një hap të rëndësishëm ka shënuar analiza e Durkheim<sup>64</sup>, i cili krijoi konceptin e "*anomia*". Me këtë term, ai i referohet faktit, se në përgjithësi, individët nuk i njohin rregullat që përbëjnë sistemin shoqëror si një të tërë. Koncepti i *anomisë* është i një rëndësie të madhe, pikërisht, sepse tregon mungesën e korrelacionit, midis normave individuale dhe shoqërore, të cilat në shumicën e rasteve mund të identifikohen si një nga faktorët kryesorë etiologjik në origjinën e sjelljes devijante. Koncepti i *anomisë* nuk i referohet vetëm mosfunksionimit të shërbimeve, mosfunksionimit të institucioneve ose mosfunksionimit të strukturave organizative, por është diçka më komplekse dhe më e thellë: është aftësia për të siguruar ato vlera të qëndrueshme të sjelljes, që kontribuojnë në krijimin e normave të përshtatshme për individët.

Ky kusht do të ishte më i dukshëm në kontekste shoqërore me densitet të veçantë demografik: sidomos kur ekziston përqasja e kulturave të ndryshme.

Në një situatë kontradiktore, individët më të prekur, dhe që kanë më shumë gjasë që të preken nga sjellja devijante, janë elementët më të brishtë të shoqërisë, të miturit.

Kështu, adoleshentët janë aktorët socialë, që janë më të ekspozuar ndaj një shoqërie të gabuar e për rrjedhojë, janë ata që manifestojnë një sjellje devijante, pasi nuk janë të integruar ende në procesin e kohezionit social.

Sjellja e devijuar e kësaj kategorie mund të jetë rezultat i kushteve të ndryshueshme sociale dhe ekonomike, e për pasojë, përqendrimi dhe manifestimi i sjelljeve delikuede nga këta adoleshentë është i madh.

---

<sup>64</sup> Emil Durkheim (1858-1917), studiues i shkencave sociale në Francë. Në tezën e tij të doktoratës, "*De la division du travail social* (1893) - Ndarja e punës në shoqëri", Durkheim shkruan se "...*çështja kryesore e veprës është pikërisht raporti i individit ndaj shoqërisë.*". "Leksione sociologjike", botim i vitit 2005.

Në vitet 1950, Cohen bëri një hulumtim shumë interesant për devijimin e të rinjve<sup>65</sup>. Nga ky studim janë shfaqur disa faktorë të përbashkët për grupet rinore të devijuara, të cilat mund të përmbliidhen si vijon:

- Devijimi i rinisë kryesisht përfshin adoleshentë, që i përkasin grupeve ekonomikisht të pafavorizuara dhe të marginalizuara;
- I riu e përcakton veten, duke u ndikuar nga pesha që i atribuojnë gjykimet e shprehura nga të tjerët;
- Vlerat e një klase shoqërore, të ndryshme nga ajo që i përkasin asaj, pranohen dhe konsiderohen si të rëndësishme për shoqërinë, sidomos ato të klasës së mesme (të cilat u bënë pikë referimi për orientimin e kushteve të realizimit shoqëror);

Për këtë arsye, është i dukshëm hendeku që krijohet, ndërmjet gjendjes së individit dhe atyre qëllimeve dhe vlerave, të cilat konsiderohen si të rëndësishme për shoqërinë, por të vështira për t'u arritur për shkak të kushteve të marginalizimit.

Më shumë se gjysmë shekulli ka kaluar që nga përpunimi i hetimit sociologjik të Cohen, por kjo është ende e vlefshme, sidomos në lidhje me formimin dhe funksionimin e grupeve të të rinjve. Kjo mënyrë e qartë nuk shpjegon dhe nuk mund të shpjegojë të gjitha fenomenet e devijimit të të miturve, por kjo mund të ndihmojë për të kuptuar atë kulturë që karakterizon “grupimin” si fenomen problematik dhe, që shpeshherë përbën një nga faktorët e riskut të kriminalitetit të të miturit, të cilin ne do t'a trajtojmë më konkretisht në Kreun II, të këtij punimi.

---

<sup>65</sup> COHEN A.K., (1955) “Djemtë e paskrupullt”, trad. en, Milano, Feltrinelli, 1963.(A K Cohen “Ragazzi deliquenti” (1955)

## KREU II

### Të miturit në konflikt me ligjin

#### 2.1. Faktorët e riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve

Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT-it, numri i përgjithshëm i fëmijëve konsiston në rreth ¼ e popullsisë. Grupmoshat e të rinjve 14-18 vjeç jjanë më të rrezikuarat nga përfshirja në krime dhe kundravajtje penale, si ndërmjet vetë të rinjve, ashtu edhe ndaj personave të tjerë<sup>66</sup>.

Për shumë të rinj sot, modelet tradicionale të ndërtimit të marrëdhënieve, ndërmjet familjes, shkollës dhe punës, janë duke ndryshuar vazhdimisht. Marrëdhëniet shoqërore, që sigurojnë një proces të qetë të socializimit të tyre janë duke u shkatërruar, kjo për faktin se, stili i jetës për këta të rinj, në ditët e sotme, është bërë më i larmishëm, më dinamik dhe më pak i parashikueshëm. Ristrukturimi i tregut të punës, periudha e varësisë së të rriturve të rinj në familje dhe, ndoshta, mundësitë më të kufizuara për t'u bërë një i rritur i pavarur, janë të gjitha ndryshimet që ndikojnë në marrëdhëniet me familjen, shoqërinë, komunitetin, pjesëmarrjen në tregun e punës, aktivitetet e kohës së lirë dhe mënyrën e jetesës.

Kjo situatë haset jo vetëm në vendet e zhvilluara, por edhe në vendet në zhvillim, ku po ashtu, shihet një rritje e numrit të të rinjve, që kalojnë periudhën tranzitore, nga fëmijëria në adoleshencën e pavarur, me plot problematika. Rritja e shpejtë e popullsisë, mungesa e shërbimeve të banimit dhe mbështetjes, varfëria, papunësia midis të rinjve, mbipopullimi në zonat urbane të varfëra, shpërbërja e familjes dhe sistemet joefektive të arsimit, janë disa nga problemet, që të rinjtë duhet të përballen. E natyrisht, presioni në këto raste është i madh. Ai bëhet shkak për gjetjen e rrugëve të gabuara të zgjidhjes së situatave.

Të rinjtë në ditët e sotme, pavarësisht nga gjinia, prejardhja sociale ose vendbanimi, janë subjekt i rreziqeve individuale. Gjithashtu, ata përballen me mundësi të reja individuale ose jo, disa prej të cilave, të dobishme dhe disa potencialisht të dëmshme. Këto të mundësi

---

<sup>66</sup> Burimi INSTAT.

shpeshherë rezultojnë të gabuara dhe i çojnë të rinjtë drejt dukurive kriminale, përdorimit të substancave narkotike apo manifestimit të dhunës me bashkëmoshatarët e tyre<sup>67</sup>.

Problemi i delikuencës së të miturve po bëhet gjithnjë e më i komplikuar dhe universal dhe programet e parandalimit të kriminalitetit të të miturit janë ose të pakta në numër, ose gati nuk ekzistojnë. Shumë vende në zhvillim kanë bërë pak ose aspak me të miturit në konflikt me ligjin dhe programet, qoftë në nivel ndërkombëtar, rajonal apo kombëtar në këtë drejtim, janë padyshim të pamjaftueshme. Vendet e zhvilluara janë të angazhuara në aktivitete që synojnë parandalimin e krimit të të miturve, por efekti i përgjithshëm i këtyre programeve është mjaft i dobët, sepse mekanizmat në vend janë të pamjaftueshme për të adresuar situatën ekzistuese.

Gjithsesi, përpjekjet e vazhdueshme për të luftuar delikuencën e të miturit karakterizohen nga mungesa e veprimeve sistematike dhe përcaktimi i objektivave edukativo-socialë, efektivë, të orientuar kah punës që duhet bërë qoftë me të miturit në konflikt me ligjin, por edhe me ata që janë viktimat/dëshmitarë në një veprër penale.

Të dhënat statistikore në shumë vende tregojnë, se delikuenca është kryesisht një fenomen grupor. Gati dy të tretat dhe tre të katërtat e të gjitha veprave penale të të miturve kryhen nga anëtarë të grupeve të ndryshme. Edhe ata të mitur që kryejnë vepra penale më vete, si individë, mund të ndodhë që t'i përkasin një grupimi<sup>68</sup>.

Në vijim, sipas studimeve të kryera nga Shoqata e Psikologëve Amerikanë (APA), janë gjetur ngjashmëri në karakteristikat themelore të sjelljes së grupit të të miturve, në pothuajse çdo klasë dhe kontekst kulturor. Në grupmoshat për të mitur janë vërejtur nivele të larta të kohezivitetit social, organizimit hierarkik dhe të një kodi sjelljeje, mbështetur në refuzimin e vlerave shoqërore dhe përvojës së të rriturve. Aspektit subkulturor të aktiviteteve të

---

<sup>67</sup> Të dhënat statistikore tregojnë, se në pothuajse të gjitha vendet, me përjashtim të USA, numri i krimeve të kryera nga të rinjtë u rrit në vitet 1990. Në Evropën Perëndimore, një nga rajonet e pakta, për të cilat janë të disponueshme të dhëna, arrestimet e kriminelëve të mitur dhe shkelësve nën moshë për përgjegjësi penale, u rritën me një mesatare prej rreth 50%, midis mesit të viteve 1980 dhe fundit të viteve 1990. Vendet në tranzicion kanë dëshmuar gjithashtu, një rritje dramatike të shkallës së delikuencës. Që nga viti 1995, nivelet e krimit të të miturve në shumë vende në Evropën Lindore dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarura, janë rritur me më shumë se 30%. Shumë nga veprat penale janë të lidhura me abuzimin e drogës dhe përdorimin e tepruar të alkoolit.

<sup>68</sup> Psh, në një studim të kryer në Rusi, sipas të dhënave, shkalla e veprimtarisë kriminale mes të miturve në grupe është rreth tre deri katër herë më e lartë, se ajo e të pandehurve të rritur. Krimi i grupit të të miturve është më i përhapur në mesin e 14-vjeçarëve dhe më së paku mbizotërues në mesin e 17-vjeçarëve. Treguesit janë më të lartë për veprat penale të vjedhjes, grabitjes dhe përdhunimit dhe më të ulëta për ato të vrasjes me paramendim dhe lëndime të rënda trupore. United Nations, Centre for Social Development and Humanitarian Affairs "The global situation of youth in 1990s: trends and prospects".



grupmoshave të të miturve, rrallë i është kushtuar vëmendja e duhur. Grupet e ndryshme të të miturve janë të prirur të miratojnë atë që përbën një përzierje heterogjene ose sintezë të vlerave mbizotëruese, (e bazuar kjo në klasat shkollore), të cilat shpërndahen nga gama e larmishme e argëtimit dhe vlerat grupore, prezente në familje ose komunitet. Subkultura mund të përkufizohet, si sistem i veçantë i jetesës që zhvillohet në grupe dhe është në pozita strukturore vartëse, si rezultat i presionit të ushtruar nga sistemet mbizotëruese<sup>69</sup>.

Të dhënat statistikore dëshmojnë se kriminaliteti ka baza të forta gjinore. Të dhënat e punonjësve të policisë tregojnë, se treguesit e krimit të të miturit dhe të miturit delikuentë, janë më shumë se dyfishi i femrave të reja dhe marzhet e dënimit janë gjashtë ose shtatë herë më të larta<sup>70</sup>. Ekzistojnë disa arsye, pse më shumë të rinjtë meshkuj, janë të përfshirë në sjellje të dhunshme ose kriminale në raport me të rejtat femra. Kjo, në gjykimin tim ka të bëjë me atë, që faktorë të ndryshëm kufizues dhe nxitës inkurajojnë të rejtat femra, që të jenë në përputhje me vlerat e moralit shoqëror, të cilat në fakt nuk zbatohen për të rinjtë meshkuj (psh: frika nga sulmet apo ngacmimet seksuale). Gjithashtu, të rejtat adoleshente janë subjekt i kontrollit më të fortë familjar sesa të rinjtë djem. Dhe kjo sërish e ka një argument: konceptet kulturore janë të tilla, që shoqëria në përgjithësi është më pak tolerante dhe më shumë paragjyquese, gjyquese dhe e ashpër ndaj sjelljeve të devijuara të vajzat e reja adoleshente sesa tek të rinjtë djem<sup>71</sup>.

Përveç kësaj, agresioni dhe dhuna luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e maskilizmit dhe seksualitetit në një shoqëri patriarkale, qëllimi kryesor i së cilës është përforcimi dhe ruajtja e statusit dhe pozitës autoritare të meshkujve. Perceptimi mashkullor i dhunës mund të minimizohet, falet, mohohet ose justifikohet. Meshkujt, veprime të tilla si: fyerje verbale ose seksuale, shpesh nuk i konsiderojnë që përbëjnë sjellje të dhunshme, përkundrazi, të qenit mashkull nuk mund të perceptohet ndryshe pa këto sjellje.

Intensiteti dhe ashpërsia e veprave penale të të miturve përgjithësisht përcaktohen nga kushtet shoqërore, ekonomike dhe kulturore që mbizotërojnë në një vend. Ka dëshmi të një rritjeje në shkallë botërore për sa i përket delikuencës së të miturve, e evidentuar kjo

---

<sup>69</sup> American Psychological Association, "Violence and youth: psychology's responses", a summary report of the APA Commission on Violence and Youth (Washington D.C., 1993).

<sup>70</sup> Numri i të miturve të dyshuar për çdo 100 000 anëtarë të grupmoshës së caktuar është më shumë se gjashtëfishi i shifrës përkatëse për femrat; për ata në kategorinë e të rinjve raporti i dyshuar mashkull-femër është edhe më i lartë në 12.5 në 1.6 .

<sup>71</sup> D.Gilmore, *Manhood in the Making: Cultural Concepts of Masculinity* (London, Yale, University Press, 1990).

paralelisht me rënien ekonomike, veçanërisht në rrethinat – getot e varfra të qyteteve të mëdha. Në shumë raste, fëmijët e rrugës bëhen shkelës të rinj, pasi kanë hasur në dhunë në mjedisin e tyre familjar, shkollor, në komunitet a gjetkë, si dhe mund të jenë në pozitë të dëshmitarit në një vepër penale ose viktimë të akteve të dhunshme. Arritjet arsimore të këtij grupi janë mjaft të ulëta dhe përvoja sociale bazë, e përfutur në familje është shumë shpesh e pamjaftueshme dhe nën nivelin mesatar të shoqërisë dhe, mjedisi socio-ekonomik përcaktohet nga varfëria dhe papunësia.

Faktorët e riskut që ndikojnë në rritjen e kriminalitetit të miturit, zakonisht gjenden në çdo nivel të strukturës shoqërore, duke përfshirë shoqërinë në tërësi, institucionet shtetërore, grupet dhe organizatat shoqërore apo marrëdhëniet ndërpersonale. Zgjedhja me vonë dhe drejtimit që do të marrin në jetë të miturit dhe të qenit në vijë me sjellje kriminale, i atribuohet një game të gjerë faktorësh, disa prej më të rëndësishmëve do të përpiqem t'i listoj më poshtë<sup>72</sup>.

*a) Faktorët ekonomikë dhe socialë*

Kriminaliteti të miturit në rritje sot, i dedikohet tërësisht gjendjes ekonomike-sociale dhe pasojave negative të saj. Në veçanti, kriza ekonomike, paqëndrueshmëria e sistemeve politike dhe dobësimi i institucioneve shtetërore (si psh: sistemet e arsimit publik dhe asistencës publike, familja, etj), sjellin papunësinë e vazhdueshme apo të ardhura të ulëta në mesin e të rinjve, gjë që mund të rrisë gjasat e përfshirjes së tyre në veprimtarinë kriminale.

*b) Faktorët kulturorë*

Sjelljet delikate e të devijuara, shpesh janë të dukshme në mjediset shoqërore, në të cilat normat bazë të moralit shoqëror ose janë shkatërruar, ose ato nuk konsiderohen të tilla. Në këto kushte, shumë nga rregullat dhe vlerat e përbashkëta që ndajnë anëtarët në një shoqëri të ndërtuar mbi bazat e moralit dhe, që i pengon pikërisht individët, anëtarë të saj, të kryejnë veprime dhe sjellje të papranueshme, mund të humbasin rëndësinë e tyre për disa prej këtyre anëtarëve. Ata i përgjigjen ndryshimeve traumatizuese dhe destruktive në realitetin shoqëror, duke u angazhuar në veprimtari rebele, devijuese apo edhe kriminale. Për shembull një mjedis i tillë është modernizimi i shoqërive tradicionale si rrjedhojë e aplikimit të

---

<sup>72</sup> United Nations Guidelines for the Prevention of Juvenile Delinquency ( The Riyadh Guidelines), adopted and proclaimed by General Assembly, resolutions 45/112 of 14 December 1990.

teknologjive të reja, që shoqërohet me ndryshime të aktivitetit në punë, të karakteristikave sociale, të mënyrës së jetesës, etj. Të gjitha këto ndryshime, nga ana tjetër, ndikojnë në strukturat e autoritetit, format e bindjes dhe mënyrat e pjesëmarrjes në politikë, madje duke shkuar aq larg, sa të ndikojnë në perceptimet e realitetit.

#### *c) Urbanizimi*

Analiza gjeografike sugjeron që vendet me popullsi më të urbanizuar kanë tregues më të lartë të krimit të regjistruar, sesa ato me stile jetese të dukshëm rural dhe me baza në komunitet. Kjo mund t'i atribuohet ndryshimeve në kontrollin social dhe kohezionin social. Grupimet rurale mbështeten kryesisht, në kontrollin e familjes dhe komunitetit, si një mjet për t'u marrë me sjelljet antisociale dhe shfaqin tregues të ulët të kriminalitetit. Shoqëritë e industrializuara urbane priren të përdorin masa formale ligjore dhe gjyqësore, që duket se lidhet me treguesit më të lartë të kriminalitetit. Dallimet kulturore dhe institucionale janë të tilla, që përgjigjet për të njëjtën vepër mund të ndryshojnë shumë nga një vend në tjetrin.

#### *ç) Familja*

Studimet tregojnë, se fëmijët, që marrin mbikëqyrje, përkujdesje dhe vëmendje prindërore kanë më pak të ngjarë të angazhohen në veprimtari kriminale. Cilësimet jo funksionale të familjes, të karakterizuara nga konflikti, kontrolli i pamjaftueshëm prindëror, lidhjet e dobëta të brendshme dhe integrimi dhe autonomia e parakohshme, janë faktorë që lidhen ngushtësisht me delikuecën e të miturve. Fëmijët në familjet me disavantazhe, që kanë pak mundësi për punësim të ligjshëm dhe përballen me një rrezik më të lartë të përjashtimit social, janë të mbipërfaqësuar midis të miturve në konflikt me ligjit – autorë të veprave penale. Situata e pakicave etnike dhe emigrantëve, përfshirë personat e zhvendosur dhe refugjatët në pjesë të caktuara të botës, është veçanërisht shqetësuese. Vendet në tranzicion po përballen me sfida të veçanta në këtë drejtim, me pasigurinë dhe trazirat që lidhen me rritjen e numrit të fëmijëve dhe të miturve të lënë pas dore nga prindërit e tyre dhe vuajtjen e abuzimit dhe dhunës në shtëpi.

#### *d) Emigracioni*

Për shkak se, emigrantët janë një kategori shoqërore dhe fenomen që haset kudo, i përkasin atyre individëve, të cilët kanë pak shanse për sukses në kuadrin e rendit ligjor ekzistues. Kjo bën, që ata shpesh të kërkojnë komoditetin duke u shpërngulur nga vendet e origjinës drejt vendeve që u krijojnë lehtësira në punësim, jetesë dhe shkollim. Dallimet në vlerat, edukimin dhe shkallët e ndryshme të pranueshmërisë së disa veprimeve në nënkultura të ndryshme etnike, rezultojnë në konflikte kulturore, të cilat janë një nga burimet kryesore të sjelljes kriminale. Popujt vendas urbanë priren të perceptojnë emigrantët si devijantë të dukshëm.

#### dh) *Mediat*

Në ditët e sotme, televizioni ka lartësuar "kultin e heronjve", sidomos në filma, ku heroi vendos drejtësinë, nëpërmjet eliminimit fizik të të ashtëquajturve "armiq". Shumë studiues kanë arritur në përfundimin, se të rinjtë që shohin dhunë, priren të sillen më agresivë dhe të dhunshëm, veçanërisht kur ata provokohen. Kjo është kryesisht, karakteristikë e djemve të moshës nga 8 deri në 12 vjeç, të cilët janë më të ndjeshëm ndaj ndikimeve të tilla. Media sjell një individ në dhunë në tri mënyra:

**Së pari**, filmat që shfaqin veprime të dhunshme – filmat aksion, nxisin audiencë dhe energjia agresive pastaj, mund të transferohet në jetën e përditshme, duke e shtyrë një individ të përfshihet në aktivitet të tilla "aksion" fizik edhe në rrugë.

**Së dyti**, televizioni mund të portretizojë dhunën e përditshme të kryer nga prindërit ose bashkëmoshatarët<sup>73</sup>.

**Së treti**, dhuna e përshkruar në media është joreale dhe ka një cilësi surrealistike, (plagët rrjedhin më pak dhe dhimbja dhe agonia e vërtetë, që rezultojnë nga veprime të dhunshme tregohen shumë rrallë, kështu që pasojat e sjelljes së dhunshme shpesh duken të papërfillshme).

#### e) *Përrjashtimi*

Shtresëzimi në rritje i shoqërisë ka çuar në fenomenin e të ndjerit "i padëshiruar për të tjerët". Përrjashtimi i disa njerëzve po rritet gradualisht me akumulimin e pengesave, prishjen e

---

<sup>73</sup> Psh, vendosja e masave ndëshkuese të dënimit nga ana e prindërve për moskryerjen me korrektësi të detyrimeve shkollore, ose për shkelje të disa rregullave ose normave të sjelljes.

lidhjeve shoqërore, papunësinë dhe krizat e identitetit. Sistemet e mirëqenies që kanë ofruar lehtësim, por nuk kanë eliminuar pozicionin e përlur socio-ekonomik të grupeve të caktuara, së bashku me rritjen e varësisë së familjeve me të ardhura të ulëta në shërbimet e sigurimeve shoqërore, kanë kontribuar në zhvillimin e një klase "të re të varfër" në shumë vende.

#### ë) *Ndikimi shoqëror*

Zakonisht, të miturit apo të rinjtë adoleshentë janë kollaj të ndikueshëm prej njëri-tjetrit. Grupimi është një fenomen që haset rëndom në këto moshë. Të qenit apo përkatësia në një grup, duket sikur kësaj kategorie i ofron mbështetje dhe siguri. Eksperienca ka treguar, se të miturit që përfshihen në një grup të caktuar, ndihen krenarë dhe shfaqin besnikëri për të zbatuar rregullat dhe "politikat" e grupit<sup>74</sup>.

#### f) *Identiteti i vonuar i sjelljes kriminale*

Në identifikimin e shfaqjes së sjelljes kriminale të një i mitur, është e rëndësishme të përcaktohet, se cilët janë ata faktorë, që ndikojnë në një identitet të vonuar të të qenit delikuent. Në fakt, ky identitet është mjaft kompleks dhe në gjykimin tim është mbulesë e disa identiteteve njëherazi, të cilat lidhen me gjininë, racën, klasën e një individi, gjendjen shoqërore apo edhe me vetë dukurinë e kriminalitetit. Identiteti i një sjelljeje të vonuar kriminale ndërtohet si një alternativë e identitetit konvencional të një shoqërie më të madhe dhe, dhuna dhe konflikti janë dy elementë të domosdoshëm në ndërtimin e tij.

#### g) *Shkelësit dhe viktimat*

Veprimtaria kriminale është e lidhur shumë me sjelljen e viktimës. Ndonjëherë, një viktimë reagimi mund të provokojë një shkelës, sikurse "një sjellje e përshtatshme" mund të parandalojë një vepër penale ose mund të minimizojë pasojat e saj. Sipas studiveve socio-psikologë, gjasat për t'u bërë viktimë lidhen me karakterin dhe cilësitë e një individi, me një situatë socio-ekonomike të caktuar, që mund të provokojë një sjellje kriminale, apo

---

<sup>74</sup> Një i mitur i moshës 13 vjeçare në USA, kur u pyet pse u përfshi në grupim, u shpreh se "...kishte pasiguri dhe frikë për të dashurën e tij, se mos ja ngacmonin apo dhunonin seksualisht. Kështu, që banda që vepronte në lagjen ku ai banonte, ju duk si zgjidhja më e mirë për të shpëtuar këtyre pasigurive dhe frikërave...". M.E.Wolfgang, T.P.Thornberry and R.M.Figlio, "From Boy to Man, from delinquency to crime", Chicago, University Press, 1987).

karakteristika të tilla individuale si: statusi familjar/individual, gjendja ekonomike, etj, mund të jenë përcaktues në shtrirjen e viktimizimit. Sipas klasifikimit që këta studiues bëjnë në teorinë shkencore të studimit të tipologjive të sjelljes kriminale, ekzistojnë dy lloje tipike viktimash adoleshente të dhunës:

- *Viktima aksidentale* – njerëz të prirur për t'u bërë viktima;
- *Viktima "të lindura"*

Në shumicën e rasteve që shkaktojnë dëmtime trupore, studimet kanë treguar, se autori i krimit dhe viktima kanë patur njohje me njëri-tjetrin (bashkëshortë/partner, shokë, të afërm, etj)<sup>75</sup>.

Në shumë prej vendeve të BE-së, rritje e kriminalitetit të të miturit ka ardhur si pasojë e rritjes së varfërisë, gjendjes së keqe ekonomike dhe rritjes së papunësisë. Gjithashtu, edhe kriza e përgjithshme e tranzicionit në vendet e Evropës Qendrore e Lindore (por jo vetëm)<sup>76</sup>, ku kalimi nga një ekonomi e centralizuar, në një ekonomi të hapur të tregut, u shoqërua me rritjen e sjelljes kriminale të të miturit, për shkak edhe të dobësimit të strukturave shoqërore të socializimit, të tilla si: familja, sistemi arsimor, institucionet e ofrimit të shërbimeve shoqërore, etj.

Delikuenca të të miturit në rajonin tonë është e lidhur ngushtësisht me faktorë ekonomikë, të tillë si: papunësia e të rinjve dhe prindërve, gjendja e keqe ekonomike dhe varfëria në shumë prej familjeve me të ardhura nën minimumin jetik, si dhe modeli patriarkal i jetesës në familje, ku prindërit ushtrojnë presion në mënyrë të vazhdueshme për kufizimin e lirive të veprimit e mendimit për këta të rinj.

---

<sup>75</sup> Të dhënat statistikore dëshmojnë se kjo ndarje është e vërtetë për 80% të krimeve për vrasje dhe 70% të krimeve seksuale. American Psychological Association, "Violence and youth: psychology's responses", a summary report of the APA Commission on Violence and Youth (Washington D.C., 1993).

<sup>76</sup> Në vendet e mëdha të Evropës Lindore dhe në ish-Bashkimin Sovjetik, numri i nënave dhe baballarëve të privuar nga ushtrimi i të drejtave prindërore po vjen në rritje dita-ditës. Këta janë zakonisht individë, të cilët janë përdorues të substancave narkotike deri në varësi ekstreme, alkoolistë dhe me sjellje të theksuara antisociale. Papunësia, të ardhurat e pamjaftueshme dhe papërgjeshmëria prindërore janë faktorët kyçë, që ndikojnë në kriminalitetin në rritje të të miturit në shumë prej këtyre vendeve. Të miturit e këtyre familjeve pësojnë devijacione të sjelljes dhe karakterit e personalitetit: ata poshtërohen, fyhen, mbi ta ushtrohet dhunë, madje ata nxirren në rrugë të lypin ose dhe të prostitutojnë. Në shumë vende të ish-Bashkimit Sovjetik, prishja e strukturave publike arsimore, ka çuar në dështimin e përpjekjeve për të parandaluar dukuritë kriminale. Për shumicën e fëmijëve nuk ekziston mundësia e përfshirjes dhe integritimit në veprimtari social-kulturore, me qëllimin e mbajtjes larg rrugës dhe krimit.

## **2.2. Organet/personat kompetentë të administrimit të drejtësisë për të mitur**

Masat e përshtatura që marrin parasysh aftësinë e fëmijës për të ushtruar të drejtat e veta, siç është caktimi i një personi mbështetës<sup>77</sup>, e drejta për t'u mbrojtur nga vështirësitë gjatë procesit gjyqësor apo pjesëmarrja e organeve kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur janë çështje, të cilat kanë zgjuar debat në arenën juridike të kohës. Kështu, në udhëzuesit e Kombeve të Bashkuara lidhur me kushtet e kujdesit alternativ për fëmijët<sup>78</sup>, përcaktohet se:

***“...Shtetet duhet të sigurojnë funksionimin e një mekanizmi për caktimin e një personi të veshur me të drejtën dhe përgjegjësinë ligjore për të marrë vendime në jetën e përditshme, në interesin më të mirë të fëmijës, duke u këshilluar me të, në situata kur prindërit e fëmijës mungojnë, ose nuk kanë zotësinë për t'i marrë këto vendime....”***

Në këtë kuptim, duke u ndalur në përgjegjësitë e veçanta të secilit prej këtyre organeve në vijim dhe rolit që ato kanë në këtë proces, në mënyrë të përgjithshme më lejoni t'i parashtroj për këtë qëllim, përmbledhtazi se cilat janë këto përgjegjësi:

- a) garantimi i kujdesit, strehimit, ofrimit të kujdesit shëndetësor, asistencë të specializuar psiko-sociale, arsimimit dhe komunikimit në gjuhë të përshtatshme për fëmijën;
- b) krijimi i kushteve të nevojshme që fëmijët të kenë mundësi të përfaqësimit ligjor, kur kjo është e nevojshme, duke respektuar edhe mendimin e tyre, në mënyrë që pikëpamjet e fëmijëve të merren parasysh nga ana e autoriteteve vendimmarrëse;
- c) këshillimi dhe informimi i vazhdueshëm e periodik i fëmijës për të drejtat e tij në aspektin e të drejtave dhe lirive themelore, si dhe zbatimi korrekt në praktikë i parimit të “interesit më të lartë të fëmijës” dhe mirëqenies së tij;
- ç) identifikimi i zgjidhjeve të qëndrueshme në interesin më të lartë të fëmijës;
- d) vendosja e urave të bashkëpunimit me organizata të ndryshme jofitimprurëse për garantimin e ofrimit të shërbimeve në të mirë të fëmijës;

<sup>77</sup> Edhe në ligjin nr.37/2017, konkretisht në nenin 35 të tij përcaktohet se *përfaqësuesi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, lidhur me të miturin dëshmitar dhe viktimë është personi mbështetës dhe ka për detyrë : “...të mbështesë të miturin emocionalisht, të ofrojë mbështetje gjatë gjithë procesit penal, të këshillojë nëse ndjkeja e një terapie ose këshillimi profesional është i nevojshëm, të ruajë komunikimin me të afërmit ose shokët apo mbrojtësin e viktimës, të informojë të miturin për gjendjen e tij procedurale, ta informojë për shërbimet shëndetësore, etj...”*. Referuar legjisllacionit në fuqi, konkretisht ligjit për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës, Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është struktura për mbrojtjen e të miturit në nivel vendor (neni 3, i ligjit nr.37/2017).

<sup>78</sup> Udhëzuesit e Kombeve të Bashkuara për përdorimin e përshtatshëm dhe kushtet e kujdesit alternativ për fëmijët [www.crin.org/docs/Draft\\_UN\\_guidelines.pdf](http://www.crin.org/docs/Draft_UN_guidelines.pdf)

dh) ofrimi i asistencës së duhur për gjetjen e familjeve birësuese për fëmijën, etj;

Miratimi i ligjit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur në vendin tonë, i hapi rrugë vendosjes së urave të bashkëveprimit, koordinimit dhe komunikimit institucional, ndërmjet të gjithë organeve kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, duke shmangur kështu një herë e mirë fragmentarizimin e përgjegjësi dhe minimizimin e mosmarrëveshjeve, si pasojë e mungesës së kuadrit ligjor, që sanksiononte rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit në këtë drejtim.

### *2.2.1. Struktura për të miturit në Policinë e Shtetit<sup>79</sup>*

Punonjësit e policisë së shtetit duhet të mbajnë në rajonet e policisë informacion për asistencën ndaj fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të veprës penale. Në kontaktin e parë me punonjësit e policisë së shtetit, menjëherë t'i rekomandojnë fëmijët viktime dhe dëshmitarë, nëse marrin pëlqimin e tyre, të shërbimet ekzistuese mbështetëse dhe në vendet ku ekziston ky institucion, të kërkojnë caktimin e një personi mbështetës. Veprimet e kryera nga punonjësi i Policisë së Shtetit lidhur me të miturit, duhet të kryhen nga një punonjës i specializuar dhe i trajnuar në fushën e drejtësisë penale për të miturit<sup>80</sup>. Gjithashtu, duhet që në komisariatet e policisë të ekzistojnë manuale, guida apo protokolle të komunikimit, me prokurorinë dhe shërbimet e tjera të tilla si: psikologu, mbrojtësi ligjor, komuniteti, shkolla apo qoftë edhe me organizatat jofitimprurëse që veprojnë në këtë fushë, me synim kryesor edukimin e të miturit dhe jo ndëshkimin e traumatizmin e tij.

### *2.2.2. Policia gjyqësore*

Edhe punonjësit e policisë gjyqësore, që merren dhe trajtojnë të tilla çështje, trajnohen dhe specializohen në këtë fushë<sup>81</sup>. Aktualisht, organizimi i strukturave të policisë gjyqësore është i ndërlikuar dhe nuk janë të qarta lidhjet e policisë gjyqësore me strukturat e tjera të policisë.

<sup>79</sup> Sipas të dhënave të publikuara në një raport të UNICEF, për drejtësinë për të miturit në vendin tonë, rezulton se, në nivel qendror (në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë) një prej strukturave që lidhet më ngushtë me drejtësinë penale për të miturit është Drejtoria Kundër Akteve Terroriste & Krimeve të Hapura, e cila ka në përbërjen e vet Sektorin për Mbrojtjen e Fëmijëve. Sektori ka një staf të limituar dhe në veprimtarinë e tij vlen të përmenden statistikat e detajuara lidhur me të miturit autorë të veprave penale. Në nivel qarku (Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Gjirokastër, Elbasan, Lezhë, Shkodër, Kukës, Dibër) funksionojnë 12 Drejtoritë e Policive në qarqe. Konstatohet që në të gjitha Drejtoritë e Policisë së Qarkut përfshi edhe Tiranën nuk ka një specialist që merret me çështjet e të miturve. Kjo strukturë që ka ekzistuar të paktën për DQ Tiranë, edhe këtu nuk figuron më. Konkludojmë se strukturat në të gjitha nivelet janë plotësisht të pamjaftueshme.

<sup>80</sup> Neni 30, i KDPM, "Trajnimi dhe specializimi i punonjësve të policisë së shtetit".

<sup>81</sup> Neni 29, i KDPM



Ndërkohë, që për çështjet e drejtësisë për të miturit nuk ka një sektor të posaçëm që mbulon këto çështje

### *2.2.3. Prokuroria*

Prokurorët duhet të rekomandojnë fëmijët viktima dhe dëshmitarë pranë shërbimeve ekzistuese mbështetëse, në rast se ky rekomandim nuk është bërë nga punonjësit e policisë së shtetit. Ata duhet të monitorojnë mundësinë që kanë fëmijët viktima dhe dëshmitarë për të përdorur shërbimet ekzistuese dhe të marrin, sipas rastit, masat me qëllim që atyre t'u sigurohet asistenca e duhur. Sipas rastit, prokurori duhet të kërkojë caktimin e një kujdestari për fëmijën ose zbatimin e masave të tjera të asistencës. Edhe për këtë prokurorë trajnimet dhe specializimet në fushën e drejtësisë penale për të mitur janë një kusht i domosdoshëm<sup>82</sup>. Sot, referuar organizimit dhe funksionimit të institucionit të prokurorisë, strukturat dhe prokurorët e specializuar në shkallë vendi dhe në të gjitha nivelet e prokurorive lidhur me veçoritë e ndjekjes penale të veprave penale të kryera prej të miturve mungojnë. Një pjesë e vogël e prokurorëve janë përfshirë në disa trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

### *2.2.4. Asistenca ligjore dhe psikologjike*

Mbrojtësi ligjor është një garanci për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit, sidomos të pandehurit të mitur, i cili nuk ka arritur pjekurinë intelektuale dhe ka nevojë për asistencë të kualifikuar ligjore. Kështu, ligji procedural penal ka parashikuar asistencë të detyrueshme nga mbrojtës të kualifikuar për të pandehurin e mitur, edhe në rastet, kur ai apo familja e tij nuk kanë mundësi financiare për të siguruar të tillë. Të miturit, që në momentin e arrestit në flagrancë apo të ndalimit, i sigurohet asistenca e mbrojtësit ligjor, për t'a sqaruar për arsyet, se përse është arrestuar dhe për veprën penale, e cila i atribuohet. Në këtë kuptim, me të miturin nuk mund të kryhet asnjë veprim procedural dhe, nuk mund të nënshkruhet asnjë akt, pa praninë e mbrojtësit që duhet t'i sqarojë atij rëndësinë e faktit dhe pasojat e veprimeve apo të deklarimeve. Çdo akt procedural, i kryer me të pandehurin e mitur, pa praninë e mbrojtësit ligjor, do të sillte si pasojë pavlefshmërinë absolute të aktit dhe papërdorshmërinë e tij. Pra, ligji procedural i garanton të miturit ndihmën e avokatit, në mënyrë që ai të mos deklarojë për vetëpërgjegjësi dhe të mos rëndojë pozitën e tij, me deklaratimet apo me provat që vë në dispozicion të organit procedues.

---

<sup>82</sup> Po aty.

E rëndësishme për të pandehurin e mitur është dhe asistenca e psikologut, si në seancat e marrjes së deklarimeve, edhe në ndikimin, që ka në vlerësimin që do të bëhet për të pandehurin nga gjykata. Psikologu është mirë të jetë i pranishëm, gjatë deklarimeve që jepen nga i mituri, qoftë ky autor i një veprë penale apo thjesht deklarues. Kjo për faktin, se do t'i thjeshtojë kuptimin e pyetjeve që i bëhen, do t'a ndihmojë në shprehjen sa më të qartë të mendimit dhe do t'a ndihmojë, që procesi i pyetjes të mos ndikojë negativisht në psikikën apo zhvillimin mendor të të miturit. Kështu, psikologu kontakton me të pandehurin e mitur, duke marrë të dhëna që lidhen me zhvillimin e tij mendor, psikik, temperamentin, marrëdhëniet familjare, rrethin shoqëror, etj. Në të njëjtën kohë, merr të dhëna prej tij për veprën e kryer, për shkaqet që e shtynë në kryerjen e saj, për shkaqet që e kanë shtyrë në atë lloj reagimi ndaj ndonjë ngacmimi të caktuar, për mënyrën, se si është ndjerë, gjatë apo pas kryerjes së veprës penale. Me këto të dhëna psikologu krijon një mendim për të miturin, për shkaqet dhe rrethanat që e kanë shtyrë në kryerjen e veprës penale, si dhe për mënyrën që mund të reagojë, ndaj llojeve të ndryshme të dënimit. Gjithashtu, me këto të dhëna, harton një relacion, që i jepet gjykatës si vlerësim ekspert, në bazë të nenit 42/2 të K.Pr.Penale dhe merret në konsideratë për llojin dhe masën e dënimit, që do të caktohet për të pandehurin e mitur.

### *Gjykata*

Kështu, gjyqtarët sipas rastit, urdhërojnë caktimin e një kujdestari për fëmijën ose zbatimin e masave të tjera për dhënie asistence, ose në vende ku ekziston ky institucion, ata duhet caktojnë një person mbështetës në rast se, kjo nuk është kërkuar nga punonjësit e policisë së shtetit.

### *Avokatët*

Avokatët duhet të informojnë viktimat për disponueshmërinë e shërbimeve të asistencës dhe të lidhen me këto shërbime dhe autoritetet, me qëllim që viktimat e veprës penale të kenë mundësinë më të mirë për të përfituar nga kjo asistencë. Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të vërë në dispozicion të institucioneve të ndihmës juridike falas, një listë të avokatëve, të cilët kanë eksperiencë dhe ekspertizën e duhur për çështjet e drejtësisë penale për të mitur<sup>83</sup>.

---

<sup>83</sup> Neni 31, i ligjit, i cili përcakton gjithashtu se: “...*Institucioni që administron ndihmën juridike falas, në rastet e parashikuara me ligj, siguron menjëherë ndihmë ligjore me kërkesën e të miturit ose të çdo organi*

Ndërsa, *ligjvënësit* duhet të garantojnë në legjislacion të drejtën e të gjithë fëmijëve viktime dhe dëshmitarë për të marrë asistencën e duhur, përfshirë, sipas rastit, asistencë mjekësore, psikologjike, sociale ose asistencë të një lloji tjetër, në fazën më të hershme pas zbulimit të veprës penale dhe të përcaktojnë modalitetet për ofrimin e saj. Kështu, ligji i ri për drejtësinë penale për të mitur në vendin tonë, ka përcaktuar edhe organe/persona të tjerë, të specializuar në drejtësinë për të mitur, të cilët marrin të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme, për hartimin e programeve të trajnimit dhe të regjistrimit të të trajnuarve, duke e përditësuar atë në vazhdimësi<sup>84</sup>.

Gjithashtu, *organizatat jofitimprurëse* që veprojnë në këtë fushë duhet të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me autoritetet shtetërore, për ofrimin e asistencës së duhur fëmijëve viktime dhe dëshmitarë, për shembull, duke krijuar qendra për mbrojtjen e fëmijës, të bashkëpunojnë ngushtë me policinë dhe institucionin e prokurorisë, të nxisin mekanizmat mbrojtës dhe mbështetës me bazë komuniteti që mund t'ju shërbejnë fëmijëve të përfshirë në procese gjyqësore, si dhe të zhvillojnë veprimtari që ndihmojnë për rritjen e rolit mbështetës të kujdestarëve të fëmijëve viktime.

### **2.3. Procedimi i të miturve në çështjet penale**

Procesi gjyqësor ndaj të miturit, për shkak të moshës, pjekurisë dhe nivelit psikosocial, është po aq delikat sa edhe fazat e hetimit paraprak e të caktimit të masave të sigurimit personal. Të miturit i sigurohet asistencë e mbrojtësit në procesin gjyqësor, për të garantuar mbrojtjen juridike profesionale. Gjithashtu, të miturit i sigurohet prania e psikologut në procesin gjyqësor, që t'ia thjeshtojë kuptimin e faktit kriminal për të cilin gjykohet, si dhe ta bëjë më të thjeshtë shprehjen e të miturit, lidhur me këtë fakt. Psikologu gjithashtu, pasi komunikon me të miturin, krijon një profil psikosocial të tij dhe bën një relacion që ia vë në dispozicion gjykatës. Të miturit i sigurohet diskrecioni gjatë procesit gjyqësor, duke vendosur gjykimin me dyer të mbyllura, kur është në favor të tij.

---

*kompetent. Kur kërkesa bëhet nga i mituri, ajo mund të paraqitet në çdo lloj forme dhe përpara organit kompetent, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuq...".i*

<sup>84</sup> Në nenin 32, përcaktohet në mënyrë të shprehur se persona/organe të përfshirë në sistemin e drejtësisë penale për të mitur janë: “...punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, psikologu, përfaqësuesi procedural, ndërmjetësi, punonjësi i shërbimit të provës, punonjësi i qendrës së rehabilitimit për të mitur dhe paraburgimit, i specializuar në drejtësinë për të mitur...” dhe ata të përfshirë në hartimin e programeve të trajnimit dhe regjistrimit të të trajnuarve janë: “...Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, Urdhri i Psikologut/Punonjësit Social, Dhoma Kombëtare e Avokatishë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Shërbimi i Provës dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe institucione të tjera...”.

Në kuptimin penal, i mitur konsiderohet personi që ka mbushur moshën për të mbajtur përgjegjësi penale, por që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç. Në nenin 12, të Kodit Penal Shqiptar, por edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, i miratuar së fundmi nga Parlamenti, është përcaktuar që mosha për të mbajtur përgjegjësi penale është 14 vjeç<sup>85</sup>. Personat që nuk kanë mbushur këtë moshë, nuk mbajnë përgjegjësi penale, pasi konsiderohen që nuk kuptojnë rëndësinë e veprimeve të tyre, si dhe të pasojës që sjellin këto veprime. Gjithsesi, këta persona, pavarësisht moshës së vogël, mund të kryejnë vepra penale të ndryshme, madje dhe me pasoja të rënda. Për këto vepra penale, ndaj të miturit që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, nuk mund të zhvillohet një proces gjyqësor dhe ai nuk mund të dënohet penalisht. Ndaj këtyre personave të mitur, duhet të ndërmerren masa edukuese, në mënyrë që të mundësohet rehabilitimi, të kufizohet mundësia për të kryer vepra të tjera penale, të mbrohen dhe t'u jepet ndihma e nevojshme, që ata të riintegrohen në shoqëri. Në të drejtën penale, persona të mitur që mbajnë përgjegjësi penale, konsiderohen personat që në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë mbushur moshën 14 vjeç, por jo atë 18 vjeç, moment në të cilin dhe në aspektin civil, fitojnë zotësinë e plotë juridike për të vepruar. Personat në këtë moshë nuk kanë arritur zhvillimin e plotë psikologjik, mendor dhe social, për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që kryejnë. Mbi këtë bazë, në të gjitha teoritë e së drejtës dhe në legjislacionet e ndryshme penale, janë parashikuar masa dënimi shumë më të buta, se ato që aplikohen për të njëjtat vepra, për personat e rritur. Duke patur parasysh, që qëllimi kryesor i dënimit është riedukimi dhe risocializimi i të dënuarit, te personat e mitur është shumë i rëndësishëm ky parim, pasi ata janë në hapat e para të jetës, ndaj masat penale që merren ndaj tyre duhet që të kenë efekt parandalues dhe jo ndëshkues. Për këtë, legjislatori ka parashikuar trajtim të veçantë të personave të mitur, si në procesin gjyqësor që zhvillohet ndaj tyre, si në masat e dënimit që caktohen për vepra të ndryshme, ashtu edhe në mënyrën e ekzekutimit të dënimit. Ka teori të së drejtës, që të mitur konsiderojnë personat që nuk kanë mbushur moshën 21 vjeç. Në ligjin penal shqiptar, nuk parashikohet ndonjë trajtim i veçantë për personat nga 18 deri në 21 vjeç, por në mbështetje të nenit 49 të Kodit Penal, gjykatat e kanë konsideruar si rrethanë lehtësuese moshën e re të autorit të veprës penale. Kështu, po të shohim vendimet e gjykatave shqiptare, do të vërejmë që për personat e rinj, sidomos kur ata ndjekin proceset shkollore dhe nuk janë recidivistë, janë aplikuar masa dënimi më të buta, se për të rriturit.

---

<sup>85</sup> Neni 3, i ligjit nr.37/2017.

➤ **Përfshirja e të miturit në procesin gjyqësor si viktimë dhe dëshmitar në proces**

Në manualin “Për procesin gjyqësor ku fëmijët përfshihen si viktima apo dëshmitarë të veprës penale”<sup>86</sup> miratuar nga UNDOC dhe UNICEF, udhëzuesit në këtë manual parashikojnë një sërë masash për të parandaluar vështirësitë gjatë një procedimi penal me të mitur, me qëllim respektimin e interesit të lartë të fëmijës dhe dinjitetit të tij, sidomos në rastet kur ata janë viktima ose dëshmitarë në këtë proces.

Pikërisht një nga çështjet, për të cilat dua të ndalem në këtë punim është ajo e procesit gjyqësor, ku të miturit përfshihen si viktima dhe dëshmitarë të veprës penale.

Ndodh shpesh në praktikë, që në sistemet e drejtësisë penale, viktimat e veprës penale të harrohen. Kur flasim për harresë sjellim në vëmendje faktin se një sistem i paanshëm, efektiv dhe human i gjykimit penal është ai sistem, që respekton të drejtat themelore të të dyshuarve dhe të autorëve të veprave penale, si dhe ato të viktimave, dhe që mbështetet te parimi se viktimat duhen vlerësuar drejtë dhe duhen trajtuar me respekt dhe në mënyrë dinjitoze. Kategoritë e viktimave, përfshirë të miturit, të cilat janë veçanërisht të cenueshëm, për shkak të karakteristikave të tyre personale ose rrethanave të veprës penale, duhet të përfitojnë nga trajtimi i përshtatur me situatën e tyre.

Ekzistojnë standarde dhe rregulla në fushën e drejtësinë penale dhe trajtimin e të pandehurve, të cilat ofrojnë një tërësi udhëzimesh për të gjithë ato vende, që janë në reformim e sipër të sistemeve të tyre të procedimit penal. Në fushën e trajtimit të fëmijëve nga ana e sistemit të drejtësisë penale, këto rregulla dhe norma, sikurse i kemi trajtuar edhe në kapitujt pararendës të këtij punimi, përfshijnë:

- “Rregullat minimale standarde të Kombeve të Bashkuara lidhur me administrimin e proceseve gjyqësore me të pandehur në moshë të mitur”, të njohura ndryshe si Rregullat e Pekinit<sup>87</sup>;
- Udhëzuesit e Kombeve të Bashkuara “Për parandalimin e krimit të kryer nga të mitur” ose Udhëzuesit e Riadit<sup>88</sup>;

---

<sup>86</sup> Seria e manualeve për legjislacionin penal, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Kontrollin e Drogës dhe Parandalimin e Veprave Penale ( UNDOC), Kombet e Bashkuara, New York, 2009.

<sup>87</sup> Rezoluta 40/33 e Asamblesë së Përgjithshme, Shtojca.

- Rregullat e Kombeve të Bashkuara “Për mbrojtjen e të miturve që iu është privuar liria”<sup>89</sup> dhe,
- Udhëzuesit “Për veprimet me fëmijët në sistemin e drejtësisë penale”<sup>90</sup>.

Në fushën e mbrojtjes së viktimave:

- Deklarata “Për parimet bazë të legjislacionit për viktimat e veprës penale dhe shpërdorimit të pushtetit”<sup>91</sup>;
- Rezoluta e Këshillit Ekonomik dhe Social 1989/57, “Për zbatimin e Deklaratës “Për parimet bazë të legjislacionit për viktimat e veprës penale dhe shpërdorimit të pushtetit” dhe,
- Plani i veprimit “Për zbatimin e Deklaratës “Për parimet bazë të legjislacionit për viktimat e veprës penale dhe shpërdorimit të pushtetit”<sup>92</sup>.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e cila ka karakter universal, përmban dispozita të përgjithshme, lidhur me fëmijët viktimë të abuzimit dhe drejtësisë për të mitur<sup>93</sup>. Dispozita përkatëse për mbrojtjen e viktimave<sup>94</sup> gjenden në aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe janë detyruese nga pikëpamja ligjore<sup>95</sup>.

Në Rezolutën e tij 2005/20, Këshilli Ekonomik dhe Social miratoi disa udhëzues lidhur me procesin gjyqësor, ku fëmijët përfshihen si viktimë dhe dëshmitarë të veprës penale. Këta udhëzues plotësuan një boshllëk në standardet ndërkombëtare në fushën e trajtimit të fëmijëve si viktimë ose dëshmitarë të veprës penale<sup>96</sup>.

<sup>88</sup> Rezoluta 45/112 e Asamblesë së Përgjithshme, Shtojca.

<sup>89</sup> Rezoluta 45/113 e Asamblesë së Përgjithshme, Shtojca.

<sup>90</sup> Rezoluta 1997/30 e Këshillit Ekonomik dhe Social, Shtojca.

<sup>91</sup> Rezoluta 40/34 e Asamblesë së Përgjithshme, Shtojca.

<sup>92</sup> Rezoluta 1998/21 e Këshillit Ekonomik dhe Social, Shtojca. Në fakt, ky plan veprimi nuk parashikonte udhëzues të hollësishëm dhe të posaçëm për trajtimin e fëmijëve si viktimë ose dëshmitarë të veprës penale.

<sup>93</sup> Kombet e Bashkuara, Seria e Traktateve, vol. 1577, nr. 27531.

<sup>94</sup> Po aty, nenet 19, 39 dhe 40, të Serisë së Traktateve.

<sup>95</sup> Kombet e Bashkuara, Seria e traktateve, vol. 2187, nr. 38544, Nenet 68, 75 dhe 79. Kombet e Bashkuara, Seria e traktateve, volumet 2225, 2237, 2241 dhe 2326, nr. 39574, nenet 6-8.

Psh, Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërshtetëror dhe Protokollat e saj, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, etj.

<sup>96</sup> Konkretisht, një prej tyre është manuali “Për procesin gjyqësor, ku fëmijët përfshihen si viktimë dhe dëshmitarë të veprës penale”, një botim i UNICEF dhe UNODC, OKB, udhërrëfyes për politikbërësit dhe organet ligjzabuese, apo çdo aktor tjetër si psh : OJF që vepron në fushën e drejtësisë penale për të mitur, por jo vetëm.

Ajo që kërkohet të arrihet, nëpërmjet miratimit të këtyre dokumenteve është ofrimi i një kuadri praktik për arritjen e disa objektivave të rëndësishëm, përmbushja e të cilëve përfaqëson përvojën pozitive të një vendi, për arritjen e standardeve bashkëkohore në sistemin e drejtësisë penale për të miturit, mbështetur kjo në ndërthurjen e përvojave pozitive të vendeve të zhvilluara, sistemeve bashkëkohore të drejtësisë penale për të miturit delikuentë, si dhe normave, standardeve dhe parimeve përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale.

Disa prej këtyre objektivave janë si vijon:

- Ofrimi i asistencës në rishqyrtimin e ligjeve, procedurave dhe praktikave kombëtare, me qëllim që ato të sigurojnë respektimin e plotë të të drejtave të fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të veprës penale dhe të nxitin e garantojnë zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës nga shtetet palë nënshkruese të kësaj Konvente;
- Krijimi i kushteve të duhura dhe ofrimi i asistencës në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit, politikave, programeve, strategjive sektoriale e ndërsektoriale, si dhe praktikave që trajtojnë çështje të rëndësishme lidhur me fëmijët viktime dhe dëshmitarë të veprës penale për qeveritë, organizatat ndërkombëtare, agjencitë shtetërore, OJF-të, si dhe palët e interesuara;
- Drejtimi i profesionistëve dhe, sipas rastit, edhe OJF-ve, që punojnë me fëmijët viktime dhe dëshmitarë të veprës penale, në praktikën e tyre të përditshme në procesin e drejtësisë për të mitur në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar, në përputhje me Deklaratën “Për parimet bazë të legjislacionit për viktimat e veprës penale dhe shpërdorimit të pushtetit”;
- Ofrimi i asistencës dhe mbështetjes së duhur për të gjithë ata, që kujdesen për fëmijët, në trajtimin me ndjeshmëri të fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të veprës penale;
- Ofrimi i asistencës profesionistëve dhe politikëbërësve, që zbatojnë dispozitat akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve apo disa udhëzuesve të kësaj fushe<sup>97</sup>.

---

<sup>97</sup> Psh, një i tillë është edhe manuali për udhëzuesin “Për procesin gjyqësor ku fëmijët përfshihen si viktime dhe dëshmitarë të veprës penale”. Ky manual mbështetet në përvojat më të mira ndërkombëtare në trajtimin nga ana e sistemit të drejtësisë penale të fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të veprës penale. Ai synon të shërbejë si udhërrëfyes për profesionistët dhe politikëbërësit, që merren me fëmijët viktime dhe dëshmitarë të veprës penale, siç janë gjyqtarët, personeli mjekësor dhe ndihmës, punonjësit e rendit, prokurorët, punonjësit socialë, personeli i organizatave joqeveritare dhe mësuesit. Manuali është hartuar duke patur parasysh se kuadri ligjor, social, ekonomik dhe kulturor është i ndryshëm nga njëri vend në tjetrin. Ndaj, nuk është e thënë që masat, të cilat propozohen në këtë manual, të jenë urdhëruese për vendet të cilat e zbatojnë, përkundrazi masat e trajtuara në të ofrojnë alternativa për vendet që janë të gatshme të trajtojnë nevojat e veçanta të fëmijëve viktime dhe

- *E drejta për fshehtësinë e informacionit*

Fshehtësia e informacionit për fëmijët viklima dhe dëshmitarë duhet mbrojtur si çështje me rëndësi të veçantë. Nxjerrja e informacionit për një fëmijë viktimë ose dëshmitar, sidomos në media, mund të ketë pasoja dramatike të fëmija. Kjo gjë mund të vërë në rrezik sigurinë e fëmijës. Gjithashtu, mund të bëjë që fëmija të ndihet mjaft i turpëruar dhe i poshtëruar, mund ta shkurajojë atë që të tregojë se çfarë ka ngjarë, si dhe mund të shkaktojë dëm shumë të madh emocional tek ai. Nxjerrja e informacionit për një fëmijë viktimë ose dëshmitar mund të tensionojë marrëdhëniet e fëmijës me familjen, bashkëmoshatarët dhe komunitetin, sidomos në rastet e abuzimit seksual. Në disa raste, kjo gjë mund të çojë edhe në stigmatizim nga ana e komunitetit, duke përkeqësuar kështu viktimizimin dytësor të fëmijës<sup>98</sup>.

Përgjithësisht, pranohet se të gjitha viktimat kanë të drejtën për fshehtësinë e informacionit, por fëmijët viklima, në veçanti, e kanë këtë të drejtë që, nganjëherë, garantohet në kushtetutën e shteteve<sup>99</sup>.

Në praktikën ndërkombëtare ekzistojnë dy mënyra thelbësore për mbrojtjen e fshehtësisë së informacionit lidhur me fëmijët viklima dhe dëshmitarë:

- *së pari*, kufizimi në bërjen publike të informacionit për fëmijët viklima dhe dëshmitarë dhe,
- *së dyti*, kufizimi në praninë në sallat e gjyqeve të publikut të gjerë apo personave që nuk janë të domosdoshëm e që nuk kanë lidhje me çështjen.

Në rastin e kufizimit të informacionit për një fëmijë viktimë apo dëshmitar në një proces penal, masa e parë për mbrojtjen e fshehtësisë së informacionit për ta, është kufizimi i deklarimit të informacionit, që mund të çojë në identifikimin e një fëmije, i cili është viktimë

---

dëshmitarë të veprës penale. Në përputhje me strukturën dhe përmbajtjen e udhëzuesve, manuali është i përbërë nga 12 kapituj, të cilat trajtojnë, përkatësisht, interesin më të lartë të fëmijës, të drejtën për t'u trajtuar me dinjitet dhe dhembshuri, të drejtën për t'u mbrojtur nga diskriminimi, të drejtën për t'u informuar, të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet, të drejtën për asistencë të efektshme, të drejtën për fshehtësinë e informacionit, të drejtën për t'u mbrojtur nga vështirësitë gjatë procesit gjyqësor, të drejtën për siguri, të drejtën për dëmshtëpërblim, të drejtën për masa të posaçme parandaluese, si dhe zbatimin e udhëzuesve.

<sup>98</sup> Neni 8 (e) i Protokollit Fakultativ të Konventës për të Drejtat e Fëmijës për shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve, ratifikuar me ligjin nr.9834/2007, "Aderimi i RSH në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së, "Për të drejtat e fëmijëve"", përcakton se: "*...për të mbrojtur fshehtësinë e informacionit dhe identitetin e fëmijëve viklima dhe për të shmangur përhapjen e papërshtatshme të informacionit, duhen marrë masat e duhura...*"

<sup>99</sup> Egjipt, Kushtetuta, Nenet 44-45 dhe 57.



ose dëshmitar në procesin gjyqësor. Në disa shtete, autoritetet gjyqësore ngarkohen me përgjegjësinë që të garantojnë fshehtësinë e informacionit për identitetin dhe vendndodhjen e fëmijës<sup>100</sup>. Ky rregull zbatohet për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë, si dhe për fëmijët që janë në konflikt me ligjin. Në fakt, fshehtësia e informacionit duhet të sigurohet për të gjithë viktimat, pavarësisht nga mosha e tyre, apo format e caktuara të kriminalitetit, si p.sh.: krimet seksuale. Kufizimi ndaj deklarimit të informacionit mbron palët e përfshira, pavarësisht nga mjeti i deklarimit të mundshëm, me gojë, me shkrim apo në mënyrë audio-vizuale.

Rast nga praktika ndërkombëtare, për sa i përket garantimit të fshehtësisë së informacionit në këto raste, lidhur me këtë kategori të të miturve, mund të gjendet në legjislacionin federal të Shteteve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë<sup>101</sup>.

Por, praktikat ligjore janë të ndryshme nga njëri vend në tjetrin. Ajo që është më kryesorja, lidhur me kufizimin dhe ruajtjen e fshehtësisë së informacionit për të miturit delikuentë, viktimë apo dëshmitarë në një proces gjyqësor, është ndërgjegjësimi i opinionit publik, medias së shkruar dhe vizive, rrjeteve *on-line* të gazetarisë, televizioneve, që në raste të kësaj natyre të mos publikojnë të dhëna, foto apo gjithçka tjetër që lidhet me këtë kategori. Ose, për aq sa është e mundur, edhe në raste e transmetimit të këtij lloji informacioni, fotot e të miturve të mos bëhen publike<sup>102</sup>.

Në rastin e dytë, kufizimi i pranisë së publikut gjatë procedurave në sallën e gjyqit, ku përfshihet një i mitur delikuent, viktimë ose dëshmitar, është një masë e nevojshme për mbrojtjen e fshehtësisë së informacionit. Zakonisht, gjykata lëshon urdhrat për kufizimin e pranisë së publikut, të cilat mund të ndryshojnë në gamën e tyre. Nganjëherë, gjykata mund të urdhërojë kufizimin e pranisë vetëm për kategori të caktuara të personave. Sidoqoftë,

---

<sup>100</sup> Kenia, Akti për Fëmijët, 2001 (Kapitulli 8 i Legjislacionit të Kenias), Seksioni 76 (5).

<sup>101</sup> Shtetet e Bashkuara, "Përmbledhje e Kodeve të Shteteve të Bashkuara", 18, Kapitulli 223, Pjesa 3509, "Të drejtat e fëmijëve viktimë dhe fëmijëve dëshmitarë", Nënseksioni (d), "Mbrojtja e fshehtësisë së informacionit", ku në mënyrë eksplicite parashikohet se: "*...Një person, i cili vepron në cilësinë e përcaktuar në nënparagrafin (B) lidhur me një procedim penal:*

*i) i mban të gjitha dokumentet që bëjnë publik emrin ose ndonjë informacion tjetër për fëmijën në një vend të sigurt ku nuk ka akses asnjë person, i cili nuk ka arsye që ta dijë përmbajtjen e tyre; dhe ii) ua bën të njohura dokumentet e përcaktuara në dispozitën (i) ose informacionin që përmbajnë ato për një fëmijë vetëm personave, të cilët, për shkak të pjesëmarrjes së tyre gjatë procedurave të ndjekjes penale, kanë arsye për ta ditur këtë informacion..".* Ky parashikim ligjor zbatohet për të gjithë punonjësit e shtetit, që kanë lidhje me çështjen, përfshirë punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë, ndonjë agjenci ligjzbatuese, të përfshirë në çështje, dhe ndonjë person të punësuar nga shteti për të ofruar asistencë gjatë procedurave të ndjekjes penale, punonjësit e gjykatës, të pandehurin dhe personat që e asistojnë atë, përfshirë avokatin dhe personat e punësuar nga i pandehuri apo avokati i të pandehurit, të cilët ofrojnë asistencë gjatë procedurave të ndjekjes penale dhe, anëtarët e jurisë.

<sup>102</sup> Në këto raste, mospublikimi i këtij informacioni, është çështje vullneti dhe morali, nëse për të nuk ka një rregullim ligjor të posaçëm.

legjislacioni vendas i shumicës së shteteve parashikon përjashtimin e plotë të publikut nga ana e gjykatës, gjë që çon në zhvillimin e procedurave gjyqësore në seanca të me dyer të mbyllura, me qëllim mbrojtjen e fshehtësisë së informacionit për këtë kategori<sup>103</sup>. Këtë urdhër mund ta lëshojë gjykata *proprio motu* (me nismën e vet) ose me kërkesën e veçantë të njëjës palë. Ndodh, që në rregulloret e përgjithshme, që sanksionojnë dhënien e urdhrit për seancat me dyer të mbyllura në rastet kur, përfshihen të mitur delikuentë, viktima ose dëshmitarë, plotësohen me dispozita që, automatikisht, përcaktojnë seanca me dyer të mbyllura lidhur me figura të veçanta krimi, si psh: krimet seksuale ose trafikimi i qenieve njerëzore<sup>104</sup>.

Për sa më sipër, të gjithë aktorët pjesëmarrës në një procedurë gjyqësore, si gjyqtarët, prokurorët, avokatët, punonjësit e policisë së shtetit, media e shkruar dhe vizive, etj, në këto raste duhet të respektojnë fshehtësinë e informacionit për fëmijët delikuentë, viktima dhe dëshmitarë të veprës penale dhe të kërkojnë marrjen e masave për mbrojtjen e identitetit të fëmijës delikuent, viktimë ose dëshmitar. Nëse këto masa nuk zbatohen automatikisht, organet ligjzbatuese të ndjekin penalisht këdo që shkel të drejtat e fëmijës përsa i takon jetës private apo fshehtësisë së informacionit.

- *E drejta për t'u mbrojtur nga vështirësitë gjatë procesit gjyqësor*

Natyrisht, përballja me një proces gjyqësor është një ngjarje që lë gjurmë në ndërgjegjen e çdo individi, aq më tepër kur ky individ është një i mitur. Në proceset gjyqësore ku marrin pjesë të miturit është detyrë e organeve kompetente për të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme, në mënyrë që të respektohet interesi më i lartë i fëmijës dhe dinjiteti i fëmijëve viktima apo dëshmitarë<sup>105</sup>.

Përgjatë të gjitha fazave, nëpër të cilat kalon një proces gjyqësor, fëmijët viktima apo dëshmitarë, janë të ekspozuar ndaj vështirësive të ndryshme, të cilat mund të konsiderohen pa frikë si viktimizim për së dyti për të miturin e ndodhur në një situatë të tillë. Ndaj, është e

---

<sup>103</sup> Bosnjë-Hercegovinë, Kodi i Procedurës Penale, nr. 56/03, 2003, Neni 250.

<sup>104</sup> Zvicër, Ligji Federal "Për ndihmën për viktimat e veprave penale", Përmbledhje e legjislacionit federal (RS) 312.5, 1991, neni 5 (3).

<sup>105</sup> Udhëzuesit "Për procesin gjyqësor ku fëmijët përfshihen si viktima dhe dëshmitarë të veprës penale", kapitulli XI, "E drejta për t'u mbrojtur nga vështirësitë gjatë procesit gjyqësor" parasheh se : "... **Profesionistët duhet të marrin masa për të parandaluar vështirësitë gjatë zbulimit, hetimit dhe procesit gjyqësor, me qëllim respektimin e interes të lartë dhe dinjitetit të fëmijëve viktima dhe dëshmitarë...**", fq.67, botim i UNDOC dhe UNICEF.

nevojshme, që në këto raste të përdoren procedura të veçanta, të përshtatshme për të miturin, përfshirë dhoma të veçanta të marrjes në pyetje, pushime të shpeshta gjatë kohës së dëshmisë, sisteme të veçanta të njoftimit, me qëllim që i mituri të paraqitet në gjykatë, vetëm kur është e nevojshme prania e tij, etj. Gjithashtu, duhet të shmangin vonesat në senacat e gjykimit, me qëllim që ato të zhvillohen më shpejt, si dhe të ofrojnë siguri për procesin, për rritjen e besueshmërisë së të miturit në të.

#### **2.4. Dënimi me burgim, si mjet i fundit ndaj të pandehurit të mitur në përputhje me përjashtimin e procedurave gjyqësore**

Një ndër standardet ndërkombëtare të drejtësisë për të mitur është përdorimi i masave të burgimit si mjet i fundit dhe riintegrimi si synim i sistemit të drejtësisë. Drejtësia duhet të jetë e butë me fëmijët dhe të jetë në krah të tyre. Heqja e lirisë si mjet i fundit dhe për një periudhë të shkurtër kohe është shprehur qartë dhe trajtuar në aktet ndërkombëtare, të cilat i kam trajtuar më herët në këtë studim.

Ajo çka është e rëndësishme në aspektin e aplikimit të masës “*dënim me burgim*” është pasja dijëni mbi zbatimin e dispozitave ligjore në favor të drejtësisë për të mitur dhe boshllëqet përkatëse. Kjo realizohet duke u fokusuar fillimisht te legjislacioni kombëtar.

Kushtetuta e RSH-së, përmend termin “*i mitur*” si vijon: “*...Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme: ...ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent...*”<sup>106</sup>.

Edhe në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet një trajtim specifik lidhur me këtë parim, por ky Kod bazohet në kriterin e mosarrestimit të të miturit, kur ai akuzohet për kundravajtje penale<sup>107</sup>.

Në rastet e caktimit të masës së sigurimit personal, gjykata nuk mund të ndërpresë proceset edukative konkrete<sup>108</sup>. Edhe pse, nuk ka gjetur pasqyrim shprehimisht në legjislacionin penal, në praktikë ndodh e kundërta.

<sup>106</sup> Neni 27/c Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>107</sup> Neni 230/4 Kodi i Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

<sup>108</sup> Po aty, neni 229/3.

Të trajtosh një të mitur që ka kryer një vepër penale nuk mund të krahasohet me trajtimin e një të rrituri që ka kryer po një të tillë. Kjo, sepse një fëmijë, jo vetëm që nuk ka aftësinë për të përballuar fizikisht qëndresën në këto institucione, por qëndrimi i tij aty, do të nxisë kureshtjen për “t’u specializuar” në fushën e krimit. Ndërkohë, që nuk është aspak qëllimi që i nevojitet një fëmije që ka gabuar në kryerjen e një vepre penale. Përdorimi i foljes “gabuar” në këtë rast, ka të bëjë me faktin se vetë mosha e një të mituri të bën të mendosh, se ekzistojnë faktorë të ndryshëm që e shtojnë atë drejt kësaj rruge. Janë të rriturit ata, që pavarësisht rrethanave, kanë dështuar në rritjen dhe mirë-edukimin e fëmijëve të tyre, duke bërë shpesh herë që forma më e parapëlqyer për edukimin të jetë përdorimi i dhunës ndaj të miturve. Dhunë kjo, që shërben si një shembull demonstrues në veprimtarinë kriminale të të miturit të pandehur. Fryma e evidentimit të më të “fortit” e paraqitur në familjen e tyre, i shtyn të miturit që t’a demostrojnë këtë edhe në mjedise të tjera shoqërore, shkollore, duke u bërë kështu, shkak për një veprimtari kriminale<sup>109</sup>.

Ndër mekanizmat e duhur, për largimin e të miturve nga rruga e kriminalitetit është krijimi i mundësive për ndjekjen e shkollave të arsimit e formimit profesional, për profesione të ndryshme, si psh: marangoz, hidraulik, teknik ndërtimi, etj<sup>110</sup>. Natyrisht, që bashkëpunimi e bashkëveprimi ndër-institucional, ndërmjet të gjithë organeve ligjzbatuese, agjencive shtetërore, OJF-ve, komunitetit, familjes, bën të mundur orientimin e të miturve drejt integritit në shoqëri.

Në Shqipëri është bërë progres në administrimin e drejtësisë për të miturit, për t’a bërë sistemin sa më njerëzor, duke ofruar garanci ligjore dhe procedurale, dhe duke kaluar nga një sistem ndëshkues në një sistem me një qasje të drejtësisë që edukon dhe riintegron. Kështu, përpara se i mituri të kryejë veprimtari kriminale, është e nevojshme edukimi i tij ligjor në një gjuhë të kuptueshme dhe të thjeshtë. Ky edukim duhet bërë praktikë e shpeshtë, me qëllim shmangien e minimizimin e dukurive kriminale.

---

<sup>109</sup> Lidhur me këtë çështje, një hap i rëndësishëm është ndërmarrë nga ish- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me Këshillin e Europës, në drejtim të prezantimit të dokumentit politik “E ardhmja e Sistemit të Integruar të Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri”. Një ndër objektivat kryesore të këtij dokumenti ishte krijimi i një sistemi të drejtësisë sa më miqësor për fëmijët.

<sup>110</sup> Alternativa më e mirë është orientimi drejt edukimit dhe në këtë aspekt, edhe ofrimi i një profesioni apo shkolle që të mësojë një zant, sepse kjo është mënyra më e mirë që të integrohet në shoqëri, por edhe t’i shërbejë asaj.

Kështu, në kuadrin ligjor në fuqi, një ndër institucionet shtetërore, Shërbimi i Provës<sup>111</sup>, në përmbushjen e veprimtarisë së tij administrative, ka marrë një mision të ri ligjor, atë të realizimit të mbikëqyrjes elektronike, në funksion të kontrollit të zbatimit të urdhërimeve që përmban një vendim gjyqësor, që cakton një nga alternativat e dënimit me burgim, dënim plotësues, një nga llojet e masave shtrënguese, apo një urdhër mbrojtjeje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje<sup>112</sup>. Kjo masë, mbikqyrja elektronike e largon tërësisht të miturin nga rruga e burgut dhe nga trajtimi me burg, duke e shmangur në këtë mënyrë burgun si masë alternative të edukimit të të miturit. Ata të mitur që janë gjendur në rrethana kriminale, në rrethana të shkeljes së ligjit nuk është e nevojshme të trajtohen në IEVP, si të rriturit apo njësoj me ta por, ata mund të akomodohen në Shërbimin e Provës, në mënyrë që të ritrajtohen në pjesën e mbetur me Shërbimin e Provës.

Masat e ndryshme, si pajtimi midis viktimës dhe shkelësit të ligjit, praktikave dëmshpërblyese dhe dënimet alternative për të miturit, që janë zbatuar së fundmi, kanë kontribuar në alternativa ndaj masës me burg për të miturit që kanë shkelur ligjin. Burgimi ka pasoja negative për të ardhmen e të miturve. Burgimi ndërpret edukimin normal dhe zhvillimin, për më tepër nuk mund të shihet si alternativa më e mirë për të parandaluar shumë të mitur që të kryejnë përsëri krime<sup>113</sup>. Drejtësia ndëshkuese nuk është zgjidhje. Kërkohej një qasje më gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe kujdesin. Ideale do të ishte miratimi i politikave që do t'u ofronin të rinjve shanse më të mira në jetë, arsimim dhe mundësi punësimi, kur të arrijnë moshën madhore.

Paketa ligjore për drejtësinë për të miturit e modifikon “*arrestin në burg*” duke parashikuar ndër të tjera, që në rastin e të miturve të mos aplikohet arresti me burg për vepra penale që

---

<sup>111</sup> Me ligjin nr.10 494, datë 22.12.2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, në nenin 12 të tij, parasheh se “*...institucioni kompetent për realizimin e mbikëqyrjes elektronike (ME) është Shërbimi i Provës..*”. Shërbimi i Provës, në mënyrë periodike, informon Ministrinë e Drejtësisë për kontrollet e ushtruara për mënyrën e realizimit të ME-së. Shërbimi i Provës vendos, çdo javë, në dispozicion të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit, të dhëna të përditësuara për numrin e pajisjeve në dispozicion për përdorim dhe mundësinë teknike të realizimit të ME-së. Metodologjia dhe rregullat e ushtrimit të kontrolleve të Shërbimit të Provës për mënyrën e realizimit të ME-së, periodicitetit dhe përmbajtja e informacionit të përcjellë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe rregullat për paraqitjen e të dhënave të përditësuara pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

<sup>112</sup> Shih nenin 1, të ligjit nr.10494, datë 22.12.2011, “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

<sup>113</sup> Në raportin kombëtar për situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 2013-2014, një botim i ish-MMSR ASHTMDF dhe UNICEF, është përfaqësuar një qasje e re në monitorimin e situatës së të drejtave të fëmijëve. Ky raport nuk kufizohet vetëm në analizën e zbatimit të objektivave të identifikuar në Planin e Veprimit për Fëmijët, 2012-2015, por ai fokusohet më gjerë mbi situatën e të drejtave të fëmijëve me qëllimin, për të kuptuar në mënyrë sa më të plotë këtë situatë dhe problematikën e saj, ku një ndër më kryesoret mbetet kriminaliteti i të miturve.

dënohen me 2 vjet burg. Nga analiza e legjislacionit dhe zbatimit praktik të tij rezulton, se edhe masa e sigurimit “*arrest në shtëpi*” në rastin e të miturit që ndjek proceset edukative do të ketë vështirësi në realizimin e këtij procesi. Zbatimi në praktikë i masave të sigurimit evidenton faktin se, ndërkohë që sipas standardeve ndërkombëtare të sipërcituara arresti me burg duhet të jetë masa e fundit, në praktikën gjyqësore rezulton që bilanci të jetë i përmbysur. Ajo çka të bie më shumë në sy është, që aplikimi i masës “*arrest me burg*” kundrejt masave të tjera është në një nivel të dukshëm më të lartë.<sup>114</sup> Parimi i heqjes së lirisë si mjet i fundit ndaj të pandehurit të mitur, qëndron në përputhje me standardin e përjashtimit të procedurave gjyqësore dhe atyre institucionale. Nga analiza e vendimeve gjyqësore konstatohet, se në disa raste gjykata nuk mban parasysh mos ndërprerjen e proceseve edukative, duke caktuar si masë sigurimi “*arrest në burg*” për të mitur që janë nxënës shkolle. Nuk ndodh e njëjta gjë në rastet, kur vendoset masë sigurimi e ndryshme nga “*arrest në burg*”. Në këtë rast, gjykata bën kujdes dhe, gjithmonë përmend faktin, që autori është i mitur dhe merr parasysh statusin e tij “si nxënës shkolle”.

Një mënyrë e përjashtimit të procedurave gjyqësore është dhe ndërmjetësimi ndaj të miturve, si veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjans (ndërmjetësi), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin<sup>115</sup>. Në rastet e të miturve në konflikt me ligjin, ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm nëse ekziston pëlqimin i lirë për ndërmjetësim i shprehur si nga i të miturit i akuzuar i veprës penale dhe palës së dëmtuar dhe dhënia e pëlqimit është detyrim për t’u shënuar në procesverbalin e organit procedues. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm me pjesëmarrjen personale të të miturit autor i veprës penale dhe palës së dëmtuar. Gjithashtu, në procesin e ndërmjetësimit, me pëlqimin e palëve, mund marrin pjesë edhe përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij<sup>116</sup>. Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rastit, mund të zbatohet edhe

---

<sup>114</sup> “Drejtësia për të mitur në Shqipëri”, një analizë e sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri, fq. 20

<sup>115</sup> Neni 64, i ligjit nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit”, miratuar nga Parlamenti në datën 30.3.2017 dhe bortuar në FZ nr.92, fq.5210. Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2018. Ndërkohë, procedura e ndërmjetësimit zhvillohet në bazë të këtij Kodi dhe ligjit në fuqi për ndërmjetësimin. Gjithashtu, shih Manualin “Shërbimi i ndërmjetësimit dhe drejtësia restauruese për të miturit në konflikt me ligjin” – për procedurat e ndërmjetësimit përmes gjykatës, botim i kuadër të projektit Institucionalizimi i Drejtësisë Restauruese dhe Ndërmjetësimit Viktimë-Kundërvajtës për të Miturit në Shqipëri”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga organizata “Save the Children” në partneritet me Fondacionin “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”. Përgatitja e manualit u realizua në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Tiranë 2015.

<sup>116</sup> Po aty, ligji përcakton se Prokurori mund të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimit nëse ai e vlerëson.

si masë shmangieje, por edhe si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale<sup>117</sup>.

Paraqet rëndësi marrja e masave të nenevojshme dhe të domosdoshme, për trajtimin e fëmijëve të mitur, pa ju drejtuar procedurës gjyqësore, me qëllim promovimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe në mënyrë të posaçme garanton mbrojtjen ligjore<sup>118</sup>.

Janë të shumta konventat e ratifikuara nga vendi ynë, lidhur me të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti. Në bazë të Kushtetutës, këto akte ndërkombëtare bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe janë të detyrueshme për zbatim. Ajo çka konstatohet është se shpesh herë në praktikë rezulton, se niveli i njohjes së tyre dhe zbatimit nga gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët është i kufizuar. Kjo sjell mosaplikimin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sistemi i drejtësisë dhe mosvënien e tyre në shërbim të atyre që kërkojnë akses në drejtësi<sup>119</sup>.

Domosdoshmëria e reduktimit të masave të kufizimit të lirisë për të miturit vjen si një rekomandim i fortë edhe prej Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve. Burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër<sup>120</sup>. Edhe Rregullat e Pekinit parashikojnë pikërisht këtë gjë, duke dhënë një standard të përgjithshëm mbi termat “*masë e fundit*” dhe “*për një periudhë sa më të shkurtër kohë*”<sup>121</sup>.

Ajo që vlen të theksohet, është se në rastet kur shihet e arsyeshme, zbatohen masat alternative të llojit: përkujdesi intesiv apo sistemimi në një institucion edukimi apo familje. Ekzistojnë edhe raste, kur paraburgimi nuk mund të evitohet dhe masat alternative nuk mund

---

<sup>117</sup> Shih ligjin nr.10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim funksionimin dhe realizimin e shërbimit të ndërmjetësimit. Ai përshkruan dispozitat bazë që duhet të ndiqen nga ndërmjetësi, si dhe bazën për procesin e plotë të ndërmjetësimit, duke filluar me referimin e çështjes, e më pas me procedurën e ndërmjetësimit, caktimin e ndërmjetësit dhe raportimin në gjykatë/institucion tjetër referues lidhur me rezultatin e çështjes së ndërmjetësuar (neni 1, i ligjit)

<sup>118</sup> Neni 40/5/b i Konventës së OKB-së, “Për të drejtat e fëmijëve”, ratifikuar nga Parlamenti me ligjin nr.7531/1991.

<sup>119</sup> Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore ka rezultuar se përgjithësisht referimi tek këto konventa është në nivele tepër të ulëta.

<sup>120</sup> Neni 37 i KDF.

<sup>121</sup> Shih trajtimin që është bërë në Kreun III, lidhur me kuadrin ligjor ndërkombëtar.

të zbatohen<sup>122</sup>. Referuar sistemit tonë të drejtësisë, kur paraburgimi nuk mund të evitohet duhet që organi procedural të përpiqet që hetimi i çështjes të përfundojë sa më shpejt.

Duhet të njihet dhe të vlerësohet nevoja dhe rëndësia e politikave të parandalimit progresiv të kriminalitetit dhe të studimit sistematik e përpunimit të masave të nevojshme. Marja e këtyre masave duhet të shmangë inkriminimin dhe penalizmin e fëmijës për sjellje, që nuk i shkaktojnë dëme të rëndësishme zhvillimit të tij apo nuk dëmtojnë të tjerët.

Këto politika dhe masa duhet të përfshijnë:

- **sigurimin e mundësive**, në mënyrë të veçantë të atyre edukuese, për të plotësuar nevojat e ndryshueshme të të rinjve dhe të shërbejnë si një kuadër mbështetës për sigurimin e zhvillimit personal të të gjithë të rinjve;
- **ndërhyrjen zyrtare** që duhen ndjekur vetëm për/dhe në interesin e përgjithshëm të të rinjve duke u udhëhequr nga drejtësia dhe barazia;
- **ruajtjen e mirëqenies, zhvillimit, të të drejtave** dhe interesave të të gjithë të rinjve;
- faktin që sjelljet ose veprimet e të rinjve që nuk përputhen me normat dhe vlerat e përgjithshme shoqërore janë shpesh pjesë e procesit të rritjes e pjekurisë dhe kanë prirje të zhduken spontanisht në pjesën më të madhe të individëve gjatë kalimit në moshën e rritur.<sup>123</sup>

Disa nga parimet për mbrojtjen e të rinjve, të cilëve u është hequr liria janë si:

- heqja e lirisë për të miturit si masë e fundit;
- kohëzgjatja e kufizuar dhe vendosja e saj mbi një motiv të fortë juridik e gjykim objektiv;
- krijimi i njësive të institucioneve të hapura - prioritet;
- përgatitja e të miturve, të cilëve u është hequr liria, për rikthimin e lirisë dhe rikthimin në komunitet;
- rëndësia e programeve edukuese për ta;

---

<sup>122</sup> Kjo ndodh kur bëhet fjalë për një veprim të rëndë lidhur me dhunën ndajnjë personi tjetër ose përsëritje në kryerjen e shkeljeve të tjera të rënda dhe në rast kur nuk ka reagim tjetër të përshtatshëm, Rregulli 13.2 dhe 17.1(b) Rregullat e Pekinit.

<sup>123</sup> Udhëzimet e Riadit. Adoptuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/112, datë 14 dhjetor 1990.



- mbajtja e kontakteve me familjen<sup>124</sup>.

Sistemi i drejtësisë në vendin tonë, ashtu si edhe në shumë vende të tjera, po përpiqet të ndryshojë e të reformohet, duke kaluar nga një qasje ndëshkuese, drejt një sistemi, i cili vlerëson drejtësinë restauruese, përqafon parimet e rehabilitimit dhe riintegrimin në shoqëri dhe zbatimin e masave alternative ndaj burgimit, duke e parë kufizimin e lirisë së të miturve vetëm si një masë të fundit.

Një progres në këtë drejtim shënoi edhe miratimi Kodit për Drejtësinë për të Mitur<sup>125</sup>. Ky Kod e konsideron burgimin e të miturve vetëm si një masë të fundit dhe sanksionon masa alternative për fëmijët në konflikt me ligjin. Kodi e sjell sistemin e drejtësisë për të miturit, në përputhje me përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet ndërkombëtare, e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit<sup>126</sup>.

## **2.5. Ekzistenca e problemeve ligjore dhe praktike lidhur me dënimet ndaj të miturve**

Administrimi i sistemit të Drejtësisë për të Miturit dhe përputhshmëria e tij me standardet ndërkombëtare synon vendosjen në qendër të përdorimit të masave të burgimit si mjet i fundit dhe, riintegrimin si synim parësor të sistemit të drejtësisë. Parim i njohur sot në jurisprudencën ndërkombëtare për delikuencën e të miturve është : “...*Drejtësia duhet të jetë e butë me fëmijët dhe të jetë në krah të tyre...*”<sup>127</sup>.

Në vendin tonë, krijimi i një legjislacioni të posaçëm për drejtësinë penale për të miturit, miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve apo ratifikimi i disa protokolleve të zbatueshme të Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës, dëshmojnë për progresin e bërë në administrimin e drejtësisë për të miturit. Kjo me qëllimin kryesor të konsolidimit të sistemit të drejtësisë për të mitur, afrimin e tij drejt standardeve dhe normave bashkëkohore

---

<sup>124</sup>Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës)

<sup>125</sup> Ligji nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit”, miratuar nga Parlamenti në datën 30.3.2017 dhe bortuar në FZ nr.92, fq.5210. Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2018.

<sup>126</sup> Po aty, neni 2, i ligjit.

<sup>127</sup> Raport i organizatës ndërkombëtare UNICEF për gjendjen e drejtësisë për të mitur në Shqipëri, burimi [www.unicef.al](http://www.unicef.al)

ndërkombëtare, si dhe afilacionin me vlerat njerëzore, duke ofruar kështu garanci ligjore dhe procedurale për këtë kategori të shoqërisë.

Kalimi nga një sistem ndëshkues, në një sistem me një qasje të re, asaj të drejtësisë që edukon dhe riintegron, është fryma që përshkon sot të gjithë reformimin e kuadrit ligjor të sistemit të drejtësisë për të miturit.

Pikërisht, ndryshimet ligjore të miratuara në këtë fushë të rëndësishme të veprimtarisë jetësore, siç është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, dëshmojnë për ngritjen e nivelit të shërbimeve, që autoritetet shtetërore dhe organet ligjzbatuese do të ofrojnë për kategorinë më të brishtë të shoqërisë, duke sjellë instrumenta më të plota garancie, që do të siguronin mbrojtjen e interesave më të larta të fëmijëve, sidomos të atyre në konflikt me ligjin, në situatë rruge, viktime, të braktisur, etj<sup>128</sup>. Këto ndryshime nuk prekin thelbin e sistemit aktual dhe të instituteve kryesore, por vetëm rregullojnë disa çështje, që janë veçanërisht problematike dhe janë konstatuar të tilla në praktikën gjyqësore.

Një tjetër problem i hasur janë masat e ndryshme si: pajtimi midis viktimës dhe shkelësit të ligjit, praktikave dëmshpërblyese, dhe dënimet alternative për të miturit që janë zbatuar së fundmi, të cilat kanë kontribuar në alternativa ndaj masës me burg për të miturit që kanë shkelur ligjin<sup>129</sup>.

Një tjetër problematikë e hasur është situata në rajonet e policisë. Ka akoma raste kur të miturit në paraburgim mbahen në të njëjtën qeli me të rriturit<sup>130</sup>. Mbajtja e një të mituri në të

---


<sup>128</sup> Konkretisht edhe ndryshimet e miratuara së fundmi në ligjin nr.9062, datë 8.5.2003, "Kodi i familjes", botuar në FZ nr.49, fq.1907, prekin vetëm institutin e deklarimit të braktisjes (neni 250) dhe afatet për birësimin ndërvendas (neni 257). Këto ndryshime synojnë të lehtësojnë në mënyrë të menjëhershme birësimin e disa kategorive të fëmijëve, konkretisht fëmijëve të braktisur që nga lindja dhe fëmijëve të braktisur me qëllimin për t'u dhënë për birësim. Gjatë procesit gjyqësor të deklarimit të braktisjes, gjykata bën përpjekje për gjetjen e prindërve biologjikë të fëmijës dhe kthimin e fëmijës në familjen biologjike. Njoftimi i prindërve biologjikë bëhet në adresën e tyre zyrtare, adresën e dhënë në momentin e braktisjes së fëmijës në spital apo nëpërmjet Policisë së Shtetit. Përpjekjet për të gjetur prindërit, kryesisht nënën biologjike, jo vetëm zgjasin procedurën e deklarimit të braktisjes, por, në raste të caktuara mund të vënë në rrezik jetën e nënës dhe të shkaktojnë probleme të tjera, që i shtohen braktisjes së fëmijës. Ndërkohë, një numër i konsiderueshëm nënash që braktisin fëmijët që nga lindja, kërkojnë shprehimisht që të mos kontaktohen më, për shkaqe të ndryshme, që zakonisht lidhen me faktin se lindja e fëmijës është mbajtur e fshehtë nga familja dhe komuniteti ku ajo jeton. Këto ndryshime nuk prekin thelbin e sistemit aktual dhe të instituteve kryesore, si deklarimi i braktisjes dhe birësimi, por vetëm rregullojnë disa çështje që janë veçanërisht problematike në praktikën gjyqësore.

<sup>129</sup> Në vijim, në raportin e hartuar nga UNICEF, ky i fundit shpreh shqetësimin se shërbimi i provës nuk ofrohet njësoj për të miturit në të gjithë vendin dhe është pak i financuar dhe varet së tepërmi nga mbështetja e donatorëve.

<sup>130</sup> Në raportin e fundit të Komisionit Evropian, për parandalimin e torturës dhe dënimeve dhe trajtimeve çnjerëzore apo degraduese, ai vëren se trajtimi i të miturve në vendin tonë nuk përputhet me standardet ndërkombëtare. Kështu, në burgim, fëmijët nuk marrin shërbimet e duhura dhe ka vetëm 2 qendra paraburgimi për të miturit, konkretisht: në Vlorë dhe Lezhë, si dhe një institucion për integrimin e të miturve në Kavajë, ku gjenden të mitur të dënuar. Ky institut, i ndërtuar nga BE dhe mbështetur nga UNICEF, Save the Children dhe

njëjtin vend me një të rritur mund të dëmtojë rëndë shëndetin mendor dhe fizik të një të mituri. Veçimi i të miturit është një standard i vendosur tashmë nga një sërë dokumentesh ligjore dhe synon rehabilitimin e të miturit, nëpërmjet metodave, të cilat janë të ndryshme nga ato për të rriturit. Burgimi ka pasoja negative për të ardhmen e të miturve, pasi ai është një masë represive, që ndërpret edukimin dhe zhvillimin normal të tyre. Gjithashtu, si masë e ashpër dënimi, ajo nuk parandalon, por i shtyn shumë të mitur të kryejnë përsëri krime, duke u bërë kështu recidivistë<sup>131</sup>.

**Grafiku, i referohet periudhës kohore 2004-2012 dhe, prezanton nivelin e krimeve nga të miturit – mesatarisht 67% e të miturve të dënuar ka ardhur si pasojë e kryerjes së krimeve të rëndomta**



**Burimi: UNICEF**

Ajo që vlen të theksohet është se, gjithsesi drejtësia ndëshkuese nuk është zgjidhje. Kërkohe një qasje më gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe kujdesin. Parandalimi i kriminalitetit të të miturit është detyrë që i përket të gjithë shoqërisë, jo vetëm familjes dhe komunitetit. Detyrë parësore është hartimi i programeve të posaçme të parandalimit të dukurive dhe fenomeneve kriminale, me qëllim parandalimin e kriminalitetit të të miturit<sup>132</sup>.

disa OJQ vendore, ofron një model për trajtimin e të miturve të dënuar. Të dënuarve u ofrohen aktivitete edukuese, trajnuese, ndërmjetësimi, asistencë ligjore falas, dhe aktivitete ri-integruese. Pjesa më e madhe e të dënuarve janë të moshës 16-17 vjeç. Pjesa më e madhe e tyre e kishin braktisur shkollën dhe i përkasin komuniteteve Rom dhe Egjiptian. (www.coe.gov.al)

<sup>131</sup> Në analizën që i kam bërë raportit të UNICEF, duket haptazi shqetësimi që ky organizëm ngre, lidhur me numrin në rritje, ndër vite, të krimeve të kryera nga të miturit delikuentë. Në 2011, 683 të mitur morën dënime penale në Shqipëri. 470 raste krimi ishin krime ndaj pronës, diçka e klasifikuar si krim i rëndomtë. **Shih grafikun**

<sup>132</sup> Kjo nënkupton që grupet komunitare duhet të fuqizohen për të luajtur një rol aktiv në parandalimin e kriminalitetit të të miturit, në partneritet të ngushtë me agjencitë shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, komunitetin e biznesit dhe median, shkollën, etj. Në kuadrin e kësaj fushe kryesore, metodat komunitare të ofrimit të shërbimeve publike duhet të orientohen kah kësaj grupmoshe, që është më e rrezikuara për shkak të moshës dhe zhvillimit psiko-motor, për të rënë pre e krimit të organizuar. Një praktikë e tillë është edhe ndërmarrja e nismës "*Shkolla si qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë*", që është përfshirë

Sot, sistemi i drejtësisë vuan nga proceset e gjata, korrupsioni dhe niveli i ulët i zbatimit të ligjit<sup>133</sup>. Vlerësohet se pothuajse 65% e të miturve e kalojnë kohën e masës së dënimit në paraburgim, për shkak të procedurave të tejzgjatura gjyqësore. Përdorimi i tepruar të dënimit me burg, si përgjigje ndaj fajësisë nuk ka parandaluar dukurinë e kriminalitetit të të miturit, por përkundrazi, ajo që vërehet më së shumti është fakti se numri i të miturve në konflikt me ligjin sa vjen dhe rritet, duke marrë përmasa shqetësuese. Ndaj, parësore është gjetja e rrugëve dhe marrja e masave të nevojshme, nëpërmjet miratimit të strategjive dhe politikave shtetërore, për t'u ofruar të miturve dhe të rinjve shanse më të mira në jetë, arsimim dhe mundësi punësimi, kur të arrijnë moshën madhore.

Mungesa e aksesit në drejtësi është një atribut i disa faktorëve që lidhen me gjendje ekonomike, varfërinë, për disa kategori shoqërore si: gratë, minoritetet, personat me aftësi të kufizuara (PAK), etj. Por, ata që vuajnë më shumë aksesin në drejtësi, janë fëmijët, për shkak të statusit të tyre. Ata kanë të drejtën e aksesit në drejtësi, por aksesin e të miturve në drejtësi në Shqipëri, nuk është akoma i mjaftueshëm<sup>134</sup>.

Së fundmi, një nga problematikat e hasura është edhe mungesa e institucioneve apo kapaciteteve të përkujdesjes, nëpërmjet të cilave ofrohet përkujdesje dhe programe rehabilitimi për të miturit. Fëmijët viktimë apo dëshmitarë në një vepër penale, rrezikojnë të viktimizohen për së dyti, pasi nuk ka mjaftueshëm institucione apo kapacitete që të ofrojnë përkujdesje dhe programe rehabilitimi. Shërbimet sociale janë të dobëta, vuajnë mungesën e një stafi të kualifikuar dhe të trajnuar dhe, nuk kanë ndonjë rol në trajtimin dhe mbështetjen e të miturve nën moshën e përgjegjësisë penale në konflikt me ligjin.

---

tashmë në sistemin arsimor shqiptar, si pjesë e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar (2014-2020) dhe, që synon të zgjerohet për të mbështetur përpjekjet e të gjithë aktorëve dhe faktorëve. Kjo nismë inkurajon partneritetet midis shkollave, familjeve dhe të gjithë komunitetit. Në këtë kuptim, shkollat nuk janë thjesht ofrues të arsimit, por edhe katalizatorë të kohezionit e zhvillimit të komunitetit. Projekti "Shkolla si qendër komunitare" mund të shndërrohet në një instrument të fuqishëm, duke ofruar shërbime këshillimi e duke vepruar si hallkë qendrore në konceptimin e programeve parandaluese. Mësuesit janë punonjës të rëndësishëm të vijës së parë, të cilët shërbejnë si ndërlidhës brenda komuniteteve. Për rrjedhojë, aftësia e tyre për të shquar dhe për t'u kundërpërgjigjur dukurive kriminale e për t'i parandaluar ato, duhet forcuar e përkrahur në mënyrë të vazhdueshme.

<sup>133</sup> Mjafton të sjellim në vëmendje ligjin për aksesin në asistencën ligjore falas, i miratuar që në vitin 2009 dhe, akoma është në fazat e para të zbatimit. Ky ka qenë edhe një nga shembujt e theksuar edhe nga Komisioneri i Nivelit të Lartë për të drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës.

<sup>134</sup> Drejtësia për të miturit ka të bëjë me fëmijët në konflikt me ligjin, qofshin ato çështje penale, civile, administrative, etj. ose për çfarëdo arsye. Nëse të drejtat e tyre janë dhunuar, ata kanë nevojë për një përgjigje të duhur dhe në kohën e duhur. Kështu, organizatat ndërkombëtare si UNICEF, etj, janë ofruar të mbështesin autoritetet shtetërore dhe organet ligjzbatuese në vend, nëpërmjet ofrimit të asistencës financiare e projekteve, për garantimin e aksesit të plotë në drejtësi për grupet vulnerable, ku një nga propozimet kryesore është rishikimi i tarifave të trajtimit gjyqësor të kërkesave të qytetarëve, duke zvogëluar diferencat që kushtëzojnë marrjen e ndihmës ligjore falas.

## **2.6. Dënimi - alternativat e dënimit**

Veprat penale që kryhen nga të miturit nuk janë të ndryshme nga ato që kryhen nga personat madhorë, si dhe nuk janë më pak shoqërisht të rrezikshme. Kështu, që për vepra penale të kryera nga të miturit, është e domosdoshme të caktohet një lloj dhe mase dënimi e caktuar. Siç dihet, qëllimi i dënimit nuk është vetëm ndëshkimi për një veprim amoral dhe të kundraligjshëm, por riedukimi, risocializimi dhe integrimi i të dënuarit në shoqëri. Për të miturin, nisur nga zhvillimi mendor e psikosocial, është shumë i rëndësishëm roli edukues dhe socializues i dënimit, në mënyrë që i mituri ta kuptojë vlerën antishoqërore dhe amonale të veprës së kryer, në mënyrë që të mos e kryejë më, duke u shkëputur nga faktorët që e shtynë në kryerjen e saj dhe duke u integruar në jetën normale shoqërore. Ndaj, është e domosdoshme që të ketë mundësi dënimesh alternative, për të miturit dhe të mos jetë dënimi me burgim, mënyra e vetme e zgjidhjes së problemit. Në këtë frymë, edhe vetë ligji parashikon dënime më të buta për të pandehurit e mitur, në nenin 51 të Kodit Penal, ku përcaktohet, që të miturit nuk mund t'i caktohet një masë dënimi më e lartë, se gjysma e dënimit që parashikon dispozita e konsumuar. Në paragrafin e dytë të nenit 31 të Kodit Penal, parashikohet ndalimi i aplikimit të dënimit me burgim të përjetshëm për të miturit, por kjo dispozitë është shfuqizuar me ligjin nr.9686, datë 26.2.2007, “Për disa ndryshime në Kodin Penal të R.SH.”.

Këto janë përcaktimet ligjore, përse i përket dënimit me burgim të të miturit, dënim i cili, duhet të aplikohet atëherë, kur asnjë alternativë tjetër dënimi nuk është e përshtatshme. Për sa i përket alternativave të tjera të dënimit, në legjislacionin shqiptar nuk ka hapësirë të konsiderueshme. Kështu, enkas për të miturin është sanksionuar neni 52 i Kodit Penal, i cili përcakton rastet e përjashtimit të të miturit nga dënimi, që ka të bëjë kryesisht, me vepra penale të lehta, kryesisht kundravajtje. Neni 53, që është ulja nën minimumin e dënimit të parashikuar në ligj dhe neni 59, që ka të bëjë me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, nuk kanë të bëjnë vetëm me të pandehurin e mitur. Por, të dy këto dispozita përdoren gjerësisht për të dhënë dënime të buta me burgim për të miturit. Në ndryshimet e fundit, që i janë bërë Kodit Penal me ligjin nr.10023, datë 27.11.2008, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, janë parashikuar disa alternativa dënimi, që përmendin edhe të pandehurin e mitur. Kështu, neni 58 i këtij Kodi, që ka të bëjë me gjysmëlirinë, është ndryshuar, duke i dhënë mundësi të dënuarit, deri në një vit burgim, që ndjek proceset arsimore, ta kryejë dënimin në gjysmëliri, pra duke ndjekur procesin mësimor-edukativ. I dënuari i mitur, që kryen këtë lloj dënimi, siç do të përcaktohet

në vendimin e gjykatës, do të kthehet në institucionin e vuajtjes së dënimit në mënyrë vullnetare, pas shlyerjes së detyrimeve të domosdoshme arsimore. Në ndryshimet që i janë bërë nenit 59 të Kodit Penal, përfshihet përsëri i pandehuri i mitur, megjithëse jo në mënyrë eksplicite. Neni 59/a, që i është shtuar këtij kodi, ka të bëjë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit me burgim deri në dy vjet ose me të dënuarin, që i ka mbetur për të vuajtur deri në dy vjet burgim. Në shkronjën “d”, të kësaj dispozite përcaktohet, që mund të aplikohet ky lloj dënimi për personat e rinj, deri në moshën 21 vjeç, për nevoja shëndetsore, arsimore, të punës apo gjendjes familjare. Në këtë dispozitë, parashikohet vuajtja e dënimit, pranë ambientit të shtëpisë, duke u dhënë leje për të dalë nga këto ambiente, për të plotësuar nevojat e tyre studimore, të programeve të rehabilitimit, të programeve të punës, etj. Në të dy dispozitat e ndryshuara, të neneve 58 dhe 59/a, të Kodit Penal, parashikohet vuajtja e dënimit në shtëpi dhe lëvizja nga ky vend qëndrimi, kërkon miratimin me vendim të gjykatës dhe kontrollohet nga shërbimi i provës. Në nenin 60, parashikohen detyrimet e të dënuarit të vënë në provë, që mund të aplikohen dhe për të dënuarin e mitur, në funksion të rehabilitimit të tij, dhe mbikqyren nga shërbimi i provës. Në nenin 63, të Kodit Penal, parashikohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe detyrimin e kryerjes së një pune në interes publik. Kjo është gjithashtu, një alternativë dënimi, që mund të aplikohet tek të miturit dhe po të krijohen kushte të posaçme pune, për të miturit do të ketë një efekt pozitiv në riedukimin dhe integrimin e të dënuarit të mitur. Këto alternativa të reja dënimi, megjithëse nuk janë të aplikueshme vetëm për të dënuar të mitur, janë një mundësi pozitive për të evituar, sa më shumë të jetë e mundur, dënimin me burgim të të miturit.

## **2.7. Ekzekutimi i dënimit**

Në këtë paragraf, do të përqëndrohemi në ekzekutimin e dënimit me burgim. Ekzekutimi i dënimit me burgim për të miturit, ka një rëndësi të veçantë, ndaj dhe në Kodin Penal, në nenin 33 të tij, është përcaktuar që të miturit t’u kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta nga të rriturit. Rregullat, mbi mënyrën e vuajtjes së dënimit, të drejtat dhe detyrat e të dënuarve me burgim, rregullohen me ligj të veçantë. Kështu, në ligjin nr.8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”<sup>135</sup> dhe në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”<sup>136</sup> rregullohet mënyra e ekzekutimit të

---

<sup>135</sup> Ligji nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar me ligjin nr.10024, datë 27.11.2008.

<sup>136</sup> Ligji nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”,  
❖ Ndryshuar me ligjin nr.8758, datë 26.3.2001 botuar në FZ nr.15  
❖ Ndryshuar me ligjin nr.9071, datë 22.5.2003 botuar në FZ nr.53

dënimit me burgim. Të dy këto ligje, parashikojnë rregulla të veçanta për ekzekutimin e dënimit për personat e mitur. Të dënuarit e mitur e vuajnë dënimin në institucione të veçanta, më vete nga të rriturit, madje dhe kur vendoset vuajtja e dënimit në burg të sigurisë së lartë, të miturit e vuajnë dënimin në seksione të veçanta. Të miturit trajtohen në mënyrë të veçantë, jo vetëm për sa i përket ambienteve, ku nuk kanë kontakte me të dënuarit e rritur, por edhe për sa i përket programeve arsimore, sportive e çlodhëse, si dhe programeve të formimit kulturor e profesional<sup>137</sup>. Të miturit gëzojnë trajtim të posaçëm edhe për sa i përket, asistencës së psikologut e punonjësit social, për sa i përket kontakteve me familjarët apo mbrojtësin ligjor, si dhe për sa i përket, masave disiplinore që mund të caktohen për ta, e kohëzgjatjes së tyre. Në këto institucione të vuajtjes së dënimit, gjithnjë e më shumë i jepet rëndësi programit mësimor edukativ, me qëllim socializimin dhe integrimin shoqëror të të miturit, gjatë vuajtjes së dënimit.

Ligjet e sipërpërmendura parashikojnë dhe rregullat e ekzekutimit të masave edukuese, të cilat duhet të ekzekutohen në mënyrë vullnetare nga prindi dhe në rast të kundërt, ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme, por institucione të tilla mungojnë në Shqipëri. Për sa i përket dënimeve alternative, si ai me kusht duke u vënë në provë, gjysmëliria apo qëndrimi në shtëpi, ekzekutimi dhe kontrolli i zbatimit të tyre, bëhet nga shërbimi i provës, që është një institucion i ri dhe nuk ka krijuar ende një praktikë pune të konsoliduar.

---

❖ Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008 botuar në FZ nr.44  
❖ Ndryshuar me ligjin nr.10 087, datë 26.2.2009 botuar në FZ nr.32  
❖ Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014, botuar në FZ nr. 67

<sup>137</sup> Penalogjia, Prof.as.dr.Vasilika Hysi, fq 178-179, 2006



## KREU III

### I mituri si autor i veprës penale në aspektin ndërkombëtar

#### 3.1. Konteksti ligjor ndërkombëtar në fushën e drejtësisë për të mitur dhe raporti i tij me të drejtën e brendshme

Legjislacionet më të përparuara botërore, që mbikqyrin sistemin e drejtësisë për të mitur, si dhe të gjitha konventat e rregullat ndërkombëtare në këtë fushë, si: Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, apo Rregullat e Riadit dhe të Pekinit, synojnë mirëqenien, mirërritjen, vazhdimin e edukimit të të miturve, duke konsideruar se ky proces nuk ka përfunduar ende. Këto rregulla kanë për qëllim, të zbusin ashpërsinë e sistemeve tradicionale, të cilat kanë tendencën e shpagimit dhe të ndëshkimit të fajtorit të mitur, gjë, e cila vërehet mjaft qartë në mbizotërimin e dënimeve me burgim ose të masave të sigurisë me arrest në burg. Pikërisht, këto standarde ndërkombëtare synojnë të aplikojnë kryesisht, *masa edukative dhe pedagogjike, ndaj të miturve*, në vend të privimit të tyre nga liria.

Nisur nga karakteri i normës (detyrues ose jo), si dhe organizatës ndërkombëtare, që e ka nxjerrë atë, më poshtë po parashtroj një përshkrim të shkurtër të këtyre rregullave dhe konventave ndërkombëtare, në të cilat vendi ynë ka aderuar, ratifikuar e nënshkruar, duke i bërë pjesë të së drejtës së brendshme.

Ndër aktet ndërkombëtare në fushën e drejtësisë për të mitur përmendim: Konventa e OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve (1989)”, ratifikuar nga Parlamenti më 27 shkurt 1992 dhe Protokolli shtesë i saj, datë 18 janar 2002, për shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ 1948), si dhe Deklarata për të Drejtat e Fëmijës.

#### ➤ **Konventa “Për të Drejtat e Fëmijës”, miratuar nga OKB, 20.11.1989**

Kjo konventë është një instrument i rëndësishëm ndërkombëtar, i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, në datë 28 shkurt 1992 dhe si e tillë, ajo është bërë pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe e zbatueshme në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Katër janë parimet bazë të Konventës:



- Mosdiskriminimi (neni 2, i konventës);
- interesi më i lartë i fëmijës (neni 3);
- e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit (neni 6);
- e drejta e pjesëmarrjes (neni 12).

Nisur nga një këndvështrim i ngushtë i Konventës, shikojmë që perceptimi që i bëhet fëmijëve aty, është shumë demokratik, që do të thotë se, në një shtet, që në themel të tij ka parimin “*welfare state*”- *shteti i mirëqenies sociale*”, fëmijët të shihen si qytetarë dhe subjekt të drejtash. Në nenin 1 të saj, jepet përkufizimi i termit “*fëmijë*”, sipas të cilit, është fëmijë çdo qenie njerëzore, nën moshën 18 vjeç, përveç rasteve, kur ligji i brendshëm vendos ndryshe.

Në nenin 3/1, thuhet se, në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga institucione publike, private apo të përkrahjes shoqërore, gjykatat apo autoritetet administrative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë në konsideratë mbizotëruese.

Nenet 37, 39 dhe 40 të Konventës, rregullojnë marrëdhënien e të miturit me sistemin e drejtësisë penale, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe zbatimi i masave të sigurimit ndaj të miturve.

Neni 37/b, sanksionon se arrestimi, ndalimi apo burgimi duhet të merren në përputhje me ligjin, të përdoren vetëm si masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër. Ky aspekt gjen përshtatje edhe me nenin 31, të ligjit nr.8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në të cilin shprehimisht thuhet: “...*Kur gjykata, në vendimin e dënimit me burgim ka vendosur pezullimin dhe zëvendësimin e tij me kryerjen e një pune, me interes publik, prokurori me urdhrin e ekzekutimit, ja kalon çështjen për veprim organit përmbarimor, sipas rregullave të parashikuara në nenin 63, të Kodit Penal.....*”.

Në nenin 40 të Konventës, përcaktohen në mënyrë të detajuar garancitë procedurale, që duhet të respektohen, ndaj një fëmije të dyshuar ose autor të një vepre penale. Me interes në fushën që po trajtojmë, është detyrimi që përcakton konventa për shqyrtimin pa vonesë të çështjes së tij nga një autoritet ose organ gjyqësor, respektimi plotësisht i jetës private në të gjitha fazat e procedimit, si dhe detyrimi i shteteve palë, që sa herë është e nevojshme dhe e detyrueshme, këta fëmijë të trajtohen pa ju drejtuar procedurës gjyqësore. Gjithashtu, po në mbështetje të nenit 40, të konventës, shtetet palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon tek fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën

e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve, si dhe që mban në konsideratë moshën e fëmijës dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri, në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.

➤ **Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të miturit. (Rregullat e Pekinit 1985)**

Këto rregulla, të miratuara nga rezoluta e Asamblesë së përgjithshme 40/33, e datës 29 nëntor 1985, njihen ndryshe si “Rregullat e Pekinit”, dhe në themel të tyre qëndron mirëqenia e të miturit dhe për arritjen e së cilës, të gjitha vendet anëtare, marrin përsipër të krijojnë kushtet e duhura, që i japin mundësinë të miturit të jetojë një jetë plot kuptim brenda komunitetit. Rregullat e përmendura, në pjesën e parë, “Parime të përgjithshme”, e vënë theksin, në rolin e rëndësishëm që duhet të luajë një politikë sociale, konstruktive për të miturit, *inter alia*, në parandalimin e krimeve dhe shkeljeve nga të miturit. Masat e parashikuara në këto politika sociale, të cilësuara si masa përkujdesjeje për të rinjtë, para kryerjes së një vepre penale, shërbejnë si kushte bazë të hartuara për të parandaluar nevojën e zbatimit të Rregullave.

Rregullat standarde minimale, u formuluan në atë mënyrë, që të gjenin mundësi zbatimi prej të gjitha vendeve anëtare, pavarësisht sistemit ligjor të tyre, si dhe të zbatoheshin për të gjitha rastet, pa dallim dhe në mënyrë të paanshme.

Në këto Rregulla, jepen përkufizime të termave “i mitur” dhe “shkelje”, në funksion të termit, i cili qëndron në themel të Rregullave, “shkelës i mitur i ligjit”, duke përcaktuar se kufizimet e moshës, varen nga sistemet ligjore të vendeve, pra nga sistemi politik, ekonomik, shoqëror e kulturor i tyre. Nisur nga ky këndvështrim, mosha e përgjegjësisë penale për të miturit, varion nga njëri vend në tjetrin, duke krijuar një grupim të gjerë moshash nën këtë përkufizim, nga 7 në 18 vjeç e sipër.

Rregullat e Pekinit i kushtojnë rëndësi zgjerimit të rrjetit të kontrollit shoqëror ndaj të miturve, duke nënkuptuar përfshirjen e familjes, shkollës dhe komunitetit e më gjerë, në trajtimin e tyre, si dhe synojnë arritjen e disa objektivave themelorë, ndër më të rëndësishmit është nxitja e mirëqenies së të miturve, kryesisht edhe në ato sisteme ligjore, që zbatojnë modelin e gjykatave penale. Një nga objektivat e tjerë thelbësorë është edhe i ashtëquajtura “*parim i përpjestueshmërisë*”, i njohur si një mjet, për të kontrolluar masat ndëshkuese, në raport me rëndësinë e shkeljes.

Ndërkohë, që në këto Rregulla theksohet, se heqja e lirisë ndaj të miturit, duhet të kufizohet në ato raste, të konsumimit të veprave penale serioze, nëpërmjet përdorimit të dhunës, apo ndaj të miturve përsëritës, të cilët nuk shfaqin shenja përmirësimi.

Por, ajo çka është më e rëndësishme në këto rregulla, ka të bëjë me atë që gjykata, duhet të ketë në dispozicion një numër të madh të masave, në mënyrë që ajo të jetë sa më fleksibël në qëndrimin e saj, për caktimin e një mase sa më të përshtatshme ndaj një të mituri. Këto masa rekomandohen të jenë: këshillimi, mbikqyrja, kujdesi, dënimi me kusht dhe vënia në provë, puna në interes publik, kompensimi i dëmit, pjesëmarrja në seanca grupore për këshillim psikologjik, të cilat kanë një të përbashkët, bëjnë të mundur që gjatë zbatimit të tyre, i mituri qëndron në gjirin e familjes dhe të komunitetit. Analiza e detajuar e Rregullave të Pekinit orienton në dy kahe të rëndësishme, ku duhet drejtuar drejtësia për të mitur dhe posaçërisht, masat shtrënguese ndaj tyre: *nga njëra anë zgjerimi i masave të sigurimit ndaj të miturve* (siç do të vini re nga studimi i mëposhtëm vetëm tre janë masat që aplikohen ndaj të miturve: arresti në burg, detyrimi për paraqitje dhe shumë pak arresti në shtëpi), dhe nga ana tjetër, *të rishihet mundësia që për vepra penale të lehta*, i mituri të përjashtohet nga zhvillimi i një procedure hetimore dhe gjyqësore dhe ndaj tij, të aplikohen masa të tjera si ato, të përmendura më lart.

➤ **Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve, të deprivuar nga liria, 14 dhjetor 1990 (Rregullat e Havanës 1990)**

Rregullat për mbrojtjen e të miturve, të cilëve u është hequr liria, janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, datë 14 dhjetor 1990, të njohura ndryshe si “Rregullat e Havanës”. Këto rregulla, të aprovuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, synuan të vendosnin për herë të parë standardet minimale të pranuar nga Kombet e Bashkuara, për mbrojtjen e të miturve të deprivuar nga liria, në të gjitha format, në përputhje me të drejtat njerëzore dhe liritë themelore, me qëllim zbatimin e tyre pa asnjë dallim race, seksi, moshe, religjioni, kombësie, bindjeje politike, origjine sociale apo etnike dhe paaftësie. Gjithashtu, ato u hartuan të tilla, për të respektuar të gjitha bindjet fetare, kulturore dhe konceptet morale e praktike të të miturit. Që në hyrje të pjesës së parë “Perspektivat themelore”, sistemi i drejtësisë minore, përcaktohet si i tillë që të ruajë të drejtat, sigurinë dhe mirëqenien fizike dhe mendore të të miturve, si dhe sanksionon, se *deprivimi nga liria i një të mituri duhet të jetë një masë e fundit, e caktuar nga zyrtarët ligjorë, për një kohë sa më të shkurtër dhe duhet të kufizohet vetëm në raste të*

*jashtëzakonshme*. Për qëllime të zbatimit të rregullave në praktikë, heqje e lirisë (deprivim) do të thotë çdo lloj ndalimi ose burgimi, apo vendosja e një personi në një institucion publik ose privat, nga i cili ky person nuk lejohet të largohet me dëshirën e tij apo pa lejen e zyrtarëve.

Arrestimi/ndalimi para gjyqit shmanget, aq sa është e mundur dhe kufizohet në rrethana të jashtëzakonshme. Prandaj, bëhen të gjitha përpjekjet për zbatimin e masave alternative. Megjithatë, edhe kur përdoret ndalimi parandalues, organet proceduese i japin një përparësi më të madhe procedimit të përshpejtuar të këtyre rasteve, për të siguruar kohëzgjatjen më të shkurtër të mundshme të paraburgimit. Personat, të cilët nuk janë të dënuar dhe janë të paraburgosur, duhet të ndahen prej të miturve të akuzuar.

Kushtet, nën të cilat një i mitur është i deprivuar nga liria, duhet të jenë në pajtim me rregullat e sipërpërmendura, si dhe duhet t'u njihet e drejta për të patur këshilltarin e tyre ligjor, t'u mundësohet ndihma ligjore falas (nëse një gjë e tillë është e mundur), t'i sigurohet në vazhdimësi një komunikim me të, pa cënuar privacinë e këtij komunikimi.

Qëndrimi i të miturit në një institucion paraburgimi, duhet të jetë veçmas nga të rriturit. Të miturve, u duhet garantuar e drejta për të marrë pjesë në veprimtari dhe programe, të cilat do të shërbenin për të nxitur dhe ruajtur shëndetin dhe vetërespektin e tyre, për të nxitur ndjenjën e tyre të përgjegjësisë dhe për të inkurajuar ato qëndrime dhe aftësi, që do t'i ndihmonin ata në zhvillimin e potencialit të tyre, si anëtarë të shoqërisë. Gjithashtu, përsa i përket numrit të të miturve në institucione të tilla, kërkohet që ai të jetë i reduktuar, në mënyrë që të krijohet mundësia e trajtimit individual, duke respektuar nevojat individuale, statusin, kërkesat speciale, personalitetin, gjininë, shëndetin mendor e fizik të të miturit.

I mituri mund të dërgohet në një institucion paraburgimi, vetëm si rezultat i një vendimi gjyqësor, ose vendimi tjetër administrativ për paraburgim.

Mbrojtja e të drejtave individuale të të miturve, përsa i përket sidomos ligjshmërisë së zbatimit të masave të ndalimit sigurohet nga autoriteti kompetent, ndërsa objektivat e integritetit shoqëror duhet të sigurohen nga kontrollet sistematike sipas standarteve ndërkombëtare, ligjeve dhe rregulloreve vendase, nga një organ i autorizuar për të vizituar të miturit dhe që nuk i përket mjediseve të paraburgimit.

Të gjithë raportet, përfshirë të dhëna ligjore, të dhëna mjekësore dhe ato të proceseve disiplinore, të gjithë dokumentet që kanë lidhje me formën, përmbajtjen dhe detajet e trajtimit, vendosen në një dosje individuale, e cila përbën informacion konfidencial dhe përdoret vetëm nga zyrtarët apo personat e autorizuar.

Çdo i mitur, brenda mundësive që i jepen, mund të ndërhyjë për të përmirësuar çdo fakt apo opinion në përmbajtje të këtyre dosjeve, madje duke lejuar rregullimin e deklaratave të pabaza.

Në një kohë sa më të shkurtër, pas momentit të pranimit në një institucion paraburgimi, për çdo të mitur përgatitet një raport psikologjik dhe social duke identifikuar çdo faktor që ka lidhje me llojin dhe nivelin specifik të kujdesit dhe programit që kërkohet nga i mituri, pas një intervistimi që i është bërë atij. Ky raport, së bashku me raportin e përgatitur nga mjeku që ka ekzaminuar të miturin në momentin e pranimit, i dërgohen drejtuesit të institucionit për të përcaktuar vendin më të përshtatshëm për të miturin, brenda institucionit të paraburgimit. Personeli i trajnuar, duhet të përgatisë me shkrim një plan trajtimi të të miturit, duke specifikuar objektivat e trajtimit, afatin kohor dhe me të cilat duhet të arrihen.

Lidhur me mjediset fizike dhe akomodimin e të miturve në këto institucione paraburgimi, kërkohet që ato të jenë në përputhje me qëllimin rehabilitues të trajtimit rezidencial (të banimit), duke marrë parasysh nevojat e të miturit për privaci, arsim, pjesëmarrje në veprimtari fizike dhe sporte, mundësinë për t'u shoqëruar me moshatarë, si dhe për të marrë pjesë në veprimtari të tjera të kohës së lirë. Gjithashtu, të miturit, gjatë qëndrimit në këto institucione, gëzojnë të drejtën në liritë dhe shërbimet, që ndeshen në të gjitha kërkesat e dinjitetit human dhe shëndetësor, çka do të thotë që të miturit duhet t'i sigurohen kushte optimale fjetjeje, ushqimi dhe higjieno-sanitare, lidhur me zotërimin e sendeve personale. Të miturit duhet t'i sigurohet një kujdes shëndetësor i përshtatshëm, si parandalues dhe kurues, kushte të përshtatshme për arsim, trajnim profesional, ushtrimin e praktikave fetare dhe veprimtarisë zbavitëse. Rregullat vazhdojnë edhe më tej, me një rregullim të posaçëm, në drejtim të realizimit të proceseve disiplinore, inspektimit të ankimeve, kualifikimit të personelit të institucioneve të paraburgimit, rikthimit të të miturit në komunitet, etj.

Një analizë e hollësishme e këtyre rregullave tregon se ka shumë për të bërë, jo vetëm për sa i përket të miturve, të cilët janë të izoluar në një institucion paraburgimi, në kuadër të caktimit të një mase shtrënguese, por edhe në tërësi në fushën e drejtësisë për të mitur.

➤ **Direktivat e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të miturve (Direktivat e Riadit 1990)**

Ky dokument është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me rezolutën 45/112, të datës 14 dhjetor të vitit 1990 dhe, një ndër parimet themelore, të sanksionuara në të është parandalimi i kriminalitetit tek të miturit, si një pjesë thelbësore e parandalimit të kriminalitetit në shoqëri.

Qëllimi i këtyre direktivave është, se ato duhet të interpretohen dhe zbatohen në kuadër të akteve të tjera ndërkombëtare, të njohura si: Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore, Konventës Ndërkombëtare Për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklaratës për të Drejtat e Fëmijve dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijve, si dhe në kuadër të Rregullave Themelore Standarde të Kombeve të Bashkuara, Për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit).

Në fakt, ajo që të bie në sy tek këto direktiva është se, krahas aspekteve juridike të parandalimit, vend i veçantë i kushtohet edhe faktorëve të tjerë pjesëmarrës si: shkolla, shoqëria, komuniteti etj. Në ndryshim nga Rregullat e Havanës, të cilët shprehen për heqjen e lirisë së të miturit si masë e fundit dhe përgjithësisht për kushtet në paraburgim, Direktivat e Riadit e vënë theksin tek parandalimi i kriminalitetit me kontributin e të gjithëve, nëpërmjet hartimit të strategjive jo vetëm kombëtare, por edhe rajonale apo ndërkombëtare.

Në përfundim mund të themi se, Direktivat e Riadit, së bashku me Rregullat e Havanës dhe të Pekinit, përbëjnë gurin e themelit, nga i cili, mund të marrim shkas për hartimin e një kuadri ligjor, sa më të përshtatshëm në fushën e drejtësisë për të mitur në përgjithësi, dhe në atë të caktimit të masave shtërnguese ndaj të miturit, në veçanti.

➤ **Disa dokumentë të tjera të Këshillit të Europës<sup>138</sup>**

- ✓ Rezoluta (78) 62 “Mbi delikuencën e të miturve dhe ndryshimet sociale”;
- ✓ Rekomandimi (85) 7 “Mbi pjesëmarrjen e publikut në politikën penale”;
- ✓ Rekomandimi (87)20 “Mbi reagimin social ndaj delikuencës së të miturve”;

---

<sup>138</sup> “Drejtesia për të mitur në Shqipëri”, botim i UNICEF, BE dhe CRCA

- ✓ Rekomandimi nr (88) 6 “Mbi reagimin social ndaj delikucencës në të rinjtë që vijnë nga familje emigrantë”;
- ✓ Rekomandimi (85) 4 “Për dhunën në familje”;
- ✓ Rekomandimi (91) 11 “Në shfrytëzimin seksual, pornografinë, prostitucionin dhe trafikimin e të rinjve dhe të fëmijëve”;
- ✓ Rekomandimi i Këshillit të Evropës “Për ndërhyrjen e hershme psiko-sociale në parandalimin e kriminalitetit” qershor 2000;
- ✓ Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi trafikimin e fëmijëve dhe për fëmijët ushtarë.

Me mjaft rëndësi në trajtimin e këtij punimi, është Rekomandimi (87)20 “Mbi reagimin social ndaj delikucencës së të miturve”. Kjo, për vetë faktin se ky rekomandim përcakton se: *“Të gjitha masat kundër të miturve duhet të kenë karakter edukativ, pasi bëhet fjalë për persona në zhvillim, reagimi social i delikucencës së të miturve duhet të bëhet duke marrë parasysh personin dhe nevojat specifike të të miturit, sistemi penal duhet të jetë i inspiruar me edukimin dhe integrimin social si qëllimin kryesor të drejtësisë për të mitur. Duhet të shmangët sa të jetë e mundur masat që konsistojnë në heqjen e lirisë, masat ndaj të miturve duhet të involvojnë edhe bashkësinë dhe komunitetin.”*

Në vijim, edhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit<sup>139</sup>, i miratuar së fundmi dhe që hyn në fuqi në datë 1 janar 2018, është mbështetur në parimet e sanksionuara në KRSH-së, në Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës, në aktet ndërkombëtare dhe në rregulla të njohura në nivel ndërkombëtar, lidhur me administrimin e drejtësisë penale për të mitur<sup>140</sup>. Gjithashtu, ai është përgatitur me asistencën dhe mbështetjen e ekspertëve më të mirë të BE-së e më gjerë. Ky ligj, së bashku me Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale, implementojnë konceptet më bashkohore për trajtimin e delikuentëve të mitur. Ashtu sikurse përcaktohet edhe në këtë Kod, dispozitat e tij nuk mund të interpretohen apo zbatohen në kapërcim të dispozitave ligjore ndërkombëtare, duke kufizuar kështu, garancitë dhe rregullat standard minimum lidhur me drejtësinë penale për të mitur, si dhe të drejtat e shprehura në aktet ndërkombëtare, të cialt vendi ynë i ka ratifikuar, ka aderuar apo nënshkruar, *Acquis* e BE-së dhe KDF të OKB-së<sup>141</sup>.

Në këtë ligj, parashikimi i masave alternative dhe i masave të edukimit si sanksione jopenale ndaj kryerësve të mitur të veprave penale, përbën një prioritetet, ku së bashku me

<sup>139</sup> Ligji nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, botuar në FZ nr.92, fq.5210.

<sup>140</sup> Neni 1/1, i ligjit nr.37/2017

<sup>141</sup> Po aty, neni 1/2, i ligjit.

pjesëmarrjen e shërbimit e provës si dhe organin e kujdestarisë, të cilët në bashkëpunim me prindërit e të miturit, prokurorin dhe gjykatën, në ekzekutimin e tyre e bëjnë këtë ligj, ndër më të arriturit e rajonit e më gjerë, pasi privimi i lirisë, përkatësisht dënimi me burgim i të miturit, është paraparë, jo vetëm si mjet i fundit, por dhe i kufizuar në afat shumë të shkurtër. E tërë fryma që përshkon Kodin, parimet e sanksionuara në të, të drejtat dhe garancitë procedurale të të miturit në konflikt me ligjin, trajtimi i të miturit viktimë apo dëshmitar në një vepër penale, janë plotësisht në përputhje me Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës, Rregullat e Pekinit, të Tokios, e një sërë dokumentesh të tjera ligjore, që do të thotë se trajtimin e delikuentëve të mitur në procesin penal e bën në përputhje me standardet më bashkëkohore të së drejtës penale dhe kriminologjisë.

### **3.2. Strategjia e drejtësisë për të miturit (2015-2020)**

Çështjet e të drejtave të fëmijëve janë në vëmendje të politikave të Bashkimit Evropian si dhe në fokusin e dokumentave të rëndësishëm për Shqipërinë, si udhërrëfyesi për 5 prioritetet kyçe<sup>142</sup> dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian<sup>143</sup>. Në kuadrin e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian (BE), qeveria shqiptare ka miratuar një sërë dokumentesh politikë dhe strategjikë, të cilët pasqyrojnë angazhimin e saj në arritjen e këtij procesi. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI, 2015 - 2020), Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE 2017 - 2020), Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale janë disa prej dokumenteve kryesore të lidhura ngushtë dhe me realizimin e të drejtave të fëmijëve. Krahas tyre një sërë dokumentesh strategjikë sektorialë lidhen me të drejtat e fëmijëve, të cilat janë si më poshtë:

- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2014 – 2020;
- Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale, 2016 – 2020;
- Plani i Veprimit për Fëmijët në Situatë Rruge, 2015 – 2017;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë, 2015 – 2020;
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2014 – 2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016-2020

<sup>142</sup> Vendimi nr.330, datë 28.5.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013”, botuar në FZ nr.84, fq.3377.

<sup>143</sup> Vendimi nr.74, datë 27.1.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2016-2020”, botuar në FZ.nr.17, fq.1053.



- Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues, 2017 - 2021 ;
- Strategjia e Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit, 2014 -2017;
- Strategjia Ndërsektoriale, Agjenda Digjtale e Shqipërisë, 2015 – 2020;
- Strategjia e Strehimit Social, 2016 – 2025, etj.

Në vijim, edhe reforma në drejtësinë për të mitur ka njohur progres gjatë viteve të fundit. Ministria e Drejtësisë është angazhuar në hartimin e një strategjie të re sektoriale për drejtësinë për të mitur, e cila do të ketë për qëllim trajtimin e të gjitha problemeve ligjore që hasin fëmijët në Shqipëri. Vazhdimësia e politikave ekzistuese, si edhe hartimi i politikave të reja në fushën e drejtësisë për të miturit, synojnë arritjen e disa objektivave strategjike:

- administrimin e drejtësisë për të miturit (të miturit në konflikt me ligjin dhe të miturit nën moshën e përgjegjësisë penale);
- të miturit viktima të krimit dhe,
- të miturit dëshmitarë.

Për sa u përket dokumenteve strategjike e ligjorë, përveç atyre që listuam më lart, në hartimin e këtij punimi më kanë ndihmuar edhe:

- Plani i Veprimit për Fëmijë, 2012-2015<sup>144</sup>;
- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, 2017-2020<sup>145</sup>;
- Rekomandimet prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2017<sup>146</sup>;
- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015–2020 dhe Plani i Veprimit të saj<sup>147</sup>;
- Agjenda Kombëtare e Drejtësisë për të Mitur<sup>148</sup>.

<sup>144</sup> Vendimi nr.182, datë 13.3.2012, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit të Veprimit për Fëmijë, 2012-2015”, FZ.Nr.39, fq.2155.

<sup>145</sup> Vendimi nr.42, datë 25.1.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2017-2020”, FZ. Nr.12, fq.319.

<sup>146</sup>Vendimi nr. 324, datë 12.4.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2017”, FZ.nr.86, viti 2016, fq.5091

<sup>147</sup> Vendimi nr. nr.1071, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, botuar në FZ nr.239, fq.16304.

<sup>148</sup> Vendimi nr.372, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020”, FZ.nr.100, fq.5598. Shtyllat strategjike të Agjendës janë: (i) Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve; (ii) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës për fëmijët; dhe (iii). Sisteme dhe Shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët: zhvillimi dhe arsimimi, drejtësia, shëndetësia dhe ushqyerja, dhe mbrojtja sociale.

Një nga detyrat parësore për të gjitha agjencitë shtetërore, që veprojnë në fushën e drejtësisë penale për të mitur, (por jo vetëm), është dhe domosdoshmëria për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet mekanizmave ligjorë dhe institucionalë dhe angazhimit të përbashkët për garantimin e drejtësisë miqësore dhe realizimin e interesave më të lartë të fëmijës. Pjesë e rëndësishme e reformës në drejtësi është vendosja e standardeve për respektimin e të drejtave të të miturve, jo vetëm si autorë të veprave penale, por dhe në pozicione të tjera procedurale, në përbashkë me sistemin e drejtësisë (si psh: viktimë dhe /ose dëshmitarë në një vepër penale). Legjislacioni për të miturit, i miratuar së fundmi nga Parlamenti<sup>149</sup> synon të korigjojë mospërputhjen, midis legjislacionit ndërkombëtar për të miturit, të ratifikuar nga vendi ynë dhe zbatimit në praktikë nga organet ligjzbatuese.

Mbështetur në reformimin e sistemit të drejtësisë dhe ndryshimeve ligjore koherente, parashikimet e reja ligjore, me qëllim respektimin e të drejtave të njeriut të subjekteve të procedimit penal, në Rekomandimet Prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2017 qeveria, ndër të tjera i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm *“...rritje të numrit të çështjeve penale të hetuara dhe dënuar me vendim të formës së prerë për rastet e nxjerrjes së fëmijëve për të lypur ose punuar në rrugë/shfrytëzimit të fëmijëve; kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor, dhe në rastet kur ajo kërkohet/vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më shkurtër të mundshme; hetime të shpejta, efektive dhe ashpërsim të politikës penale, në rastet e veprave penale me natyrë gjinore dhe diskriminuese, duke patur në vëmendje të veçantë rastet e dhunës në familje; fuqizim të kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të ngarkuar me hetimin e veprave penale me subjekt të procedimit penal të miturit, viktimat e dhunës në familje dhe atyre të trafikimit...”*<sup>150</sup>.

Po ashtu, mbrojtja sociale<sup>151</sup> është një nga komponentët kyç në realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre. Identifikimi i familjeve në nevojë dhe hartimi i standardeve

<sup>149</sup> Është fjala për ligjin nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, i cili hyn në fuqi më 1 janar 2018.

<sup>150</sup> Shih vendimin nr. 324, datë 12.4.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2017”, FZ.nr.86, viti 2016, fq.5091.

<sup>151</sup> E drejta për mbrojtjen sociale është parashikuar në katalogun e të drejtave dhe lirive themelore të individit në Kushtetutën e RSH-së, si një nga të drejtat bazike. Po ashtu, neni 9 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore njih të drejtën e secilit për të pasur mbrojtje sociale. Në mënyrë të ngjashme, në Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara njihin, gjithashtu, të drejtat e veçanta për mbrojtjen sociale. Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara etj. Mbrojtja e grupeve të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë, bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.

bazë për to, për mënyrën sesi duhet të trajtohen këto familje nga shteti duhet të jetë prioritet i institucioneve shtetërore që e kanë fushë përgjegjësie këtë veprimtari. Hartimi dhe miratimi i dokumenteve politikë, strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit duhet të reflektojnë konsiderata të rëndësishme edhe për mbrojtjen e fëmijëve dhe rëndësinë e politikave efektive që mundësojnë realizimin e të drejtave të tyre<sup>152</sup>. Mbrojtje sociale duhet t'u ofrohet të gjithë fëmijëve në situatë rruge, jo vetëm atyre që ndodhen në qytetet të mëdha (si psh: Tiranë), si dhe një kategorive të veçanta, fëmijë me aftësi të kufizuar (PAK), viktima të trafikimit, viktima të dhunës, etj.

Kjo strategjia e mbrojtjes sociale ka prioritet familjet dhe grupet e rrezikuara: familjet me kryefamiljare gra; familjet në rrezik përjashtimi, përfshirë romët; fëmijët dhe të rriturit me aftësi mendore të kufizuara; fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë dhe nuk shkojnë në shkollë; fëmijët në konflikte ligjore; fëmijët dhe gratë e prekura nga dhuna në familje, etj<sup>153</sup>.

Të dhënat mbi prevalencën e dhunës dhe format e dhunës te fëmijët janë sporadike<sup>154</sup>. Dhuna psikologjike është forma e dhunës që raportohet më së shpeshti nga fëmijët<sup>155</sup>. Rreth 61,69% e fëmijëve kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës psikologjike një herë në jetën e tyre; 48,42% e fëmijëve kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës fizike gjatë jetës së tyre dhe 59,45% e fëmijëve raportojnë se kanë përjetuar dhunë fizike gjatë vitit të kaluar. 11.4% e fëmijëve kanë përjetuar ngacmim seksual dhe 4.88% e fëmijëve dhunë seksuale me kontakt, të paktën një herë gjatë jetës së tyre<sup>156</sup>.

Të dhëna nga shqetësimet e fëmijëve që kontaktojnë shërbimit telefonik “*ALO 116 111*”, tregojnë se arsyet më të shpeshta të telefonatave janë:

- i)probleme me bashkëmoshatarët, prindërit dhe mësuesit;
- ii)probleme me bullizmin, me abuzimin fizik, seksual dhe emocional dhe,

---

<sup>152</sup> Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015–2020 dhe plani i veprimit të saj është miratuar me vendimin nr.1071, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave dhe synon përcaktimin e objektivave të qartë, të matshëm dhe të buxhetuar, për mundësimin e zbutjes dhe të lehtësimit të varfërisë, përmirësimin e mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara (PAK) dhe zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social.

<sup>153</sup> Vendimi nr. nr.1071, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, botuar në FZ nr.239, fq.16304.


<sup>154</sup> Sipas raportit të fundit organizatës World Vision mbi mirëqenien e fëmijëve në Shqipëri (2016) 3 në 4 fëmijë të varfër në Shqipëri pohojnë se e kanë ndeshur dhunën dhe abuzimin në jetën e tyre, por më pak se 15% janë gati për t'ia treguar këtë dikujt.

<sup>155</sup> Cenko E., Hazizaj A., Haxhiymeri E., Çoku B. (2013), Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri. Studimi Epidemiologjik në Ballkan mbi abuzimin e Fëmijëve dhe Neglizhencën (BECAN), CRCA Shqipëri, Tiranë.

<sup>156</sup> ASHMDF (2014). Raport Kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 2013 – 2014, marrë nga <http://eurokonventa.al/wp-content/> aksesuar në 13 qershor 2016.

iii) dhuna në familje<sup>157</sup>.

Ndërkohë, në raportin e të dhënave vjetore të punës së NJMF-ve tregohet se nga 555 raste në ndjekje gjatë vitit 2015, 63% janë raste neglizhimi, 19% raste të abuzimit psikologjik, 13% raste të abuzimit fizik dhe 5% të abuzimit seksual (shih grafikun).



**Burimi : Agjenda Kombëtare për të drejtat e fëmijëve – botim i ASHMDF**

Abuzimi seksual është një nga format më ekstreme të dhunës ndaj fëmijëve dhe, sipas studimeve të fundit, ai ndodh më shumë në rrethin e besimit. Fëmijët priren të mos e raportojnë dhe profesionistët po ashtu, për shkak të pasigurisë<sup>158</sup>. Në Shqipëri mungon shërbimi i trajtimit të specializuar dhe afatgjatë për fëmijët viktime të abuzimit seksual dhe/ose të formave të rënda të dhunës<sup>159</sup>.

<sup>157</sup> UN Children's Fund (UNICEF), Child Notice Albania, 23 July 2015, e marrë nga <http://www.refworld.org/> aksesuar në 13 Qershor

2016 UN Children's Fund (UNICEF), Child Notice Albania, 23 July 2015 marrë nga <http://www.refworld.org/> aksesuar në 13 qershor 2016.

<sup>158</sup> ASHMDF (2012). Plani kombëtar i veprimtimit për fëmijë 2012 - 2015.

<sup>159</sup> Burimi nga Axfenda e Drejtëisë për të Mitur, një botim i ASHTMDF, miratuar me vendimin nr.372, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Axfendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020", FZ.nr.100, fq.5598. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 – 2020 u hartua nga ish-Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Kjo Agjendë u mbështet nga UNICEF në Shqipëri, në kuadrin Programit të Bashkëpunimit midis qeverisë shqiptare dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016.

Së fundmi, për realizimin e objektivave madhorë në fushën e drejtësisë për të mitur, ***është e nevojshme që ndryshimet e bëra në infrastrukturën ligjore, të shoqërohen me ngritjen e infrastrukturave të duhura për promovimin, mbrojtjen, garantimin dhe realizimin faktik të të drejtave të fëmijëve në të gjitha nivelet e shoqërisë.*** Kjo do të thotë, ngritje dhe/ose riorganizim i të gjitha strukturave shtetërore në nivel qendror dhe vendor, sigurimi i burimeve financiare nga buxheti i shtetit, i dedikuar për këto struktura që merren me administrimin e drejtësisë për të mitur, por edhe më gjerë, si dhe bashkërendimi i veprimtarisë së autoriteteve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, për ofrimin e shërbimeve për këtë kategori të shoqërisë.

Gjithashtu, ***bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat e shoqërisë civile*** paraqet një rëndësi të veçantë, në kuadrin e reformimit të sistemit të drejtësisë për të mitur, për realizimin e të drejtave të fëmijëve, për ndërgjegjësimin e të gjithë shoqërisë për këto të drejta, për ofrimin e ekspertizës së duhur, aq të nevojshme dhe të domosdoshme, me qëllim qasjen e një fryme bashkëkohore në/dhe për mbështetjen në ofrimin e shërbimeve cilësore miqësore për fëmijët dhe adoleshentët.

### **3.3. Parimet kryesore ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin**

Politika penale ndaj kriminalitetit në përgjithësi nuk mund të kuptohet e veçuar nga zhvillimet rajonale e më gjerë. Në frymën e politikës bashkëpunuese, jo vetëm legjislacioni juridiko-penal i Shqipërisë, por edhe i vendeve të rajonit, është hartuar dhe transformuar në harmoni me konventat ndërkombëtare përkatëse, të miratuara nga institucionet ndërkombëtare, si OKB-ja, BE-ja, etj, për luftën ndaj kriminalitetit. Sikurse e trajtuam më lart, vendi ynë ka ratifikuar Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës e në mënyrë të posaçme, çështjet që prekin të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin, janë kryesisht të parashikuara në nenet 37, 39 e 40 të saj. Nisur nga katër parimet bazë të sanksionuara në Konventë, si: mosdiskriminimi (neni 2, i konventës), interesi më i lartë i fëmijës (neni 3), e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit (neni 6), e drejta e pjesëmarrjes (neni 12), përbëjnë edhe bazën e vendosjes së standardeve nga ana e çdo shteti palë, për mbrojtjen e veçantë dhe dinjitoze të të miturve.

Për sa më sipër, një të mituri, të dyshuar, akuzuar për një vepër penale, ose për të cilin hamendësohet se ka kryer shkelje të ligjit penal, është detyrim i çdo shteti palë në KDF, që t'i ofrojë atij një trajtim të posaçëm e dinjitoz, në raport me moshën e të miturit dhe dëshirën për riintegrim e tij në shoqëri, duke garantuar kështu, të drejtat dhe liritë themelore të individit.

Gjithashtu, mbi të miturin e dyshuar, të akuzuar ose i cilësuar fajtor për shkelje të ligjit penal, për arsye të veprimeve ose mosveprimeve, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i shtetit ose ajo ndërkombëtare, në çastin e kryerjes së tyre, nuk vepronë pasojat me efekt prapaveprues<sup>160</sup>.

Për një të mitur në konflikt me ligjin ekzistojnë garanci procedurale (neni 40 i KDF), të cilat në kuadrin ligjor në fuqi<sup>161</sup>, njihen si parime të drejtësisë penale përe të mitur. Ato janë :

- a) Prezumimi i pafajësisë<sup>162</sup>;
- b) Parimi i interesit më të lartë të fëmijës<sup>163</sup>;
- c) E drejta e informimit<sup>164</sup>;
- d) Shmangia e vonesave në shqyrtimin e çështjes<sup>165</sup>;
- e) Trajtimi i fëmijëve në përputhje me mirëqenien e tyre<sup>166</sup>;
- f) Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi<sup>167</sup>;
- g) Parimi i propocionalitetit<sup>168</sup>;

<sup>160</sup> Neni 40, paragrafi i parë , shkronja “a”, i KDF.

<sup>161</sup> Ligji nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, i cili pritet të hyjë në fuqi më 1 janar 2018.

<sup>162</sup> Shih edhe nenin 30 të KRSH-së, që nënkupton që i mituri të mos detyrohet nga ana e organeve ligjzbatuese të dëshmojë kundër vullnetit të tij, ose të pohojë se e ka kryer ai veprën penale, etj.

<sup>163</sup> Neni 9, i Kodit, ku në mënyrë të qartë përcaktohet se: “*...Organet kompetente në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarrë në zbatim të këtij Kodi, duhet të vlerësojnë me përparësi interesin më të lartë të të miturit...*”, që do të thotë se në zbatimin e këtij parimi në praktikë, duhet të mbahen parasysh nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritjen/përkatësinë në një familje, mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar, etj

<sup>164</sup> Të miturit duhet që, vetëm nëpërmjet prindërve të tij ose përfaqësuesit ligjor, ti komunikohet menjëherë dhe drejtëpërdrejt akuza e ngritur, t'i ofrohet mbrojtje dhe asistencë e duhur ligjore e psikolog, si dhe çdo lloj ndihme tjetër, si psh: përkthyes falas, nëse i mituri nuk ka e nuk njih gjuhën e vendit në të cilin ka ndodhur krimi.

<sup>165</sup> Kjo nënkupton, që në të tilla raste me të pandehur të mitur, të dyshuar ose të akuzuar, shmangen procedurat dhe vonesat, duke përcaktuar shpejt instancën gjyqësore kompetente, duke garantuar që gjykimi do të jetë i paanshëm, i drejtë, objektiv dhe në interesin më të lartë të fëmijës, si dhe duke garantuar praninë e prindërve ose përfaqësuesve ligjorë.

<sup>166</sup> Ky parim mban në konsideratë moshën e të miturit dhe raportin e gjendjes me shkeljen e kryer.

<sup>167</sup> Neni 11, I Kodit ka përcaktuar në harmoni të plotë edhe me parimin kushtetues të mbrojtjes nga diskriminimi ( neni 18 I KRSH-së), se: “*...Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të mituri...*”

h) Përparësia e masave alternative të shmangies<sup>169</sup>.

Krahas këtyre parimeve të sipërcituara, ka edhe standarde të tjera, të përmendura në një sërë dokumentesh ligjorë, si psh: Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike<sup>170</sup> apo Direktivat për drejtësinë për të miturit, Vjenë 1997<sup>171</sup>.

---

<sup>168</sup> Në nenin 12, të ligjit parashikohet se : “...Çdo masë e marrë ndaj të miturit në konflikt me ligjin duhet të jetë në raport me rrethanat e kryerjes së veprës penale, personalitetin e të miturit, në përputhje me nevojat që lidhen me moshën, edukimin, arsimimin kushtet personale, familjare, sociale dhe mjedisore, nevojat zhvillimore, si dhe nevoja të tjera të të miturit përfshirë, nëse është rasti, edhe nevojat e veçanta...”.

<sup>169</sup> Neni 14, i Kodit lidhur me përparësinë e masave alternative të shmangies përcakton se: “...Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë. Kur bëhet ky vlerësim, nga çdo organ kompetent, në aktet respektive pasqyrohet mbajtja në vëmendje që masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal...”.

<sup>170</sup> Miratuar më 1966, hyrë në fuqi më 1976 dhe ratifikuar nga vendi ynë, ku në nenin 10.2.b, parashihet se: “... të rinjtë e burgosur duhet të ndahen nga të rriturit dhe shqyrtimi i çështjes së tyre duhet të mbarojë sa më shpejt që të jetë e mundur; procedura që zbatohet për të rinjtë duhet të mbajë në konsideratë moshën dhe interesin që paraqet riedukimi i tyre (neni 14.4); fëmija nuk duhet të diskrimonohet për shkaqe të tilla si: mosha, feja, ngjyra, raca, shtetësia, etj (nenet 23 e 24)...”

<sup>171</sup> Rezoluta 1997/30, e 21 korrikut 1997 parasheh se: “... ndaj të miturit duhet të veprojnë e ashtëquajtura drejtësi restauruese dhe e ndërmjetësimi, duhet të përcaktohet me ligj mosha minimale për ndjekje penale, duhet të fuqizohen institucionet e edukimit e riedukimit, etj...”



## KREU IV

### Trajtimi i të miturit në fazat e procesit penal. Vështrim krahasues me sistemin italian të drejtësisë penale për të mitur

#### 4.1. Parimet e drejtësisë penale për të mitur sipas ligjit

Ashtu sikurse e trajtuam më lart, parimet e drejtësisë penale për të mitur, të sanksionuara në aktet dhe rregullat ndërkombëtare, por jo vetëm, kanë gjetur shprehjen e tyre edhe në legjislacionin tonë të brendshëm.

Në vijim, ligji nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, një ligj i ri, në të gjithë përmbajtjen e tij vlerëson dhe mban në konsideratë këto parime të tilla si:

- Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi;
- Parimi i interesit më të lartë të fëmijës;
- Prezumimi i pafajësisë;
- E drejta për zhvillimin harmoik të fëmijës;
- Parimi i proporcionalitetit;
- Përparësia e masave alternative të shmangies;
- Pjesëmarrja e të miturit në proces;
- Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi;
- Kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit;
- Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut<sup>172</sup>.

Bashkimi Evropian nuk ka sjellë risi të rëndësishme lidhur me procedimet penale për të miturit, për një kohë të gjatë. Deri në vitin 2009, procedimet penale, duke përfshirë mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarit dhe personit të dënuar, nuk përfshiheshin në kompetencën specifike të BE-së, ndaj nuk mund të merren parasysh, indirekt apo rastësisht<sup>173</sup>. Traktati i Lisbonës është përqëndruar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si një objektiv i Bashkimit Evropian: Ky objektiv është i mbrojtur edhe në Kartën e të Drejtave

<sup>172</sup> Shih nenet 8-18, të kreut II, të ligjit nr.37/2017.

<sup>173</sup> MAZZA O., “Burimet evropiane të ligjit për burgjet e të miturve, në COPPETTA M.G. (redaktuar nga), Procedura Penale e Burgjeve për Minoritetet në Kartat Ndërkombëtare dhe Ligji Italian, Giuffrè, Milano, 2010 fq. 1-19



Themelore të Bashkimit Evropian<sup>174</sup>, dhe i njeh fëmijët si mbajtës të të drejtave të pavarura dhe autonome dhe parashikon, që veprimet e autoriteteve publike dhe të OJF-ve që mbrojnë e promovojnë të drejtat e fëmijëve, duhet të zbatojnë parimin e “interetit më të lartë të fëmijës”. Bashkimi Evropian, nëpërmjet Komisionit Evropian, është angazhuar për njohjen e të drejtave të të miturve, duke shprehur vullnetin dhe angazhimin për realizimin e këtyre të drejtave në të gjitha politikat e tij, jo vetëm në aspektin e kriminalitetit, por edhe në të drejtat civile dhe ato administrative. Veprimi i institucioneve të Komunitetit bazohet në tre parime:

- i) vendosja e një drejtësie;
- ii) mbrojtja e fëmijëve të prekur dhe,
- iii) mbrojtja e të drejtave të fëmijëve edhe në veprimet e jashtme, veçanërisht nëpërmjet kundërveprimit me shfrytëzimin e punës së fëmijëve dhe përdorimin e fëmijëve në konflikte të armatosura.

#### **4.1.1. Elementë të procesit të gjyqimit të të miturit në konflikt me ligjin**

Qëllimi i gjyqimit penal për të mitur është kryesisht, për të bërë të arritshme sistemin e sanksioneve ndaj subjekteve më të vegjël, që për shkak të fazës së veçantë zhvillimore, nuk mund të jenë në gjendje të kuptojë plotësisht sjelljen devijuese, procesin dhe pasojat, etj. Fraza “Jo më fëmijë, akoma jo të rritur” mund të jetë ajo që dënon një ndër periudhat më delikate në të gjithë fazën evolutive të formimit të njeriut. Në fakt, në adoleshencë, perceptimi i fëmijëve karakterizohet nga shpejtësia e transformimit dhe mosmarrëveshjeve në trupin dhe shpirtin e tyre. Për herë të parë individi është një dëshmi e ndryshimit dhe transformimit të tij/saj: ai sheh, e ndjen dhe e jeton atë. Por, adoleshentët nuk e kuptojnë plotësisht këtë transformim dhe, për këtë arsye, pikërisht për shkak se është ende një adoleshent, nuk është plotësisht i pjekur, ai shfaq besim të madh dhe iniciativë, deri në arrogancë, e cila shpesh herë e çon drejt një pasigurie dhe dobësie tipike të fëmijërisë, duke jetuar jetën me një ndjenjë të fortë të sfidës në një konkurrencë të vazhdueshme. Kjo gjendje “euforie”, krahas faktorë të tjerë (të cilët ne i kemi trajtuar në kapitujt pararendës), shpeshherë i çon të rinjtë drejt dukurive kriminale.

Procesi i administrimit të drejtësisë penale për të miturit, është një procedurë e veçantë, që zbatohet për individët e moshës 14 vjeç (nën këtë moshë të miturit nuk kanë përgjegjësi

---

<sup>174</sup> Karta e Bukur e vitit 2000 u komunitarizua me Traktatin e Lisbonës i cili hyri në fuqi në vitin 2010

penale) deri në 18 vjeç. Ndërsa, për kundravajtjet penale, mosha minimale e përgjegjësive penale është 16 vjeç<sup>175</sup>.

Parimisht, në Kod, është përjashtuar përgjegjësia penale për të miturit, pasi sipas nenit 4, “... *Ndaj të miturve, të cilët janë nën moshën për përgjegjësi penale ndaj të cilëve nuk fillon procedimi penal, ose nëse ka filluar, pushohet menjëherë...*”. Mundësia e dënimit me burgim i të miturit, sipas ligjit, është paraparë përjashtimisht, vetëm nëse është fjala për të mitur të rritur dhe i cili, ka kryer vepër penale, për të cilën sanksioni i parashikuar është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet<sup>176</sup>.

Ndaj, organi kompetent, pjesëmarrës në administrimin e drejtësisë penale për të mitur, në rastet e përfshirjes në këtë proces, duhet të jetë i kujdesshëm e i trajnuar dhe specializuar në çështjet penale me të mitur të rinj<sup>177</sup>.

Kështu, ligji nr.37/2017, përcakton në mënyrë të qartë, se në çdo fazë të procedimit penal, i mituri ka të drejtë për mbrojtje dhe procedura të veçanta, në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale për të mitur<sup>178</sup>.

Për nga natyra shkencore, në bazë të së cilës, rregullohen konceptet e përgjithshme të së drejtës penale dhe çështjeve të tjera që lidhen me to, ky kod, është i ngjashëm me shumicën e kodeve të drejtësisë penale për të miturit të shteteve bashkëkohore.

#### **4.1.2. Dëshmia e të miturve në procesin penal**

Një nga aspektet juridike që ngjall debat është edhe dëshmia e të miturve në procesin penal. Në parim, siç parashikohet edhe në Kodin e Procedurës Penale, “*çdo individ ka aftësinë për të dëshmuar*”. Një parim i tillë vlen si referim me karakter të përgjithshëm edhe për të

<sup>175</sup> Neni 3, i ligjit nr.37/2017.

<sup>176</sup> Në nenin 97, të ligjit nr.37/2017, përcaktohet shprehimisht se: “*...Burgimi ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një vepër penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë...*”.

<sup>177</sup> Shih nenin 3, të KDPM, ku sipas rastit, përcaktohet se organ kompetent mund të jenë: gjyqtari, prokurori, punonjësi i policisë së shtetit, oficeri i policisë gjyqësore, psikologu, avokati, punonjësi social, etj.

<sup>178</sup> Neni 19/2, Kreu III, i ligjit nr.37/2017

miturit. Kodi i ri i Drejtësisë Penale për të Miturit ka parashikuar rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë/dëshmitar nën 14 vjeç<sup>179</sup>.

Mosha më e vogël e një dëshmitari, nuk ndikon në aftësinë e tij për të dëshmuar, e cila udhëhiqet nga parimi i përgjithshëm që cituam më lart<sup>180</sup>. Por, ajo që vlen të theksohet, ka të bëjë me vlerësimin e dëshmisë, pra sa të besueshme janë thëniet e tij. Për ekzaminimin e të miturit, që i është besuar organit gjykues dhe për të realizuar pyetjen e tij, Kodi ka përcaktuar se ajo bëhet vetëm në praninë dhe me pëlqimin e përfaqësuesit ligjor/procedural, psikologut dhe mbrojtësit të tij<sup>181</sup>. Megjithatë, sigurisht, marrja e dëshmisë së një mituri, pikërisht pse është e tillë, duhet të ndodhë me kriteret dhe modalitetet, që ligji ka përcaktuar, por që zakonisht në praktikë lë shumë për të dëshiruar dhe, një gjë e tillë konstatohet shpesh nga magistratët, avokatët, psikologët, psikiatrit, kriminologët, etj.

Në këtë kontekst, problemi më i madh që shtrohet përpara atij, që duhet të vlerësojë dëshminë e të miturit, në gjykimin tim, shtrihet në dy aspekte:

- *zotësia e të miturit për të dëshmuar* dhe,
- *vërtetësia e rrëfimit* (dhe kjo është akoma më e vërtetë kur i mituri është edhe viktimë).

Për sa i takon të miturit, dëshmia e tij duhet të ndjekë një rrugë disi të ndryshme.

Pikërisht, për të dhënë udhëzime sipas *modus operandi* (edhe pse me referencë specifike për dëshmitarët e mitur viktime të abuzimeve seksuale), në mënyrë thelbësore, KDPM, përveç parashikimeve ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, parashikon që profesionistët e specializuar për të mbledhur dëshmitë e të miturve ("*rectius-vërtetësinë e dëshmisë së të miturve*), duhet të përdorin metoda dhe kriteret e njohura si të besueshme nga komuniteti shkencor referues<sup>182</sup>. Konkretisht, në të tilla raste duhet të qartësohen modelet

---

<sup>179</sup> Konkretisht në nenin 42, të ligjit nr.37/2017, përcaktohet se: "... *Për të miturit viktime dhe dëshmitarë nën 14 vjeç, përveç parashikimeve të këtij neni, zbatohen për aq sa është e mundur të gjitha garancitë dhe të drejtat e parashikuara nga ky Kod dhe në nenin 361/a, të Kodit të Procedurës Penale...* ".

<sup>180</sup> Në nenin 155, të Kodit të Procedurës Penale, miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, i ndryshuar, parashikohet qartë: "...*çdo person ka zotësinë për të dëshmuar, me përjashtim të atyre që për shkak të të metave mendore ose fizike nuk janë të dëshmojnë...*".

<sup>181</sup> Neni42/2, i KDPM, ku parashikohet se: "...*Të miturit nën 14 vjeç i shpjegohet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, si dhe përmes shembujve, rëndësia për të thënë të vërtetën dhe pasojat që mund të sjellë mosthënia e të vërtetës për personat e tretë. Të miturit i shpjegohet që nuk ka përgjegjësi penale për veprën penale, për refuzimin e dhënies së dëshmisë ose të dhënies së një dëshmie të rreme...*".

<sup>182</sup> Në nenin 41, të këtij Kodi, parashikohet se: "...*Përveç rregullave të parashikuara në nenin 58/b, të Kodit të Procedurës Penale, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 40, të këtij Kodi, në pyetjen e të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar, të shfrytëzimit seksual ose dhunës seksuale. Për këta të mitur, regjistrimi audio dhe video gjatë pyetjes është i detyrueshëm. Dëshmia në audio dhe video e dhënë nga i mituri mund të*

teorike të përdorura, në mënyrë të tillë që të japin mundësinë e vlerësimit kritik të rezultateve. Megjithatë, pika më e rëndësishme për t'u nënvizuar, është që vlerësimi psikologjik nuk mund të ketë si objekt ekzaminimin e fakteve për të cilat po procedohet. Pra, në terma më të thjeshta, çfarë është marrë nga deklaratimet e të miturve duhet të shërbejë vetëm për të qartësuar gjyqtarin, që i mituri është i përshtatshëm ose jo, për të dëshmuar. Kjo nuk mund t'i lejohet ekspertit, pra të vlerësojë besueshmërinë e ndonjë fakti të treguar nga i mituri. Kjo është detyrë që i takon ekskluzivisht gjykatës. Pra, ndërsa vlerësimi në lidhje me aftësinë për të dëshmuar mund t'i besohet një eksperti, vërtetësia ose jo e rrëfimit të të miturit (dëshmisë) duhet t'i takojë vetëm gjyqtarit.

Nëse i mituri është në moshë shumë të vogël, ndodh shpesh që të ketë një përfshirje të prindërve “për të dëshmuar”, por që dëshmia e këtyre të fundit nuk mund të merret për bazë. Është në fakt, gjithmonë e parapëlqyer nga organi kompetent përfshirja e të miturit për të dëshmuar drejtëpërsëdrejti<sup>183</sup>.

Vetëm në raste të rralla dhe të veçanta, jurisprudenca vlerëson dëshminë indirekte<sup>184</sup>, ku dëshmia e dhënë nga i mituri viktimë dhe/ose dëshmitar i shfrytëzimit seksual apo dhunës seksuale, bëhet nëpërmjet teknologjive bashkëkohore (videoregjistrim) dhe në këtë rast, thëniet e tij mund të jenë objekt të një dëshmie “*de relat*”.

Aspekti i dytë që duhet vlerësuar, dmth vërtetësia e rrëfimit të të miturit, është i lidhur ngushtësisht më të parin (aftësia për të dëshmuar) dhe, jo më pak problematik. Në shumicën e rasteve, të ndodhura për fat të keq nga fakti që shpesh minorenët janë dëshmitarë të abuzimeve seksuale që ju janë bërë atyre, metoda më e përshtatshme për ekzaminimin e dëshmisë së të miturit është incidenti provues (ose dëshmues), me garancitë kushtetuese dhe procedurale të ruajtuara për të gjitha palët e procesit. Në këtë kontekst, nën profilin e vërtetësisë së rrëfimit, duhet vlerësuar paraprakisht mënyra për ekzaminimin e dëshmitarit. Asnjë nuk ka dyshim, që gjyqtari, i cili do të vendosë incidentin provues, të urdhërojë që të procedohet me të gjitha përkujdesjet e nevojshme, sepse përpara së gjithash, duhet të

---

*shfaqet gjatë seancës gjyqësore. Dëshmia e të miturit viktimë e shfrytëzimit seksual dhe/ose abuzimit seksual mund të dëgjohet në sallën e gjyqit pa qenë i pranishëm vetë i mituri, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të nevojshme të komunikimit. I mituri dëshmitar ose viktimë e dhunës në familje ndalohet të merret në pyetje në praninë e prindit ose të afërmit abuzues gjatë procedurës së vendosjes së urdhrit të mbrojtjes, urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në rastet me të mitur viktimë ose dëshmitarë të shfrytëzimit seksual dhe/ose abuzimit seksual, gjithë procesi i gjyqimit zhvillohet me dyer të mbyllura...”.*

<sup>183</sup> Shih në jurisprudencën italiane, Cass.pen. sSez. III, 12/02/2004, n. 18058), ku përcaktohet se : “... dëshmia indirekte është e zhveshur nga padobishmëria (mos përdorimi) në kuptim në nenit 195 të K.P.P italiane, atëherë kur gjykatësi ka dështuar të procedojë, pavarësisht kërkesës së mbrojtjes, për të marrë dëshminë direkte, edhe në rastin kur ky i fundit është person në moshë të mitur” (Cass. pen., Sez. III, 28/11/2001, n. 1948).

<sup>184</sup> Shih nenin 41, të KDPM.



mbrohen nevojat e të miturit<sup>185</sup>. Ai mund të përcaktojë mënyra të veçanta për të proceduar me incidentin provues, që i vlerëson të nevojshme dhe të përshtatshme.

Së fundmi, vlen të theksohet se, nuk ekzistojnë referime ligjore dhe për rrjedhojë procedurale, të tilla që të shkatërrojnë kufijtë, brenda të cilave duhet të vlerësohen dy elementët themelorë (që folëm më lart), për të proceduar me ekzaminimin e dëshmisë së të miturit (aftësia për të dëshmuar dhe vërtetësia e deklarimeve). Megjithatë, falë ndihmesës thelbësore të ekspertëve të fushave të psikologjisë, psikiatrisë, neuro-psikiatrisë infantile, kriminologjisë, ekzaminimi i dëshmisë së të miturit është tashmë përkrah atyre garancive kushtetuese, mbrojtëse, të vendosura në themel të sistemit tonë juridik.

#### **4.1.3. Të drejtat dhe garancitë procedurale të të miturit në konflikt me ligjin**

Ligji parasheh se në çdo fazë të procedimit penal me të mitur në konflikt me ligjin, si dhe me të mitur viktimë apo dëshmitarë në një vepër penale, pavarësisht nga mosha, prania e një psikologu është e detyrueshme<sup>186</sup>. Po kështu, ligji ka parashikuar se në çdo fazë të drejtësisë penale, çdo i mitur në konflikt me ligjin ose viktimë, ka të drejtën e përfitimit të ndihmës ligjore dhe psikologjike pa pagesë. Kjo ndihmë i garantohet atij nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi<sup>187</sup>. E drejta e mbështetjes emocionalisht dhe psikologjikisht e të akuzuarit të mitur nga prindërit ose kujdestari ligjor i caktuar, ose një person i besuar i të miturit në çdo fazë të procedurës<sup>188</sup> është një e drejtë e pamohueshme në këtë rast, për asnjë arsye dhe rrethanë.

Gjithsesi, e drejta e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë për asistencë efikase e të menjëhershme, shkon përtej pranisë së personave mbështetës. Shpesh, në praktikë, për zgjidhje të shpejta dhe oportune, mund të jetë e nevojshme caktimi i një kujdestari ligjor, që zëvendëson kujdestarët e zakonshëm - prindërit e fëmijës, kur interesi më i lartë i fëmijës e

---

<sup>185</sup> Neni 76, i ligjit nr.37/2017, parasheh se: *“...Gjatë pyetjes së të miturit, nga ana e organit procedues garantohet trajtimi me dinjitet dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve... Pyetja e të miturit bëhet në prani të mbrojtësit dhe psikologut. Nëse i mituri jep pëlqimin, gjatë pyetjes së tij mund të marrë pjesë edhe përfaqësuesi ligjor/procedural...”*

<sup>186</sup> Neni 18, i ligjit nr.37/2017, përcakton në mënyrë eksplicite se: *“...Prania e psikologur synon që të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t'i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi...”*

<sup>187</sup> Neni 20/1, i ligjit nr.37/2017

<sup>188</sup> Po aty, në nenin 19/3, ligji i ka njohur të drejtën gjykatës që në rast se personi i besuar ndikon negativisht në rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturit, ajo nuk e pranon këtë person të besuar, duke u shprehur me vendim të arsyetuar për shkaqet e mospranimit.

kërkon këtë<sup>189</sup>. Përkufizimi, funksionimi dhe caktimit i një kujdestari ligjor, ndryshon nga njëri vend te tjetri, sipas kuadrit ligjor që e parashikon këtë<sup>190</sup>. Procesi i drejtësisë penale për të mitur, në çdo fazë parashikon përfshirjen e familjes së fëmijës. Njihet detyrimi parësor për të siguruar dhe ri-edukimin e fëmijës delinkuent, vendosjen e detyrimit për të njoftuar prindërit ose ata që mbajnë autoritetin prindëror (psh: kujdestari ligjor).

Referuar Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, ai i ka njohur të miturit, në çdo fazë të procedimit penal, mbrojtjen e jetës private, duke bërë kujdes që të shmanget publiciteti i tepërt i informacionit me të dhënat personale, që mund të çojë në identifikimin e të miturit në konflikt me ligjin, viktimë apo dëshmitar<sup>191</sup>.

Ajo që vlen të theksohet, është fakti se, ligji parasheh që shërbimet ndaj të miturit në drejtësinë penale, i ofrohen atij në çdo rast pa pagesë<sup>192</sup>.

Në një nga kapituj pararendës, konkretisht në kreun II, të këtij punimi, kam trajtuar faktorët e riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve. Për këtë, qëllim, pa dashur të përsëris, edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, është parashikuar se, në çdo vendimarrje për të miturin mbahen në konsideratë këta faktorë, ose ndryshe bëhet vlerësimi i rrethanave që e kanë shtyrë të miturin drejt kryerjes së një vepre penale. Ndryshe, i ashtëquajhuri vlerësim individual i të miturit<sup>193</sup>. Raporti i vlerësimit individual përshkruan nevojat e veçanta të të miturit, rrezikun e kryerjes së veprës penale, si dhe elemente të tjera në varësi të rastit dhe rekomandon masat e duhura për të nxitur zhvillimin dhe integrimin e tij në shoqëri<sup>194</sup>.

Në procesin e vlerësimit të të miturit, prokurori dhe gjykata kërkojnë përgatitjen e detyrueshme të këtij vlerësimi individual.

---

<sup>189</sup> Psh në Francë, Kodi i Procedurës Penale, nenet 706-50 dhe 706-51

<sup>190</sup> Parimet udhëheqëse ndërmjet agjencive për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, 2004, f. 47 ( www.icrc.org).

<sup>191</sup> Neni 21, i ligjit.

<sup>192</sup> Pikërisht, në nenin 23, të Kodit përcaktohet se: *“...Procedura e ofrimit të shërbimeve për të miturit në sistemin e drejtësisë penale rregullohet sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi dhe “...Pagesat e këtyre shërbimeve mbulohen nga buxheti i institucioneve dhe ekzekutohen nga institucionet përkatëse, pranë të cilave realizohet shërbimi në përputhje me legjislacionin në fuqi...”*.

<sup>193</sup> Në nenin 22, të ligjit nr.37/2017, parashikohet se: *“...me rrethana individuale kuptohet moshë, niveli i zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyra e rritjes dhe e zhvillimit, edukimi dhe arsimimi, gjendja shëndetësore, gjendja familjare dhe rrethanat e tjera, të cilat lejojnë vlerësimin individual...”*.

<sup>194</sup> Neni 47, i ligjit nr.37/2017, ku përcaktohet se : *“...raporti i vlerësimit individual është i detyrueshëm kur:*

- *Për të përcaktuar masën alternative të dënimit;*
- *Për të caktuar llojin e dënimit;*
- *Për të ekzekutuar vendimin e dënimit dhe,*
- *Për të shqyrtuar kërkesën e lirimit me kusht.”*

### *\*Qëndrim reflektues*

Ndër të tjera, asistenca për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë gjatë procedurave gjyqësore në gjykimin tim duhet të përfshijë edhe mundësinë e përfitimit të asistencës ligjore<sup>195</sup>. Kjo është arsyeja pse, me disa përjashtime të konsiderueshme, në shumicën e vendeve, që u sigurojnë viktimave të drejtën për asistencë ligjore, zbatohet sistemi ligjor “*civil law*”. Në fakt, ky është modeli që ka përqafuar edhe legjislacioni i ri për drejtësinë penale për të mitur në vendin tonë. Për të garantuar të drejtën e fëmijës për asistencë të efektshme, është detyrë parësore e autoriteteve shtetërore, por jo vetëm, që t’i krijojnë të gjitha kushtet e nevojshme fëmijës, sipas parimit “interesi më i lartë në të mirë të fëmijës”.

Shumica e vendeve me sistemin “*civil law*” u njeh të drejtën fëmijëve viktimave për asistencë ligjore<sup>196</sup>. Ajo ofrohet falas për ata përfitues, të cilët nuk kanë mundësi të paguajnë për të<sup>197</sup>. Ndodh, që për të minimizuar e zbutur efektet financiare për asistencë ligjore në buxhetin e një shteti, të gjenden zgjidhje oportune të favorshme<sup>198</sup>.

Disa vende me sistemin “*common law*” e pranojnë si përjashtim të drejtën e fëmijëve viktimë, për asistencë ligjore gjatë procedurave të ndjekjes penale. Në këto kushte, legjislacioni parashikon që këto shpenzime gjyqësore të mbulohen nga shteti<sup>199</sup>. Shtrirja e këtij përjashtimi lidhur me fëmijët viktimë në të gjitha vendet me sistemin “*common law*” do të shërbente ndjeshëm për mbrojtjen e tyre, ndërsa janë të përfshirë në procesin gjyqësor. Fëmijët viktimë ose dëshmitarë, të cilët kërkojnë asistencë ligjore, mund të asistohen nga një përkthyes, që sigurohet falas gjatë pjesëmarrjes së tyre në procedurat gjyqësore, nëse gjuha e fëmijës nuk është e vendit, në të cilin zhvillohet procesi gjyqësor<sup>200</sup>. Për të mundësuar pjesëmarrjen në procesin gjyqësor të fëmijëve, është e domosdoshme edhe marrja e masave të tjera për asistencë, duke mbajtur në konsideratë disa faktorë si: moshën e fëmijës, nivelin e pjekurisë dhe nevojat e veçanta individuale, të cilat mund të përfshijnë, por pa u kufizuar

---

<sup>195</sup> Mbretëria e Bashkuar, Institucioni i Prokurorisë së Kurorës, Ofrimi i terapisë për fëmijët dëshmitarë përpara gjykimin të çështjes penale: “Udhërrëfyes për përvojën e mirë” (2001). Në vendet me sistemin ligjor të “*common law*”, viktimat nuk janë palë në procesin gjyqësor, zakonisht, atyre u ofrohet asistencë ligjore.

<sup>196</sup> Për shembull në Bullgari, akti “Për mbrojtjen e fëmijës”, (2004), Neni 15 (8).

<sup>197</sup> Francë, Kodi i Procedurës Penale, neni 706-50.

<sup>198</sup> Psh, në Kolumbi, viktimave, të cilat nuk kanë mundësi financiare për të paguar për këshillat ligjore, mund t’u vijnë në ndihmë profesionistë të tjerë të fushës ligjore ose studentë të drejtësisë dhe, në rastin e viktimave të shumëfishta, numri i avokatëve që i përfaqësojnë ata mund të kufizohet në dy.

<sup>199</sup> Pakistan, urdhëresë “Për sistemin gjyqësor për të pandehur në moshë të mitur”, 2000.

<sup>200</sup> Në Kosta Rika, Kodi i Fëmijëve dhe Adolehentëve, miratuar me ligjin nr.7739 (1998), neni 107 (b).

vetëm në aftësinë e kufizuar, përkatësinë etnike, varfërinë ose rrezikun e riviktimizimit, apo një kombinim të këtyre faktorëve së bashku<sup>201</sup>.

Së fundmi, procedura penale në disa vende me sistemin “civil law” parashikon se, shoqatat për mbrojtjen e viktimave mund të asistojnë dhe përfaqësojnë viktimat gjatë procedurave gjyqësore në kushte të caktuara<sup>202</sup> (psh në Francë mund të përbëjë një mjet të efektshëm për t’u ardhur në ndihmë viktimave që t’i drejtohen gjykatës).

#### 4.1.4. Të drejtat e të miturit në fazën e hetimeve paraprake

### **Hetimi paraprak, masat e sigurimit personal sipas Kodit të Procedurës Penale**

Për shkak të karakteristikave të veçanta psikosociale që i përmendëm, si dhe për shkak të mbrojtjes së posaçme të lirive e të drejtave të të miturve nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, edhe ligjet procedurale parashikojnë rregulla të veçanta për të miturit. Kështu, trajtimi i veçantë i të miturit që ka kryer një krim, duhet të fillojë që në momentin e ndalimit apo arrestimit të tij në flagrancë<sup>203</sup>. Menjëherë, pas kryerjes së veprës penale bëhet shoqërimi i personit të mitur pranë organit procedues, por arrestimi apo ndalimi i tyre, me qëllim caktimin e masave të sigurimit personal, bëhet vetëm në rastet që ata kryejnë vepra penale të rënda. Në mbështetje të nenit 255 të K.Pr.Penale, menjëherë, pas arrestimit apo ndalimit të të

<sup>201</sup> Në Kolumbi, Kodi i Procedurës Penale, më konkretisht ligji nr.906, i vitit 2004, në nenin 137, “Pjesëmarrja e viktimave në procedurat e ndjekjes penale”, parashikon në mënyrë të shprehur se: “...Për të garantuar të drejtat për të vërtetën, procesin penal dhe dëmshpërblim, viktimat e një veprë penale kanë të drejtë që të marrin pjesë në të gjitha fazat e procedurave të ndjekjes penale, në përputhje me rregullat e mëposhtme: Është e detyrueshme që, me qëllim që të ushtrojnë të drejtat e tyre, viktimat duhet të përfaqësohen nga një avokat. Sidoqoftë, gjatë seancës dëgjimore përpara gjyqimit dhe nga kjo pikë e në vazhdim, me qëllim që të marrin pjesë në procedurat gjyqësore, ato duhet të jenë të shoqëruara nga një avokat ose këshilltar ligjor, që studion për t’u bërë i tillë, nga një fakultet drejtësie i miratuar nga shteti...”.

Ligji nr.906, i vitit 2004: Paragraf i pazbatueshëm : Kur ka më shumë sesa një viktimë, prokurori, gjatë hetimit, kërkon që viktimat të caktojnë deri në dy avokatë si përfaqësues të tyre. Në rast se nuk arrihet asnjë marrëveshje, prokurori e cakton këtë person siç e gjykon më të përshtatshme dhe brenda kufijve të lejuar nga ligji. Në rast se, viktimat nuk ka mjete të mjaftueshme për të punësuar një avokat, me qëllim që të marrë pjesë në procedurat gjyqësore, në bazë të një kërkesë dhe verifikimit të shpejtë të nevojës, Prokuroria e Përgjithshme e Kolumbisë cakton një avokat *ex officio*.

<sup>202</sup> Sjellim këtu rastin e Kamboxhias dhe zbatimit në praktikë të këtij sistemi lidhur me vepra të caktuara penale projekt Kodi i Procedurës Penale, 2006, neni L.131-5, “Shoqatat për eliminimin e të gjitha akteve të dhunës seksuale, dhunës në familje apo dhunës kundër fëmijëve” parashikonte se:

“...Çdo shoqate, e cila brenda tre vitesh përpara datës së kryerjes së një veprë penale, ka bërë një deklaratë vlefshme se objekti i statutit të saj është lufta kundër dhunës seksuale, dhunës në familje apo dhunës kundër fëmijëve, i njihet e drejta për të qenë palë ankimese në një padi për veprat e mëposhtme penale:

- Kërcënim me dashje kundër jetës;
- Ngacmim kundër personi apo
- Ngacmim seksual.

<sup>203</sup> Penalogjia, 2006, Vasilika Hysi faqe 177.



miturit është detyrim i organit procedues njoftimi i prindit apo kujdestarit. Në po këtë dispozitë, parashikohet se në raste të veçanta, kur paraburgimi është i papërballueshëm nga i mituri, prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e tij pranë banesës apo në ndonjë ambient tjetër. Në bazë të nenit 230, të K.Pr.Penale, nuk mund të arrestohet apo ndalohet i mituri, që ka kryer një kundravajtje penale. Të miturit i sigurohet menjëherë ndihma me mbrojtës, e cila është e detyrueshme dhe me të (të miturin), nuk mund të kryhet asnjë veprim procedural, pa praninë e mbrojtësit, i cili caktohet kryesisht në rast se, nuk mund të sigurohet nga vetë i pandehuri apo familjarët e tij. Komunikimi me të miturin, nga personi që e merr në pyetje, duhet të jetë i tillë, që të mos e imponojë apo ta dëmtojë psikikisht, por që ai të shprehet lirshëm për çfarë është në dijeni. Të miturit pyeten në prani të prindit, kujdestarit, si dhe sigurohet prania e psikologut, në mënyrë që ai të kuptojë, se për çfarë pyetet dhe përgjigjet të mos jenë të ndikuara. Gjithashtu, organi procedues në bazë të nenit 42 të K.Pr.Penale, është i detyruar të mbledhë të dhëna, lidhur me personalitetin e të pandehurit të mitur, në rrethin familjar dhe shoqëror ku ai jeton, me qëllim që të sqarohet përgjegjshmëria e tij, në lidhje me veprën dhe të caktohet lloji e masa e dënimit, e përshtatshme për çdo rast. Lidhur me këtë, organi procedues merr edhe mendimin e ekspertëve sociologë e psikologë. Në rast se, është e nevojshme, duhet të caktohet masë sigurimi ndaj të miturit, që ka konsumuar një vepër penale të rëndë. Në bazë të nenit 230, masa e sigurimit arrest në burg, caktohet vetëm në rastet, kur asnjë masë tjetër sigurimi nuk është e përshtatshme dhe vetëm në rastet, kur konsiderohet që i pandehuri i mitur mund të kryejë një vepër tjetër penale apo, kur rezikohet mbledhja dhe administrimi i provave. Masat e sigurimit caktohen, duke evituar të bëhen pengesë për procesin mësimor dhe edukativ të të miturit. Pra, vetëm në rast se është kryer një vepër tepër e rëndë, caktohet një masë sigurimi që bëhet pengesë për këto procese. Në rast se, caktohet masë sigurimi arrest në burg, të miturit mbahen në seksione të veçanta<sup>204</sup>, jo në kontakt me të rriturit dhe u krijohen mundësi takimesh të shpeshta me prindërit dhe me mbrojtësit ligjorë.

#### **4.2. Llojet e masave të dënimit**

Fryma që përshkon të gjithë Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit është mbajtja në vëmendje e parimit të “interetit më të lartë të fëmijës”.

---

<sup>204</sup> Në nenin 75, të ligjit nr.37/2017, përcaktohet qartë se : “...I mituri në paraburgim vendoset në mjedise të veçanta nga të rriturit.... Gjatë kohës që i mituri mbahet në paraburgim, sipas nevojës dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin, i ofrohet ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike..”.

Gjatë gjithë procesit të marrjes së vendimit, gjykata, duhet të mbajë në konsideratë faktin, se aplikimi i masës së dënimit me burgim i të miturit është mjeti i fundit i mundshëm, i cili konsiderohet vetëm nëse masat e shmangies, të parashikuara në ligj, janë të papërshtatshme<sup>205</sup>. Gjithashtu, kur i mituri është deklaruar fajtor për kryerje e një vepre penale, gjykata në dhënien e vendimit mban në konsideratë trajtimin e të miturit në mënyra të përshtatshme për garantimin e mirëqenies së tij, përshtatjen me rrethanat dhe rrezikshmërinë e veprës së kryer, moshën, rrethanat individuale dhe nevojat e veçanta të të miturit, nxitjen e riintegritimit të të miturit dhe përfshirjen e tij në një rol sa më konstruktiv në shoqëri, caktimin e një dënimi sa më të përshtatshëm për të korrigjuar sjelljen e të miturit, etj<sup>206</sup>.

Ligji i drejtësisë penale për të miturit ka bërë një ndarje të llojeve të dënimeve për të miturit, duke i ndarë në dy grupe:

- Dënime jo me burgim;
- Dënime me burgim<sup>207</sup>.

Gjithashtu, ligji ka bërë edhe klasifikimin dhe caktimin e dënimeve për të mitur, si vijon:

- Dënime kryesore;
- Dënime plotësuese<sup>208</sup>.

#### **4.2.1. Masat e drejtësisë restauruese**

Gjithashtu, ligji parashikon edhe masat e drejtësisë restauruese<sup>209</sup>. Qëllimi i këtyre masave është tërheqja e vëmendjes së të miturit që është në konflikt me ligjin, për shkak të kryerjes së një vepre penale për të kuptuar gabimin dhe të reflektojë, si dhe riedukimi dhe risocializimi, në funksion të një zhvillimi sa më të drejtë. Gjithashtu, për aplikimin e këtyre

---

<sup>205</sup> Neni 94, i ligjit nr.37/2017.

<sup>206</sup> Po aty.

<sup>207</sup> Neni 95, i ligjit nr.37/2017, ku në dënimet jo me burgim përfshihen: kufizimi i lirisë, qëndrimi në shtëpi, gjoba, kryerja e një pune me interes publik, përmbushja e detyrimeve të caktuara dhe ndalimi i për kryerje e një veprimtarie.

<sup>208</sup> Në nenin 96, të ligjit, parashikohen si dënime kryesore: burgimi, kufizimi i lirisë dhe gjoba. Ndërsa, si dënime plotësuese: ndalimi për kryerjen e një veprimtarie, kryerja e një pune me interes publik, përmbushja e detyrimeve të caktuara dhe qëndrimi në shtëpi.

<sup>209</sup> Neni 3, i ligjit nr.37/2017, parasheh se “...*“Masë e drejtësisë restauruese” është çdo masë, e cila lejon një të mitur në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të korrigjojë pasojat e një vepre penale, të kompensojë dëmet dhe/ose të pajtohet me viktimën/palën e dëmtuar dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale, ku i mituri që ka kryer veprën penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive për të zgjidhur pasojat e një vepre penale, zakonisht me ndihmën e një pale të tretë të pavarur...”*”.

masave është e nevojshme zbatimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe/ose ndërmjetësimi<sup>210</sup>, në mënyrë që i mituri të korigjojë pasojat e veprës penale të kryer prej tij në dëm të komuniteti, shoqërisë apo një individi.

Përveç këtyre masave, ashtu sikurse e përmendëm më lart, si dënime kryesore ligji ka parashikuar burgimin, gjobën dhe kufizimin e lirisë, ndërkohë që puna në dobi të komunitetit apo përmeshja e detyrimeve të caktuara, etj, janë parashikuar si dënime plotësuese.

Tërësia e masave të drejtësisë restauruese, masave detyruese dhe dënimi i mundësojnë gjykatës të japë atë lloj dhe masë dënimi, për të cilën mendohet se arrihet qëllimi i edukimit, reabilitimit dhe riintegritimit të të miturit në shoqëri.

#### **4.2.2. Shmangia nga ndjekja penale dhe dënimi, përmes masave alternative**

Një çështje që paraqet rëndësi dhe që është trajtuar gjerësisht edhe nga KDPM, është shmangia nga ndjekja penale dhe nga dënimi, përmes masave alternative<sup>211</sup>. Organi kompetent në marrjen e vendimit për zbatimin e masës për shmangie nga ndjekja penale, vlerëson interesin më të lartë të miturit dhe merr parasysh këto kritere dhe rrethana:

- rëndësinë e veprës penale të kryer dhe dënimin e parashikuar për atë vepër;
- moshën e të miturit;
- shkallën e fajësisë;
- dëmin e shkaktuar;
- raportin e vlerësimit individual;
- sjelljen e të miturit pas kryerjes së veprës penale<sup>212</sup>.

---

<sup>210</sup> Neni 63, i ligjit nr.37/2017, në mënyrë të posaçme përcaktohet se: “...të miturit, gjatë zbatimit të programit të drejtësisë restauruese, mund t’i kërkohet: të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës; të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë; t’i kërkohet falje viktimës dhe të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktima ose/dhe komuniteti...”.

<sup>211</sup> Kreu VII, i ligjit nr.37/2017.

<sup>212</sup> Neni 55, kreu VII, “Shmangia nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative”, i ligjit nr.37/2017. Po vetë kjo dispozitë ka parashikuar rastet, për të cilat zbatohet masa e shmangies nga organi kompetent, si psh: kur i mituri pranon dhe shpjegon veprën penale të kryer në prani të mbrojtësit, kur i mituri nuk është kallëzuar për kryerjen e një vepre penale, ose kur nuk është recidivist, etj.

Ndërsa në rastin e prokurorit, ligji parashikon se ai (prokurori) mund të vendosë zbatimin e masës së shmangies deri në momentin para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes.

Masa e shmangies ndaj të miturit në konflikt me ligjin mund të merret me iniciativën e prokurorit ose me kërkesë të të miturit në konflikt me ligjin, ose me kërkesë të përfaqësuesit të tij.

Në ato raste, kur masa e shmangies merret me iniciativën e prokurorit, ai i propozon të miturit në konflikt me ligjin masën e shmangies nga ndjekja penale dhe në rast se i mituri jep pëlqimin, prokurori vendos përfundimisht zbatimin e saj<sup>213</sup>.

Po kështu, zbatimi i masës së shmangies mund të vendoset edhe nga gjykata, sipas rastit, kryesisht ose me kërkesë të arsyetuar të palëve, punonjësit social apo psikologut. Në këto raste, ajo vendos kthimin e çështjes prokurorit, për të proceduar më tej me zbatimin e masës së shmangies, por më parë gjykata dëgjon të miturin dhe kërkon pëlqimin e tij<sup>214</sup>.

Masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale janë si vijon:

- a) programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- b) këshillimi për të miturin dhe familjen;
- c) paralajmërimi me gojë;
- ç) paralajmërimi me shkrim;
- d) masat detyruese;
- dh) vendosja nën kujdes<sup>215</sup>.

---

<sup>213</sup> Shih nenin 55, të ligjit nr.37/2017.

<sup>214</sup> Shih nenin 57, të ligjit.

<sup>215</sup> Neni 62, i ligjit nr.37/2017, përcakton se: *“...Ndaj të miturit mund të zbatohen në të njëjtën kohë disa masa nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këto masa përcaktohen mbështetur në raportin e vlerësimit individual të të miturit, sipas rregullave të parash ikuara në Kod dhe ato duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me nevojat e të miturit në konflikt me ligjin dhe të viktimës. Asnjë detyrim nuk mund t'i imponohet të miturit në procesin e vendosjes së masës së shmangies, e cila mund t'i shkaktojë poshtërim, degradim, përjashtim nga procesi normal edukativ dhe/ose punësimi kryesor, si dhe dëmtim të shëndetit fizik ose/dhe mendor...”*

#### **4.2.3. Masa sigurimi të veçanta për të miturit**

Përveç masave të sigurimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ndaj të miturit në konflikt me ligjin mund të vendosen edhe këto masa:

- a) vendosja e të miturit në mbikëqyrje;
- b) vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar<sup>216</sup>.

Ajo që synon aplikimi i këtyre masave të sigurimit të veçanta për të miturit ka për qëllim garantimin e qenies prezent të të miturit sa herë që kjo kërkohet nga gjykata, prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore. Natyrisht, që realizimi i saj kërkon bashkërendimin dhe koordinimin e të gjithë aktorëve të përfshirë siç janë: familja, të afërmit, institucionet e specializuara ose personi mbështetës<sup>217</sup>.

#### **4.2.4. Masat disiplinore**

Nëse një i mitur në konflikt me ligjin, në përfundim të një procesi gjyqësor është dënuar dhe është vendosur në një institucion të vuajtjes së dënimit, sipas legjislacionit në fuqi, administrata e këtij të fundit është e autorizuar të përdorë masa disiplinore ndaj të miturit, nëse ai ka kryer shkelje disiplinore.

Kodi ka parashikuar disa lloje të masave disiplinore si më poshtë vijon:

- a) vërejtje në formë paralajmërimi;
- b) kufizim deri në 1 muaj i së drejtës për të përdorur sende të lejuara, me përjashtim të ushqimeve dhe të mjekimit të dhënë nga mjeku;
- c) kufizim i së drejtës për të përdorur dyqanin e ndodhur në mjedisin e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur deri në 1 muaj;
- c) kufizim deri në një muaj i së drejtës për të marrë pako<sup>218</sup>;

---

<sup>216</sup> Shih nenin 82, të ligjit nr.37/2017.

<sup>217</sup> Neni 83, i ligjit.

<sup>218</sup> Neni 126, i ligjit nr.37/2017

Në të njëjtën kohë, ligji ka parashikuar edhe procedurat sesi veprohet për dhënien e masave disiplinore<sup>219</sup>.

---

<sup>219</sup> Në nenin 127, përcaktohet se: “...Shkelja disiplinore e të miturit të arrestuar/të dënuar shqyrtohet në një seancë dëgjimore, me përjashtim të rastit kur i mituri prish rregullin ose pengon kryerjen e seancës, nuk merr pjesë ose refuzon të marrë pjesë në të. Ky fakt pasqyrohet në procesverbalin e mbajtur gjatë kësaj séance... I mituri i arrestuar/i dënuar ka të drejtë për të pasur një mbrojtës në seancën dëgjimore të shqyrtimit të shkeljes disiplinore. Përpara se të fillojë seanca dëgjimore, i mituri informohet për të drejtën për të pasur një mbrojtës, gjë që ushtrohet brenda gjashtë orëve nga dhënia e informacionit, në rast se ka një pëlqim të lidhur me të. Në rast se mbrojtësi nuk paraqitet në kohën e përcaktuar, të miturit do t'i caktohet një mbrojtës kryesisht. I mituri jep pëlqimin lidhur me mbrojtësin kryesisht. Shpenzimet për mbrojtjen kryesisht mbulohen sipas parashikimeve të legjisllacionin për ndihmën juridike...”.

### **\*Qëndrim reflektues**

Në përfundim të këtij parashtrimi për çka parashikon Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, dëshiroj të theksoj se, ***parandalimi i delikuentës së të miturve është një pjesë thelbësore e parandalimit të përgjithshëm të krimit në shoqëri***. Siç është përmendur edhe në kapitujt pararendës, në trajtimin që ju bë kuadrit ligjor ndërkombëtar, një numër i akteve të Kombeve të Bashkuara pasqyrojnë një preferencë për qasjet sociale, dhe jo gjyqësore ndaj kontrollit të kriminalitetit të të miturit. Udhëzimet e Rijadit dhe Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit), rekomandojnë vendosjen e masave pozitive për të forcuar mirëqenien e përgjithshme të të miturve, në mënyrë që të minimizojnë nevojën e ndërhyrjes së shtetit në këtë drejtim.

Ndërhyrja që në fazat e hershme të shfaqjes së dukurive dhe sjelljeve kriminale nga të miturit, përfaqëson qasjen më të mirë për të parandaluar delikuentën e të miturve. Parandalimi kërkon ***përpjekje individuale, grupore dhe organizative*** që synojnë mbajtjen e adoleshentëve nga shkelja e ligjit.

Vende të ndryshme përdorin metoda të ndryshme për të dekurajuar sjelljen delikate dhe kriminale. Disa përqëndrohen ***në parandalimin ndëshkues***, që synon të trembë shkelësit e ligjit, duke siguruar që ata të kuptojnë mundësinë e dënimit të ashpër ose, në marrjen e masave për të parandaluar krimin periodik, që përfshin shpjegimin e aspekteve negative të një veprë penale për një të mitur në konflikt me ligjin dhe, përpjekjen për të pajtuar shkelësit dhe viktimat<sup>220</sup>.

Puna e parakohshme parandaluese duhet të kryhet në disa fusha, ***por e orientuar drejt sektorit ekonomik, me qëllim krijimin e programeve të zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional***, për të siguruar alternativa ligjore për gjenerimin e të ardhurave. ***Krijimi i mundësive ekonomike, nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të punës për të rinjtë***, ofrimi i shanseve ***për ndjekjen e shkollave të arsimit dhe formimit profesional, asistencë financiare në organizimin e bizneseve dhe iniciativave sipërmarrëse***, mund të ndihmojnë në parandalimin e përfshirjes së të rinjve në veprimtari kriminale. Gjithashtu, ***edhe programet edukative*** janë një mundësi e mirë që të rinjtë të mësojnë, se si të angazhohen në

---

<sup>220</sup>Psh: procesi i ndërmjetësimit, parashikuar në ligjin nr.37/2017, i cili synon procesin e zgjidhjes jashtëgjyqësisht dhe përmes dialogur, ndërmjet një të mituri që ka kryer krimin dhe viktimës.

vetëvlerësim pozitiv, të bëhen pjesë e debateve konstruktive në një konflikt dhe të arrijnë të vetëpërbahen.

Në vijim, përmendëm që një prej faktorëve të riskut që ndikon në rritjen e kriminalitetit të të miturit është edhe urbanizimi. Shpesh, është e mundur të zvogëlohet niveli i shfaqjes së dukurive kriminale të të miturit, duke ndryshuar mjedisin urban, duke ndryshuar karakteristikat fizike të tij, përmes planifikimit arkitektural dhe peisazhor dhe, duke ofruar kështu mundësi, për të zgjuar interesin e të rinjve dhe për t'i angazhuar ata në këtë drejtim<sup>221</sup>.

Situata aktuale në lidhje me krimin e të miturve dhe delikuencës, mund të jetë e karakterizuar nga këta faktorë themelorë dhe tendencat e mëposhtme:

- vërehet një rritje e dukshme e dhunshme dhe e rënduar e kriminalitetit mes të rinjve;
- numri i krimeve të lidhura me drogën po rritet;
- procesi i globalizimit dhe lëvizshmëria më e madhe e grupeve të mëdha të popullsisë kanë çuar në një rritje të aktivitetit kriminal, të ndërlidhur me intolerancën ndaj anëtarëve të kulturave të tjera<sup>222</sup>;
- në shumë raste, krimet e të miturve janë të lidhura me burime më pak të dukshme të motivimit<sup>223</sup>;
- shumë shpesh, sjellja agresive dhe kriminale është portretizuar pozitivisht në media, duke krijuar një imazh surreal për dhunën dhe përdorimin e saj;
- varfëria, përjashtimi social dhe papunësia shpesh shkakton marginalizim dhe të rinjtë që janë më të ndjeshëm ndaj zhvillimit dhe mbajtjes së sjelljes delikente;
- kriminaliteti të të miturit është kryesisht një fenomen grupor, shpesh është i angazhuar nga nënkultura të caktuara të të rinjve, që kanë marrë së bashku një identitet të veçantë<sup>224</sup>;

---

<sup>221</sup> Një studim hulumtues i kryer në një qytet, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, zbuloi se shumica e aktiviteteve të grupeve të delikuentëve të mitur ishin përqendruar rreth parkut të vetëm të qytetit. Planifikimi i parkut u ridizajnuar për të krijuar shumë më tepër mundësi argëtimi dhe rekreative për të miturit dhe prindërit e tyre. Gjithashtu, u rrit numri i aktiviteteve pozitive të pasdites, të mbajtura në shkollë dhe në parqe. Të gjitha këto masa çuan në një reduktim të ndjeshëm të delikuencës së të miturve; në Shtetet e Bashkuara, krimi i të miturve, duke përfshirë veprat e dhunshme, arrin kulmin në orën 3 pasdite, zakonisht pas shkollës. **Burimi i APA – American Psychological Association, “Violence and Youth: psychology’s response”, summary report of the APA Commission on Violence and Youth, Washington D.C., 1993.**

<sup>222</sup> Vështirësitë e hasura nga emigrantët dhe pasardhësit e tyre në disa vende, ndonjëherë lidhen me nivelet e larta të krimit të grupeve në vendet ku ata emigrojnë.

<sup>223</sup> Veprime të ndryshme mund të pasqyrojnë, për shembull, standardet e subkulturave të veçanta, mësimet apo traditat, që rrjedhin nga filozofitë fetare, radikalizmi ekstrem ose detyrimi për përdorimin e dhunës, si një mjet për të ndërtuar identitetin gjinor. Mjaft shpesh, sjellja agresive dhe kriminale portretizohet pozitivisht në media, duke krijuar një pamje të hutuar të normave të moralit shoqëror, të pranueshme brenda disa nënkulturave të të rinjve.



- fëmijët dhe adoleshentët në rrethana të vështira përbëjnë rezerva të gatshme për krimin e organizuar, pjesëmarrjen në konflikte të armatosura, trafikimin njerëzor dhe të drogës dhe shfrytëzimin seksual.

Dukuritë kriminale të të miturit mbulojnë një mori shkeljesh të ndryshme të normave ligjore dhe sociale, duke filluar nga veprat e kundërligjshme deri tek krimet e rënda të kryera nga të rinjtë. Disa lloje të delikuençës së të miturve përbëjnë pjesë të procesit të maturimit dhe rritjes dhe zhduken në mënyrë spontane, kur të rinjtë bëjnë kalimin nga adoleshenca në moshën e rritur. Shumë të rritur me përgjegjësi shoqërore kanë kryer lloje të ndryshme të veprave të lehta penale, gjatë adoleshencës së tyre.

Për më tepër, të rinjtë kanë më shumë gjasa të bëhen viktimë të krimeve të kryera nga delikuentë të mitur. Gjithashtu, ajo që vërehet, është se delikuenca është kryesisht një fenomen mashkullor, me shkallën e krimit për të miturit dhe të rinjtë e rinj, më shumë se dyfishi i kriminalitetit tek të rejtat.

Nëse politikat për parandalimin e kriminalitetit të të miturit duhet të jenë me të vërtetë efektive, *i duhet dhënë prioritet më i lartë të rinjve të marginalizuar, të pambrojtur dhe të pafavorizuar në shoqëri* dhe, çështjet që kanë të bëjnë me të miturit në konflikt me ligjin duhet të jenë një fokus qendror i politikave kombëtare për të rinjtë.

Administrimi i drejtësisë për të mitur *duhet të decentralizohet*, me qëllim që të inkurajojë autoritetet vendore (psh: Njësitë e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijës në nivel Vendor<sup>224</sup>), të përfshihen në mënyrë aktive në parandalimin e kriminalitetit të të miturit dhe të rinjtë dhe, riintegrimin e tyre në shoqëri, *përmes programeve të drejtësisë restauruese, projekteve mbështetëse*, me synimin kryesor të riedukimit në vazhdim dhe riintegrimin të kësaj kategorie shoqërore me normat dhe vlerat e moralit shoqëror dhe të të qenit qytetarë të përgjegjshëm në komunitet e më gjerë.

---

<sup>224</sup> Disa prej veprimtarive kriminale të të miturit lidhen me intolerancën e anëtarëve të kulturave të tjera ose grupeve fetare, racore ose etnike.

### 4.3. *Legjislacioni për drejtësinë për të mitur në kontekst krahasues me atë italian lidhur me të miturin në procesin penal*

Në thelb të drejtësisë penale për të mitur, kryesisht në procesin penal ndaj të miturve, parimi bazë, që orienton të gjitha zgjedhjet ligjore është ai i mbrojtjes së të miturit dhe parimi i “interesit më të lartë të fëmijës”.

Çështja delikate e së drejtës penale për të mitur në Itali, nuk është trajtuar në mënyrë organike, pasi vetëm në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë lindi nevoja për të rregulluar në veçanti funksionin ndëshkues të ligjit, ndaj të miturve.

Për të përcaktuar më mirë situatën aktuale të sistemit gjyqësor Italian, është thelbësore që të rishikohen edhe pse për një periudhë të vogël kohore, fazat më të rëndësishme, përmes të cilave ky sistem ka ardhur në fizionominë aktuale.

Krahasuar me atë që ndodhi në vende të tjera evropiane dhe joevropiane, krijimi i një juridiksioni të specializuar për të mitur në Itali, u zhvillua relativisht vonë: pika e mbërritjes së një procesi të gjatë dhe të trazuar<sup>225</sup> - ajo e krijimit të një gjykate të specializuar posaçërisht për të miturit, përfaqësonte përkushtimin në nivelin institucional të administrimit të drejtësisë për të miturit. Për më tepër, nevoja për një diferencim të trajtimit ligjor, ndërmjet të rriturve dhe të miturve, filloi të shfaqej gjithnjë e më shumë, vetëm në fillim të shekullit të kaluar.

Zhvillimet e jurisprudencës italiane dhe gjykimet e saj, shkaktuar nga pamjaftueshmëria dhe papërshtatshmëria e reagimit institucional, ndaj problemit të delikuençës së të miturve, luajtën një rol katalizator në rrugën sociale, që do të çonte disa vite më vonë në themelimin e gjykatës për të mitur.

Ndërhyrja e parë që synonte zbulimin e nevojës për një trajtim të individualizuar të fëmijës, e cila duhej kryer nën kujdesin efektiv pedagogjik, ishte më 11 maj 1908, nga ish-ministri Guardasigilli Vittorio Emanuele Orlando, i cili, i alarmuar “...nga rritja e frikshme e delikuençës së të miturve...” dhe “...ngadalësia e pashmangshme e veprimeve legislative në këtë drejtim...”, i drejtoi gjykatës një numër rekomandimesh, që përcaktonin bazat e trajnimit më të specializuar të gjyqtarëve, që merreshin me gjykimin e çështjeve penale për të miturit, veçanërisht për të miturit, nën moshën 15 vjeç<sup>226</sup>.

---

<sup>225</sup> *Reggio Decreto Legislativo* nr.1404, datë 20 korrik 1934, "Themelimi dhe funksionimi i Gjykatës për të Mitur", formalizoi ndërgjegjen e organeve kompetente të administrimit të drejtësisë për të mitur në Itali dhe gjithë shoqërisë, për të parë fenomenin e devijimit të të miturit, nën dritën e një vetëdijeje të re dhe më të pjekur.

<sup>226</sup> Në të tilla rrethana u është rekomanduar krerëve të gjykatave, që në gjykatat me dy ose më shumë gjyqtarë ose seksione të shumëfishta, të ishin të njëjtët gjyqtarë përgjegjës për trajtimin e procedimeve kundër të miturve të akuzuar. Këtyre gjyqtarëve u kërkohet të “...të studionin me një frymë pothuajse atërore, psikologjinë e të

Qarkorja “Orlando” ishte padyshim një moment historik në traktatin, që do të çonte në krijimin e një gjykate për të mitur në Itali.

Sidoqoftë, përpos suksesit në disa seanca të zhvillimeve legislative të njëpasnjëshme, në praktikë kjo qarkore nuk pati zbatimin e dëshiruar, megjithëse në shumë aspekte ishte cilësuar si e nevojshme dhe e domosdoshme.

Edhe pse, pati lulëzim në një gamë të gjerë iniciativash legislative të fushëveprimit të ndryshëm, ende nuk kishte asnjë shenjë për krijimin e një sistemi gjyqësor të posaçëm, megjithatë ndërgjegjësimi për nevojën për zgjidhje më të gjera dhe më të artikuluar, bëri që ish-ministri i Drejtësisë, Alfredo Rocco, të lëshonte një qarkore, e cila kishte brenda një kontekst më të gjerë dhe përfshinte edhe disa nga direktivat e qarkores “Orlando”, të cilat nuk ishin përkthyer kurrë në ligj.

Ende nuk mund të flitej për reforma, por pa dyshim ky ishte një hap i mëtejshëm, i rëndësishëm, drejt realizimeve më konkrete institucionale. Për më tepër Kodi i ri Penal, hyri në fuqi në 1913 në të njëjtën kohë me Kodin e Procedurës Penale, përveç rritjes së moshës së përgjegjësisë nga 9 deri në 14 vjeç dhe uljes së moshës së përgjegjësisë të plotë nga 21 në 18 vjeç. Gjithashtu, u prezantua si një përjashtim i një logjike të rreptë ndëshkuese, instituti i “*faljes gjyqësore*” (neni 169), për të garantuar “...*kthimin e të miturve dhe të rinjve adoleshentë në rrugë të drejtë, larg veseve dhe krimit, e bashkëjetesës shoqërore me vlerat e moralit dhe ligjit...*”<sup>227</sup>.

Gjatë periudhës fashiste, gjykata e të miturve, tradicionalisht e kuptuar si një institucion liberal i frymëzimit, u krijua më në fund me Regio Decreto Legislativo nr.1404, më 20 korrik 1934 e më pas u kthye, me modifikime, në ligj më 7 maj 1935<sup>228</sup>.

Një rëndësi të veçantë, në funksion të realizimit të një legjislacioni që është më i vëmendshëm dhe i përshtatur ndaj nevojave reale të fëmijës, në zhvillimin e një sistemi për

---

*akuzuarit, t'a trajtonin atë me të mirë dhe pa frikë, duke u përprekur të fitonin besimin e tij dhe t'a bënin atë të kuptojë domosdoshmërinë e respektimit të ligjeve dhe respektit për disiplinën dhe autoritetin publik...*” Gjithashtu, nga këta gjyqtarë u kërkua që “...*të mos kufizoheshin në shqyrtimin e veprës penale nga pikpamja materiale e personale, por të vazhdonin me hetime të mëtejshme, që lidheshin me njohjen e gjendjes familjare të të miturit të akuzuar dhe kushtet e jetës së tij, vendet dhe shoqëria që frekuentonte, karakterin e atyre që e kishin në kujdestari, mjetet që përdorshin për t'a tërhequr atë në rrugën e drejtë të ligjit dhe moralit shoqëror, të gjitha ato element që mund të jenë përcaktues të saktë të shkaqeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta, për të cilat i mituri ka thyer ligjin...*”. Në vijim, seancat dëgjimore me të miturit e akuzuar, këta gjyqtarë duhej t'i mbanin në ditë dhe orë, kur nuk kishin seanca gjyqësore me të rriturit e akuzuar. Konkretisht, kërkohesh që në seancat në ngarkim të të miturve nën moshën 18 vjeç, duhej të mbaheshin “...*në vende të ndara dhe larg ambjentëve, në të cilat gjykoreshin personat më të mëdhenj në moshë, në mënyrë që të shmangeshin kontaktet e pakëndshme me të akuzuarit e vegjël, gjatë qëndrimit të tyre në Pallatin e Drejtësisë...*”. Qarkorja e ish-ministrit të Drejtësisë, V. E. Orlando, 11 maj 1908, cit./ Qarkorja nr.2236/29, cit., fq. 766

<sup>227</sup> Raporti ministror mbi draftin përfundimtar të një Kodi të ri Penal, në punën përgatitore për Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, vol.V, Romë, 1929, fq. 220.

<sup>228</sup> Qarkorja e ish-ministrit Guardasigilli Rocco, nr.2236, datë 22 shtator 1929, në Buletinin Zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë, 1929, fq. 766.

mbrojtjen dhe promovimin e personalitetit në një fazë evolutive, sigurisht kishte Karta Kushtetuese, e cila shënoi një ndryshim të kursit në filozofinë e përgjithshme të sistemit penal - jo vetëm minoren - me një vlerësim të fortë të komponentit të riedukimit që shoqërohet me sanksionin.

Në sistemin para-kushtetues të veprimit penal kundër të miturve ishte tashmë i pranishëm, mundësia për të hequr dorë nga masa ndëshkuese (nëse kjo do të ishte funksionale në riedukimin e të miturit) dhe, ishte njohur një zbutje e përgjegjësisë dhe një metodologji e ndjekjes penale "*...më e kujdesshme për të arritur një proces pozitiv evolucionar...*"<sup>229</sup>, ndryshe nga sa parashikohej në sistemin e drejtësisë penale për të rritur. Sidoqoftë, në praktikë, më shumë se sa kontributi në procesin e rregullt të shoqërizimit dhe se privimi i lirisë, rezultoi të ishte parandalimi më efektiv kundër devijimit dhe recidivizmit. Rrjedhimisht, edhe pse kërkohet përdorimi i institucioneve të një natyre më të "mëshirshme", është detyrim i gjykatës për të aplikuar një dënim më të butë për të miturin, pasi sanksionet në këtë rast, nuk ndryshonin shumë nga ato që aplikoheshin për të rriturit, duke patur pothuajse të njëjtat karakteristika ndëshkuese.

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës, përcaktohet progresivisht, maturimi i një ndjeshmërie të re ndaj problemit të delikuencës së të miturve, e cila bazohet në premisa kulturore dhe ideologjike, thellësisht të ndryshuara. Edhe pse, nuk përfshinte një statut gjithëpërfshirës për mbrojtjen e të miturit, Karta Kushtetuese ofroi një nxitje të konsiderueshme në zhvillimin e një sistemi të mbrojtjes dhe promovimit të personalitetit në formim (neni 31/2 i Kushtetutës). I mituri njihet si bartës i të drejtave të rrënjësura në shembuj themelorë të personalizimit të plotë. Në të njëjtën kohë, problemet që lidhen me sjelljen devijante, trajtohen dhe zgjidhen duke mos e izoluar të miturin nga konteksti i jetës së tij, por duke përfshirë dhe mbështetur familjen dhe duke aktivizuar të gjitha burimet e komunitetit përkatës.

Në këtë kornizë të re, ndërhyrja kriminale nuk mund të mos ndryshojë qëllimin dhe mjetet operationale: qasja e ndryshme në interpretimin dhe vlerësimin e fenomenit të devijimit të fëmijës dhe zhvlerësimi i profilit, kryesisht për shkak të reagimit të komponentit të riedukimit në themel të veprimit sanksionues (neni 27/3, i Kushtetutës), reflektohet automatikisht në vendosjen e ndërhyrjeve të kontrollit dhe identifikimin e mjeteve të afta për të siguruar përgjigje adekuate për problemin. Megjithatë, vetëm në vitet 1970, nisi të

---

<sup>229</sup> Në këtë drejtim, cf. A. C. MORO, "Manual mbi të Drejtat e Fëmijëve", Bologna, 2000, fq. 379.

diskutohej në parlamentin Italian reforma e drejtësisë për të miturit, ku ndihej nevoja për të përshtatur këtë legjislacion me reformën më të përgjithshme të Kodit të ri Penal për të Rriturit.

Ideja fillestare ishte se, sapo të reformohej Kodi i Procedurës Penale, çështja e ndërhyrjes penale kundër të miturit, ishte adresuar veçmas dhe, kjo nuk ishte konsideruar e përshtatshme për të privuar reformën e çështjeve procedurale nga një ndërhyrje më gjithëpërfshirëse reformiste edhe në fusha të tjera, përveç asaj procedurale - mendohej për të drejtën penale dhe rendin gjyqësor, por të ndërlidhur më ngushtë.

Për këtë arsye, ligji nr.108, i miratuar më 3 prill 1974, që përmban direktivat dhe parimet udhëzuese për nxjerrjen e Kodit të ri të Procedurës Penale, trajtoi plotësisht tematikën e çështjes penale të të miturve<sup>230</sup>.

Elementi sistematik, që shfaqet në miratimin e një kuadri ligjor në vitin 1987 është një njohje e fuqishme dhe e kualifikuar e karakteristikave të veçanta të procesit penal të të miturve, brenda skemës procedurale të zakonshme dhe, për aq sa është e mundur, në harmoni me të njëjtën procedurë.

Në këto kushte, interpretohet pjesa e parë e nenit 3, të ligjit nr.81/1987, i cili përcakton "*parimet e përgjithshme të gjyqimit të ri penal*". Megjithatë, këto parime i nënshtrohen modifikimeve dhe plotësimeve të imponuara nga kushtet e veçanta psikologjike të fëmijës, pjekurinë e tij, nevojat e edukimit të tij, etj.

Prandaj, ky sistem i ri procedural u realizua në aspektin prioritar të nevojave arsimore të fëmijës, një paradigmë themelore referimi, për të vlerësuar nëse dhe, si duhet të transpozohen parimet e përgjithshme të këtij procesi.

Le të ndalemi më konkretisht:

### ***Ndërhyrje të hershme në fillim të viteve 1900***

Në Itali, në vitin 1908, me një qarkore të Orlando-s<sup>231</sup>, autoriteteve gjyqësore ju dhanë direktivat e para, të cilat dëshmuuan për një orientim të qartë drejt konsolidimit të drejtësisë

---

<sup>230</sup> Kishte vetëm dy dispozita, që përmbanin: në paragrafin 13, ku parashikohej "*...përfshirja e të miturit në rastin e kundërvajtjeve..*", tjetra në paragrafin 30, ku parashihej "*...ushtrimi opsional i fuqisë për arrestimin e të miturit të kapur në flagrancë gjatë kryerjes së një krimi të rëndë...*".

<sup>231</sup> Ish-ministri Guardian Vittorio Emanuele Orlando më 11 maj 1908, thirri një tavolinë të rrumbullakët me qëllimin e diskutimit të çështje ministrore dhe, parashitri një numër rekomandimesh, me të cilat u vendosën bazat, sipas ligjit për të miturit, të parimeve të specializimit e të trajnimit të gjyqtarëve që do të gjykonin të

penale për të mitur. Kjo qasje, e cila, përkundër retorikës së keqkuptimit të mirëqenies së të rinjve, u ndikua qartë nga nevoja për mbrojtje sociale, u pasua me një sërë projektesh legislative, për të kulmuar me reformën organike në fushën penale, e cila në pak më shumë se një dekadë fashizmi, përfundoi dhe, kështu, u propozua reforma e parë legislative për problemin e trajtimit penal të shkelësve të mitur. Reforma fashiste kishte avantazhin e trajtimit e problemit të krimit të të miturve nga perspektiva e një rritjeje më të madhe të masave, që u morën në këtë drejtim për parandalimin e kriminalitetit të të miturve<sup>232</sup>. Me miratimin e Kodit Rocco të 1930<sup>233</sup> ndryshime të rëndësishme janë bërë në drejtim të reformimit të disa institucioneve ekzistuese.

Me rëndësi të veçantë është “*falja gjyqësore*”, një institut i parë i konceptuar posaçërisht për “kriminelët” e mitur, që synon shpëputjen e të miturve delikuentë nga bota e krimit dhe rishoqërimin e riintegrimin e tyre në shoqëri. Futja e masave të sigurisë për të miturit në kodin Zanardelli<sup>234</sup> ishte gjithashtu, shumë e rëndësishme. Kështu, nga njëra anë, i mituri nuk dënohet në moshën 14 vjeçare, sepse ai nuk konsiderohet i pjekur në mënyrë të mjaftueshme për t’u nënshtruar një aktgjykimi me përgjegjësi penale.

Dekreti Mbretëror i 1934<sup>235</sup>, përfshiu për herë të parë në ligj konceptin e një organi të specializuar gjyqësor, që do të merrej me gjykimin e të gjitha veprave penale, të kryera nga

---

miturit në konflikt me ligjin: “...në gjykata, ku dy ose më shumë gjyqtarë janë të përfshirë në gjykimet penale me të mitur, një prej tyre të kujdeset në mënyrë të veçantë për procedurën kundër të pandehurve të mitur...”. Ai argumentoi se: “...gjyqtarët duhet të studionin psikologjinë, me mendje pothuajse atërore për të pandehurit, për t’i trajtuar ata mirë dhe pa frikë, duke u përpjekur të fitojnë besimin dhe ta bëjnë të pandehurin e mitur të kuptojë nevojën për përputhje me ligjet dhe respektimin e disiplinës dhe autoriteteve publike...”; gjykatësit u ftuan gjithashtu, që të mos kufizoheshin “...vetëm për zbulimin e veprës penale në materialitetin e saj të pastër...”, por “...të vazhdojnë të hetojnë nëpërmjet mbledhjes së informacionit për të njohur statusin e familjes së të akuzuarit të vogël dhe kushtet e jetës së tij, vendet dhe kompanitë që ai frekuenton, karakterin e tij, kujdestarinë, psikologjinë e tij, etj, pra të gjitha atë informacion që mund të japë një kriter të saktë të shkaqeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, për të cilën i mituri erdhi në konflikt me ligjin...”. Teksti i qarkores është tërësisht në NOVELLI G., Shënime ilustrative të Dekretit Mbretëror të 20 korrikut 1934, nr.1404, në institucionin dhe funksionimin e Gjykatës për të mitur në Riv.dir. Penit. 1934, II, fq. 802.

<sup>232</sup> Në veçanti, dekreti legjislativ nr.888/1956 ndryshon konkretisht nga nenin 25 i *Regio Decreto Legge* nr.1404, i 20 korrikut të 1934, që përcakton se: “... **Kur një i mitur i moshës 18 vjeç dëshmon për parregullsi të sjelljes ose karakterit, prokurori i Republikës, shërbimi i mirëqenies së fëmijës, prindërit, kujdestari, institucionet e edukimit, mbrojtjes dhe ndihmës për fëmijët dhe adoleshentët e rinj, mund të raportojnë faktet në Gjykatën për të Mitur...**”.

<sup>233</sup> Kodi Penal Italian (i njohur si “Kodi i Rocco”, me emrin e tij kryesor, për nder të Ruajtësit të Qeverisë së Musolinit Alfredo Rocco) është një tërësia e dispozitave ligjore, të kodifikuara në të drejtën penale italiane. Alfredo Rocco (Napoli, 9 shtator 1875 - Roma, 28 gusht 1935) ishte një politikan dhe jurist italian, emri i të cilit lidhet me Kodin Penal që ai ka nxjerrë dhe është ende në fuqi, si dhe Kodin e Procedurës Penale.

<sup>234</sup> Kodi Penal Italian i vitit 1889 (zakonisht i referuar si “Kodi Zanardelli” nga Giuseppe Zanardelli), ishte kodi penal në fuqi në Mbretërinë e Italisë nga viti 1890 deri në vitin 1930. Giuseppe Zanardelli (lindi në Brescia, 26 tetor 1826 dhe vdiq në Toscolano Maderno, 26 dhjetor 1903) ishte një patriot dhe politikan italian i shquar i asaj kohe, ministër i Drejtësisë në qeverinë *Depretis* të 1881, president i Dhomës së Deputetëve, 1892-1894, etj.

<sup>235</sup> *Regio Decreto Legge* nr.1404, i 20 korrikut 1934, “**Istituzione e funzionamento del tribunale per i minorenni- themelimi dhe funksioni i gjykatës për të miturit**”, botuar në Gazetën Zyrtare, datë 5 shtator 1934, nr.208 e kthyer në ligj me modifikimet e 27 majit 1935, nr. 835. *Presidenza e Këshillit të Ministrave: Departamenti i Marrëdhënive me Publikun dhe Punët e Rajonit, Circ. 5 dhjetor 1996, nr.8661*

individë, që nuk kishin mbushur moshën 18 vjeç<sup>236</sup>. Gjithashtu, u parashikua, që të përfshihej një zyrë e specializuar e prokurorisë. Risi e këtij organi gjyqësor nuk ishte vetëm në varësinë e tij, por edhe në juridiksionin e çështjeve penale. Ligji për të Mitur i 1934-ës, prezantoi reformat e rëndësishme për disa institute thelbësore të ligjit penal, tashmë të pranishme në Kodin Penal.

Reformat në institucionet e ligjit penal, që ndikojnë në shmangien e përgjegjësisë penale për të miturit, synojnë parandalimin e kriminalitetit të të miturit dhe rehabilitimin e të miturit, nëpërmjet programeve të drejtësisë restauruese, për rintegrimin e edukimin e të miturit në jetën sociale<sup>237</sup>.

Ndër institutet e ndryshme që krijohen, në kuadër të reformës së administrimit të drejtësisë për të mitur, gjithashtu kemi krijimin e "Qendrave të Rehabilitimit për të Miturit". Përveç juridiksionit të gjykatës për të mitur, këtyre institucioneve, u janë besuar kompetencat administrative, sipas neneve 25-31, të *Regio Decreto Legge* nr.1404/1934, fillimisht me detyrën e vetme për korrigjimin moral e edukativ të subjektit të mitur nën 18 vjeç.

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës dhe vendosjes së parimeve kushtetuese, lidhur me të drejtat edhe për të miturit (siç është psh: arsimimi), kërkohet një rishpërndarje radikale e kompetencës administrative të gjykatës për të miturit dhe masave përmirësuese, në mënyrë që këto masa të jenë mjetet e mbështetjes reale dhe të ndihmojnë në një evolucion pozitiv të personalitetit të fëmijës, në rastet e sjelljeve devijuese. Me ligjin nr.888, të 25 korrikut 1956<sup>238</sup>, ky ndryshim bëhet i dukshëm, të paktën nga pikëpamja teorike, pasi përfshihet për herë të parë në këtë ligj koncepti i "*mirëqenies së vërtetë*" në fushën e drejtësisë për të mitur. Risia më e vlefshme e këtij ligji ishte themelimi i Zyrës së Shërbimit Social për të Miturit, që fillimisht u kërkua për të bashkëpunuar me gjyqtarin për të mitur, për zbatimin e masave administrative dhe në veçanti, për masën e "*besimit të shërbimit social*" që u prezantua pikërisht me këtë ligj.

Në vitet '70, sistemi për të miturit kishte përparuar aq shumë, sa ishte e nevojshme ndërhyrja në legjislacion, me qëllim që ai t'i përgjigjej nevojave të kohës, si dhe zbatimit efektiv në

---

<sup>236</sup> Neni 9 i *Regio Decreto Legge* nr.1404, i 20 korrikut të 1934, parashikon që: "...*Të gjitha procedurat penale për veprat penale të kryera nga fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, të cilët janë nën ligjet e juridiksionit të autoritetit gjyqësor janë nën juridiksionin e gjykatës për të mitur...*".

<sup>237</sup> Në nenin 25, të *Regio Decreto Legge* nr.1404, i 20 korrikut të 1934, thuhet se: "... *një nga anëtarët e Gjykatës për të Mitur, i caktuar për këtë qëllim nga presidenti, kryen një hetim të plotë mbi personalitetin e fëmijës dhe urdhëron me dekret masat e mëposhtme:*

- *kujdestarinë e fëmijës në shërbimin e mirëqenies së fëmijës;*
- *vendosjen e të miturit në institucionin e rehabilitimit ose në një institucion psiko-pedagogjik...*".

<sup>238</sup> Ligji nr.888, 25 korrik 1956, ishte ligji që ndryshoi *Regio Decreto Legge* nr.1404, 20 korrik 1934, për Tribunalin e të Miturve.

praktikë të objektivave, për të cilat ishte krijuar. Filloi të shquhej në sistemin e drejtësisë për të mitur, aplikimi i masave të riedukimit, si *“ndërhyrje me dashamirësi për fëmijën”*. Në vitet e fundit, edhe Gjykata Kushtetuese Italiane ka ndërhyrë, me qëllimin për të përshkruar një sistem të drejtësisë për të miturit, që braktis vlerësimet skematike dhe të paramenduara të të miturit në konflikt me ligjin dhe, promovon një qasje të personalizuar dhe të respektueshme ndaj nevojave të subjektit të procedurës ligjore – në këtë rast të miturit. Ligji nr.35, i 9 marsit 1971<sup>239</sup> i atribuohet ekskluziviteti i funksioneve dhe stabilitetit në sistemin e drejtësisë për të miturit, duke siguruar sisteme organike autonome.

Sinjali i parë i rëndësishëm në këtë drejtim, është në fushën e procedurës, me vendimin interpretues të Gjykatës Kushtetuese, nr.46 të vitit 1978, i cili deklaroi të pazbatueshëm ligjin nr.152, të vitit 1975 (*Royal Law*) për të miturit<sup>240</sup>, duke siguruar që *“liria e përkohshme”* si masë është e lejuar për të gjitha llojet e veprave penale.

Mund të shihet se ndërhyrjet e ligjvënësit dhe të Gjykatës Kushtetuese Italiane bazohen në dispozita procedurale, duke përjetësuar në mënyrë të vazhdueshme, qasjen (e siguruar fillimisht nga reforma e drejtësisë për të mitur), të ndërhyrjes më shumë në gjyqësor, se sa në sanksionet dhe të kuptuarit themelor të sistemit. Kjo me ndërgjegjësimin, për të mos nënvlerësuar ashpërsinë e fenomenit të kriminalitetit të të miturit, por gjithashtu, pa lënë mënjanë, shanset për rimëkëmbjen e subjekteve, që ende nuk janë plotësisht të pjekur nga këndvështrimi psiko-fizik.

Kjo krizë e evolucionit dhe ndryshimi, ishte pjesë e asaj që po ndodhte në të gjithë Evropën, veçanërisht në lidhje me dy komponentët, atë të ndihmës dhe trajtimit që duhet t'i bëhet të miturit në konflikt me ligjin, ndryshe nga delikuentët e rritur, në kuadër të sistemit të administrimit të drejtësisë penale për të mitur.

---

<sup>239</sup> Ligji nr.35/9 mars 1971, është i pari ligj në Itali, që siguroi vendosmërinë e magjistratëve që trajtonin në mënyrë të pavarur çështjet e drejtësisë për të miturit, duke konsoliduar në gjyqësor konceptin e “kulturës minorene”.

<sup>240</sup> Neni 1 i ligjit nr.152/1975 deklaroi të pazbatueshme masën e *“lirimit të përkohshëm”* për një numër veprash penale nga hyrja në fuqi e ligjit. Duke ju referuar këtij rregulli, një çështje e legjitimitetit kushtetues u ngrit nga Gjykata e të Miturve në Torino. Gjykata, me aktgjykimin nr.46, të vitit 1978 parashtrroi se: ***“...teksti i nenit 1, të ligjit nr.152/1975, duket të jetë i aftë për një interpretim, që nuk përjashton dhënien e lirisë së përkohshme të të miturve në moshën prej 14 deri në 18 vjeç: një interpretim i cili është gjithashtu, i vetmi që të jetë në harmoni me nenin 3 të ligjit...”***. Sipas arsyetimeve të gjykatës, çështja e ngritur nga Tribunali i Mitur i Torinos nuk u pranua.



Kështu, nevoja në rritje për një reformë organike të ligjit penal për të mitur në Itali, në thelb të saj synoi, *jo vetëm marrjen e masave për nxjerrjen e një të mituri nga rruga e krimit*, por në të njëjtën kohë, edhe *parandalimin e fenomenit të delikuencës të të miturit*.

Për të realizuar daljen e shpejtë të të miturit nga qarku penal, në sistemin italian të drejtësisë penale për të mitur janë futur mekanizma të ndryshëm të shmangies nga ndjekja penale. Flitet për shmangie nga ndjekja penale, duke ju referuar çdo devijimi nga rendi normal i akteve të procesit penal para formulimit të aktpadisë: flitet për shmangie nga procesi ose nga ndëshkimi në varësi të faktit, nëse metoda ka për qëllim largimin e subjektit nga procesi gjyqësor formal apo një ndëshkim më të rreptë. Më konkretisht, hipoteza e shmangies, si metodat që zgjedhin të heqin dorë nga veprimi penal, ashtu dhe ato që çojnë në pezullimin e tij paraprakisht në fazën dëgjimore, jep mundësinë e zëvendësimit të dënimit penal me forma të trajtimit shoqëror – rehabilitues, riintegruës e rishoqërizues, me qëllim përcaktimin e një devijimi të procesit drejt një epilogu jogjyqësor ose, diçka ndryshe nga logjika e gjyqimit dhe dënimit të merituar.

Pra, le të analizojmë metodat më të rëndësishme që identifikojnë mekanizmat e shmangies nga procesi i ndjekjes penale ose të dënimit në legjislacionin italian të drejtësisë penale për të mitur.

#### *a) Parëndësia e faktit*

Neni 27 i D.P.R. 448/1988<sup>241</sup> ka parashikuar në sistemin gjyqësor italian të drejtësisë penale për të mitur, një normë të drejte shumë të rëndësishme. Një normë e tillë parashikon, se gjykatësi mund të deklarojë të pavënd procedimin e të paditurit/pandehurit të mitur, në prani të disa kushteve të caktuara: natyra e parëndësishme e faktit objekt hetimi, natyra e rastësishme e sjelljes, etj si dhe faktin, që vazhdimi i mëtejshëm i procesit penal kundër tij, do të sillte dëme të kosiderueshme në nevojat edukative të të miturit. Ky institut bazohet në Rregullat e Pekinit, të cilat parashikojnë “*devijimin*” në nenin 11, pra zgjidhjen e hershme të procesit për të favorizuar ikjen e të miturit nga sistemi gjyqësor, si dhe duke shmangur efektet deshoqërizuese që rrjedhin nga dhënia e dënimit<sup>242</sup>.

<sup>241</sup> Dekreti Presidential nr.448, i 22 shtatorit të 1988, Kodi i Procesit Penal për të Mitur

<sup>242</sup> Covelli M., “Manuali i legjislacionit penal mbi të miturit”, Napoli, Satura, 2006., p.211

Një nga rastet, kur veprimi penal i ushtruar ndaj subjektit të mitur në momentin e kryerjes së veprës, mund të përmbillet me vendim për të mos vazhduar për “*parëndësi të faktit*”, është kryerja e një vepre të konsideruar si vepër me rrezikshmëri të ulët shoqërore. Duhet të ekzistojë një shkelje sado e lehtë, sepse në rastin e sjelleve, të cilat nuk janë parashikuar si kundravajtje me ligj, vendoset *notitia criminis*.

Natyra e parëndësishme e faktit vlerësohet jo në mënyrë abstrakte, por konkretisht, duke ju referuar natyrës së vetë faktit, efekteve të tij, kontekstit në të cilin është kryer dhe karakteristikave të veprimit. Që fakti të mund të konsiderohet i parëndësishëm, sjellja nuk duhet të karakterizohet nga një vlerë negative sociale e veçantë. Duke ju referuar sjelljes, mund të konsiderohen të parëndësishëm, në radhë të parë, sipas Kodit Penal Italian, veprat penale, për të cilat ky Kod parashikon një dënim me burg deri në 5 vjet. Nga ana tjetër, më lehtë dhe rast pas rasti, mund të vlerësohen si pak të rëndësishëm, në aspektin e vlerave sociale negative, të gjitha sjelljet që janë pjesë faktorë determinantë në kryerjen e një krimi, të karakterizuara nga një impuls i momentit apo një faj i lehtë. Për sa i përket vetë ngjarjes, duhen mbajtur parasysh fakte – krime, që kanë fushëveprimi të kufizuar në dëmtimin e të mirave publike materiale ose jo, të mbrojtura me ligj, d.m.th. që të shkaktojnë një gjendje alarmi social, të tillë që të provokojë reagime dhe shqetësime modeste në komunitet. Gjykata e Kasacionit në Itali ka deklaruar se “një natyrë e tillë e parëndësishme” mund të arrihet, nëse fakti është objektivisht modest dhe që i atribuohet mendjelehtësisë së të rinjve, që shpesh nuk mendojnë mjaftueshëm për pasojat e sjelljes së tyre<sup>243</sup>.

Një tjetër kriter për të marrë vendimin, për të mos vazhduar si pasojë e “*parëndësisë së faktit*”, është *sjellja e rastësishme, si në kuptimin kronologjik dhe atë psikologjik*.

Në aspektin kronologjik, nuk mund të përkufizohen sjellje të rastësishme ato, që janë brenda fushëveprimit të krimeve të përcaktuara nga një mori veprimesh apo lëshimesh (vepër e vazhdueshme dhe vepër e zakonshme) ose nga sjellje të vazhdueshme në kohë (vepër e përhershme). Megjithatë, nuk është e nevojshme, që fakti për të cilin kërkohet parëndësia, të jetë krimi i parë i të miturit dhe, fakti që nuk është i pari, nuk mund të merret shembull për të treguar se sjellja nuk është e rastësishme. Duke vlerësuar elementin psikologjik, duhet të konsiderohen të rastësishme, ato sjellje, të cilat nuk bazohen në zgjedhje të caktuara e të vetëdijshme devijuese, por të përcaktuara nga impulse momentale, tipike të ndryshueshmërisë ekstreme emocionale të gjendjes së adoleshencës, dhe kështu këto vepra

---

<sup>243</sup> Sipas Gjykatës Kushtetuese, Vendimi IV, 7 shkurt 1995, n.1208

konsiderohen si veprime momentale, duke qenë se nuk kërkojnë as ndonjë parapërgatitje të veçantë<sup>244</sup>.

Prania e këtyre dy elementeve nuk është e mjaftueshme për të dhënë një vendim për të mos vazhduar si pasojë e “*parëndësisë së faktit*”. Duhet që vazhdimi i procedurës penale kundrejt të miturit, të passjellë dëm në drejtim të arsimimit të tij.

Koncepti u përfshi në sistemin italian të drejtësisë penale për të mitur, me qëllim për të shmangur përballjen e parë të të miturit me institucionin gjyqësor. Ndaj, ajo që vlen të theksohet është se, kur prokuroria synon të kërkojë, që procesi gjyqësor të mos vazhdojë për shkak të “*parëndësisë së faktit*”<sup>245</sup>, nuk është e detyruar të njoftojë të miturin dhe palët e interesuara (kompetenca për të njoftuar përmendet në nenin 415-shtojca të Kodit të Procedurës Penale<sup>246</sup>, me të cilën komunikohet mbyllja e hetimeve paraprake. Kjo vjen për shkak se kërkesa për “*parëndësi*” bëhet përgjatë hetimeve dhe jo pas përfundimit të tyre: sapo prokuroria e kupton se janë plotësuar kriteret e kërkuara në nenin 27, të Dekretit të Presidentit të Republikës, nr.448/1988).

Mund të merret vendimi për të mos vazhduar për “*parëndësi të faktit*”, si rezultat i një ***procedure të veçantë, tipike dhe ekskluzive të procesit penal të të miturve***, ose si konkluzion i një ***procesit gjyqësor normal***.

Në rastin e parë, procedimi për “*parëndësi fakti*” nis me kërkesë të prokurorisë, kur gjykon bazuar në hetimet paraprake, se kriteret e parashtruara në nenin 27 të sipërpërmendur janë përmbushur, atëherë ushtron kompetencën duke i kërkuar gjyqtarit për hetimet paraprake në Gjykatën për të Miturit, analizimin e procedurës drejtpërdrejt me vendim, për të mos vazhduar për “*parëndësi fakti*”. Ky gjyqtar, në bazë të dispozitave ligjore, për dhomën e këshillimit (seancë e cila zhvillohet pa praninë e publikut), sipas nenit 127 të Kodit të Procedurës Penale Italine, njofton për pavlefshmërinë të miturin, mbrojtësin e tij, personin e dëmtuar dhe shërbimin e të miturve. Gjyqtari për hetimet paraprake (G.I.P.), me qëllim që të vlerësojë rëndësinë sociale të faktit dhe personalitetin e të miturit, duhet të dëgjojë të pranishmit gjatë seancave dëgjimore. Disa autorë italianë, studiues të së drejtës penale italiane, argumentojnë se për dhënien e gjykimit për të mos vazhduar për “*parëndësi fakti*”,

<sup>244</sup> PALOMBA F., “Sistemi i procesit të ri penal të të miturve”, Milano, Giuffrè editore, 1991, fq.381

<sup>245</sup> Neni 27/1, parashihet se ***...gjatë hetimeve paraprake, nëse konstatohet rrezikshmëri e ulët e veprimeve të kryera dhe fakti që personi nuk është recidivist, Prokurori i kërkon gjyqtarit të vendosë në lidhje me mosfillimin e çështjes për parëndësi të faktit, kur vazhdimi i mëtejshëm i procesit penal do të ndikonte negativisht në edukimin e të miturit...***

<sup>246</sup> Dekreti i Presidentit të Republikës nr.447/1988, Kodi i Procedurës Penale Italine.

duhet dhe pëlqimi i të miturit<sup>247</sup>, por në realitet Gjykata e Kasacionit në Itali ka vendosur që “...nuk kërkohet dhënia e pëlqimit nga ana e të miturit në rastet kur, gjatë hetimeve paraprake, gjyqtari, me këkesë të prokurorit shqyrton mundësinë për të dhënë vendimin e shfajësimit për “parëndësi fakti”...”<sup>248</sup>.

Gjykimi mbi “parëndësinë e faktit” përmban një konstatim pozitiv mbi fajësinë dhe përgjegjësinë e të dyshuarit. Sidoqoftë, gjyqtari gjatë seancës dëgjimore mund të konstatojë që fakti nuk ekziston, që i dyshuari nuk e ka kryer atë, që fakti nuk përbën vepër penale, ose që nuk parashtrohet si vepër penale nga ligji, që mungon një nga kushtet e kërkuara nga procedura dhe, si rrjedhojë vendos të mos vazhdojë të procedohet, për një nga këto shkaqe, ndryshe nga rasti i “parëndësisë së faktit”, duke dhënë kështu një shfajësim tërësisht çlirues. Nëse nga ana tjetër, gjyqtari vendos të mos pranojë kërkesën e formuluar nga prokurori publik, ai ja kthen aktet këtij të fundit dhe, i kërkon të riformulojë brenda dhjetë ditëve padinë, ose gjyqtari mund t’ia kthejë aktet prokurorit publik dhe, nëse konsideron të nevojshme kryerjen e hetimeve të reja, ja kërkon t’a bëjë këtë, duke i vendosur edhe një afat për përfundimin e këtyre hetimeve.

Prokurori publik duhet të kryejë hetime të tjera sipas kërkesës së gjyqtarit dhe, në përfundim të këtyre hetimeve shtesë, mund të mbyllë hetimin sërish me një vendim, për të mos vazhduar procesin për “parëndësi fakti” ose të kërkojë një rinisje të gjykimit<sup>249</sup>. Kundër vendimit për të mos vazhduar në këtë fazë, i mituri, avokati mbrojtës i tij dhe Prokuroria e Përgjithshme kanë mundësi të apelojnë te Seksioni i të Miturve në Gjykatën e Apelit, brenda pesëmbëdhjetë ditëve<sup>250</sup>. Gjykata e Apelit procedon gjithmonë me dhomën e këshillimit, sipas nenit 127 të KPP italiane dhe mund të konfirmojë vendimin për “parëndësi të faktit” ose të japë vendim për mosvazhdim me formulë më favorizuese për të pandehurin, ose të caktojë kthimin e akteve te prokurori publik në Gjykatën e të Miturve. Kundër vendimeve për mosvazhdim për “parëndësi”, të lëshuara nga gjyqtari mund të bëhet ankim, i cili mund të kërkohet nga prokurori publik, të njëjtit gjyqtar që dha vendimin, për arsye të zbulimit të

<sup>247</sup> PATANE V., “Konsensusi i të miturit në përmbylljen e përsheptuar, midis nevojave të garancisë së kundërshtimit dhe zgjatjes së arsyeshme, në Kasacionin penal”, 2002, fq.3405.

<sup>248</sup> Sipas Kasacionit Penal, Seksioni I, 22 tetor 2003, n.39976

<sup>249</sup> COVELLI M., op.cit.,p.220

<sup>250</sup> Pika 3 e nenit 27 të D.P.R. 448/1988 parashikon: “...Kundër vendimit mund të apelojnë i mituri dhe Prokurori i Përgjithshëm në gjykatën e apelit. Gjykata e apelit vendos sipas parashikimeve të nenit 127 të Kodit të Procedurës Penale dhe nëse nuk konfirmon vendimin, i kthen aktet prokurorisë...”.

prova të reja, të cilat veçmas apo së bashku me ato ekzistuese, mund të përcaktojnë një gjykim të ri<sup>251</sup>.

Kërkesa për mosvazhdim mund të ndërhyjë dhe në përfundim të seancës dëgjimore paraprake me pëlqimin e të miturit, ose si rezultat i gjykimit të shkurtuar, mund të deklarohet edhe në apel, vetëm nëse kërkohet nga palët në arsyet e ankesës. Si përfundim, mund të jetë gjyqtari i seancës, ai që do të japë këtë masë. Dispozita parashikon, që gjyqtari i seancës mund të japë vendimin e mosvazhdimit për “*parëndësi të faktit*”, vetëm nëse procedurat mungojnë në seancën paraprake.

Gjykata e Kasacionit në Itali konfirmoi, që një vendim i tillë nuk mund të jepet në fund të një seance dëgjimore, që vjen pas rinisjes së gjykimit të vendosur nga gjyqtari i shqyrtimit paraprak - përgjegjës për seancën paraprake mbi kërkesën e prokurorisë për dhënien e masës së sigurisë edhe pse, thuhet, që kur arrihet në seancën dëgjimore janë pakësuar efektet dëmtuese, që mund të sjellë vazhdimi i procesit në edukimin e të miturit<sup>252</sup>.

Gjykata Kushtetuese ndërhyri sakaq në vitin 2003, duke modifikuar nenin 27 të *Dekretit të Presidentit të Republikës*, nr.448/1988, ku i mituri nuk bie dakord me procesin në seancën paraprake, si pasojë e mungesës, papranueshmërisë ose mosdisponueshmërisë dhe në këtë mënyrë, do të privohej padrejtësisht nga mundësia e gëzimit të parimit të “*parëndësisë së faktit*”, duke u trajtuar i pabarabartë. Si rrjedhim, vendimi për parëndësi jepet gjithmonë në seancë<sup>253</sup>. Kundër vendimeve të lëshuara nga gjyqtari i seancës paraprake, i mituri, avokati mbrojtës i tij me prokurë të posaçme apo prokurori, mund të paraqesin kundërshtimin brenda pesë ditëve, siç parashikohet nga neni 32 i D.P.R. 448/1988<sup>254</sup>. Kështu, konsolidohet një proces normal në tre shkallë gjykimi. Prokurori Publik dhe Prokurori i Përgjithshëm mund të apelojnë vetëm në Kasacion. Kundër vendimeve për parëndësi të shpallura sipas formatit të shkurtuar, palëve u lejohej apeli vetëm në Kasacion. Apeli kundër vendimeve të nxjerra pas seancës dëgjimore, ndjek rregullat e përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni penal.

<sup>251</sup> COVELLI M., op. cit., p.224

<sup>252</sup> Sipas Kasacionit Penal, Sez. VI, 25 janar 2002, n.2984

<sup>253</sup> Sipas Gjykatës Kushtetuese, Vendimi n.149 i 2003(dep. 9 Maj 2003)

<sup>254</sup> Neni 32, “Masat”, i D.P.R. nr.448/1988, parashihet se: “...Në seancën paraprake, para fillimit të diskutimit, gjyqtari i kërkon të pandehurit, nëse ai lejon që procesi të përcaktohet në atë fazë, përveç nëse pëlqimi është dhënë paraprakisht në një nga mënyrat e përcaktuara në ligj dhe të vlefshme. Nëse miratohet pëlqimi, gjyqtari, në fund të seancës dëgjimore, merr vendim për të mos vepruar në rastet e parashikuara në nenin 425 të Kodit të Procedurës Penale ose për qëllimin e dhënies së faljes ose të paragjyimit të çështjes....”.

## b) Falja gjyqësore

Falja nuk është një koncept juridik, por më tepër fetar ose i lidhur me ndërgjegjen e individit. Sistemi italian merr në konsideratë faljen në fazën e ekzekutimit të vendimit, duke qenë e nevojshme për dhënien e lirisë me kusht ose në konsultimin me personin e dëmtuar nga vepra penale apo trashëgimtarët e këtij të fundit. Funkzioni i “faljes gjyqësore”, sipas pjesës më të madhe të doktrinës së jurisprudencës italiane, por jo vetëm, është një parandalim i veçantë, që do të thotë, qëllimi i ligjvënësit është inkurajimi për riintegrimin e rishoqërizimin e të miturit dhe parandalimi i çfarëdo dukurie kriminale, që mund të vijë si rezultat i kontaktit me mjediset e burgut<sup>255</sup>. Falja gjyqësore është vendosur në rendin italian, midis çështjeve të eleminimit të pasojës së veprës penale, të parashikuar nga nenet 150-169, të Kodit Penal Italian<sup>256</sup>. Kjo vendosje sistematike nuk është e ndarë në doktrinë (për sa i përket aspektit material), mbizotëron parimi, ku një fakt që nuk është kryer, nuk mund të konsiderohet të ketë ndodhur (*factum infectum fieri nequit*). Ndërkohë, në aspektin juridik vërehet, se pavarësisht aplikimit të “faljes gjyqësore”, nuk ndalohet aplikimi i masave lidhur me rrezikshmërinë e veprës penale<sup>257</sup>.

Ka disa qëndrime, për sa i takon konceptit të faljes. Studiuesit e shkencave juridike përdorin një term të ndryshëm, nga ai i përdorur në ligj. Disa prej tyre pohojnë se “...falja nuk e shuan veprën penale si fakt të parashikuar në ligjin penal...”<sup>258</sup>. Falja gjyqësore jepet nëse subjekti, në momentin e kryerjes së veprës penale nuk kishte zotësi për të vepruar, aftësi për të kuptuar e dëshiruar, pavarësisht përgjegjësisë penale. Dhënia e faljes i nënshtrohet disa kufijve të jashtëm dhe një kufiri të brendshëm<sup>259</sup>. “Falja gjyqësore” mund të jepet vetëm njëherë, pra

<sup>255</sup> CARRARO E., “Falja gjyqësore e sistemit të ri të drejtësisë penale të të miturve”, 4/2008 fq.63

<sup>256</sup> Neni 169 “Falja gjyqësore për të miturit nën moshën 18 vjeç”, parashikon se: “...Në qoftë se, për krimin e kryer nga të miturit nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, ligji përcakton heqje të lirisë që nuk kalon një maksimum dënimi prej dy vjetësh apo jo një gjobë të kalojë një maksimum prej tre milion lireta...,... gjyqtari mund të mos bëjë kërkesë kur, duke marrë parasysh rrethanat e përmendura në nenin 133, të KP, ai pretendon se kryerësi do të abstenojë nga kryerja e kundërvajtjeve të tjera....”.

<sup>257</sup> Shih nenin 25 të Regio Decreto Legge nr.1404, i 20 korrikut të 1934 Themelimi dhe funksionimi i gjykatës për të miturin, i cili parashikon se *Kur një i mitur i moshës 18 vjeç dëshmon për parregullsi të sjelljes ose karakterit, prokurori i Republikës, shërbimi i mirëqenies së fëmijës, prindërit, kujdestari, institucionet e edukimit, mbrojtjes dhe ndihmës për fëmijët dhe adoleshentët e rinj, mund të raportojnë faktet në Gjykatën për të Mitur, dhe një prej anëtarëve të saj, të caktuar për këtë qëllim nga presidenti, kryen një hetim të plotë mbi personalitetin e fëmijës dhe urdhëron me dekret masat e mëposhtme:*

- kujdestarinë e fëmijës në shërbimin e mirëqenies së fëmijës;
- vendosjen e të miturit në institucionin e rehabilitimit ose në një institucion psiko-pedagogjik...

<sup>258</sup> MANZINI V., Traktati i të Drejtës Penale Italiane, Torino, UTET, 1981 Vol III p.736

<sup>259</sup> COVELLI M., op.cit.fq.251. Kufijtë e jashtëm parashikohen nga nenet 164 dhe 169 të Kodit Penal Italian, ku përcaktohet, se për të qenë në gjendje për të dhënë faljen gjyqësore, dënimi me burg konkretisht, nuk duhet të kalojë dy vjet, ose dënimi me gjobë, veçmas ose së bashku me atë me burg, nuk duhet të tejkalojë 1549,37 euro; për më tepër i mituri nuk duhet të ketë qenë recidivist (i dënuar më parë me dënim me burg për krim) dhe së fundi, i mituri nuk duhet të jetë deklaruar kriminel i zakonshëm apo profesional.

nuk mund të përfitojë nga një masë e tillë dikush, që e ka përfituar njëherë më parë. Limiti i brendshëm në dhënien e faljes gjyqësore përbëhet nga prognoza favorizuese mbi sjelljen e ardhshme të subjektit, që do të thotë një vlerësim, që të çojë në konkluzionin, që i mituri të mos bjerë më në situatë kriminale<sup>260</sup>.

Nga marrëdhënia, midis formulës së pezullimit të dënimit me kusht dhe të faljes, lindin disa probleme, ndërkohë, që të dyja kanë të njëtat parakushte për t'u aplikuar, përkatësisht që:

- përfituesi të heqë dorë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe,
- të dy lejojnë eliminimin e pasojës së veprës penale.

Sipas qasjes tashmë të konsoliduar të Gjykatës së Kasacionit në Itali, gjyqtari në rast prognoze absolutisht të sigurt dhe pozitive, është i detyruar të japë faljen, në raste më pak të sigurta, të pezullojë dënimin me kusht<sup>261</sup>.

Gjykata e Lartë në Itali ka vendosur që gjykatësi, për t'u siguruar nëse të miturit, pa zotësi për të vepruar, mund t'i jepet pezullimi i dënimit me kusht apo përfitimi më i pastër, siç është "*falja gjyqësore*", duhet të mbajë parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe personalitetin e të miturit fajtor. Në vijim, përfitimi i faljes gjyqësore mund të gëzohet vetëm njëherë, siç parashikohet në nenin 169 të Kodit Penal Italian<sup>262</sup>.

"*Falja gjyqësore*" nuk vihet në kontrast me parimin e detyrimit të ushtrimit të veprimit penal, sepse ajo mund të jepet vetëm pas shtyrjes së gjykimit. "*Falja gjyqësore*" si masë mund të jepet në seancën paraprake, por vetëm me pëlqimin e të miturit, sipas formës së shkurtuar, në fund të gjyqit të shkallës së parë, ose në apel, nëse mungesa e të miturit gjatë procesit, ka qenë shkak për dënimin e tij. Por, nga ana tjetër, ajo si masë nuk mund të jepet në Gjykatën e Kasacionit, duke qenë se "*falja gjyqësore*" është objekt i një vlerësimi merite. Falja, e cila bëhet e pakthyeshme me miratimin e aktgjykimit, deklaron shuarjen e veprës penale dhe pengon aplikimin e dënimeve shtesë dhe masave të sigurisë. Falja nuk pengon

<sup>260</sup> DOLCINI E.- MARINUCCI G. E Drejta penale në transformin, Milano, Giuffrè, 1985, p.289

Ky vlerësim kryhet sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 133 të KP Italian, që i atribuon gjyqtarit "*...veprime të kushtëzuara nga rregullat e vendosura nga vetë ligji...*"

<sup>261</sup> Sipas Kasacionit Penal, Sez. II, 24 Korrik 1991, n 7751

<sup>262</sup> Debati në Itali shpesh është sjellë rreth mundësisë së dhënies së faljes për herë të dytë. Në vijim, Gjykata Kushtetuese në Itali ndërhyri për këtë çështje lidhur me dy vendime: në 1976 me vendimin n.154, ajo deklaroi paligjshmërinë e nenit 169 të KPI, në pjesën ku përjashton mundësinë që të mund të jepet sërish falja në rast dënimi për krim të kryer para se të jepej vendimi i mëparshëm i faljes dhe, me vendimin n.108/1973-shit, deklaroi kushtetueshmërisht të paligjshme ligjin e cituar në pjesën, ku nuk lejon, që të mund të përhapet falja gjyqësore në krime të tjera të lidhura nga vazhdimësia, me ato, për të cilat është dhënë përfitimi.

propozimin e veprimit civil në gjykatën kompetente. Kundër vendimeve për “falje gjyqësore” mund të kërkohet rehabilitimi i veçantë, i parashikuar në nenin 24, të *Regio Decreto Legge nr.1404/1934*, megjithatë, ndërsa kartela e lidhur me faljen, e cila ruhet në të dhënat kriminale, asgjësohet sipas rregullave, kur i mituri arrin moshën 21 vjeç, vendimi për rehabilitim të veçantë mbetet në certifikatën e të dhënave kriminale të aplikantit me shënimin përkatës të vendimit të faljes së dhënë<sup>263</sup>.

Në Itali, janë bërë përpjekje në të shkuarën, për zgjerimin e përfitimit të “faljes gjyqësore” edhe te të rriturit, sepse në këto lloj vendimesh identifikohet një mundësi pendimi dhe riaftësimi në shoqëri edhe për të rriturit dhe, për më tepër do të ishte një zgjidhje e problemit të mbipopullimit të burgjeve<sup>264</sup>.

### c) *Vënia në provë*

Formula e “*vënies në provë*”, paraqitur dhe rregulluar nga nenet 28 dhe 29 të *Dekretit të Presidentit të Republikës nr.448/1988* dhe nga neni 27, i *Dekretit Legjislativ, nr.272/1989* përfaqëson, bashkë me shpalljen e “*parëndësisë së faktit*”, risinë kryesore në drejtësinë penale italiane për të miturit.

“*Vënia në provë*” është e sanksionuar si koncept në nenet 27 dhe 31, të Kushtetutës Italiane dhe, parashikon detyrimin e ligjvënësit “...*të vendosë metoda direkte për mbrojtjen dhe riedukimin e të rinjve...*”, si dhe Rregullat e Pekinit, në nenet 9 dhe 11, që favorizojnë praktikën “provuese”<sup>265</sup>, tipike të ligjit të zakonshëm.

Pezullimi i procesit me “*vënien në provë*” konsiston në ndërprerjen e procesit gjyqësor ndaj të miturit, duke i ofruar atij mundësinë për të mos u dënuar, nëse ai provon dhe shfaq pendesë për krimin e kryer. Më saktë, në përputhje me nenet 28 dhe 29, të *Dekretit të Presidentit të Republikës nr.448/1988*, kur gjyqtari konsideron se duhet të vlerësojë

<sup>263</sup> COVELLI M., op.cit., p.255

<sup>264</sup> Që në 1962, ministri i Drejtësisë në atë kohë propozoi aplikimin e formulës te të rriturit për dënime jo më të larta se disa muaj. Propozimi u ripropozua në vitet 1968,1971, 1972 dhe 1975, për dënimin me një vit ose një vit e gjashtë muaj, në dënime të veçanta. Së fundmi, ndryshimet e propozuara në qershor të vitit 2004,në Kodin Penal Italian, të propozuara nga *komisioni Nordio*, parashikonin mundësinë e dhënies së faljes gjyqësore edhe të dënuarve të rritur jo përsëritës (duke shmangur kështu pjesën e rehabilitimit). Çfarë parashikonte konkretisht ky propozim. Që fakti të jetë i një përmbajtjeje të veçantë, dëmi dhe shkalla e fajësisë duhet të jenë minimale dhe dënimi që mund të jepej të mos jetë më i lartë se gjashtë muaj. Natyrisht, të gjitha propozimet e paraqitura nuk u miratuan nga Parlamenti.

<sup>265</sup> Në një vështrim të shpejtë të legjislacionit penal italian, mund të përmenden llojet e mëposhtme:

1. Prova e policisë: nuk aplikohet në këtë sistem
2. Prova gjyqësore në fazën strukturore: neni 27 D.P.R.448/1988
3. Prova gjyqësore në fazën e pezullimit të gjykimit: neni 28 D.P.R.448/1988
4. Prova në fazën e gjykimit me pezullim vendimi: neni 163 c.p.
5. Prova dënuese: dhënia në provë të Shërbimet Sociale neni 47 L.354/1975



personalitetin e të miturit si rezultat i provës, pezullon procesin dhe ja beson të akuzuarin Shërbimeve të të Miturve. Pas kalimit të periudhës së pezullimit, gjykatësi deklaron të shlyer veprën kriminale nëse, duke mbajtur parasysh sjelljen e të miturit dhe personalitetin e tij, beson se ai ka reflektuar dhe ka dëshmuar rezultate pozitive në sjellje. Me këtë metodë, kërkohet të realizohen parimet e shkeljes minimale të procesit, e mbrojtjes së nevojave edukative, të mbajtjes së paraburgimit, pa neglizhuar rastet e mbrojtjes sociale dhe parandalimit të veçantë dhe, të parimeve të përgjithshme të lidhura me kryerjen e veprës penale<sup>266</sup>.

Meqenëse, personaliteti i të miturit ndryshon vazhdimisht, ky evolucion mund të mbështetet pozitivisht nga një program i përshtatshëm për të miturin, që të përfitojë ndihmë dhe mbështetje në këtë proces. Është detyrë e shtetit të mbështesë të miturin të ndjekë një rrugë të tillë, përmes ofrimit të programeve edukative të individualizuara, në përputhje me nevojat e tij, me qëllimin e riintegrit të të miturit në shoqëri. Kështu procesi, përveçse është terren për konstatimin e faktit, bëhet mjet për ndërhyrjen në personalitetin e të akuzuarit; nëse një ndërhyrje e tillë arrihet, vërehet, se sanksioni nuk është më i nevojshëm (përkundrazi ai mund të rezultojë me pasoja negative), ka përfitime të rëndësishme edukative për subjektin (si dhe ekonomike për shtetin), pa ju hequr asgjë nevojave të mbrojtjes sociale. Ky është dallimi më thelbësor i analizuar më parë: “...i mituri për t’u larguar nga procesi penal, duhet të japë fillimisht prova për një ndryshim real...”.

Në bazë të këtij instrumenti ekziston në praktikën gjyqësore italiane edhe një lloj pakti: shteti heq dorë nga ndjekja e procedurës penale dhe nga dënimi i mundshëm i autorit të mitur në konflikt me ligjin, por i kërkon në këmbim atij, jo vetëm një sjellje korrekte, konform normave ligjore e shoqërore (të mos kryejë vepra të tjera penale), por ajo që është më e rëndësishmja, i kërkon një angazhim serioz pozitiv, nëpërmjet përfshirjes në programe rehabilituese. Për më tepër, heqja dorë nga dënimi vjen, vetëm pas një analize të kujdesshme të procesit të maturimit të individit të mitur. Krahasuar me metodat e tjera, “*vënia në provë*” lejon më mirë të mbahen në konsideratë edhe rezultatet e mbrojtjes sociale.

“*Vënia në provë*”, si masë alternative dënimi, shpesh në praktikë gjyqësore italiane ka provokuar ndjenjën e pasigurisë në komunitet, por edhe ndërmjet të miturve, që e kanë marrë

---

<sup>266</sup> CIAVOLA A., “Specifikimi i formulave vendimarrëse të të miturit”, në ZAPPALA E. Jurisdiksioni i specializuar në drejtësinë penale të të miturve, Torino, Giappichelli, 2009, p.178. Ky autor, argumenton se: “...Përgjigjia e shtetit është në kohën e duhur, pasi mund të ndërhyjë më tepër në fazën procedurale sesa atë ekzekutive, por ndryshe nga metodat e tjera, nuk lejon një dalje të shpejtë të të miturit nga qarku penal, duke mundur të zgjasë qëndrimin për një periudhë që, për krimet më të rënda mund të zgjasë deri në tre vjet...”.

atë si masë, duke bërë që të ndjehen edhe të diskriminuar dhe të pabarabartë në trajtim, për shkak të një aplikimi jo homogjen në terren të kësaj mase<sup>267</sup>.

Ndaj, është kërkesë e legjislacionit për administrimin e drejtësisë penale për të miturit, jo vetëm në Itali, por kudo gjetkë, që organet/personat kompetentë të kenë trajnimin dhe specializimin e duhur në fushë<sup>268</sup>.

### ***Kushtet për aplikim***

Kushtet për aplikim të masës “*vënie në provë*” janë përgjithësisht të ndarë në subjektivë dhe objektivë, nëse i referohemi verifikimit të fakteve dhe rrethanave, lidhur me kushtet personale të të pandehurit ose që nuk kanë asnjë lidhje me këto të fundit. Për sa i përket kushteve të aplikimit, neni 28, i *Dekretit të Presidentit të Republikës Italiane 448/1988*<sup>269</sup> është kritikuar shpesh për paqartësi, sepse lejon “*interpretime nga më të ndryshmet dhe subjektive*”<sup>270</sup>. Parë në këndvështrim objektiv, së pari, “*vënia në provë*” mund të bëhet për çdo vepër penale dhe, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale, nuk shkakton përjashtimin e dhënies së masës, ndërkohë që ndikon në kohëzgjatjen e saj.

Në fakt, për veprat penale, që parashikojnë një dënim me burgim, në maksimum deri 12 vjet, “*vënia në provë*” mund të shtrihet edhe deri në 3 vjet, ndërsa, për vepra më pak të rënda deri në një vit. Gjithashtu, rëndësia e faktit, përbën një nga elementët e vlerësimit të personalitetit të të miturit dhe, mund të parandalojë dhënien e masës, duke theksuar papërshtatshmërinë e metodës për arritjen e qëllimit të vet në riedukimin e të miturit. Jurisprudenca italiane ka konsideruar, se nuk mund t’ja japë masën, në rastet, kur rrezikshmëria shoqërore e veprës penale është e lartë<sup>271</sup>. Nëse, duhet të ndahet nevoja për një kujdes më të madh në dhënien e “*vënies në provë*” si masë, për krimet më të rënda, kjo me shumë gjasë nuk duket se mund të ndahet.

Një tjetër gjykim, referon te vendosja e kufizimeve në aplikimin e kësaj mase, për një kategori të caktuar të veprave penale, ku spikat personaliteti i të miturit, mundësitë e tij për ndryshim, kushtet që rrjedhin nga konteksti shoqëror – familjar, faktorë, të cilët janë të

<sup>267</sup> Në këtë kuptim shprehet SCIVOLETTO C., “Vënia në provë: një mundësi për të gjithë. Të nsim me disa reflektime në të Miturit në Drejtësi” nr.4/2005 suppl. fq. 133

<sup>268</sup> Shih ligjin nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”

<sup>269</sup> “Dispozita mbi procesin penal në ngarkim të të pandehurve të mitur”

<sup>270</sup> FUMU G. Zgjedhjet e vështira të ligjvënësit të të miturve midis konstatimit, edukimit dhe sanksionimit në AA. VV., Çështje të reja të procedurës penale, Reformat plotësuese, Padova, CEDAM, 1991, fq.80

<sup>271</sup> Sipas Kasacionit penal Sez. I, 9 prill 2003 n.19532

ndryshueshëm dhe jo të klasifikueshëm në skema normative të vështira<sup>272</sup> dhe, që mbahen në konsideratë në vlerësimin individual të delikuentit të mitur. Pa marrë në konsideratë pastaj, që në rastet e krimeve më të rënda, konstatimi i personalitetit, përmes një periudhe prove mund të ofrojë rezultate interesante.

Kusht i paparashikuar, por që mendohet se duhet të përbëjë një supozim për dhënien e masës, është konstatimi i faktit të ekzistencës së veprës penale dhe fajit të të pandehurit. Kjo garanton prezumimin e pafajësisë dhe ligjshmërisë. Për shkak se “*vënia në provë*” si masë, e angazhon të miturin në një udhëtim rishoqërizues (duke sjellë kufizime të lirisë personale), është e nevojshme të verifikohet më parë, që ka elementë prove që dëshmojnë përgjegjësinë. Konstatimi i përgjegjësisë është përcaktuar si një parakusht thelbësor logjik në dhënien e masës së “*vënies në provë*”<sup>273</sup>.

Një tjetër supozim i nënkuptuar është, që i pandehuri është i aftë të kuptojë dhe të dëshirojë, se, dhënia e kësaj mase nuk mund të bjerë ndesh me parimet e përgjithshme të së drejtës penale. Pavarësisht, ndonjë mendimi kundër<sup>274</sup>, rrëfimi nuk është kusht i nevojshëm për dhënien e masës “*vënie në provë*”. Prandaj, rrëfimi duhet të konsiderohet një e dhënë neutrale, mungesa e së cilës, nuk është e papajtueshme me dhënien e masës “*vënie në provë*”. Sipas këtij cilësimi, do të transformohej qëllimi riedukues në një kusht të zbatueshmërisë. Një konkluzion i tillë nuk duhet të gjente asnjë bazë, as në planin e drejtpërdrejtë, as në atë sistematik, edhe sepse do ta bënte masën të papajtueshme me supozimin e pafajësisë dhe të drejtës së mbrojtjes<sup>275</sup>.

Kushtet subjektive lidhen mbi të gjitha me personalitetin e të miturit. Gjyqtari, mbi bazën e hetimeve të kryera, sipas parashikimit të nenit 9, të *Dekretit të Presidentit të Republikës Italiane* 4498/1988<sup>276</sup>, duhet të marrë informacione pozitive si rezultat i provës. Vlerësimi i personalitetit bëhet *ex-ante* (paraprakisht) dhe, përbën kushtin, mbi bazën e të cilit, shprehet

---

<sup>272</sup> LARIZZA S., “Përgjigjet e reja institucionale kundrejt kriminalitetit të të miturve”, në PALERMO FABRIS E., PRESUTTI A., (redaktuar nga), *Të Drejtat dhe procedura penale e të miturve në ZATTI P.* (redaktuar nga) Traktati i të drejtës familjare, vol V, Milano, Giuffrè, 2002 p.226

<sup>273</sup> Sipas Gjykatës Kushtet. 5 prill 1995 n.125(dep. 14 prill 1995)

<sup>274</sup> Gjykata e Kasacionit në Itali shpjegoi se “...*rrëfimi apo pranimi i pjesshëm i fajit nga ana e të miturit, përfaqëson një element për t’u marrë në konsideratë në formulimin e një gjykimi pozitiv mbi riedukimin dhe evoluimin e personalitetit drejt një riintegrimi në shoqëri...*”. Gjyk. Kas. Pen. Sez. III, 6 qershor 2008, n.27754

<sup>275</sup> CIAVOLA A., op.cit.p. 184

<sup>276</sup> Neni 9 Dekretit të Presidentit të Republikës Italiane 4498/1988, parasheh se “...*Prokurori dhe gjyqtari marrin informacion në lidhje me situatën personale, familjare, shoqërore dhe ambientale të të miturit, me qëllim që të verifikojnë përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë, të vlerësojnë ndikimin social të fakteve objekt akuye, si dhe të marrin masat penale dhe ato të mundshme civile që konsiderohen të përshtatshme për të t’ju aplikuar rastit konkret. Po me ato qëllime, prokurori dhe gjyqtari marrin informacion nga persona që kanë pasur kontakte me të miturin të dëgjojnë mendimin e ekspertëve, pa adaptuar asnjë formalitet në këtë drejtim...*”

një gjykim i një prognoze pozitive. Gjyqtari nuk mund të përdorë masën e “*vënies në provë*” si instrument për të njohur personalitetin e të pandehurit të mitur.

Nuk ka një tregues konkret të elementëve, të cilët duhet të mbajë parasysh gjyqtari. Ata mund të jenë disa, midis tyre “...*thelbësor është vlerësimi, nëse vepra e diskutuar është një episod plotësisht i rastësishëm dhe jo një zbulues i një sistemi jetësor, që përjashton prognozën pozitive të evoluimit të personalitetit të të miturit, kundrejt modeleve të përshtatshme me shoqërinë...*”<sup>277</sup>. Elementë të tjerë mund të nxirren nga lloji i veprës së kryer, nga mënyrat e kryerjes së saj, nga shkaqet që e shtynë të kryejë një krim, nga precedentët penalë të fajtorit dhe/ose nga karakteri i tij. Natyrisht, elementë të tillë duhen analizuar rast pas rasti, pa u mbyllur brenda çfarëdo lloji skeme rregullatore. Nuk përbëjnë faktorë pengues ekzistenca e precedentëve penalë dhe gjykues ose, fakti, që mund të ketë përfutur më parë nga një “*falje gjyqësore*” apo nga një masë “*vënie në provë*”, me rezultat negativ.

Pezullimi mund të jepet edhe më shumë herë, sepse kjo si masë përdoret çdo herë që ndodhesh përballë një situatë subjektive, të tipit psiko-evolutive, që mund të ndikohet nga rikuperimi social.

Kështu, as arritja e moshës madhore nuk do të përbëjë pengesë për “*vënien në provë*”, pavarësisht nëse dispozita i referohet të miturve, mendimi mbizotërues është se ligjvënësi, duke patur si objektiv rishoqërimin e fajtorit, nuk ka për qëllim t’i mohojë shfrytëzimin e masës subjektivit, i cili në pjesën më të madhe të procesit penal mund të ketë qenë i rritur. Në bazë të parimit, sipas të cilit, çdo vendimarrje kërkon një analizë të individualizuar (në Kodin tonë të Drejtësisë Penale për të Mitur, i ashtëquajtur i raport i vlerësimit individual, nenet 22 dhe 47, të ligjit nr.37/2017), moshë duhet të konsiderohet një lloj si edhe elementët e tjerë në dispozicion të gjyqtarit, me përjashtim të provës në prani të një “...*strukture psikologjike të personalitetit tashmë të orientuar përfundimisht...*”<sup>278</sup>.

Pezullimi mund të përdoret nga ana tjetër, edhe mbi të rinjtë, që edhe pse, sipas moshës janë tashmë të rinj të rritur, rezultojnë ende në procesin evolues post-adoleshencë<sup>279</sup>. Për zbatueshmërinë e masës së “*vënies në provë*”, duhet që të jetë marrë më parë pëlqimi i të pandehurit. Është një kriter që nuk parashikohet nga ligji dhe që vetë Gjykata Kushtetuese Italiane është shprehur se nuk është i nevojshëm<sup>280</sup>. Por, nga ana tjetër, pjesa më e madhe e

<sup>277</sup> Sipas Kas. Pen. Sez. II, 4 nëntor 2003, n.2879

<sup>278</sup> Sipas Kas. Pen. Sez.22 prill n.21671

<sup>279</sup> Gjykata e të Miturve Catania, 29 mars 1995, I, në Foto It,1996

<sup>280</sup> Parimet e vendosura nga Gjykata kushtetuese kërkojnë që ekzekutimi i dënimit të një fëmije të mos përjashtojë asnjë vlerësim, i cili është gjithmonë fleksibil dhe i individualizuar, i përshtatshëm dhe i mundësisë; vlerësimin e nevojshëm për ekzekutimin e dënimit dhe në përgjithësi disiplinën e kufizimeve të

doktrinës së jurisprudencës italiane, e përcakton si kriter strukturor, të vendosur si garanci për suksesin e aplikimit të kësaj mase, pasi konsensusi është një shprehje e vullnetit nga ana e të miturit, për pranimin e rishoqërimit dhe, shpreh gadishmërinë e tij, për ndjekjen e programeve rehabilituese, të parashikuara posaçërisht për të. Nevoja e konsensusit të të pandehurit ose të paktën një gatishmëri e shprehur qartë për t'ju nënshtruar masës së “*vënies në provë*”, mund të merret edhe si rrjedhojë e drejtpërdrejt e nenit 27, të *Dekretit Legjislativ nr.272/1989*<sup>281</sup>, “Kodi i procesit penal për të mitur”, cili në aspektin e përmbajtjes, i referohet angazhimeve që “merr përsipër” i mituri, duke shprehur vullnetin e të pandehurit t’u vënë në provë<sup>282</sup>.

### ***Procedura e dhënies së masës***

Duke folur për procedurën me të cilën jepet masa, mund të shohim se si nisma e pezullimit të procesit mund të merret nga palët ose të jepet nga gjyqtari. Kërkesa mund të paraqitet edhe nga avokati mbrojtës i të pandehurit, nisur nga këndvështrimi i mbrojtjes për “përshtatshmërinë optimale procedurale”. Prokurori publik<sup>283</sup> ka për detyrë të marrë përsipër vlerësimet psikologjike dhe sociologjike të kryera nga shërbimet dhe t’i sintetizojë, duke i krahasuar me zbatueshmërinë ligjore të masës dhe në fund, të kërkojë aplikimin e nenit 28, të Dekretit të Presidentit të Republikës nr.448/1988<sup>284</sup>. Janë të autorizuar gjithashtu, për

---

lirisë personale, në përputhje me kërkesat kushtetuese për mbrojtjen e personalitetit të fëmijës (Dekreti nr. 46, 1978, nr. 125, 1992)

<sup>281</sup> Dekreti Legjislativ nr.272, i 28 korrikut 1989, “Kodi i procesit penal për të miturit”, Itali, ku në nenin 27, “Pezullimi i gjyqimit dhe vënia në provë”, përcaktohet shprehimisht se: “...*Gjykata në bazë të nenit 28 të dekretit të Presidentit të Republikës së 22 shtatorit 1988, nr.448, bazohet në një plan ndërhyrjeje, të hartuar nga shërbimet e drejtësisë për të miturit, në bashkëpunim me shërbimet sociale të autoriteteve lokale... Kryetari i kolegjit, i cili ka urdhëruar pezullimin e gjyqimit dhe mbështetjen e raporteve të shërbimit dhe ka kompetencën, të delegojë tek një anëtar tjetër i kolegjit, të dëgjojë, pa formalitete të procedurës, operatorët dhe të miturin...*”.

<sup>282</sup> CIAVOLA A., op.cit., p.186

<sup>283</sup> **Publico Ministero** – prokurori publi P.M., në rendin e organizimit shtetëror të Republikës Italiane është një organ i administratës gjyqësore, i artikulluar funksionalisht në disa zyra të Prokurorit të Republikës. Prokurori i Republikës, sipas rendit të organizimit shtetëror të Republikës Italiane përfshin zyrat e prokurorit publik në gjykatën e zakonshme, në gjykatën për të mitur dhe në gjykatën ushtarake.

<sup>284</sup> Neni 28, “Pezullimi i procesit dhe vënia në provë” parashikon se: “...*Gjykata, pasi dëgjon palët, mund të urdhërojë me urdhëresë pezullimin e procesit kur ndjen nevojën për të vlerësuar personalitetin e fëmijës...*”  
Procesi është pezulluar për një periudhë jo më shumë se tre vjet në procedurë për kundërvajtje, për të cilën është planifikuar me burgim të përjetshëm ose me burgim prej jo më pak se dymbëdhjetë vite... në raste të tjera, për një periudhë jo më të gjatë se një vit. Gjatë kësaj periudhe pezullohet periudha e kufizimit.

2. Me qëllim të pezullimit gjyqtari ia beson të miturin shërbimeve të drejtësisë për të mitur për të kryer, në bashkëpunim me shërbimet lokale, vëzhgime përshtatshme, trajtimin dhe mbështetjen. Me të njëjtën masë, gjykatësi mund të lëshojë këshillime për të korigjuar pasojat e krimit dhe për të nxitur pajtimin me viktimën e vogël të krimit. Prokurori publik, i pandehuri dhe avokati mbrojtës i tij mund të ankohen për urdhrin. Pezullimi nuk mund të bëhet, nëse i pandehuri kërkon një gjykim të shkurtuar ose një vendim të menjëhershëm. Pezullimi do të revokohet në rast të shkeljeve të përsëritura dhe serioze të përshtatshme të vendosura... Urdhëresa: është masa që gjykata lëshon gjatë rrjedhës së procedurës për të rregulluar sjelljen e tyre dhe me të cilën zgjidhen rastet ose faya të caktuara të procesit.

pezullimin dhe “*vënien në provë*”, prindërit, edhe shërbimet kompetente të të miturve. Gjyqtari mund të urdhërojë pezullimin e procesit, në bazë të ekzistencës së kushteve të përcaktuara nga ligji dhe “...*duke i ftuar Shërbimet e të Miturve të hartojnë një plan ndërhyrjeje për të miturin që do të marrë masën...*”. Pezullimi bëhet me urdhër ose, gjatë seancës dëgjimore paraprake, ose në gjyq. Vendimi për hartimin e masës së “*vënies në provë*” në një fazë të procesit, dhe jo më parë, është koherent me kompleksitetin e vendimit. Sipas parimit të shkeljes minimale të procesit, në perspektivën e reduktimit të ndikimit, që ka sistemi gjyqësor në mentalitetin, ndërgjegjen dhe personalitetin e të miturit, është më e përshtatshme, që vendimi të merret në çastin e parë të volitshëm: d.m.th. në përfundimin e seancës dëgjimore paraprake, gjithmonë kur i akuzuari ka dhënë miratimin<sup>285</sup>. Masa mund të merret edhe në rastin kur është dhënë një gjykim i posaçëm i drejtpërdrejtë, i menjëhershëm ose i shkurtuar<sup>286</sup>.

Nuk është fort e qartë situata juridike, sipas praktikës gjyqësore italiane, lidhur me mundësinë e dhënies së masës “*vënie në provë*” gjatë gjykimit në apel. Gjyqtari i shkallës së dytë vlerëson në mënyrë pozitive raportin e vlerësimit individual të personalitetit të të miturit dhe, sipas këtij cilësimi, vendimi mund të merret prej tij edhe *ex-officio*. Në vijim, do të ishte e mundur, që gjyqtari i apelit të miratojë pezullimin dhe masën “*vënie në provë*”, por vetëm në rastin kur, vetë i pandehuri i mitur ka apeluar masën, me të cilën është refuzuar padrejtësisht në shkallë të parë<sup>287</sup>.

Institucioni i pezullimit të gjykimit dhe vënia në provë përbëjnë një risi të madhe në sistemin italian të drejtësisë penale për të mitur. Në themel të aplikimit të këtyre masave nga organet kompetente të drejtësisë, qëllimi është përjashtimi i të miturit nga qarku penal, duke shmangur fazën e debatimit dhe njëkohësisht, ofrimi i ndihmës së duhur.

Masa e pezullimit lëshohet me urdhër dhe e arsyetuar, dhe bëhet fjalë për një akt kompleks, sepse përbëhet nga një pjesë përshkruese dhe një urdhëruese, lidhur me fiksimin e një seance tjetër të mundshme. Masa për pezullim mund të lëshohet sipas më shumë referimeve, në rast se ka vështirësi në hartimin e një projekti edukativ ose, nëse ka nevojë të thellohen analizat mbi personalitetin. Projekti edukativ, i hartuar nga Shërbimet e të Miturve<sup>288</sup>, përbën në të

<sup>285</sup> CIAVOLA A., op.cit.fq.187

<sup>286</sup> Në të vërtetë neni 28, parashikon që: “...*ishte përjashtuar aplikimi i një mase të tillë, në rastin kur, i pandehuri ka kërkuar një gjykim të shkurtuar ose të menjëhershëm, sepse mendohej se i akuzuari mund të tërhiqej nga vënia në provë, pikërisht për zgjedhjen e një mase alternative...*”.

<sup>287</sup> Për një paraqitje më të gjerë e të qartë mbi shifrat e aplikimit të masës Departamenti për Drejtësinë e të Miturve, Zyra e Shefit të Departamentit, Pezullimi i procesit dhe vënia në provë (neni 28 D.P.R. 448/88) Analiza statistikore – viti 2011, 3 tetor 2012

<sup>288</sup> Sqarohet kështu se si dhënia te Shërbimet e të Miturve bëhet boshti i rishoqërimit dhe përgjegjësisimit të të miturit, që bazohet në mbikqyrjen e detyrave specifike dhe të përcaktuara

njëjtën kohë përmbajtjen e vendimit të gjyqtarit dhe programin jetësor që i mituri duhet të ndjekë<sup>289</sup>. Shërbimet, në përputhje me pikën e tretë të nenit 27 të Kodit<sup>290</sup>, informojnë në mënyrë periodike gjyqtarin mbi aktivitetin e zhvilluar dhe evoluimin e rastit, duke propozuar aty ku e shohin të arsyeshme, ndryshime të projektit, ndonjë shkurtrim të tij, ose në rast shkeljesh të rënda të përsëritura, revokimin e masës së pezullimit.

Shkurtimi i “*vënies në provë*” kërkohet kur angazhimi i të miturit dhe rezultatet e arritura, të jenë të tillë që të shprehin një proces përgjegjësimi të të miturit, që nuk ka nevojë vazhdimi i mëtejshëm i provës. Revokimi, nga ana tjetër, sipas pikës pesë të nenit 28 të Kodit, ka kushte të ndryshme, dhe asaj mund t’i referohet vetëm, kur gjatë “*vënies në provë*” i mituri ka bërë shkelje të rënda dhe të përsëritura të përsëritura të përsëritura të dhëna nga projekti<sup>291</sup>.

### ***Ndërmjetësimi penal***

Metodat e procesit penal për të mitur, krijuar sipas nevojave edukative të të miturve, mund të perceptohen nga personi i dëmtuar në mënyrë negative, duke rritur ndjenjën e mosbesimit të tij kundrejt institucioneve dhe duke krijuar një sens pasigurie shoqërore më të madhe. Në këtë kontekst, pra, kalimi nga sistemi penal ndëshkues në sistemin edukativ, lejon në një masë të madhe marrjen në konsideratë të pretendimeve të viktimave të veprave penale, të cilat sistemet tradicionale gjyqësore i kanë lënë pas dore. Adoptimi nga drejtësia restauruese e procesit të ndërmjetësimit, midis viktimës dhe fajtorit, lejon të krijohet një hapësirë brenda së cilës protagonistët mund të shprehin ndjesitë e tyre mbi faktin që i lidh. Në të njëjtën kohë, marrja e procedure të këtyre, si instrument përgjegjës, brenda procesit penal për të mitur, mund të jetë shumë i dobishëm në pikëpamjen e qëllimit riaftësues që ajo ndjek. Disa autorë italianë argumentojnë se “*...ndërmjetësimi si mjet për rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë, mund t’i japë mundësinë të miturit ta rianalizojë eksperiencën konkrete të veprës penale dhe të arsyetojë mbi pasojat e saj... ”*.

Le të shohim se cilat janë sipas legjisllacionit penal për të miturit në Itali, dënimet që mund t’i jepen një fajtori të mitur të moshës 18-vjeç. Kemi parë tashmë se si procedimi i të miturit mund të përmbillet me formula shfajësuese, që për të rriturit nuk janë parashikuar, ose me

<sup>289</sup> CESARI C., op.cit.p.377

<sup>290</sup> Siç është parashikuar në këtë dispozitë, vendimi merret në bazë të një plani ndërhyrjeje, të hartuar nga shërbimet e administratës së drejtësisë për të miturit në lidhje me shërbimet e mirëqenies sociale të autoriteteve lokale. Gjyqtari duhet të dëgjojë palët në të drejtën e tyre për mundësinë për të testuar fëmijën dhe llojin e projektit arsimor. Besohet se në raste të tilla interesi i fëmijës mbrohet nga prezenca e avokatit mbrojtës dhe punonjësit social gjatë seancës dëgjimore.

<sup>291</sup> IMPERIALE N., “Ndërmjetësimi penal i të miturve. Aspekte juridike dhe sociologjike” në <http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/minori/imperial/index.htm>



zgjdhje të tjera të ndryshme, nga dënimi, që mund të çojnë, në rast rezultati pozitiv, në shuarjen e veprës penale. Legjislacioni italian parashikon, që në rastin, kur procesi gjyqësor arrin në dhënien e një dënimi, llojet e sanksioneve lidhur me veprat penale të kryera nga të mitur, të jenë të njëjtat të parashikuara për të rriturit. Ato janë:

- Burgimi;
- Arrestimi;
- Gjoha dhe,
- si dënime të shkurtuara, dënimi i pjesshëm dhe liria e kontrolluar<sup>292</sup>.

Siç e shohim, sanksionet janë *quasi* të njëjta me ato që aplikohen për të rriturit, duke mos patur legjislacion të dedikuar në mënyrë të posaçme për sanksionet që janë tipike për të mitur<sup>293</sup>. Në fakt, i vetmi element që bën dallimin midis të rriturve dhe të miturve është rrethana lehtësuese e moshës së të miturit<sup>294</sup>.

Në një kontekst të tillë të mungesës së diferencimit të sanksioneve, ndërmjet të miturve dhe të rriturve, në Itali kanë vazhduar dhe vazhdojnë ende të forta kritikrat, kundër një sistemi që nuk shquan as në një plan të thjesht sasior, trajtimin e të miturve nga ai i të rriturve. Pasoja e një alternative të tillë do të jetë vetëm një: parësi absolute, të paktën në nivel teorik, i dënimit me burg.

Është e vërtetë, se mungesa e propozimeve për reformimin e sistemit të drejtësisë penale për të miturit, filozofia e mbështetur kryesisht në ndëshkimin me burg, si masa e vetme e dënimit, është kapërcyer pjesërisht falë instrumenteve të përmendur më sipër si “*falja gjyqësore*”, “*shfajësimi për papjekuri ose parëndësi fakti*” dhe në fund “*vënia në provë*”. Nuk mund të mos kujtojmë se deri në 1994, dënimi me burgim të përjetshëm ishte i aplikueshëm edhe për të miturit dhe, heqja e dënimit me vdekje për të miturit u bë me ndërhyrjen e Gjykatës Kushtetuese Italiane<sup>295</sup>.

Dhe me futjen e procedurës së paqes përballë gjykatësit, që ka në dispozicionin e tij lloje të ndryshme të dënimeve, në praktikën gjyqësore italiane nuk është siguruar diferencimi në

<sup>292</sup> Sot këto sanksione janë ndryshuar plotësisht nga D.P.R 448/1988.

<sup>293</sup> Duhet qartësuar se të njëjtat shtesa dënimesh janë të aplikueshme për të miturit në format dhe mënyrat e parashikuara nga neni 95/ 2 i KP Italian.

<sup>294</sup> LARIZZA S., Përgjigjia institucionale klasike ndaj kriminalitetit të të miturve, në PALERMO FABRIS-PRESUTTI (redaktuar nga), E drejta dhe procedura penale e të miturve, në ZATTI (drejtuar nga) Traktati i të drejtës familjare, Milano, Vol. V, Giuffrè, 2002, fq.159

<sup>295</sup> Kështu, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.168/1994, në Giur. Cost 1994/II,p.1254, me shënime GALLO E., “Një hap i parë drejt tejkallimit të dënimit të përjetshëm”, ivi,p.1267; GEMMA G., Dënimi i përjetshëm për të mitur: vërtet jokushtetues, ivi, p.1271; fq.41



dënim, ndërmjet dënimeve të aplikueshme te të miturit dhe dënimet e aplikueshme te të rriturit e moshës 18 vjeç. Ajo që duhet të mbizotërojë në dhënien e masave të dënimit karshi të miturve në konflikt me ligjin, është veçantia e kushteve të të miturve, ndryshimi thelbësor i tyre nga të rriturit në aspektin fiziologjik, mendor, të pjekurisë, etj., dhe, rrjedhimisht politika që duhet të ndiqet është : *jo ndëshkimit, po riedukimit dhe riintegrimin të të miturit në shoqëri.*

Në nivelin e të drejtës përmbajtësore, drejtësia penale për të miturit në Itali është larg eksperiencave të vendeve të ndryshme evropiane, të cilat kanë bërë diferencën, nga këndvështrimi cilësor në dënimet e të miturve<sup>296</sup>. Një sistem i tillë duket se bie ndesh edhe me Kushtetutën Italiane, konkretisht dispozitat kushtetuese 27/3 dhe 31/2, të cilat në mënyrë eksplicite parashikojnë mbrojtjen e të miturit, duke e orientuar dënimin e tij drejt riedukimit.

Rreth vitit 1988 diçka ndryshoi në sistemin italian të drejtësisë penale të të miturve, por jo në drejtimin më prioritar, pra zhvillimit të sistemit penal të sanksioneve të diferencuara, për veprat penale të kryera nga të miturit, kryesisht i mbështetur drejt masave edukative<sup>297</sup>. Pavarësisht të gjitha burimeve ndërkombëtare dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese Italiane, vërejmë se dënimi me burgim mund të përdoret, në veçanti kundrejt të miturve, vetëm në raste ekstreme. Shpresohet kështu, për një ndërhyrje në fushën e dënimeve, duke shtuar për të miturit dënime me burgim dhe gjoba, dënime plotësuese, si: dënimi i pjesshëm, qëndrimi në shtëpi, liria e kontrolluar, sanksione me përmbajtje ndalimi dhe sanksione që lidhen me sjellje rregulluese ose të kryerjes së shërbimeve me dobi publike. Këto dënime kanë hyrë tashmë në sisteme të tjera dhe mund të përshtaten më mirë se burgu, në kontekstin e ndërhyrjeve edukuese dhe me përmbajtje, që e orientojnë të miturin drejt ndryshimit.

### **Sistemi i burgjeve (jo-ekzistent) i të miturve**

Ligji për sistemin penitenciar në Itali, është konsideruar tradicionalisht një aparat “shërbyes” i sistemit penal, i privuar nga autonomia dhe i destinuar drejt zbatimit mekanik të zgjedhjeve për politikën kriminale që përmbajnë kodet. Ndaj, epoka liberale dhe ajo fashiste kanë njohur

---

<sup>296</sup> Ekzistojnë në fakt, vende që kanë ndërtuar për të miturit një sistem sanksionues. Midis eksperiencave më të dallueshme të kohëve të fundit përmendim: *Jugendgerichtsgesetz i 1990 në Gjermani; Ligji mbikqyrës edukues i 14 Shtator 1999 në Portugali; Ligji organik i 12 Janar 2000 në Spanjë; Jugendgerichtsgesetz i 1988 në Austri, i modifikuar së fundmi nga ligji i 30 qershor 2001.*

<sup>297</sup> LARIZZA S., op.cit.p.162

vetëm sistem penitenciar, të strukturuar si shtojcë të kodeve penale dhe, të lidhur me to edhe kronologjikisht. Bëhej fjalë, sidoqoftë, për sistem, të vendosur për të disiplinuar jetën e të dënuarve dhe ushtrimin e fuqisë së administratës dhe, jo të drejtën për riedukim apo të drejtat “*tout court*” të të dënuarit<sup>298</sup>.

Sot, në Itali, nuk është më kështu. Rritja e vazhdueshme e vëmendjes mbi të drejtat e të burgosurve (dhe atyre të të pandehurve), pamundësia për një rishkrim organik të lëndës penale dhe përsëritja ciklike e një situatë shpërthyesë në mjediset e burgut, kanë detyruar ligjvënësit italianë të ndërhyjnë në sektorin e burgjeve, në veçanti, me ligjin n.354, të 1975 dhe ligjin nr.663, të 1986<sup>299</sup> (i njohur si *ligji Gozzini*). Kjo, nga njëra anë ka sjellë në ndarjen e ligjit të organizimit të sistemit penitenciar në dispozita heterogjene të natyrave të ndryshme dhe, nga ana tjetër, më pak monopol kodues në sistemin e sanksioneve, i cili ka shkuar duke u fraksionuar progresivisht<sup>300</sup>. Në fakt ajo që vërehet, sipas juristëve të së drejtës penale në Itali, ligji i organizimit dhe funksionimit të sistemit penitenciar, përfshin edhe sistemin sanksionues. Për këtë qëllim, dilema më e madhe e këtij sistemi lidhet me të miturit e moshës nën 18 vjeç. Aktualisht, ekzekutimi penal i dënimit për autorin e mitur, ka si dispozitë ligjore referimi, nenin 79/1, për sistemin e burgjeve (ligji nr.354/1975)<sup>301</sup>. Pikërisht, përfshirja e

<sup>298</sup> Të shihet R.D.n.787 i 1931

<sup>299</sup> Ligji nr.354, i 26 korrikut 1975, “Rregullat për organizimin dhe funksionimin e burgjeve dhe zbatimin e privilegjeve dhe të masave të kufizimit të lirisë”, botuar në Gazetën Zyrtare nr.212, S.O., datë 9 gusht 1975. Ky ligj u cilësuar si ligj "revolucionar", i cili u njeht njerëzve që mbahen në burgje, të drejta të ushtruara përpara një gjyqtari (ligji përcakton figurën e magjistratit të mbikëqyrjes me një funksion edhe për të garantuar ligjshmërinë e ekzekutimit të dënimit) dhe prezanton atë parim të fleksibilitetit në ekzekutimin e masave të dënimit, e cila shënon dhe pikën e kthesës në kalimin, nga sistemi represiv fashist, i bazuar në konceptimin e ndëshkimit si snaksion, në një sistem demokratik ndëshkues, të bazuar në parimin e ri-edukimit dhe ri-shoqërizimit për të dënuarit. (*neni 27 i Kushtetutës Italiane* : “...ndëshkimi duhet të ketë për qëllim ri-arsimimin e personit të dënuar ...”).

Edhe *ligji “Gozzini”*, u cilësua nga juristët e shquar italianë si një nga risitë më të rëndësishme të reformave të burgjeve, për shkak të fleksibilitetit në aplikimin e dënimeve. Ky fleksibilitet në aplikimin e dënimit gjatë ekzekutimit të tij, ka për qëllim favorizimin e parimit për riedukimin e të dënuarve dhe jo ndëshkimin e tyre. Fleksibiliteti arrihet përmes një sërë mjedesh, të njohura si "përfitimet" e Gozzinit, qëllimi i të cilit tani është të lejojë rivendosjen graduale të personit të dënuar, në kontakt me botën jashtë, duke reduktuar kohëzgjatjen e dënimit ose duke zëvendësuar sanksionin e burgut me një masë alternative dënimi. Gjithashtu, ky ligj futi konceptin e masave alternative të dënimit, me qëllimin për të ofruar mundësi më të mëdha për të dënuarit, për të përballuar dënimin jashtë burgut; sanksionin pjesëmarrjen e të dënuarit në programe trajnuese dhe punësim, qoftë edhe duke e shpërblyer. Ligji gjithashtu, parashikon kurse të arsimit dhe të formimit profesional dhe aktiviteteve kulturore dhe argëtuese; sigurimi i punës apo vuajtjes së dënimit në institucione sa më afër vendbanimit të familjes së të dënuarit, edhe pse ndodh shpesh, që në praktikë këto të fundit nuk janë zbatuar. Vërejmë që asnjë nga "përfitimet" e ligjit Gozzinit nuk është "automatike", pasi zbatimi në praktikë i këtyre masave alternative i është nënshtruar një vlerësimi të përgjithshëm të sjelljes së të dënuarit dhe pjesëmarrjes së tij në procesin e riedukimit. Për më shumë, nuk është vetëm "sjellja e mirë" që vjen në shqyrtim, sjellja për të cilën, sidoqoftë, shpesh denoncohet më i rrezikshëm, por është një vlerësim i përgjithshëm mbi rrugën e risocializimit të personit, bazuar në një periudhë të kqyrjes dhe të trajtimit nga një ekip i përbërë nga psikologët dhe edukatorët.

<sup>300</sup> PEPINO L., “Sistemi i burgjeve për të miturit: një çështje jo aktuale por e hapur, në AA. VV., Procesi penal i të miturve: cila reformë, për cilën drejtësi”, Milano, Giuffrè, 2004, p.53

<sup>301</sup> Kjo dispozitë parashikon, që normat e përmbajtura në një ligj të tillë të jenë të aplikueshme edhe te të miturit 18 vjeçarë, që i nënshtrohen masave penale, deri kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji.

kësaj dispozite tranzitore ishte për të shmangur, boshllëkun ligjor, të krijuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr.354/1975, lidhur me masat privuese të lirisë personale të të miturve (rregulluar në *Regio Decreto* nr.789/1931) dhe, nuk u lejon atyre përdorimin e masave të ndryshme nga ndalimi, që përmes sistemit penitenciar, u futën në sistemin e drejtësisë penale italiane<sup>302</sup>.

Eedhe pse domosdoshmëria e një ligji të posaçëm për organizimin dhe funksionimin e sistemit penitenciar, që i përgjigjet në mënyrë të dedikuar kushteve të të miturve, ka qenë nevojë e shoqërisë, sërish ka shkaktuar debat dhe, për gjithë këto vite ndërhyrjet e Gjykatës Kushtetuese Italiane në këtë aspekt, të interpretimit të dispozitave ligjore, lidhur me sistemin penitenciar edhe për të miturit, kanë qenë të shumta.

Gjatë viteve, janë parë shumë iniciativa për reformimin e sistemit penitenciar për të miturit, para dhe pas “reformës së burgjeve të 1975-ës”, por asnjëra nuk arriti të shkonte deri në fund<sup>303</sup>. Sistemi italian i burgjeve pa të ekzistonin këto dy realitete në kundërshtim me njëra tjetrën: një pjesë konfirmon, se gjendja e të miturit është e veçantë dhe prandaj ka nevojë për përkujdesje të veçanta, por nga ana tjetër, nuk kërkohet një zgjidhje ligjore për shpëtimin e kësaj veçantie që sjellin të miturit.

Pra, përveç disa përjashtimeve të parashikuara në legjislacionin për të miturit (për të cilët për shembull, dhënia e funksioneve mbikqyrëse Gjykatës së të Miturve, një zgjerim më i madh i lejeve, një aplikim më i gjerë i dënimeve shtëpiake dhe lirisë me kusht, një masë e ulët pengesash), për pjesën tjetër duhet t’i drejtohet ligjit të paracaktuar për të rriturit<sup>304</sup>.

---

<sup>302</sup> Në draftin e parë të ligjit të reformës së sistemit penitenciar të 1960-ës dhe në atë të 1965-ës, ishte përfshirë edhe pjesa lidhur me të miturit që i nënshtroheshin masave privuese dhe kufizuese të lirisë personale si të karakterit penal, ashtu edhe riedukativ-asistencial. Për shumë kohë, projektet e reformës lidhur me sistemin e burgjeve, si për të rriturit dhe për të miturit, u bënë objekt i një teksti të vetëm. Menjëherë, pas fillimit të reformës, u krijua konfuzion dhe dyshime, lidhur me aplikimin integral të disiplinës edhe te të miturit. Teksti i projekteve të tilla është publikuar në *Rass. Studi penit.*1996, fasc.spec.,II pp.30 e ss. Pp. 91 e ss.

<sup>303</sup> Një projekt reforme është prezantuar në Dhomën e Deputetëve në 17 korrik 2000 nga ministri i Drejtësisë Fassino dhe parashikonte një sistem përshkrimesh fleksibël për t’u aplikuar te të dënuarit të mitur, para ekzekutimit të dënimit me burgim, në zëvendësim të masave alternative të parashikuara aktualisht për të rritur.

<sup>304</sup> PENNISI A., “Ekzekutimi penal dhe masat e ndryshme nga burgimi. Drejtësia penale e të miturve: formimi, deviancat, e drejta dhe procesi”, Milano, Giuffrè,2004, fq.398

### *\*Qëndrim reflektues*

Nga një vështrim i shkurtër për sistemin e drejtësisë penale për të mitur në Itali dhe administrimin e saj, mund të vërehet se ka ende nevojë që legjislacioni në këtë fushë duhet të përmirësohet.

Para së gjithash, vërejtëm, që për të miturit, nuk është e mundur të flitet për riedukim, por është e nevojshme të nisë me supozimin, që një i ri 14 vjeç ose pak më shumë, nuk ka përmbyllur ende procesin edukues. Pra, është e pavend të flasësh për riedukim, kur nuk ka ende një edukim të vërtetë ose të paktën nuk është kompletuar ende ky proces.

Pyetja që shtrohet në momentin kur, i mituri i nënshtrohet një procesi gjyqësor dhe më tej, një sanksioni penal, është nëse edukimi që ai ka marrë është tërësisht efektiv, eficient dhe i vlefshëm apo, tërësisht negativ. Prosesi (ri)edukues duhet të marrë si pikë referimi kontekstin socio-kulturor, në të cilin i riu është rritur, të evidentohen pikat e forta ku mbështetet dhe në bazë të saj të tregojë veprimin risocializues, dhe të eliminojë pikat kritike, mbi të cilat lindi sjellja kriminale.

Referuar disa të dhënave statistikore, të hartuara nga Departamenti për Drejtësi për të Miturit, i Ministrisë së Drejtësisë Italiane (të dhëna të referuara në 3 dhjetor 2012), shihet se për rreth njëzetë mijë të mitur, që bien në kontakt me procesin gjyqësor, vetëm një 5% i tyre hyjnë në një burg për të mitur, pra pjesa më e madhe përfiton nga një dënim alternativ i dënimit me burgim. Këto rezultate të ndryshme të adoptuara, në veçanti "*vènia në provè*", lënë të kuptohet për një bashkëpunim më të madh nga ana e të miturit për rishoqërim, duke e ndihmuar përgjatë një procesi të marrjes së përgjegjësisë. Pikërisht, falë aplikimit të këtyre masave si "*vènia në provè*", "*parëndësia e faktit*", etj, faza procedurale të merrte vlerën e saj (ri)edukative, duke bërë që procesi i rritjes fizike dhe psiko-motor të të miturit, të mos ndërpritet nga një dënim, por përkundrazi, të shërbejë si një proces, ku i mituri të mund të përfitojë sa të jetë e mundur.

Për sa i përket ekzekutimit të dënimit me burgim, duhen institucione të vecanta për të miturit, që të jenë menduar e ndërtuar në vende, që mund të ofrojnë kontakte të vlefshme me realitetin shoqëror rreth e qark dhe, që edhe në nivel strukturor, të jenë ideuar si vende të hapura, në të cilat të rinjtë mund të lëvizin lirisht. Për këtë, nevojitet edhe një specializim dhe trajnim i mëtejshëm i të gjithë personelit, që punon brenda këtyre instituteve, duke nisur nga oficerët e policisë së burgjeve e deri te edukatorët dhe drejtorët e institutit, specializim për të garantuar një formim të përshtatshëm për realitetin e veçantë të të dënuarve adoleshentë.

*Si përfundim*, edhe aktivitetet e vogla trajnuese duhet të karakterizohen nga ky specializim, duke ju përshtatur realitetit subjektiv të një adoleshenti delikuent. Për të realizuar të gjitha këto, do të ishte me vend ekzistenca e burgjeve dedikuar vetëm të miturve, për faktin, se çdo njeri që i nënshtrohet dënimit me burgim (apo çfarëdo mase tjetër) është i ndryshëm dhe, prandaj trajtimi duhet t'i përshtatet veçantive subjektive, duke arritur për të gjithë të njëjtat rezultate : riedukim dhe rishoqërim.

## KREU V

### Vendime gjyqësore të formës së prerë

#### 5.1. E drejta e ankimit si e drejtë themelore e individit

Konventa për të Drejtat e Fëmijës<sup>305</sup>, por jo vetëm<sup>306</sup>, parasheh të drejtën e ankimit, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të individit kundër një vendimi të organit kompetent, në një instancë gjyqësore më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, edhe në nenin 43 të Kushtetutës së RSH, që reflekton zbatimin korrekt të normës ndërkombëtare, parashikohet se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë<sup>307</sup>. Edhe KPP, parashikon ankimin dhe rekursin në instancat më të larta gjyqësore, sipas çështjes konkrete<sup>308</sup>.

Ndryshimet e fundit ligjore në Kodin e Procedurës Penale<sup>309</sup> për të pandehurit e mitur kanë përcaktuar, se dispozitat procedurale penale të parashikuara në këtë Kod, janë të zbatueshme edhe për të pandehurit e mitur, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligjin e posaçëm në fuqi<sup>310</sup>. Gjithashtu, një ndër ndryshimet thelbësore në kodin e procedurës penale, lidhur me të pandehurin e mitur, është garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të të miturit, duke trajtuar në mënyrë të posaçme çdo proces që lidhet me të<sup>311</sup>.

<sup>305</sup> Neni 40/2(b).

<sup>306</sup> Shih nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

<sup>307</sup> Konkretisht nenin 43, i KRSH parashikon në katalogun e të drejtave dhe lirive themelore të individit, kryesisht në kreun II, “Liritë dhe të drejtat vetjake”, se : “*...Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës...*”.

<sup>308</sup> Nenet 249 dhe 407, të Kodit të Procedurës Penale.

<sup>309</sup> Ligji nr.35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

<sup>310</sup> Fjala është për ligjin nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

<sup>311</sup> Neni 58/a “Të drejtat e viktimës së mitur”, të ligjit nr.35/2017, ka përcaktuar shprehimisht se: ‘*...Përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe parashikimeve të tjera të këtij Kodi, si dhe legjislacionin e posaçëm për të miturit, viktimat e mitur ka të drejtë:*

*a) të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;*

*b) të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;*

*c) të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.*

*Organi procedues duhet të trajtojë viktimën e mitur të veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm. Nëse ekziston mundësia që viktimat është e mitur dhe mosha e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur. Viktimat e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kritereve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktimat e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedis të përshtatura për të....”.*

### **5.1.1. Trajtimi i të miturit në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale**

Nga një analizë e legjislacionit në fuqi, për aktet ligjore e nënligjore, për drejtësinë për të miturit, vërejmë se Kodi Penal, lidhur me personat e mitur trajton:

#### **➤ *Të miturin si të dëmtuar/viktimë të veprës penale dhe konkretisht:***

- Neni 50, vepra penale e kryer kundër të miturit përbën rrethanë rënduese;
- Neni 79, vrasja me dashje e të miturit;
- Neni 83, kanosja serioze për gjakmarrje ndaj një të mituri;
- Neni 100, marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me të mitur;
- Neni 101, marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç;
- Neni 108, vepra të turpshme;
- Neni 109/2, rrëmbimi ose mbajtja peng e të miturit
- Neni 117, pornografia;
- Neni 124, braktisja e fëmijës së mitur
- Neni 125, mosdhënia e mjeteve për jetesë,
- Neni 127, marrja e padrejtë e fëmijës;
- Neni 128, trafikimi i fëmijëve
- Neni 129, shtytja e të miturve në krim.

#### **➤ *Të miturin si subjekt/autor të veprës penale***

Lidhur me këtë një vend të veçantë zënë dispozitat që kanë të bëjnë me rregullat për:

- moshën për përgjegjësi penale;
- diferencimet në caktimin e dënimit të të miturve të akuzuar për vepra penale;
- masat edukuese për të miturit;
- dënimet alternative.

Kodi i Procedurës Penale, për personat e mitur, të proceduar penalisht parashikon garancitë procedurale të të pandehurit të mitur, të cilat bazohen në një sërë aktesh ndërkombëtare e kombëtare<sup>312</sup>. Më konkretisht, në të gjejnë pasqyrim, parime të njohura të tilla si:

- prezumimi i pafajësisë<sup>313</sup>;
- e drejta për një proces të rregullt ligjor<sup>314</sup>;
- gjykimi i të miturve prej seksioneve përkatëse të të miturve<sup>315</sup>;
- e drejta për t'u njohur me akuzat;
- e drejta për të heshtur;
- e drejta e mbrojtjes, e ndihmës juridike dhe psikologjike;
- e drejta për të pyetur a ballafaquar me dëshmitarë ;

### **5.1.2. Statistika**

Në kuadër të legjislacionit shqiptar, i mitur konsiderohet çdo shtetas, i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeç. Përveç argumentave dhe analizës së sipërcituar mbi instrumentat kombëtare dhe ndërkombëtare, që ndikojnë në tërësi, në procesin ligjor të një të pandehuri të mitur dhe të të miturve viktime, në nivel kombëtar, kam realizuar analizën e dispozitave penale mbi të miturit, që i përkasin moshës 14 deri në 18 vjeç, të veçuar sipas gjinisë, në meshkuj dhe femra.

Analizë kjo, e parë në kontekstin e legjislacionit penal kombëtar, duke shtjelluar në bazë të statistikave të realizuara në vitin 2015, nenet e Kodit Penal, të prekura më së shumti, nga të miturit, në përputhje me vazhdimësinë në rritje apo në ulje të kryerjes së veprave penale<sup>316</sup>.

---

<sup>312</sup> Shih KDF, KEDNJ, rregullat e OKB-së, Kushtetutën e RSH-së, të cilat i kemi trajtuar me hollësi në kapitujt pararendës të këtij punimi.

<sup>313</sup> Shih nenin 4, të ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale të RSH”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “...*I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit...*”.

<sup>314</sup> Shih nenin 42, të KRSH-së, ku në mënyrë të posaçme përcaktohet se: “...*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor...*”.

<sup>315</sup> Shih nenin 13, të KPP-së, i cili parashikon se: “...*Gjykimi i të miturve bëhet nga gjyqtarë të kualifikuar për këtë gjykim, të ngarkuar posaçërisht edhe me këtë detyrë...*”.

<sup>316</sup> Të dhënat e përdorura për realizimin e grafikëve, sipas analizës së mbështetur në legjislacionin penal, janë të dhëna zyrtare të marra në Ministrinë e Drejtësisë.




### ***Kreu I i Kodit Penal***

|  |
|--|
| <b><i>Të dhëna për të pandehur</i></b>     |
| <b><i>Gjinia të mitur( 14-18 vjeç)</i></b> |

Në grafikun korrespondent, është paraqitur Kreu I i Kodit Penal, që përmban veprat penale përkatëse dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015:

- ✓ **Genocidi** (neni 73 i KP)
- ✓ **Krimet kundër njerëzimit** (neni 74 i KP)
- ✓ **Shpërndarja kompjuterike e materialeve pro genocidit/krimeve kundër njerëzimit** (neni 75 i KP)
- ✓ **Krimet e luftës** (neni 75 i KP)


Në dispozitat e sipërpërmendura, në bazë të statistikave të realizuara nga Vjetari Statistikor për vitin 2015, nuk rezulton që të miturit e kësaj grupmoshe, të kenë kryer këto vepra penale korrespondente.



***Kreu 1***

*Të dhëna për të dëmtuar  
viktima*

*Gjinia të mitur( 14-18 vjeç)*



**Kreu II i Kodit Penal**

**(Seksioni 1\_k2)**

***Të dhëna për të pandehur.***

***Gjinia të mitur( 14-18 vjeç)***

Në grafikun korrespondent, është paraqitur Kreu II i Kodit Penal, që përmban “ **Veprat penale kundër personit**”, **Seksioni i Parë “Krime kundër jetës të kryera me dashje”** dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015:

✓ **Veprat penale kundër personit**

(109 meshkuj të mitur/ 5 femra & 114 në total)

✓ **Seksioni i Parë “Krime kundër jetës të kryera me dashje”**

(22 meshkuj të mitur/ 0 femra & 22 në total)

✓ **Vrasja me dashje-Tentativa**

(Neni 76-22 KP) & (3 meshkuj të mitur/ 0 femra & 3 në total)

✓ **Vrasja me paramendim**

(Neni 78/1 KP) & (4 meshkuj të mitur/ 0 femra & 4 në total)


✓ **Vrasja e funksionarëve publikë**

(Neni 79/a KP) & (1 mashkull i mitur/ 0 femra & 1 në total)

✓ **Kanosja.**

(Neni 84 i KP) & (13 meshkuj të mitur/ 0 femra & 13 në total)

Në dispozitat e sipërpërmendura, në bazë të statistikave të realizuara nga Vjetari Statistikor për vitin 2015, përveç veprave penale të sipërcituara nuk rezulton që të miturit e kësaj grupmoshe, të kenë kryer vepra e tjera penale, të parashikuara në këtë seksion.



**Kreu II i Kodit Penal**

**(Seksioni 2\_k 2 / Seksioni 3\_k2 / Seksioni 4\_k2 / Seksioni 5\_k2)**

|  |
|--|
| <b><i>Të dhëna për të pandehur.</i></b>    |
| <b><i>Gjinia të mitur( 14-18 vjec)</i></b> |

Në grafikun korrespondent, është paraqitur Kreu i dytë i Kodit Penal, (Seksioni 2\_k 2 / Seksioni 3\_k2 / Seksioni 4\_k2 / Seksioni 5\_k2) që përmban. “ **Krime kundër jetës, shkaktuar me pakujdesi**”, “**Vepra Penale të kryera me dashje kundër shëndetit**”, “**Vepra Penale, kundër shëndetit, të kryera nga pakujdesia**” dhe “ **Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin, nga ndërprerja e shtatëzaniës ose mosdhënia e ndihmës**” dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015:

✓ **Seksioni i Tretë “ Krime kundër jetës, shkaktuar me pakujdesi”**

(60 meshkuj të mitur/ 3 femra & 63 në total)


✓ **“Plagosja e lehtë me dashje”**

(Neni 89 KP) (42 meshkuj të mitur/ 2 femra & 44 në total)

✓ **“Ndërpreja e shtatëzaniës pa pëlqim të gruas”**


(Neni 93 KP) & (1 mashkull i mitur/ 0 femra & 1 në total)

Në dispozitat e sipërpërmendura, në bazë të statistikave të realizuara nga Vjetari Statistikor për vitin 2015, përveç veprave penale të sipërcituara nuk rezulton që te miturit e kësaj grupmoshe, të kenë kryer vepra e tjera penale, të parashikuara në këtë seksion.



(Seksioni 2\_k 2 / Seksioni 3\_k2 / Seksioni 4\_k2 / Seksioni 5\_k2)

Të dhëna për të dëmtuar viktima  
 Gjinia të mitur( 14-18 vjeç)





**(Seksioni 6\_k 2)**

|                                     |
|-------------------------------------|
| <i>Të dhëna për të pandehur.</i>    |
| <i>Gjinia të mitur (14-18 vjec)</i> |

Në grafikun korrespondent, është paraqitur **(Seksioni 6\_k 2)** që përmban **“Krime seksuale”** dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015:

✓ **Seksioni i Gjashtë “Krime seksuale”**

(8 meshkuj të mitur/ 2 femra & 10 në total)

✓ **“Marrëdhënie seksuale/homoseksuale me të mitur”**

**(Neni 100/1 KP) (Neni 100/2 KP)**


(1 mashkull i mitur/ 2 femra & 3 në total) & ( 1 mashkull i mitur/ 0 femra & 1 në total)

✓ **“Marrëdhënie seksuale/homoseksuale, me dhunë, me të mitur të moshës 14-18 vjec”**

✓ **“Vepra të turpshme”**

(Neni 108/1 KP) & (2 meshkuj të mitur/ 0 femra & 2 në total)


Në dispozitat e sipërpërmendura, në bazë të statistikave të realizuara nga Vjetari Statistikor për vitin 2015, përveç veprave penale të sipërcituara nuk rezulton që të miturit e kësaj grupmoshe, të kenë kryer vepra e tjera penale, të parashikuara në këtë seksion.



(Seksioni 6\_k 2)

Të dhëna për të dëmtuar viktima

Gjinia të mitur( 14-18 vjeç)



**(Seksioni 7\_k 2)**

*Të dhëna për të pandehur*

*Gjinia të mitur(14-18 vjeç)*

Në grafikun korrespondent, është paraqitur **(Seksioni 6\_k 2)** që përmban, “**Vepra penale kundër lirisë së personit**” dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015:

✓ **Seksioni i Shtatë “ Vepra penale kundër lirisë së personit”**


(2 meshkuj të mitur/ 0 femra & 2 në total)

✓ **“Heqja e paligjshme e lirisë”**

**(Neni 110/2 KP)**


(2 meshkuj të mitur/ 0 femra & 2 në total)

Në dispozitat e sipërpërmendura, në bazë të statistikave të realizuara nga Vjetari Statistikor për vitin 2015, përveç veprave penale të sipërcituara nuk rezulton që të miturit e kësaj grupmoshe, të kenë kryer vepra të tjera penale, të parashikuara në këtë seksion.



(Seksioni 7\_k 2)

Të dhëna për të dëmtuar viktima  
Gjinia të mitur( 14-18 vjeç)



**(Seksioni 8\_k 2)**

*Të dhëna për të pandehur.*  
*Gjinia të mitur( 14-18 vjec)*

Në grafikun korrespondent, është paraqitur **(Seksioni 8\_k 2)** që përmban “ **Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit**” dhe ecurine e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015:

✓ **Seksioni i Tetë “ Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit”**

(5 meshkuj të mitur/ 0 femra & 5 në total)


✓ **“Prostitucioni”**

**(Neni 113/1 KP) (Neni 113/2 KP)**

(1 mashkull i mitur/ 0 femra & 1 në total) & (1 meshkuj të mitur/ 0 femra & 1 në total)

✓ **Seksioni i Nëntë “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”**


(11 meshkuj të mitur/ 0 femra & 11 në total)



(Seksioni 9\_k2 / Seksioni 10\_k2 )

*Të dhëna për të pandehur.*

*Gjinia të mitur( 14-18 vjec)*






(Seksioni 8\_k 2 / Seksioni 9\_k2 / Seksioni 10\_k2 )

Të dhëna për të dëmtuar viktima

Gjinia të mitur( 14-18 vjeç)



**Kreu III i Kodit Penal**

**(Seksioni 1\_k3)**

*Të dhëna për të pandehur*

*Gjinia të mitur( 14-18 vjeç)*


Në grafikun korrespondent, është paraqitur (Seksioni 1\_k 3), që përmban “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015:

✓ “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”

(455 meshkuj të mitur/ 7 femra & 462 në total)

✓ Seksioni i Parë “Vjedhja e pasurisë”

(430 meshkuj të mitur/ 7 femra & 437 në total)




(Seksioni 2\_k3)

*Të dhëna për të pandehur*  
*Gjinia të mitur( 14-18*  
*vjeç)*

Në grafikun korrespondent, është paraqitur (Seksioni 2\_k 3), që përmban “ **Mashtrimet**” dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015:

✓ “ **Mashtrimet**”


(3 meshkuj të mitur/ 0 femra & 3 në total)



(Seksioni 3\_k 3 / Seksioni 4\_k 3)

*Të dhëna për të pandehur*  
*Gjinia të mitur( 14-18*  
*vjeç)*


Në grafikun korrespondent, është paraqitur (Seksioni 3\_k 3/Seksioni 4\_k3), që përmban “**Shkatërrimi i pronës**”, “**Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare**” dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015.



(Seksioni 5\_k 3 / Seksioni 6\_k 3/ Seksioni 7\_k3)

|                                     |
|-------------------------------------|
| <i>Të dhëna për të pandehur</i>     |
| <i>Gjinia të mitur( 14-18 vjeç)</i> |


Në grafikun korrespondent, është paraqitur (Seksioni 5\_k 3 / Seksioni 6\_k 3/Seksioni 7\_k3) që përmbajnë “Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare”/“Krime në fushën e doganave”/“Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet” dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015.



(Seksioni 8\_k 3 / Seksioni 9\_k 3/ Seksioni 10\_k3/Seksioni 11\_k3)

*Të dhëna për të pandehur*  
*Gjinia të mitur( 14-18*  
*vjeç)*

Në grafikun korrespondent është paraqitur (Seksioni 8\_k 3/Seksioni 9\_k 3/Seksioni 10\_k3/Seksioni 11\_k3) që përmbajnë “Falsifikimi i dokumentave”/ “Krime Vepra penale në fushën e falimentimit”/ “Zhvillimi i palejuar i lojrave te fatit” dhe “ Vepra penale që cënojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve” dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015.




**Kreu VIII i Kodit Penal**  
**(Seksioni 3\_k8) ( Neni 261-269)**

***Të dhëna për të pandehur***  
***Gjinia të mitur( 14-18***  
***vjeç)***

Në grafikun korrespondent, është paraqitur Kreu i VIII i Kodit Penal, që përmban “**Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike**” dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015:

✓ **Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike**

(333 meshkuj të mitur/ 5 femra & 338 në total)



**(Seksioni 3\_k8) ( Neni 270-293 d)**

|                                     |
|-------------------------------------|
| <i>Të dhëna për të pandehur.</i>    |
| <i>Gjinia të mitur( 14-18 vjec)</i> |

✓ Vetëgjyqësia

(Neni 277 KP) & (3 meshkuj të mitur/ 0 femra & 3 në total)

✓ Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit

( Neni 278/2 KP) & (6 meshkuj të mitur/ 1 femra & 7 në total)

✓ Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit


( Neni 278/3 KP) & (2 meshkuj të mitur/ 0 femra & 2 në total)

✓ Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit

( Neni 278/4 KP) & (16 meshkuj të mitur/ 0 femra & 16 në total)

Në dispozitat e sipërpërmendura, në bazë të statistikave të realizuara nga Vjetari Statistikor për vitin 2015, përveç veprave penale të sipërcituara nuk rezulton që të miturit e kësaj grupmoshe, të kenë kryer vepra e tjera penale, të parashikuara në këtë seksion.






**(Seksioni 4\_k8)**

*Të dhëna për të pandehur*  
*Gjinia të mitur( 14-18*  
*vjeç)*

Në grafikun korrespondent, është paraqitur Kreu i tetë i Kodit Penal, që përmban, “**Veprat penale kundër sekretit dhe rendit shtetëror**” dhe ecurinë e kryerjes së këtyre veprave, nga grupmosha 14-18 vjeç, meshkuj dhe femra, në vitin 2015:

✓ **Veprat penale kundër sekretit dhe rendit shtetëror**

(4 meshkuj të mitur/ 0 femra & 4 në total)



## 5.2. Të dhëna statistikore të institucionit të prokurorisë për të pandehurit e mitur në konflikt me ligjin, 2013-2015

Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë në strukturën dhe organikën e saj, ndërmjet drejtorive, ka edhe një sektor të rëndësishëm, atë të studimeve dhe statistikës. Si burime të informacionit, të përmendura në këtë punim, kanë shërbyer të dhënat e marra nga informacionet periodike 3 mujore të prokurorisë të rretheve, që përcillen në këtë institucion dhe që përpunohen çdo vit. Ne kemi shfrytëzuar statistikat e viteve 2013-2015, për të miturit dhe kemi bërë analizën e fenomenit juridik, në harmonizim me moshat e tjera të të pandehurve<sup>317</sup>. Duhet të theksojmë se, këto statistika zyrtare janë më të besueshme se statistikat e Ministrisë së Brendshme, jo vetëm për skemën objektive dhe shkencore, por edhe se në analizë të fundit ato janë të matshme, pasi për çdo rast, ka një dosje përkatëse me të gjithë dinamikën dhe mënyrën e përfundimit të çështjes. Këto statistika zyrtare janë një detyrim karshi publikut (por jo vetëm), sepse ato përmbushin respektimin në praktikë të një prej të drejtave dhe lirive themelore të individit, atë të së drejtës për informim, mbi bazën e domosdoshmërive të përcaktuara mirë, si dhe janë më efikente në drejtim të vendimmarrjeve të duhura.

Vëllimi dhe dinamika e krimeve të kryera nga të miturit marrin përgjigje më të plotë në analizimin e të dhënave të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ato të Ministrisë së Drejtësisë, pasi metodika e mbledhjes së këtyre statistikave është e tillë, që të dhënat për të miturit si subjekte të veprës penale, i trajton vetëm në cilësinë si të dënuar ose si të hetuar të mitur dhe jo si dinamikë e procedimit penal, gjatë hetimeve paraprake apo shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pra të dhënat për të mitur nuk i trajton në harmoni me dosjen hetimore ose gjyqësore, për arsye të kompleksit të të akuzuarve në çështje.

Ndërmjet tre institucioneve që menaxhojnë të dhënat për kriminalitetin, policia është hallka e parë, por jo më e rëndësishmja. Është hallka e parë, pasi ajo ndeshet fillimisht me ngjarjen apo faktin kriminal dhe nuk është më e rëndësishmja, sepse e dhëna nuk ka saktësi të madhe, që do të thotë se ajo është “e dhënë rrugë” e shpesh herë raportohet si e tillë, por nuk merr rrugën e duhur ligjore për t’u trajtuar.


---

<sup>317</sup> Konkretisht, shih raportin e Prokurorit të Përgjithshëm, për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2015, botim i marsit të 2016-ës. [www.pp.gov.al](http://www.pp.gov.al)

*Çertifikimin përfundimtar të të dhënës e jep procesi gjyqësor, pasi gjykata është i vetmi organ, që shpall fajtor ose dënon kryerjen e krimit.*

Referuar të dhënave statistikore të marra nga institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme, për gjendjen e kriminalitetit, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me të pandehurit e mitur në vitet 2013-2015:

Kështu, të mitur të hetuar për periudhën 2013-2015 janë sipas tabelës grafike më poshtë:




**Burimi: Prokuroria e Përgjithshme - Raport i Prokurorit të Përgjithshëm, për kriminalitetin për periudhën 2013-2015**

Në lidhje me të pandehurit e mitur, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2013, rezultojnë 911 të pandehur të mitur të hetuar, në vitin 2014, rezultojnë 1013 të pandehur të mitur ose 11 % më shumë se në vitin 2013 dhe, në vitin 2015, rezultojnë 978 të pandehur të mitur ose 3,5 % më pak se në vitin 2014.

Të miturit e dërguar në gjyq për vitin 2015 janë 849 ose 1,3 % më pak se në vitin 2014, gjatë të cilit i janë dërguar gjyqit 860 të pandehur të mitur.


Në lidhje me të pandehurit e mitur të dënuar nga gjykata, nga të dhënat statistikore rezulton, se gjatë vitit 2015 janë dënuar 758 të pandehur të mitur që përbën rritje prej 1,3 % në krahasim me vitin 2014, gjatë të cilit janë dënuar 748 të pandehur të mitur.

Në mënyrë të përmbledhur, grafiku prezanton të dhënat si vijon:



Për sa i përket kriminalitetit të të miturve në konflikt me ligjin, për veprën penale të vrasjes, për çdo vit ka të dënuar të mitur. Pavarësisht, numrit më të vogël të të miturve, të përfshirë në këtë vepër penale, në raport me veprat e tjera penale të sipërpërmendura, përfshirja e tyre në këtë vepër me rrezikshmëri të lartë shoqërore, është një dukuri dhe si e tillë, ajo duhet vlerësuar nga të gjitha institucionet e shtetit dhe shoqëria, si një dukuri që duhet minimizuar sa të jetë e mundur.

Nëpërmjet grafikut të mëposhtëm prezantohen të dhënat sipas veprave penale:



Nga të dhënat e grafikut, rezulton se për *veprën penale të vjedhjes së pasurisë*, ajo përbën grupveprat penale të kryera më së shumti nga të miturit e moshës 14 deri 18 vjeç, e konkretisht, nga 46 % e të pandehurve të mitur.

Një vepër tjetër penale, për të cilën janë regjistruar 24 % e të pandehurve të mitur është ajo e *“Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”*.

Lidhur me *veprat penale kundër personit*, rezulton se 10 % e të miturve kanë kryer vepra penale drejtuar personit. Por, në vite ka edhe të dënuar të mitur për vrasje të cilësuar, të parashikuara nga nenet 78 e 79, të Kodit Penal.


Për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, *“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”* janë regjistruar 3 % e të pandehurve të mitur.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, *“Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”* janë regjistruar 3 % e të pandehurve të mitur.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal, *“Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”* janë regjistruar 1 % e të pandehurve të mitur.

Pjesa tjetër e të miturve të regjistruar e hetuar kanë kryer vepra penale të tjera, të cilat të veçuara nuk kanë peshë specifike të veçantë brenda totalit.

Grafiku në vijim paraqet të dhënat për veprat penale të kryera nga të pandehurit në vitet 2014-2015, ku siç e shikojmë, veprat e kryera më së shumti në të dy vitet janë vjedhja e pasurisë e cila në vitin 2015 rezulton me rritje prej 4 %:




**Lidhur me caktimin e dënimit për të pandehurit e mitur 14 deri 18 vjeç gjatë vitit 2015** rezulton, se është kërkuar për 385 të pandehur të mitur caktimi i dënimeve alternative, kryesisht pezullimi i vendimit të dënimit me burg dhe vënia në provë, ndërsa në vitin 2014 është kërkuar caktimi i dënimeve alternative për 345 të pandehur të mitur, e shprehur në përqindje një rritje prej 12 % krahasuar me vitin 2014 dhe 30% krahasuar me vitin 2013. Ndërsa, kërkesat e prokurorit për caktimin e dënimit me burg<sup>318</sup> kanë ardhur duke u ulur çdo vit, ku të dhënat tregojnë se në vitin 2015 janë ulur 10% krahasuar me vitin 2014 dhe 26% krahasuar me vitin 2013.

Tabelat na ndihmojnë si vijon:

<sup>318</sup> Në shifrën e përmendur, nuk përfshihet aplikimi i nenit 53 të Kodit Penal, ulja e dënimit nën minimum ose caktimi i një dënimi më të butë se ai që parashikon dispozita.

## Dënime alternative




## Kërkesa të prokurorit për dënim me burg



### *Pasojat e veprave penale për vitin 2015*

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me pasojat në dëm të jetës e shëndetit, të regjistruara në 3 vitet e fundit:





Në lidhje me pasojat e veprave penale në dëm të jetës, në vitin 2015 rezulton, se numri i vdekjeve ka qenë 23 % më i ulët se në vitin 2014, në vitin 2014 rezulton se numri i vdekjeve ka qenë 22,7 % më i ulët se në vitin 2013.


Pasoja nga veprat penale në dëm të shëndetit “plagosje e rëndë”, rezulton në vitin 2015 ka pësuar rritje prej 5 % në krahasim me vitin 2014 dhe në vitin 2014 ka pësuar ulje prej 37 % në krahasim me vitin 2013.

Me ulje rezulton në vitin 2015 edhe numri i plagosjeve të lehta me 32 % krahasuar me vitin 2014, në vitin 2014 numri i plagosjeve të lehta rezulton me ulje prej 21 % krahasuar me vitin 2013.


Në shifrat e mësipërme përfshihen pasojat në dëm të jetës dhe të shëndetit të personave, për çdo fakt të dyshuar kriminal të hetuar, pavarësisht nga mënyra e përfundimit të procedimit rreth tij.


Të dhëna të detajuara për pasojat e ardhura nga veprat penale konkrete, paraqiten në grafikët e mëposhtëm:

## Vdekje



## Plagosje e rëndë





*Si përfundim, gjatë shqyrtimit të këtyre të dhënave, vërehet se fillimisht, të dhënat e policisë së shtetit paraqesin një tablo më të zgjeruar se realiteti, por më pas këto të dhëna “shfryhen” paksa nga prokuroria dhe marrin formë reale në gjykatë.*

Institucionet e sistemit të drejtësisë për të mitur, prokuroria dhe gjykata do të vazhdojnë të ndjekin një politikë penale të përshtatshme ndaj të miturve, që akuzohen për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, si në caktimin e masave të sigurimit, ashtu edhe në aplikimin e dënimeve alternative.

## 5.2. Probleme të hasura në praktikë

Në praktikën e përditshme dalin një sërë problemesh, gjatë proceseve penale ndaj të miturve. Këto probleme lidhen me legjislacionin, me ushtrimin e ndjekjes penale, me praktikën gjyqësore, si dhe me ekzekutimin e vendimeve penale ndaj të miturve. Në rradhë të parë, do të fokusohemi tek masat edukuese që ndërmerren ndaj të miturit, që nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe atë, që sapo e ka mbushur këtë moshë. Duke patur parasysh, që mosha më delikate për zhvillimin psiko-social të të miturit është adoleshenca e hershme, kur formohet karakteri i tij, pikërisht, është kjo moshë, në të cilën është shumë e mundshme, kalimi drejt rrugës së kriminalitetit. Ndaj, për të miturit e moshës nën 14 vjeç, që kryejnë vepra penale, duhet të merren masa edukuese, në mënyrë që ai të riedukohet dhe të riintegrohet në shoqëri, si një individ me parime morale. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh që të miturit e prirur ndaj kriminalitetit, janë ata që kanë probleme në familje, pra që nuk u kushtohet kujdesi i duhur dhe nuk u jepet edukimi i nevojshëm.

Nga analiza e legjislacionit dhe zbatimit praktik të tij rezulton, se masa “*dënim me burg*” në rastin e të miturit, që ndjek procese edukative do të sjellë vështirësi në realizimin e këtij procesi. Ndërkohë, që sipas standardeve ndërkombëtare, të përmendura në kapitujt pararendës, “*dënimi me burg*” duhet të jetë masa e fundit në praktikën gjyqësore, që duhet të aplikohet ndaj një të mituri, në realitet rezulton që nuk është ku duhet të jetë. Ajo çka të bie më shumë në sy është që aplikimi i masës së dënimit me burg, kundrejt masave të tjera është në një nivel relativisht të lartë<sup>319</sup>.

Për t’a ilustruar, referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për një çështje me të pandehur të mitur, të akuzuar për vjedhje me dhunë të kryer në bashkëpunim, rezulton se:

Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2888, datë 2.9.2015, në ngarkim të të pandehurit R.K., akuzuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes me dhunë të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139 dhe 25 i Kodit Penal dhe në zbatim të nenit 51, të Kodit Penal, ka vendosur deklarin fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij me 4 vite e 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406, të K.Pr.Penale, i pandehuri ka përfituar ulje me 1/3 e dënimit dhe është dënuar me 3 vjet burgim. Këtë dënim ai duhet ta vuajë në një nga burgjet për të miturit.

---

<sup>319</sup> Materiale të referuara në sesionin trajnues “Zbatimi i masave të sigurimit ndaj të miturve” organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me UNICEF. 22-23 janar 2007.

Gjykata e Apelit Tiranë, pasi mori në shqyrtim këtë çështje, si dhe duke i vlerësuar provat në harmoni me njëra tjetrën, vlerësoi se kjo veprë penale, nga ana objektive është konsumuar nga të pandehurit me përdorimin e dhunës dhe në bashkëpunim me njëri tjetrin, por i pandehuri R.K ka qenë më aktiv në realizimin e veprës penale. Për sa më sipër, Gjykata e Apelit e ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, në llojin e dënimit të të pandehurit R.K. dhe ka zbatuar drejt kërkesat e neneve 47-57, të KP. Në këto rrethana, Gjykata e Apelit nuk gjen shkaqe ligjore për zbutjen e masës së dënimit për të pandehurin e mitur R.K., pasi ajo mban në konsideratë rrezikshmërinë e lartë shoqërore të veprës penale (vjedhja), karakteristikat dhe personalitetin e sjelljes së të pandehurit, të kaluarën e tij kriminale, duke dëshmuar kështu, se ai nuk është përmirësuar në sjelljen e tij dhe nuk ka reaguar pozitivisht ndaj dënimit. Pra, ***nuk është arritur qëllimi i riedukimit të tij me ndjenjën e respektimit të ligjit dhe moskryerjen në të ardhmen të veprave të tjera penale***, ndaj Gjykata ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, duke e lënë në burg të miturin R.K.<sup>320</sup>.

Në një rast tjetër, Gjykata e Apelit Tiranë, në një ndër çështjet me të pandehur të mitur, për veprën penale “Vjedhje e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentavë, “Prodhim, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, ka arsyetuar si vijon:

Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2549, datë 7.7.2015, të saj ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit E.V., për veprën penale të “Vjedhje e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë dhe, në bazë të neneve 134/2 e 22 e 51, të K.P.dhe dënimin e tij përfundimtar me 1 vit e 8 muaj burgim. Këtë dënim ai duhet ta kryejë në një burg të sigurisë së zakonshme, seksioni për të mitur.

Në vlerësimin e saj, Gjykata e Apelit Tiranë konstatoi se gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë kishte gabuar në mosaplikimin e nenit 59 të Kodit Penal<sup>321</sup>, duke mos e pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim për të pandehurin e mitur E.V. Në këtë rast, Kolegji i

---

<sup>320</sup> Shih vendimin 30-2016-4780, datë 21.9.2016, për çështjen me nr.53107-03287-30-2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>321</sup> Më konkretisht, neni 59, i KP, parasheh se: “...Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënimin me burg deri në 5 vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet. Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit...”.

Gjykatës së Apelit vlerësoi, se alternativat e vuajtjes së dënimit me burgim, u drejtohen autorëve të veprave penale që:

- shkelin për herë të parë ligjin;
- nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe,
- vepra penale në ngarkim të tyre nuk është shumë e rëndë.

Ky Kolegj, në arsyetimin e tij vlerësoi, se alternativa e dënimit me burgim kërkon që të ekzistojnë të vërtetuara disa rrethana njëherazi, në mënyrë që të zbatohet nga ana e gjykatës. Në vijim duhet që:

- ***Së pari***, personi, autor i veprës penale dhe bashkëjetesa e tij në gjendje të lirë në komunitet e shoqëri, të paraqesë rrezikshmëri të ulët;
- ***Së dyti***, duhet të provohet që për shkak të moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, dënimi me burgim do t'i shkaktonte dëme të mëdha, të pariparueshme dhe jo proporcionale të dënuarit, në raport me qëllimin e nevojës së ndëshkimit të tij, parandalimit të përgjithshëm apo të posaçëm dhe riedukimit të tij. Sipas gjykatës, dënimi me burg në këtë rast, rezulton joefektiv dhe joefikas;
- ***Së treti***, Kolegji çmon se kushti tjetër që duhet të plotësohet është “... ***prania e rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale...***”, që lehtësojnë rrezikshmërinë e veprës në eventualitetin sikur ajo ka ndodhur (psh: ekzistenca e disa rrethanave lehtësuese që konkurojnë njëra tjetrën dhe njëkohësisht mungesa e rrethanave rënduese);
- ***Së fundmi***, Kolegji çmoi se të gjitha kushtet e mësipërme duhet të përmbushen njëherazi, pasi ato kanë natyrë kumulative.

Për sa i takon rrezikshmërisë shoqërore të të pandehurit të mitur E.V., nisur nga rrethanat e kryerjes së veprës penale, mekanizmit të kryerjes së saj, Gjykata e Apelit çmoi, se ajo nuk paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore, si dhe personaliteti i të dënuarit, qëndrimi pendues i tij, i padënuar më parë, të qenit i mitur, nxënës shkolle, gjendjes ekonomike jo të mirë, përbëjnë faktorë determinantë në aplikimin e nenit 59, të Kodit Penal. Në vijim, Gjykata e Apelit vlerësoi, se izolimi i të pandehurit të mitur nga shoqëria, do të passillte dëm shumë të madh në jetën e tij dhe të familjes së tij dhe, kjo nuk do të ndihmonte fare në përmbushjen e qëllimit për riedukim, rehabilitim e rishoqërizim të tij.

Nisur nga këto rrethana dhe për të gjithë arsyetimin e sipërpërmendur, Gjykata e Apelit vendosi pezullimin e vendimit të dhënë nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, për dënimin me burg të të pandehurit E.V., për një kohë prove prej 2 vjetësh me kushtin, që gjatë kësaj kohe ai të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës<sup>322</sup>.

Shembujt ilustrues që trajtuam më lart, i sollëm në vëmendje për mënyrën e argumentimit nga ana e gjykatës në aplikimin ose jo, të alternativës së dënimit me burgim. Të dy vendimet e sipërpërmendura janë për rastet e zakonshme dhe parashtrimi i tyre në funksion të këtij studimi është thjesht për llojin e dënimit të dhënë.

Në gjykimin tim, në të dy rastet, vendimi i Gjykatës së Apelit është i drejtë. Gjithashtu, edhe argumentimi i bërë prej saj në vendim, për aplikimin ose jo të alternativës së dënimit me burgim, është i gjerë dhe i plotë.

I përmenda këto shembuj, për të theksuar idenë, se jo gjithmonë mund të aplikohet alternativa e dënimit me burgim për të mitur. Megjithatë, rëndësi ka që gjykata, si në rastin kur e aplikon, ashtu edhe kur nuk e aplikon, duhet të argumentojë rrethanat, kushtet dhe kriteret për aplikimin ose jo të kësaj alternative.

Referuar praktikës gjyqësore, konstatojmë se ka mjaft raste, që masat e sigurimit që caktohen për të mitur, janë të papërshtatshme. Në disa prej tyre, gjykata nuk mban parasysh mos ndërprerjen e proceseve edukative, duke caktuar si masë sigurimi “*arrest në burg*” për të mitur që janë nxënës shkolle. Qëndrimi i gjykatës për caktimin e masave të sigurimit ndaj të miturve disa herë është subjektiv. Brenda të njëjtës gjykatë ka qëndrime të ndryshme: për të njëjtën vepër penale ndaj të miturve caktohen masa të ndryshme sigurimi. Në vendimet për caktimin e masave të sigurimit ndaj të miturve, përgjithësisht nuk pasqyrohet asnjëherë administrimi i ndonjë dokumenti rreth statusit “nxënës në shkollë” të autorit të mitur, gjendjes familjare të tij, gjendjes psikologjike apo shëndetësore, personalitetit, përveç rasteve kur ai ja paraqet vetë gjykatës këto. Në vendimet për caktimin e masave të sigurimit ndaj të miturve, po ashtu, nuk pasqyrohet marrja e të dhënave mbi kushtet e jetës personale, familjare dhe shoqërore të të miturit, si kërkesë e nenit 42/1 të KPP. Kjo gjë pothuajse nuk bëhet në seancën e caktimit të masës së sigurimit.

---

<sup>322</sup> Shih vendimin nr.30-2016-6302, datë 30.11.2016, nr.çështjes 53101-02940-30-2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë.



Në shumë raste në caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” ndikon masa e lartë e dënimit, që parashikojnë dispozita penale, të cilat konsumohen shpesh nga të miturit në konflikt me ligjin. Mund të përmendim këtu veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283 i K.P., e cila parashikon në minimum një dënim me 5 vjet burgim. Po kështu, edhe mbajtja pa leje e armëve të zjarrit dhe armëve të ftohta, me ndryshimet që ju bënë K.Penal në vitin 2012, parashikonte një dënim penal në minimum 7 vjet për armën e zjarrit dhe 3 vjet për armët e ftohta<sup>323</sup>. Këto marzhe dënimi nuk përshtateshin aspak me rrezikshmërinë shoqërore të veprave përkatëse dhe kjo situatë u zgjidh me ndërhyrjen e Gjykatës Kushtetuese<sup>324</sup>, e cila uli marzhet e dënimit, gjë që u pasqyrua edhe në ligjin penal.

Marzhet e larta të dënimit justifikojnë, që ndaj delikuentit të mitur, nga gjykata caktohet shpesh masa e sigurimit “*arrest në burg*”, masë e cila bëhet shkak për ndërprerjen e procesit edukativ, mësimor dhe formues të të miturit, duke ndikuar në shumë raste negativisht në zhvillimin psiko-motor të tij.

Edhe për veprën penale në fushën e narkotikëve, mendoj që është e nevojshme diferencimi në masën e dënimit për drogërat e lehta dhe sasitë e vogla. Ky diferencim do t'i krijonte hapësirat e nevojshme ligjore organeve të drejtësisë, për caktimin e masave të sigurimit më të buta, si dhe caktimin më shpesh të dënimeve alternative në përfundim të gjykimit.

---

<sup>323</sup> Neni 278, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, ndryshuar me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 98, datë 31.7.2014; shtuar dy paragrafë me ligjin nr. 135/2015, datë 5.12.2015; ndryshuar me ligjin nr. 82/2016, datë 25.7.2016. Neni 279 “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, edhe ky i ndryshuar disa herë.

<sup>324</sup> Shfuqizuar paragrafët i pestë dhe i gjashtë, me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.2.2016, e cila vwrrejti se : “*...Bazuar në analizën historike të dispozitës, në parim, Gjykatës i rezulton se ligjvënësi është mbështetur thellësisht në strategjinë e ndërhyrjes ndëshkuese, e karakterizuar posaçërisht nga parashikimi i instrumenteve ashpërsuese, sikundër është rritja e marzheve minimale dhe maksimale të dënimit dhe përpjekja për të parashikuar të gjitha rastet dhe rrethanat e mundshme të prodhimit dhe të mbajtjes së të gjitha kategorive të armëve, municioneve luftarake, bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, në automjet, në mjete të motorizuara, në mjedise publike apo mjedise të hapura për publikun. Në këto kushte, Gjykata gjen me vend të sjellë në vëmendje qëllimin e dënimeve penale në një shoqëri demokratike dhe parimet që duhet të udhëheqin ligjvënësin në caktimin e dënimeve penale. Në përputhje me frymën e Kushtetutës, sanksioni penal i cfarëdolloj natyre duhet të synojë vetëm riedukimin dhe më pas integrimin e të dënuarit në jetën shoqërore. Gjykata, duke pasur parasysh edhe doktrinën e konsoliduar evropiane në këtë fushë, ka theksuar se që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë edhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer (shih vendimin nr.19, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata vëren se ndryshimet e ndërmarra nga ligjvënësi në dispozitat objekt shqyrtimi (por edhe të tjera të shqyrtuara më parë nga kjo Gjykatë), kanë qenë përgjithësisht spontane, nisur nga synimi për të luftuar kriminalitetin, por pa iu nënshtruar më parë studimeve të thelluara për të shmangur prishjen e balancave jo vetëm midis masave të dënimit të veprave penale të një kapitulli, por edhe në raport me veprat e tjera penale, në varësi të rrezikshmërisë shoqërore të tyre. Një qasje (strategji) e tillë e gabuar ka deformuar strukturën e Kodit Penal, duke krijuar disproporcione të pashpjeguara (paarsyeshme) midis dënimeve të parashikuara për vepra të ndryshme të Kodit, në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës dhe të proporcionalitetit, në rastet e kufizimit të të drejtave dhe lirive të individit...”, botuar në FZ. Nr.31, datë 29.02.2016, fq.2492.*



Problemi nuk qëndron vetëm tek aplikimi i dënimit me burgim për të miturit, por edhe me kushtet e ekzekutimit të dënimit me burgim. Kështu, në momentin e parë të arrestimit të të miturit, në ambientet e policisë, nuk bëhet fjalë për kushte të veçanta, ku mund të vendoset i mituri, që të mos jetë në kontakt me persona të rritur, me një përvojë të pasur kriminale. Gjithashtu, dhe në paraburgim, është bërë një ndarje në seksione, por nuk mund të evitohet kontakti i të miturit me elemente kriminelë të rritur, në ambientet e ajrosjes apo ambiente të tjera të përbashkëta. Ka edhe raste mbipopullimi të paraburgimit, kur të miturit vendosen në seksione të zakonshme bashkë me të rriturit. Për sa i përket institucioneve të vuajtjes së dënimit, situata është pak më mirë. Kështu, të miturit vuajnë dënimin në institucione apo seksione të veçanta nga të rriturit dhe atyre u plotësohen shumë nga kushtet, që parashikohen në ekzekutimin e dënimit për të miturit. Ata kanë asistencën e psikologut, apo punonjësit social, kanë kushte argëtimi e zbavitje dhe mundësi takimi me të afërmit. Le për të dëshiruar procesi edukativ-mësimor në këto institucione dhe procesi i trajnimit, nëpërmjet punës. Gjithsesi, vitet e fundit vërehet një zhvillim pozitiv në drejtim të trajtimit të të dënuarve me burgim në përgjithësi dhe të të miturit në veçanti.

Lidhur me personat e mitur, të cilët nuk kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale, legjislacioni i ri i drejtësisë penale për të mitur parashikon disa masa edukuese, të cilat praktikisht nuk mund të zbatohen. Përmendim këtu një nga masat, që është vendosja e të miturit në një institucion riedukimi (neni 46 i Kodit Penal) dhe në vendin tonë nuk ka institucione të tilla.

Institucionet e riedukimit janë një nevojë imediate, jo vetëm për të miturit deri në 14 vjeç, por edhe për të miturit mbi këtë moshë, që kryejnë vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore. Vendosja e këtyre të miturve në institucione riedukimi do të kishte një efekt shumë të rëndësishëm në socializimin dhe integrimin shoqëror të këtyre individëve. Praktika ka treguar, që një person i mitur, deri sa mbushi moshën 14 vjeç<sup>325</sup> kreu qindra vjedhje në Korçë dhe në Tiranë, vjedhje, të cilat u provuan që u kryen prej tij dhe moshatarëve të tij. Për këtë, me kërkesën e organit të akuzës, gjykata ka vendosur masë edukuese, e cila nuk kishte ku të ekzekutohej dhe i mituri vazhdonte rrugën kriminale. Kjo masë do të ishte shumë efektive për të mitur, që kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale, ndryshe nga masat e dënimit me gjobë apo me burg që janë caktuar për ta.

---

<sup>325</sup> Bëhet fjalë për të miturin me iniciale S.S

Në përfundim të kësaj analize ajo që mund të themi është, se sistemi i drejtësisë në Shqipëri, ende ka një *përqasje ndëshkuese ndaj të miturve* në konflikt me ligjin. Ky sistem, në një masë të madhe ende i *pakonsoliduar*, nuk arrin të marrë parasysh nevojat e të miturve për mbrojtje, në respekt të të drejtave të tyre njerëzore dhe dinjitetit, megjithë hapat pozitivë që po ndërmerren këto vite e fundit<sup>326</sup>. Numri i fëmijëve që kanë kaluar nga paraburgimi gjatë viteve të mëparshme, përgjithësisht ka qenë i paqëndrueshëm. Megjithatë, në vitin 2015 (208 raste), ka patur një rënie të dukshme (rreth 40%) në krahasim me vitin 2014 (338 raste). Ditët e qëndrimit aty kanë pësuar rënie vetëm në vitin 2015, me një mesatare prej 125 ditësh (krahasuar me 140 në 2014)<sup>327</sup>.

---

<sup>326</sup> Që prej vitit 2009, me prezantimin e Shërbimit të Provës, jepen dënime alternative deri në 58% të rasteve të të miturve, shih raportin për Axhendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

<sup>327</sup>DPB (2015). Të dhëna statistikore. marrë nga <http://www.dpbsh.gov.al/newweb/aksesuar> në 5 shtator 2016.

## KREU VI

### *1. Përfundime dhe rekomandime*

Intensiteti dhe ashpërsia e veprave penale të të miturve përgjithësisht përcaktohen nga kushtet shoqërore, ekonomike dhe kulturore që mbizotërojnë në një vend. Ka dëshmi të një rritjeje në shkallë botërore për sa i përket delikuencës së të miturve, e evidentuar kjo paralelisht me rënien ekonomike, veçanërisht në rrethinat – getot e varfra të qyteteve të mëdha. Në shumë raste, fëmijët e rrugës bëhen shkelës të rinj, pasi kanë hasur në dhunë në mjedisin e tyre familjar, shkollor, në komunitet a gjetkë, si dhe mund të jenë në pozitë të dëshmitarit në një vepër penale ose viktimë të akteve të dhunshme. Arritjet arsimore të këtij grupi janë mjaft të ulëta dhe përvoja sociale bazë, e përfutur në familje është shumë shpesh e pamjaftueshme dhe nën nivelin mesatar të shoqërisë dhe, mjedisi socio-ekonomik përcaktohet nga varfëria dhe papunësia.

Në shumë prej vendeve të BE-së, rritje e kriminalitetit të të miturit ka ardhur si pasojë e rritjes së varfërisë, gjendjes së keqe ekonomike dhe rritjes së papunësisë. Gjithashtu, edhe kriza e përgjithshme e tranzicionit në vendet e Evropës Qendrore e Lindore (por jo vetëm), ku kalimi nga një ekonomi e centralizuar, në një ekonomi të hapur të tregut, u shoqërua me rritjen e sjelljes kriminale të të miturit, për shkak edhe të dobësimit të strukturave shoqërore të socializimit, të tilla si: familja, sistemi arsimor, institucionet e ofrimit të shërbimeve shoqërore, etj.

Delikuenca të të miturit në rajonin tonë është e lidhur ngushtësisht me faktorë ekonomikë, të tillë si: papunësia e të rinjve dhe prindërve, gjendja e keqe ekonomike dhe varfëria në shumë prej familjeve me të ardhura nën minimumin jetik, si dhe modeli patriarkal i jetesës në familje, ku prindërit ushtrojnë presion në mënyrë të vazhdueshme për kufizimin e lirive të veprimit e mendimit për këta të rinj.

Edhe në Shqipëri, sikurse në shumë vende të zhvilluara, nën ndikimin e akteve ligjore ndërkombëtare, standardeve dhe rregullave të administrimit të drejtësisë për të mitur, po i kushtohet gjithnjë e më shumë rëndësi të drejtave dhe lirive themelore, krijimit të kushteve të mira të jetesës dhe zhvillimit të shëndetshëm të brezit të ri.

Miratimi i ligjit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur në vendin tonë, i hap rrugë vendosjes së urave të bashkëveprimit, koordinimit dhe komunikimit institucional, ndërmjet të gjithë organeve kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, duke shmangur kështu një herë e mirë fragmentarizimin e përgjegjësive dhe minimizimin e mosmarrëveshjeve, si pasojë e mungesës së kuadrit ligjor, që sanksiononte rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit në këtë drejtim.

Ndërsa, detyrë parësore për *ligjvënësit* është garantimi në legjislacionin e drejtës për të gjithë fëmijët, viktimat dhe dëshmitarët në një veprë penale, për të marrë asistencën e duhur, përfshirë, sipas rastit, asistencë mjekësore, psikologjike, sociale ose asistencë të një lloji tjetër, në fazën më të hershme, pas zbulimit të veprës penale dhe përcaktimi i modaliteteve për ofrimin e saj. Kështu, ligji i ri për drejtësinë penale për të mitur ka përcaktuar edhe organe/persona të tjerë, të specializuar në drejtësinë për të mitur, të cilët marrin të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme, për hartimin e programeve të trajnimit dhe të regjistrimit të trajnuarve, duke e përditësuar atë në vazhdimësi.

Gjithashtu, *organizatat jofitimprurëse* që veprojnë në këtë fushë *duhet të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me autoritetet shtetërore*, për ofrimin e asistencës së duhur fëmijëve viktimat dhe dëshmitarët, për shembull, duke krijuar *qendra për mbrojtjen e fëmijës*, të *bashkëpunojnë ngushtë me policinë dhe institucionin e prokurorisë, të nxisin mekanizmat mbrojtës dhe mbështetës me bazë komuniteti*, që mund t'ju shërbejnë fëmijëve të përfshirë në procese gjyqësore, si dhe *të zhvillojnë veprimtari* që ndihmojnë për rritjen e rolit mbështetës të kujdestarëve të fëmijëve viktimat.

Ndër mekanizmat e duhur, për largimin e të miturve nga rruga e kriminalitetit është *krijimi i mundësive për ndjekjen e shkollave të arsimit e formimit profesional*, për profesione të ndryshme, si psh: marangoz, hidraulik, teknik ndërtimi, etj. Natyrisht, që bashkëpunimi e bashkëveprimi ndër-institucional, ndërmjet të gjithë organeve ligjzbatuese, agjencive shtetërore, OJF-ve, komunitetit, familjes, bën të mundur orientimin e të miturve drejt integritetit në shoqëri.

Në këtë studim, u përqëndrova në trajtimin e legjislacionit penal për të miturit në Shqipëri, në kuadër të një vështrimi historik dhe aktual, në trajtimin e institucioneve të ndjekjes penale, të gjyqimit dhe të ekzekutimit të dënimeve penale, në trajtimin e dukurisë së kriminalitetit tek të miturit në vendin tonë dhe në masat që mund dhe duhet të merren për parandalimin e tij,

në trajtimin e institucioneve të vuajtjes së dënimit, si dhe të institucioneve të mbikqyrjes së dënimeve alternative. Nga studimi dhe puna kërkuese, *arrijmë në përfundimin se legjislacioni, sistemi gjyqësor dhe i vuajtjes së dënimit, për të miturit në Shqipëri, megjithë progresin e dukshëm të shënuar vitet e fundit, ka ende shumë punë për të bërë.*

Edhe në të drejtën penale, në kuadrin e një procesi evolimi historik të pakthyesëm, trajtimi i të mitur në konflikt me ligjin, ka pësuar ndryshime pozitive. *Trajtimi i të miturve në konflikt me ligjin, duhet të jetë në përputhje me konventat ndërkombëtare, me standardet e një “procesi të drejtë”, të mbajë në konsideratë parimin e “interetit më të lartë të fëmijës” dhe, me një procedurë të ndryshme nga të rriturit. Për këtë, legjislacioni i drejtësisë penale për të miturit parashikon dënime alternative dhe dënime me burgim, më të buta se të rriturit dhe trajtim të veçantë në kuadrin procedural.*

Në Shqipëri është bërë progres në administrimin e drejtësisë për të miturit, për t’u bërë sistemin sa më njerëzor, duke *ofruar garanci ligjore dhe procedurale*, dhe duke kaluar nga *një sistem ndëshkues në një sistem me një qasje të drejtësisë që edukon dhe riintegron*. Kështu, përpara se i mituri të kryejë veprimtari kriminale, është e nevojshme edukimi i tij ligjor në një gjuhë të kuptueshme dhe të thjeshtë. *Ky edukim duhet bërë praktikë e shpeshtë*, me qëllim shmangien e minimizimin e dukurive kriminale.

Kështu, në kuadrin ligjor në fuqi, një ndër institucionet shtetërore, Shërbimi i Provës, në përmbushjen e veprimtarisë së tij administrative, ka marrë një mision të ri ligjor, atë të *realizimit të mbikqyrjes elektronike, në funksion të kontrollit të zbatimit të urdhërimeve që përmban një vendim gjyqësor*, që cakton një nga alternativat e dënimit me burgim, dënim plotësues, një nga llojet e masave shtrënguese, apo një urdhër mbrojtjeje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje<sup>328</sup>. Kjo masë, mbikqyrja elektronike e largon tërësisht të miturin nga rruga e burgut dhe nga trajtimi me burg, duke e shmangur në këtë mënyrë burgun si masë alternative të edukimit të të miturit. Ata të mitur, që janë gjendur në rrethana kriminale, në rrethana të shkeljes së ligjit nuk është e nevojshme të trajtohen në IEVP, si të rriturit apo njësoj me ta, por, ata mund të akomodohen në Shërbimin e Provës, në mënyrë që të ritrajtohen në pjesën e mbetur me Shërbimin e Provës. Edhe pse, ky Shërbim Prove nuk është krijuar enkas për të miturit, por për mbikqyrjen e dënimeve alternative në përgjithësi, *kjo është një e metë e legjislacionit, pasi shumë më efikase për të miturit do të ishte mbikqyrja*

<sup>328</sup> Shih nenin 1, të ligjit nr.10494, datë 22.12.2011, “Për mbikqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

*nga shërbimi i kujdestarisë, që do të ishte i specializuar për të miturit, për të kuptuar sa më drejt problemet dhe reagimin e tyre ndaj vendimit të gjykatës, si dhe t'u vinte në ndihmë prindërve në kontrollin e të miturit.*

Edhe në ligjin e ri të drejtësisë penale për të mitur, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2018, parashikimi i masave alternative dhe i masave të edukimit si sanksione jopenale ndaj kryerësve të mitur të veprave penale, përbën një prioritetet, ku së bashku me pjesëmarrjen e Shërbimit të Provës dhe organin e kujdestarisë, të cilët në bashkëpunim me prindërit e të miturit, prokurorin dhe gjykatën, në ekzekutimin e tyre, e bëjnë këtë ligj, ndër më të arriturit e rajonit e më gjerë, pasi privimi i lirisë, përkatësisht **dënimi me burgim i të miturit, është paraparë, jo vetëm si mjet i fundit, por dhe i kufizuar në afat shumë të shkurtër.** E tërë fryma që përshkon Kodin, parimet e sanksionuara në të, të drejtat dhe garancitë procedurale të të miturit në konflikt me ligjin, trajtimi i të miturit viktimë apo dëshmitar në një vepër penale, janë plotësisht në përputhje me Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës, Rregullat e Pekinit, të Tokios, e një sërë dokumentesh të tjera ligjore, që do të thotë se **trajtimin e delikuentëve të mitur në procesin penal e bën në përputhje me standardet më bashkëkohore të së drejtës penale dhe kriminologjisë.**

Ligji i drejtësisë penale për të miturit ka bërë një ndarje të llojeve të dënimeve për të miturit, duke i ndarë në dy grupe: **dënime jo me burgim**, ku përfshihen kufizimi i lirisë, qëndrimi në shtëpi, gjoba, kryerja e një pune me interes publik, përmbushja e detyrimeve të caktuara dhe ndalimi për kryerjen e një veprimtarie, si dhe dënime me burgim. Gjithashtu, ligji ka bërë edhe klasifikimin dhe caktimin e dënimeve për të mitur në : **dënime kryesore**, ku përfshihen burgimi, kufizimi i lirisë dhe gjoba. Ndërsa, si **dënime plotësuese**: ndalimi për kryerjen e një veprimtarie, kryerja e një pune me interes publik, përmbushja e detyrimeve të caktuara dhe qëndrimi në shtëpi.

Gjithashtu, ligji parashikon edhe **masat e drejtësisë restauruese** dhe **masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale** që janë si vijon: programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, këshillimi për të miturin dhe familjen, paralajmërimi me gojë, paralajmërimi me shkrim, masat detyruese dhe vendosja nën kujdes.

Kodi i ri i drejtësisë penale për të mitur ka parashikuar aplikimin e **masave të sigurimit të veçanta për të miturit** (vendosja nën mbikqyrje apo vendosja në një shërbim të specializuar),

me qëllimin e garantimit të qenies prezent të të miturit, sa herë që kjo kërkohet nga gjykata, prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore.

Edhe deri më tash, në Kodin Penal, janë parashikuar disa dënime alternative, të cilat nuk janë enkas për të miturit, por që mund të aplikohen gjerësisht për ta. Këtu përmendim: gjysmëliria, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë, qëndrimi në shtëpi, etj. *Këto dispozita parashikojnë dënime alternative, me aplikimin e të cilave, për të miturit, mund të realizohet qëllimi socializues dhe riedukues i dënimit, shumë më mirë nga cdo të mund ta realizonte dënimi me burgim.* Pjesa më pozitive e këtyre dënimeve alternative, *qëndron te vënia në provë e të dënuarit, duke e detyruar të ushtrojë një profesion, të mos kryejë një veprim të caktuar apo të ndjekë me rigorozitet procesin arsimor.*

Për sa i përket legjislacionit procedural penal, mund të themi që ai është i kompletuar nga ana formale. *Ky legjislacion, parashikon trajtimin e vecantë të të miturit, njoftimin e prindërve, asistencën profesionale ligjore dhe asistencën e psikologut. Problemet hasen në praktikë tek trajtimi i vecantë i të arrestuarit të mitur, nga punonjësit e policisë, te masat e sigurimit të ashpra, të caktuara për ta.* Gjithashtu, *probleme ka dhe me asistencën ligjore të garantuar nga shteti,* ku realisht avokatët pa përvojë nuk sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të të miturit. Edhe **psikologët** që merren nga gjykata për të dhënë një vlerësim të karakterit të të pandehurit, *nuk është se thellohen në krijimin e një portreti psikologjik të tij dhe mendimi i tyre nuk ka patur ndonjë ndikim të rëndësishëm në vendimin e gjykatës.*

Mungesa e gjykatave të posaçme për të miturit në sistemin tonë gjyqësor është shoqëruar me probleme, duke bërë që sistemi i drejtësisë penale për të miturit të ketë paqartësi dhe pasaktësi në thelbin e tij. Kritikën në drejtim të administrimit të drejtësisë për të miturit prej gjyqësorit janë të lidhura me të meta, mangësi apo paqartësi të kuadrit ligjor dhe institucional. *Ligji material dhe ai procedural në këtë drejtim paraqet mangësi, profesionalizmi i gjyqësorit nuk është i arrirë, pasi ky sistem aktualisht, i bazuar në seksione, nuk trajton me seriozitetin dhe etikën e duhur një rast që ka të bëjë me drejtësinë për të miturit apo rasti nuk menaxhohet në mënyrën e duhur,* etj. Është punuar dhe po punohet për kualifikimin e gjyqtarëve të këtyre seksioneve, që të jenë sa më pranë botëkuptimit dhe problemeve të të miturve, në mënyrë që të bëjnë një vlerësim të drejtë të rrezikshmërisë së veprës dhe të të miturit në konflikt me ligjin, në mënyrë që të jepen vendime sa më të drejta dhe favorizuese. Krahas seksioneve për të mitur në gjykata, janë

krijuar seksione për të mitur dhe në prokuroritë e këtyre rretheve gjyqësorë, me qëllim kualifikimin e tyre në veprat penale, që kryhen nga të miturit.

Tashmë, specializimi dhe trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve që i dedikohen këtyre seksioneve, është një detyrim ligjor që buron, edhe nga Kodi i Ri i Drejtësisë Penale për të Miturit, miratuar me ligjin nr.37/2017 dhe që hyri në fuqi më 1 janar 2018.

Ashtu, sikurse parashikohet edhe në këtë Kod, *gjyqtarëve u duhet dhënë hapësirë dhe nuk duhen paragjykuar për dënimet alternative apo të buta, të dhëna për të miturit, sic ka ndodhur në praktikë.*

*Përsa i përket institucioneve të vuajtjes së dënimit për të miturit, ekziston kuadri ligjor për rregullimin e tyre, por praktikisht ka shumë mangësi.* Problemet serioze konstatohen, sidomos *në parburgim, ku nuk plotësohen kushtet e nevojshme për jetesë të të miturve.* Në këto institucione, për shkak të mbipopullimit, mund të vendosen të parburgosurit e mitur me ata të rritur dhe problemet në parburgim janë aq të mëdha, sa nuk mund të flitet për riedukim apo risocializim të të miturit. Ka vetëm *një institucion të vuajtjes së dënimit në Kavajë, ndërsa seksione të parburgimit për të mitur ka vetëm në Lezhë dhe Vlorë.* Në to plotësohen pothuajse disa prej kushteve të nevojshme për jetesën, mbarëvajtjen dhe riedukimin e të miturit.

*Pra, lidhur me parburgimin dhe institucioneve të vuajtjes së dënimit, mbetet shumë për të bërë,* por me asistencën e shumë institucioneve ndërkombëtare, ky problem është duke u trajtuar gjithnjë e më shumë dhe mendoj se do të ketë një zgjidhje të shpejtë.

Për sa i përket aksesit në drejtësi, sipas studimit të realizuar nga zyra rajonale e UNICEF – it dhe IDLO, 95% e fëmijëve shqiptarë të pyetur dhe familjet e tyre janë shprehur se i njohin të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve, ndërkohë që kishin shumë më pak njohuri *për forumet gjyqësore, mekanizmat apo rrugët,* që mund të përdornin për të kërkuar të drejtat. Fëmijët shqiptarë kishin mësuar për këto kryesisht nga shkolla dhe mediat<sup>329</sup>. Për këtë arsye, *edukimi ligjor i fëmijëve që në fazat e para të jetës, ndër të tjera duke përmirësuar kurrikulat për arsimimin të tyre është një domosdoshmëri*<sup>330</sup>.

<sup>329</sup> UNICEF CEE/CIS dhe IDLO (2015). Aksesit i barabartë i fëmijëve në drejtësi: studim rajonal në Shqipëri, Gjeorgji&Kyrgyzstan.marrë://www.unicef.org/ceecis/Equitable\_çëss\_to\_justice\_for\_children\_in\_Central\_and\_Eastern\_Europe\_and\_Central\_Asia\_-\_v2\_1.pdf e aksesuar në 15 qershor 2016.

<sup>330</sup> Po aty, theksohet se fëmijët përballen me një sërë barrierash për të aksesuar materialisht sistemin e drejtësisë.



Në Shqipëri, më shumë se në vendet e tjera, fëmijët përballen me pengesa si: mungesa e legjitimitetit të pavarur, kufizime financiare, distanca fizike nga gjykatat/institucionet, mungesa e informacionit dhe e mbështetjes, mungesa e besimit ndaj institucioneve, pranimi kulturor i dhunës në familje, perceptimi për vendin e fëmijëve në familje etj.

Gjithashtu, jo rrallë procesi i drejtësisë për të miturit nuk është i përshtatshëm dhe miqësor për fëmijët. Janë bërë përpjekje për të ngritur kapacitetet e gjyqtarëve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë, megjithatë kanë qenë sporadike. Me qëllim promovimin e dhënies së dënimeve alternative për të miturit dhe riintegrimin e tyre në shoqëri, ***është e nevojshme të hartohen programe integrimi në komunitet, të forcohen më tej zyrat e shërbimit të provës përmes ngritjes/përmirësimit të kapaciteteve të punonjësve të shërbimit të provës***. Realizimi i programeve integruese dhe riintegruese të qëndrueshme ka si qëllim uljen e nivelit të recidivizmit për fëmijët e përfshirë në sistemin e paraburgimit.

Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, lind nevoja e përmirësimit të përmbajtjes dhe procedurave të administrimit të drejtësisë për të miturit<sup>331</sup>, e bërë kjo edhe në frymën e ndryshimeve të fundit të legjislacionit dhe reformimit të të gjithë sistemit të drejtësisë.

Përfundimisht, mund të themi se për sa i përket trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin, viktima dhe apo dëshmitarë në një vepër penale, mbetet akoma më shumë për tu bërë.

Përveç, sistemit të burgjeve dedikuar të miturve, është padyshim i nevojshëm një vullnet politik i adresuar arritjes së këtij qëllimi. I mituri në konflikt me ligjin nuk duhet të shihet si një barrë që duhet mbajtur apo një viktimë e shoqërisë që duhet ndihmuar, por përkundrazi, si një burim i rëndësishëm, përmes një rrugëtimi (ri)edukativ të përshtatshëm dhe efikas, ku të miturit mund t'i krijojnë të gjitha kushtet e nevojshme, që ai të jetë pjesë integrale dhe aktive e shoqërisë. Një trajtim i kësaj natyre, mund të bëjë që vlerat, mbi të cilat bazohet shoqëria mos të perceptohen më si të huaja dhe të largëta. Ky objektivi është më i realizueshëm për një të mitur, se një të rritur.

---

<sup>331</sup> UNICEF (2014). A survey of children resident in public and non – public institutions in Albania. P. Evans and Future Center. E marrë nga [http://www.unicef.org/albania/sq/2014-Albania\\_stock\\_flow\\_analysis\\_report\\_ver3.pdf](http://www.unicef.org/albania/sq/2014-Albania_stock_flow_analysis_report_ver3.pdf) e aksesuar në 15 qershor 2016.

Edhe investimet financiare, të nevojshme për realizimin e programeve të posaçme të trajtimit, nuk do të perceptohen nga shoqëria si shpenzime të “*humbura*”, por si investim që bëhet për këtë gjeneratë, që është edhe e ardhmja e shoqërisë.

Kjo pikëpamje duhet të ndahet jo vetëm nga institucionet politike, por nga të gjithë organet/personat kompetentë, pasi, vetëm nëse është një kontakt dhe shkëmbim i vazhdueshëm, midis të dënuarve dhe botës së jashtme trajtimi (ri)edukues mund të ketë mundësi suksesi.

Ky cilësim në procesin penal dhe në ekzekutimin e dënimit, i paraqitur nga organet shtetërore kompetente, që e sheh të miturin si burim për shoqërinë, mund të përfaqësojë vërtetë, fomën e parë të vlefshme të edukimit, që disa të mitur të caktuar mund të marrin.

***Fund!***

**Tiranë, janar 2018**

## BIBLIOGRAFI

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 21 tetor 1998.
2. Kodi Penal i RSH-së, 1995.
3. Kodi Penal i ish-RPSSH, Tiranë, 1952, marrë nga Biblioteka Kombëtare.
4. Kodi Penal i ish-RPSSH, Tiranë, 1977, marrë nga arkivi i shtetit.
5. Kodi i Procedurës Penale, 1995.
6. Ligji nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”, miratuar më 30.3.2017
7. Elezi,I, “E drejta penale”, pjesa e posacme, Tiranë, 2007.
8. “Compendio di Diritto Minorile”, VII Edizione, Edizione “SIMONE”, 2008.
9. “Elementi di Diritto Minorile – disciplina essenziale e nuovi orientamenti”, Edizione giuridiche “SIMONE”, 2008.
10. E drejta zakonore shqiptare, Tiranë, 1989.
11. Kambovski.V, “E drejta penale”, pjesa e përgjithshme, SHB “Furkan ISM”, Shkup, 2006.
12. Halili,R. “Kriminologjia”, Prishtinë, 2008.
13. Salihu,I. “E drejta penale për të mitur”, Prishtinë, 2005.
14. Ligji nr.253, datë 24.12.1946, “Mbi dispozitat e përgjithshme penale”, arkivi i Këshillit të Ministrave.
15. “Historia e Shqipërisë-II”, Tiranë, 1984.
16. Dervishi, K. “Historia e shtetit shqiptar, 1912-2005”, Tiranë, 2006.
17. Puto, A. “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare’, Tiranë, 1987.
18. Kodi Penal i Perandorisë Osmane, Tiranë, 1924, Biblioteka Kombëtare, S 12/46 D.
19. Islami. H, Hoxha. A, Panda., “Procedura penale”, komentat, Tiranë, 2003.
20. “Botim i Komisionit të Kremtimit të 25-vjetorit të Vetqeverimit, Shqipnija më 1931”, Tiranë, 1931.
21. Hysi. V, “Penalogjia”, Tiranë, 2006,
22. Hysi. V, “Kriminalogjia”, Tiranë, 2005.
23. “Gazeta zyrtare nr.1”, Tiranë, 1928, Biblioteka kombëtare.
24. “Mbi aplikimin e Kodit Penal Shqiptar”, miratuar me dekretin e 3.6.1927, arkivi i Këshillit të Ministrave, i njohur ndryshe si Kodi Penal i Zogut.
25. “Fletorja zyrtare”, nr.5, Tiranë, 1945, arkivi i Këshillit të Ministrave.
26. “Fletorja zyrtare”, nr.1, Tiranë, 1947, arkivi i Këshillit të Ministrave.

27. Kodi Penal i vitit 1948, arkivi i Këshillit të Ministrave.
28. Reka,B. “Doracaku për jurisprudencë”, Prishtinë, 2004.
29. Ligji për të miturit i Kosovës, 19.4.2004.
30. Rekomandime për drejtësinë për të miturit në Shqipëri, Avokati i Popullit, Tiranë, 2005.
31. “Raport mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në vendet e paraburgimit, gjatë periudhës nëntor 2007-mars 2008”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
32. Ligji nr.8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar.
33. Ligji nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të ndryshuar.
34. Ligji nr.8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
35. Ligji nr.9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
36. “Për emërimin e gjyqtarëve në lidhje me krijimin e seksioneve për çështje penale kundër të miturve”, Misioni “EURALIUS”.
37. Dekreti nr.5351, datë 11.6.2007, i Presidentit, “Për krijimin e seksioneve të vecanta penale për të miturit në 6 gjykata rrethi”.
38. “Përmbledhje aktesh ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut”, Tiranë, 2003.
39. “Juvenile Justice training project”, *OSCE Presence in Albania*, 2005.
40. Hall, Jerome, “General principles of criminal law”, Sec.ed, Indianapolis, 1960.
41. Hall, Jerome, Mueller, Gerhard, “Criminal law and procedure”, sec.ed, Indianapolis, 1960.
42. Mantovani, Ferrando, “Diritto Penale, parte generale”, quarta edizione, Padova, 2001.
43. Ancel, Marc et Strahl, Ivar, “Le droit penal des pays scandinaves”, Paris, 1969.
44. Sajiti, E. “E drejta e procedurës penale”, Prishtinë, 2005.
45. Elezi, I. Kacupi, S. Haxhia, M. “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë, 2001.
46. Allen, M. “Criminal law text book”, 1999, OUP.
47. “OXFORD – Dictionary of Law”, sixth edition, 2006.
48. “Vjetar statistikor”, botim i Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

49. “Direktivat e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Miturve-direktivat e Riadit”, OSCE Presence in Albania, 2005.
50. “Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur-Rregullat e Pekinit”, OSCE Presence in Albania, 2005.
51. Konventa “Për të drejtat e fëmijëve”, miratuar nga OKB, 20.11.1989.
52. “Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria”, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 14 dhjetor 1990.
53. Vjetar statistikor 2005, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë, 2006.
54. M.E.Wolfgang, T.P. Thornberry and R.M. Figlio, From Boy to Man, from Delinquency to Crime (Chicago, University of Chicago Press, 1987)
55. Covelli, M. “Manual di legislazione penale minorile”, satura editrice, 2006.
56. “Udhëzime mbi drejtësinë për të miturit viktime dhe të miturit dëshmitarë të krimeve”, Juvenile Justice Training, OSCE Presence in Albania, 2005.
57. “Sistemi gjyqësor për të miturit në Francë”, botim i Ministrisë së Drejtësisë franceze.
58. United Nations Guidelines for the Prevention of Juvenile Delinquency (The Riyadh Guidelines), adopted and proclaimed by General Assembly resolution 45/112 of 14 December 1990.
59. D. Gilmore, Manhood in the Making: Cultural Concepts of Masculinity (London, Yale University Press, 1990).
60. American Psychological Association, “Violence and youth: psychology’s response”, summary report of the APA Commission on Violence and Youth (Washington, D.C., 1993).
61. Parimet udhëheqëse ndërmjet agjencive për fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë, 2004, f. 47 .
62. United Nations, Centre for Social Development and Humanitarian Affairs, “The global situation of youth in the 1990s: trends and prospects”...
63. Udhëzuesit e Kombeve të Bashkuara për përdorimin e përshtatshëm dhe kushtet e kujdesit alternativ për fëmijët.
64. Mbretëria e Bashkuar, Institucioni i Prokurorisë së Kurorës, Ofrimi i terapisë për fëmijët dëshmitarë përpara gjyqimit të çështjes penale: “Udhërrëfyes për përvojën e mirë” (2001).
65. Kodi i Fëmijëve dhe Adoloshentëve, miratuar me ligjin nr.7739 (1998), neni 107 (b), Kosta Rika.

66. Drejtësia për të mitur në Shqipëri”, botim i UNICEF, BE dhe CRCA
67. Vendimi nr. nr.1071, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale”, botuar në FZ nr.239, fq.16304.
68. Lgjislacioni amerikan mbi të miturin në drejtësinë penale.
69. KSHH “Sistemi i drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri. Reflektime mbi të tashmen dhe të ardhmen e tij”, Tiranë 2005
70. Leonardi M., “Shkaqet dhe proceset e devijimit të të miturve”, PENNISI A, Drejtësia e të miturve: formimi, devijimi, ligji dhe gjyqi, Milan, Giuffre, 2004, pg.44, Manuali i sociologjisë, Torino, Utet 1994, fq.380
71. Cohen A.K., “Djemtë e paskrupullt”trad.en, Milano, Feltrinelli, 1963
72. Seria e manualeve për legjislacionin penal, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Kontrollin e Drogës dhe Parandalimin e Veprave Penale (UNDOC), OKB, New York, 2009
73. Ligji Federal i Zvicrës, “Për ndihmën për viktimat e veprave penale”, përmbledhje e legjislacionit federal (RS) 312.5, 1991, neni 5(3)
74. Udhëzuesit “Për procesin gjyqësor ku fëmijët përfshihen si viktima dhe dëshmitarë të veprës penale”, botim i UNDOC dhe UNICEF
75. Ligji nr.10494, datë 22.12.2011, “Për mbikqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”
76. Ligji nr.37/2017, “Kodi I Drejtësisë Penale për të Mitur”, FZ. Nr.92, fq.5210
77. Ligji nr.10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”
78. Ligji nr.9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, i ndryshuar , FZ nr.49, fq.1907
79. Vendimi nr.330, datë 28.5.2014, i KM-së, “Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013”, FZ nr.84, fq.3377
80. Vendimi nr.74, datë 27.1.2016, i KM-së, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2016-2020”, FZ nr.17, fq.1053
81. Vendimi nr.182, datë 13.3.2012, i KM-së, “Për miratimin e Planit të Veprimit për Fëmijë, 2012-2015”, FZ nr.39, fq.2155
82. Vendimi nr.42, datë 25.1.2017, i KM-së, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2017-2020”, FZ nr.12, fq.319
83. Vendimi nr.324, datë 12.4.2017, i KM-së, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2017”, FZ nr.86, viti 2016, fq.5091

84. Vendimi nr. nr.1071, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015–2020 dhe plani i veprimit të saj”, botuar në FZ nr.239, fq.16304.
85. Vendimi nr.372, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Axhendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020”, FZ.nr.100, fq.5598
86. MAZZA O., “Burimet evropiane të ligjit për burgjet e të miturve, në COPPETTA M.G. (redaktuar nga), Procedura Penale e Burgjeve për Minoritetet në Kartat Ndërkombëtare dhe Ligji Italian, Giuffrè, Milano, 2010 fq. 1-19
87. Qarkorja e ish-ministrit të Drejtësisë, V. E. Orlando, 11 maj 1908, cit./ Qarkorja nr.2236/29, cit., fq .766
88. Raporti ministror mbi draftin përfundimtar të një Kodi të ri Penal, në punën përgatitore për Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, vol.V, Romë, 1929, fq. 220.
89. Qarkorja e ish-ministrit Guardasigilli Rocco, nr.2236, datë 22 shtator 1929, në Buletinin Zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë, 1929, fq. 766.
90. A.C. MORO, “Manual mbi të drejtat e fëmijëve”, Bologna 2000, fq.379
91. Shënime ilustrative të Dekretit Mbretëror të 20 korrikut 1934, nr.1404, në institucionin dhe funksionimin e Gjykatës për të mitur në Riv.dir. Penit. 1934, II, fq. 802.
92. *Regio Decreto Legge* nr.1404, i 20 korrikut 1934, “Istituzione e funzionamento del tribunale per i minorenni- themelimi dhe funksioni i gjykatës për të miturit”, botuar në Gazetën Zyrtare, datë 5 shtator 1934, nr.208
93. Dekreti legjislativ nr.888/1956 ndryshon konkretisht nga nenin 25 i *Regio Decreto Legge* nr.1404, i 20 korrikut të 1934
94. *Regio Decreto Legge* nr.1404, i 20 korrikut 1934, “Istituzione e funzionamento del tribunale per i minorenni- themelimi dhe funksioni i gjykatës për të miturit”, botuar në Gazetën Zyrtare, datë 5 shtator 1934, nr.208 e kthyer në ligj me modifikimet e 27 majit 1935, nr. 835. *Presidenza e Këshillit të Ministrave: Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun dhe Punët e Rajonit, Circ. 5 dhjetor 1996, nr.8661*
95. Ligji nr.888, 25 korrik 1956, ishte ligji që ndryshoi *Regio Decreto Legge* nr.1404, 20 korrik 1934, për Tribunalin e të Miturve
96. Dekreti Presidential nr.448, i 22 shtatorit të 1988, Kodi i Procesit Penal për të Mitur

97. Covelli M., “Manuali i legjislacionit penal mbi të miturit”, Napoli, Satura, 2006., p.211
98. PALOMBA F., “Sistemi i procesit të ri penal të të miturve”, Milano, Giuffre editore, 1991, fq.381
99. Dekreti i Presidentit të Republikës nr.447/1988, Kodi i Procedurës Penale Italiane
100. PATANE V., “Konsensusi i të miturit në përmbylljen e përsheptuar, midis nevojave të garancisë së kundërshimitit dhe zgjatjes së arsyeshme, në Kasacionin penal”, 2002, fq.3405.
101. CARRARO E., “Falja gjyqësore e sistemit të ri të drejtësisë penale të të miturve”, 4/2008 fq.63
102. MANZINI V., “Traktati i të Drejtës Penale Italiane”, Torino, UTET, 1981 Vol III p.736
103. DOLCINI E.- MARINUCCI G., “E Drejta penale në transformin”, Milano, Giuffre, 1985, p.289
104. CIAVOLA A., “Specifikimi i formulave vendimarrëse të të miturit”, në ZAPPALA E. Jurisdiksioni i specializuar në drejtësinë penale të të miturve, Torino, Giappichelli, 2009, p.178.
105. SCIVOLETTO C., “Vënia në provë: një mundësi për të gjithë. Të nsim me disa reflektime në të Miturit në Drejtësi” nr.4/2005 suppl. fq. 133
106. LARIZZA S., “Përgjigjet e reja institucionale kundrejt kriminalitetit të të miturve”, në PALERMO FABRIS E., PRESUTTI A.,(redaktuar nga), Të Drejtat dhe procedura penale e të miturve në ZATTI P. (redaktuar nga) Traktati i të drejtës familjare, vol V, Milano, Giuffre, 2002 p.226
107. Dekreti Legjislativ nr.272, 28 korrik 1989, “Kodi i procesit penal për të mitur” në Itali
108. Ligji nr.354, i 26 korrikut 1975, “Rregullat për organizimin dhe funksionimin e burgjeve dhe zbatimin e privilegjeve dhe të masave të kufizimit të lirisë”, botuar në Gazetën Zyrtare nr.212, S.O., datë 9 gusht 1975.
109. PEPINO L., “Sistemi i burgjeve për të miturit: një çështje jo aktuale por e hapur, në AA. VV., Procesi penal i të miturve: cila reformë, për cilën drejtësi”, Milano, Giuffre, 2004, p.53
110. PENNISI A., “Ekzekutimi penal dhe masat e ndryshme nga burgimi. Drejtësia penale e të miturve: formimi, deviancat, e drejta dhe procesi”, Milano, Giuffre, 2004, fq.398



**Links:**

[www.hcch.net](http://www.hcch.net)

[www.ilo.org](http://www.ilo.org)

[www.city.ac.uk/icsl](http://www.city.ac.uk/icsl)

[www.cps.gov/juvenilecrime](http://www.cps.gov/juvenilecrime)

[www.un.org/speeches](http://www.un.org/speeches)

[www.un.org/articles/](http://www.un.org/articles/)

[www.doj/article/questionnaireonjuvenilecrime/2004](http://www.doj/article/questionnaireonjuvenilecrime/2004)

[www.unicef.org/statements](http://www.unicef.org/statements)

[www.who.org/statements.](http://www.who.org/statements)

[www.stch.gov.al](http://www.stch.gov.al)

[www.unhchr.ch/html/menu3/b/h\\_comp47.htm](http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/h_comp47.htm)

[www.icrc.org](http://www.icrc.org)

[www.crin.org/docs/Draft\\_UN\\_guidelines.pdf](http://www.crin.org/docs/Draft_UN_guidelines.pdf)

<http://codes.ohio.gov/orc/2152>

